




Padër Anton Harapi shikon qiellin për ndihmë...

GJYQI ME VDEKJE KUNDËR PATËR ANTON HARAPIT

Përgatiti **Astrit Jegeni**



Përgatiti Astrit Jegeni

Patër Anton Harapi

Regjenti në përballje me drejtësinë komuniste

Pjesa e Parë


Periudha e okupacioni fashist të Shqipërisë



Parakalimi i trupave ushtarake Italiane në Bulevardin e Tiranës



Kinoteatër "Savoia". U filluan punimet nga qeveria shqip-tare në vitin 1939 dhe u përfundua nga pushtuesit italianët në vitin 1940 në vitin 1943 pushtuesit gjermanë ja ndryshuan emri në Kinoteatër "Kosova" . Regjimi komunist ja ndryshoi përsëri emërin duke e quajtur "Teatri Kombëtar". Sot nuk egziston.



Salla e Kinema "Kosova" e kthyer në sallë gjyqi




Interesimi i qytetarëve për të dëgjuar nga autoparlantët gjyqet politike të zhvilluara në Tiranë nga regjimi komunist

Për këtë studim materiali bazë është dosja hetimore-gjyqësore ndaj Regjentit Patër Anton Harapit, Regjentit Lef Nosit e Kryeministrit Maliq Bushatit, në shkrimin tonë jemi marrë vetëm me të dhënat që lidhen me akuzat, mbrojtjen e dënimin e Patër Anton Harapin, për këtë shkrim u studjuan dhe shumë materiale të tjera historike të cilat ishin të domosdoshme për të plotësuar e qartësuar të vërtetën në këtë proces gjyqësor.

Regjent = Ai që sundon përkohësisht (në një monarki) kur mungon mbreti ose kur mbreti është i mitur.

**“Salus Patriae Suprema Lex Est”
(Shpëtimi i Atdheut është ligj sipëror)**



Patër Anton Harapi

Për komunistët vrasja e kundërshtarëve politikë nuk ishte krim!!!!

Dosja A-1086 Hetimore - Gjyqësore e Patër Anton Harapi*

Fillimi i Proçesit Gjyqësor:
Sot, ditën dhe orën e caktuar,

Gjyqi u formua nga:
Major Irakli Bozo Kryetar
Major Tonin Jakova Anëtar
Major Gjon Banushi Anëtar



Misto Treska - Prokuror

Sot ditën e caktueme 31 Janar 1946 Gjykata e formueme si ma parë me pjesmarjen e prokurorit Major Misto Treska duke qenë i asistuar prej sekretarëve aspirant Thoma Rino e kapter Zalo Xhomaqi, filloi gjykimi i çështjes botërisht, faqësisht e me dyer të çelura në sallën e Kino-Teatër “Kosova”

U soll nga burgu i pandehuri Padër Anton Hara-pi dhe u vu në vendin e tij të posaçëm duke qenë i asistuar dhe nga përfaqësuesi i tij që u sipër shënuan.

Patër Anton Harapi i biri i Loros dhe i Luçisë vjeç 58, lindur në katundin Shirokë të Shkodrës, banoes në Shkodër, fetar

Prokurori: Patër Anton Harapi brënda në Kuvendin Françeskan bën pjesë në redaksinë e revistës “Hylli i Dritës” dhe propogandonte parullat e mëdha dhe helamtonjëse të fashizmit. Mashtronte popullin shqiptar për një “Shqipëri të Madhe”, i ngrinte lavde Duçes ¹ dhe Mbretit Viktor Emanuel ² nxiste popullin e Malsisë së Shkodrës për t’u mobilizuar kundra Malit të Zi n’interes të fashizmit italian (*Memorandumi i dërguar Duçes e Viktor Emanuelit nga popullsia Hot e Grudë, në Prill të vitit 1941 Shqipërisë i janë bashkuar Ulqini, Plava, Gucia, Rozhaja, Hoti, Gruda etj krahina, që sot janë pjesë e shtetit Malazes*) ³

I Pandehuri: Nuk i kam shkruar nonji letër asnji herë Musolinit ose Viktor Emanuelit. Unë deri në vjetin 1937 kam shkruar në “Hyllin i Dritës”⁴ por ma vonë s’kam shkruar. Mund të kem shkruar ndonji herë vetëm. Kam shkruar një herë për Luigj Gurakuqin⁵. “Hylli i Dritës” ka qenë organ i Franceskve dhe ky në disa raste e ka ndihmë popullin shqiptar por në disa raste jo. Për veprat që kam shkruar pro italianëve s’ka ba mirë po keq. “Hylli i Dritës” ka ndrrue shkrimet sipas drejtorave qi kishte. Në vjetin 1939, para dhe mbas ardhjes s’Italisë, Kryetar i Françeskeve ka qenë Patër Gjergj Fishta ⁶, i cili ishte edhe drejtor “Hyllit të Dritës”. Pas vdekjes së Patër Gjergj Fishtës, kryetar i fes ka qenë Patër Çipran Nikaj ⁷. Mua në

Tiranë këta më çojtën ⁸ “Hylli i Dritës” ka shkruar një artikull të Patër Gjergjit pro Italisë dhe për këtë unë kam kundërshtuar.

Prokurori: Nuk mund të ndërronte “Hylli i Dritës” sipas drejtorave por ky ka një program që ishte program i Françeskanëve ⁹ që çdo gjë jepet me urdhër. Prokurori këndon një artikull të “Hyllit të Dritës” i cili favorizon ardhjen e Italisë në Shqipëri dhe ngre lartë ushtrinë fashiste italiane, duke e konsideruar të mirë bashkimin e Shqipërisë me Italinë fashiste dhe duke lavdëruar Musolinin dhe Perandorinë Italiane. (*Në dosje nuk është artikulli që i referohet prokurori*)

I Pandehuri: Unë nuk i shoh me të drejtë që ato që shkruhen në “Hyllin i Dritës” me mi atribue mua. Por le të gjindet ay që ka shkruar.

Prokurori: Patër Anton Harapi nuk mund të ç’këputet nga “Hylli i Dritës” sikurse “Hylli i Dritës” nuk ç’këputet nga Patër Antoni. Si përgjigjet pyetjes pse këtu qëndron poshtërsija e tradhëtisë së tij. Hiqet si njeri i vogël dhe sikur s’di gjë. Ky ka shkruar qysh në vjetin 1936 për fashizmin. Patër Anton Harapi ka mbajtur konferencë në vjetin 1936 fill mbas demonstratës së bukës në Korçë,¹⁰ dhe këndon një copë të fjalimit që ka mbajtur Patër Anton Harapi në një konferencë në Korçë, ky ka shkruar qysh atëhere për fashizmin. (*Në dosje nuk është fjalimi i Padër Anton Harapit*)

I Pandehuri: Prokurori flet për një gjë që është shkruar qysh në vjetin 1936. Rethanat e at’herëshme me rethanat e sotshme janë krejt të

ndryeshme. Unë kam thanë se duhet një autoritet dhe këtë e them dhe sot.¹¹ Kur kam qenë Drejtor i Françeskve, nuk di që rinia katolike e Shkodrës të jetë fashistizuar. Këtë detyrë e kam marrë në vjetin 1942. Italianët në Fretnit nuk kanë pasë Dopolavore ¹² por në Jezuitët ¹³ kanë pasë. Italianët si kam dashun por s'kam qenë i zoti me i luftue.

Prokurori: Këndon një letër të shkruar nga Patër Gjergj Fishta drejtuar Mbretit (Zog I-rë) ¹⁴ prokurori i tregon nënshkrimin e shkresës dhe e pyet Patër Antonin a e njeh firmën? (*Në dosje nuk është letra e Patër Gjergj Fishtës*)

I Pandehuri: Po, ky është nënshkrimi i Patër Gjergj Fishtës dhe kjo letër i drejtohet Mbretit. Besoj se Patër Gjergj Fishta do të ketë marrë sunvencione nga qeveria Italiane por unë nuk e di. Unë vetë Provincial kam qenë më 1942. Kuvendi jonë mbahesh me të ardhurat e veta duke punuar dhe mbante shkollën. Në kohën t'eme kemi marrë sunvencione vetëm nga qeveria shqiptare, përse i përket të kaluarës unë nuk e di mbasi nuk kam kontrolluar të gjitha shkresat e Kuvendit

Qeveria shqiptare gjithmonë e ka suvencionuar gjymnazin t'onë në një sasi të hollash prej 10-20.000 franga Shqiptare, këto të holla tërhiqeshin prej Provencialit të Françeskanëve ¹⁵. Është e vërtetë që para vitit 1925 kemi marrë nga Vatikani të holla, por ma vonë jo dhe që kurse qeveria Shqiptare dha sunvencionin nuk morëm më nga Papa.

Prokurori: Si Provincial duhet të dijë të gjithë veprimet që kanë kryer Provincialët e tjerë dhe në qoftë se nuk don t'i thotë ja tregoj unë me fakte që janë me firma mbi marjen e të hollave që është bërë nga qeveria italiane dhe këndon një letër që përmban të hollat që i ka dhënë Italia, klerit, dhe Patër Anton Harapi na bën këtu sikur nuk ka dijëni për këto të holla, kurse gjithë kjo llogari është shkruar me dorën e Patër Gjergj Fishtës. Këndon një shënim të Patër Gjergj Fishtës që thekson se në rast që qeveria shqiptare nuk do të japi sunvencione për shkollën atëhere do të kërkonte që këto sunvencione t'i jipe-shin nga qeveria italiane më në fund shton se për këto sunvencione duhej të shkante vetë Patër Gjergj Fishta në Romë. Këto kanë qenë lidhjet e Kuvendit Françeskan me Italinë fashiste, që kështu del në shesh interesi që qeveria italiane ka pasur me Kuvendin Françeskan. Këndon një letër të konsullatës italiane në Shkodër me datë shkurt 1937 drejtuar anxhensisë Adriatica në Durrës, që kërkon t'i lëshohet një biletë gratis për në Itali, Pater Gjergj Fishtës e firmume nga fashisti më i keq Salvatore Meloni¹⁶ (*Në dosje nuk është letra që citon prokurori*)

I Pandehuri: Unë nuk jam Patër Gjergj Fishta dhe Patër Gjergj Fishta nuk është Patër Anton Harapi dhe kështu nuk marrë asnjë përgjegjësi për veprat e kryera nga Patër Gjergj Fishta me të cilin nuk kam qenë i një mendimi, sikurse e kam deklaruar dhe në seancën e kaluar dhe se unë nuk kam bërë politik të jashtëme por vetëm të brëndëshme.

Prokurori: I pandehuri Patër Anton Harapi nuk don të tregojë kur e ka marë drejtimin e “Hyllit të Dritës”. Ky e ka marë më 1941 dhe gjer në 1944 dhe kjo provohet me një kartvizitë që kemi këtu, drejtuar prej Patër Antonit, Patër Matit (Prendushi) ¹⁷. Nuk mundem të kuptoj si ky nuk mban mend kur e ka marë drejtimin e “Hyllit të Dritës” Patër Anton Harapi si pjestar i redaksisë është dhe ky përgjegjës për ato shkrime. (*Në dosje nuk është kart-vizita, dhe as shkrimet që citon prokurori*)

I Pandehuri: Drejtor i “Hyllit të Dritës” ka qenë i pari i Françeskve dhe ky ishte përgjegjës, pse ky i pranoi këta artikuj nuk e di. Mundet që i pëlqente. Unë kam qenë deri në 1937 redaktor i “Hyllit të Dritës” dhe ma vonë e ka marë Patër Gjergj Fishta mbasi unë jam largue. Pranoj qi në kohën teme asht botue artikulli qi u këndue por pa dijeninë teme për këtë u kam tërhekun vrejten. Për artikujt e tjerë unë jam prishur me Patër Gjergj Fishtën. Pas 1937 unë kam qenë kryetar i Françeskve¹⁸. Në vjetin 1942 për shkak se botoheshin kësilloj artikuj e kam pushue përgjegjësin dhe e kam marë vet drejtimin. Kur unë kam kenë i pari i Franceskve në Shkodër janë botue artikuj me frymë fashiste, por i kam këshillue për mos me i botue dhe bile u kam tërhekun vrejten dhe i kam pushue. Patër Geraldin Pali ¹⁹ (*Bernardin Paln?*) një herë ka shkruë në kohën qi kam qenë unë dhe për këtë i kam terhekun vrejte. Në “Hyllin e Dritës” tregohej në përgjithësi mendimi i fançeskve shqiptar. Këta kanë pas për qëllim me qindrue në pasivitet karshi okupatorit, domethanë as luftë as

bashkëpunim. Artikuj në favor të fashizmit janë shkruar kur unë s'kam kenë.

Prokurori:- “Hylli i Dritës” ka shkruar mjaft për fashizmin, duke popullarizuar propogandën e tij, bile ka shkruar edhe statutin e partisë fashiste, kurse i pandehuri Patër Anton Harapi na thotë se “Hylli i Dritës” nuk ka përkrahur fashizmin. Kjo mënyrë veprimi nuk është qëndrim pasiv, siç thotë i pandehuri, por do të thotë të jesh aktiv dhe në favor të fashizmit.

Prokurori këndon artikuj të botuar në “Hyllin e Dritës” të cilët lartësojnë fashizmin dhe eksponentët e tij, si Jacomoni ²⁰ me shokë duke i konsideruar këtë agjent të fashizmit si njeri të vlefshëm dhe duke e krahasuar me heroin tonë Kombëtar Skëndërbeun. Prandaj kërkonj shpjegime nga i pandehuri si e priti fashizmin. *(Në dosje nuk janë artikujt që citon prokurori)*

I pandehuri: “Hylli i Dritës” asht organ i Franceskve dhe ky dirizhohej nga paria e Franceskve. Shkrimet qi këndon Z. prokuror nuk janë të mira dhe nuk di pse paria e françeskve nuk i ka ndaluar. Por unë besoj se këto shkrime nuk kanë kaluar nga çensura dhe prandaj janë botuar. Unë di se paria e françeskve u ka heq vretjen atyne qi kanë shkruar artikuj mbi Dukagjinin ²¹

(Në dosje nuk është shkrimi në fjalë) dhe përshkrime të tjera. Në këtë kohë ka ken drejtor vet Pater Gjergji. Unë nuk mund të përgjigjem dhe as jam përgjegjës për ç'ka ka ba kleri katolik në Shqipni. Unë jam përgjegjës për veprat shkrimet dhe

sjedhjet e mija. Ata qi kanë shkruar këta artikuj janë të këqij e tradhëtar dhe këtë e kam thanë e thom përsëri. Dhe insistoje se unë s'jam autori i ktyne shkrimeve dhe se këto janë shkrime të damshme për popullin.

Këndohet deklarata e lëshuar nga Mas'har Bekteshi ²² *(Në dosje nuk është deklarata e Mas'har Bekteshit)*

I Pandehuri: Mas'har Bekteshin nuk e njof. Nuk mbaj mend që unë të kem kryer veprën që ky deklararon.

Këndohet një deklaratë e lëshuar nga Kolë Mëhilli që ndodhet midis t'akteve. *(Në dosje nuk është deklarata e Kol Mëhillit)*

I Pandehuri: Kol Mhillin e njof dhe është profesor. Këtë e kam mbrojt nga kosovarët e nga gjermanët. Unë kam kenë emnue si anëtar n'Akademisë e Arteve të Lidhjes së Shkrimtarëve në kohën e okupacionit Italian, por s'kam pranue me marë pjesë dhe s'kam shkue kurrë në mbledhje. Sa thotë deklarata e lëshueme prej Kolë Mhilli ²³ s'janë të vërteta. Nuk asht e vërtetë qi ktij t'i kem folun me kaq përzemërsi.



Foto viti 1940. Patër Anton Harapi. Kisha e Thethit



Përvujtëria françeskane

Prokurori: Jacomoni nuk erdhi në Theth aksidentalisht ose si turist, por me qëllim, gjithashtu Patër Anton Harapi nuk qëndronte atje më kot dhe me kënaqësi por këto kishin qëllimet që u kuptuam mbrapa. Këndohen shkrimet në “Hyllin i Dritës” mbi

ardhje e Jacomonit në Theth. Lexohet deklarata e Dom Mëhill Jakut ²⁴ (Në dosje nuk është deklarata) mbi ardhjen e Jacomonit në Theth.



Francesco Jacomoni në Shkodër 01.12.1940

Kryetari i gjyqit: Patër Harapi a ke dalë në fotografi me Jacomonin?

I Pandehuri: Unë kam qenë në Theth për 15 vjet rresht. Këtu erdhi Jacomoni u takuam dhe e prita, por unë kam prit dhe gjithë të huejt e tjerë qi kanë ardhë si anglezë, francezë, jugosllavë etj. Porsa shikon pritjen e Jacomonit në Theth s'do me thanë gja një pritje në Kishë. Kur ka ardhur Jakomoni unë kam qenë, me të ishte edhe Ernest Koliqi ²⁵. Jakomonin e prita si i huaj, nuk mund ti vishnja pushkën këtij, këtë nuk e prita as keq as mirë, por me një pritje të zakonshme. Dom Mëhill Jakun?? nuk e njof

por Jakomonin se kam prit me përzëmërsi. Mue kanë dasht me më internue n'ishujt e Italisë

Prokurori: Faktet e akuzës e përgënjoshtrojnë në mënyrë kategorike se Patër Harapi gjatë gjithë kohës së okupacionit fashist, ka qenë kundërshtarë i tyre, më kot përpiqe Z. Avokat që artikullin “Përgjigje Cordignano-s”²⁶ (*Fulvio Cordignano*) kërkoi t’ia vishte Patër Anton Harapit gjoja me pseudonimin “Kritikuesi”

Merret në pyetje nga Kryetari i trupit gjykues i pandehuri Patër Anton Harapi, i cili mbasi u pyet deklaron: Coridignano e njof qysh se ka ardhë në Shqipni. Ky ka qenë Jezuit Italian. Në mbledhje me të s’kam kenë. Ky ka shkruar në një revistë akademike t’Italisë një artikull kundra Shqipnisë.

I Pandehuri: Në kohën e Italisë, italianët kanë kërkue nga superiorin e em largimin tim nga Shqipnia²⁷, por mbasi ky u kundërshtoi, ardhin një përfaqësues i gjeneralit të françeskve nga Roma dhe ky më tërhoqi vrejten për veprimtarinë reaksionare që zhvilloja kundra Italisë

Unë n’Itali, gjatë okupacionit italian në Shqipëri, kam shkuar vetëm një herë, për me u marë vesh me gjeneralin e Françeskanëve si Provincial që kam qenë, kur kam vajtur nuk e mbaj mend. Çështja e ngataresave të mia është përfunduar që me ardhjen e Doktor Franc, që e kishte dërguar Gjenerali De Bello²⁸, i cili erdhi me u fjalosur me mua simbas akuzave që më kishin bërë se un vepronja kundra italianëvevet. Këtë siç thashë e kishte dërguar gjenerali

jonë. Ky sipas shpjegimeve që unë i dhashë, duke i thënë se unë jam shqiptar dhe nuk jam fashist më bëri arsye. Arrestimi t'ëm do të bënte përshtypje si nacionalist që kam qenë.

Prokurori: Patër Harapi po na deklaroi se arrestimi i tij do të bënte përshtypje, si klerik që ishte dhe si element i Vatikanit, kur dihet se në kohën e fashizmit kushdo që shikohesh me urejtje me një herë arrestohesh ose internohesh dhe nuk liresh të rinte i lirë ²⁹.

I pandehuri: Njeriu mund të interpretojë si të dojë, por mua fashistët më kanë pasur me sy të keq, i dërguari i Gjeneralit të Françeskanëve ka qëndruar 10 ditë në Shkodër, por nëse ka qëndruar dhe sa ditë ka qëndruar në Tiranë nuk e di, ky ka qenë gjithmonë në favor të shqiptarëve, çështja t'eme u rregullua dhe unë nuk u preka.

Prokurori: Nga deklaratat e Patër Anton Harapit del në shesh se i pandehuri dhe shokët e tij kanë qenë të lidhur në favor të fashizmit, mbasi po të mos ishte kështu, shokët e tij të klerit duhet t'a ndalonin. Ky vetë duhej të ndalonte vetveten e tija; kurse ky e ka filluar dhe e ka vazhduar vijën e tija politike kundra shtetit shqiptar.

I pandehuri: Unë në Tiranë erdha i dërguem nga kleri dhe megjithse kam protestue mos me ardhë, prap se prap erdha. N'Asamble jam kenë si spektator. Karshi Ciano-s, kam protestue, tue i thanë se:

unë jam shqiptar, mburrem për këtë dhe s'bjaj politik tjetër përveç atë të kombit tim

Këndohet deklarata që i pandehuri ka bërë Komisionit Hetimor për kriminelët e luftës.

(Në dosje nuk është deklarata)

I Pandehuri tha: Ju falenderoj për lejimin që më keni ba gja procesit të gjykimit. Shtoj se protestën time para Kont Cianos e kanë botue dhe jugosllavët e çuditëm si publiku shqiptar nuk e ka parasysh. Kënaqëm që nuk dolën gjatë procesit të gjykimit dokumenta me firmën e dorës t'ime përsa shikon akuza që më atribohen.³⁰

Prokurori: Për çarë arsye Patër Anton Harapi ka rëzu lëvizjen Nacional Çlirimtare

I Pandehuri: Kleri katolik ka mbajtur qëndrim pasiv karshi lëvizjes Nac. Çl. Në përgjithësi e kam dijtë programin e lëvizjes Nacional Çlirimtare dhe kjo ka qenë lëvizje kombëtare. Ishte e drejtë me dhanë kontribut populli shqiptar në luftë kundër okupatorit, por unë asnjë kontribut s'kam dhanë vetëm kam qëndruar pasiv. Unë di përgjithësisht se kleri katolik ka mbajtur qëndrim pasiv kundër okupatorit. Në qoftë se partizantët e vdekur katolik nuk i qasnin në voret katolike, kjo ishte një gja e keqe, por nuk ka qenë në kopetencën tonë. Sipas mejtimit tim ky qëndrim (pasiv) nuk ishte i keq.



Tirana në periudhën fashiste

Plotësuese e pjesës së parë:

** Patër Anton Harapi: Lindi në Shirokë, katund (lagje) e Shkodrës, më 5 janar 1888, i biri i Loros dhe i Çile Koliqit, i pagëzuar me emrin Gaspër. Që në moshë të re, bashkë me të vëllanë, Markun, u thirën në rrugën kishtarë. Filloi mësimet në kolegjin e jezuitëve, ku kreu mësimet fillore dhe më vonë vazhdoi gjimnazin e ulët në kolegjin e françeskanëve.*

Si nxënës i mirë mori bursë për studime në Salzburg, e mandej Schwaz e Villach të Tirolit të Austrisë, më vonë vazhdoi studimet teologjike në Universitetin e Insbrucit, për filozofi në Universitetin e Vjenës.

Më 1910 kthehet në atdhe dhe shugurohet mesh-tar. Gjatë tetorit të vitit 1912 deri në prill 1913, kur Shkodra qe e rrethuar nga trupat malazeze e serbe, shërbeu në kishën “Zoja Rruzare” në Arrën e Madhe në Shkodër, ku ishte edhe Kuvendi Françeskan.

Në vitet 1916-1918, gjatë Luftës së Parë Botërore ishte në Grudë të Malsisë së Madhe. Organizoi me banorët e tre bajraqeve Hot, Grudë e Triepsh një memorandum që këto bajraqe t'i mbeteshin Shqipërisë. Memorandumin ia dorëzoi Luigi Gurakuqit e At Fish-tës, që këta t'ua dorëzonin fuqive të mëdha, të cilat po drejtonin konferencën e paqes në Paris e po vendosnin kufijtë e shteteve të Europës.

Ishte inisiatori i botimit të gazetës “Ora e Maleve” së bashku me Dom Lazër Shantojën.

Në vitin 1923 u emërua drejtor i kolegjit françeskan. Mbas përmbysjes së grushtit të shtetit të vitit 1924, si përkrahës i tyre e arrestojnë, por nuk e dënojnë.

Mbas burgut ishte mësues e drejtor i liceut “Illyricum” dhe gjithashtu mësues në shkollën normale femërore të “Motrave Stigmatine” në Shkodër. Në vitet 1930-1936 ishte drejtor i revistës “Hylli i Dritës”, ka botuar shkrime te gazeta “Posta e Shqypnisë” dhe “Zani i Shna Ndout”, mbi 70 artikuj. Disa nga shkrimet e tij janë: “Urti e burri ndër banorët e Cemit”

“Valëmbivale”, shkrime në prozë. Përktheu vepërën e Anton Herget “Edukata ose mirëritja e fëmijëve”, “Shqyptari dhe bota e tij”, “Andrat e Pretashit”, “Vlera shpirtërore” etj

Në vitin 1937 ishte famulltar në Bajzë të Shkodrës. Mbas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, së bashku me parinë e Shkodrës i kërkuan Konti Cianos që “ Shqipëria të jetë mbretëri e pavarur e me një mbret nga familja e Savojave të Italisë. Shqipëria të ketë flamurin e saj, gjuhën, shkollat shqip etj.”Konti xS ju premtoi se do ti zbatojë kërkesat e delegatëve të Shkodrës, por nuk e mbajti fjalën. Emëri i tij është te lista e asambleistëve që ia dorëzuan kurorën e

Skëndërbeut Viktor Emnauelit të III, por nuk ka firmën e tij në këtë listë.

Me 13 shtator 1943 u emërua anëtar i Këshillit të Regjencës, ku qëndroi deri në fund të vitit 1944. Patër Anton Harapi në fjalimin e tij me rastin e betimit si anëtar i Këshillit të Naltë, u shpreh:

"Më rrenë mendja se nuk ka zog shqiptari, qi të mendojë se unë e mora këtë barrë për kulltuk, për interesë a për ndonji intrigë. Mundet veç me drashtë ndokush mos qe ndonji maní e emja qi më shtyni deri këtu. Edhe un po u a vërtetoj fjalën dhe po u thom se po: manija e Shqipnis, po, qe ajo qi më vuni dilemën: a me anarkista për të ba gjak, ase me hjekun dorë prej çashtjes kombtare. Dhe mbasi shpirti nuk m'a tha të baj as njenën, as tjetrën, qeshë i shtërnguem të zgjedhi njanën dysh: a të baj një marrí tue e pranue këtë zyrë, ase të tregoj një dobsí tue u largue. Vendova ma mirë të baj një marrí: ase sikurse thonë ata shqiptarë qi duen të ruhen të pastër – desha të komprometohem".

Me vendim të datës 12 shkurt 1946 të Gjykatës ushtarake e Tiranës Patër Anton Harapin dënohet me vdekje pushkatim. Me 14.2.1946 Gjykata e Lartë Ushtarake aprovon dënimin me vdekje.

1. Benito Musolini (29 korrik 1883 – 28 prill 1945) ishte politikan dhe gazetar italian. Drejtuesi i Partisë Fashiste Kombëtare Italiane. Ai qeverisi Italinë si kryeministër nga 1922 deri më 1943. Mbas vitit 1925, kur ai drejtoi Italinë si një diktator i njohur si "Il Duce" (Drejtuesi). Musolini ishte për një "nacionalizëm revolucionar social" Pasi largoi të gjithë kundërshtarët politike përmes policisë së tij të fshehtë "O.R.V.A." dhe ndaloi grevat e punonjësve, Musolini

dhe pasuesit e tij konsoliduan fuqinë e tyre politike përmes një sërë ligjesh që e shndërruan qeverisjen e kombit në një diktaturë personale. Brenda pesë viteve, Musolini kishte krijuar autoritetin dikatorial, si me mjete legal e jo legale të qeverisjes. Politika e jashtme e Musolinit synonte të zgjeronte sferën e ndikimit të fashizmit italian në Mesdheun Lindor. Në 1923, ai filloi "Pacifikimin e Libisë" (Italia e kishte koloni Libinë nga viti 1911-1943. Kolonizimi i plotë i Libisë u shoqërua me luftra të vazhdueshme me banorët vendas. Musolini kur erdhi në pushtet nisi një fushatë propogandistike e shoqëruar me luftë për qetësimin e Libisë e pranimin e Libianëve, të Italisë si kolonizatorë Aj.) dhe urdhëroi bombardimin e Korfuzit si hakma-rrje për vrasjen e gjenerali italian Telini nga grekët . Më 1936, Musolini formoi "Afrikën Lindore Italiane" (A.O.I.) duke bashkuar Eritrea, Somali dhe Etiopinë pas krizës Abisinian dhe Luftës së Dytë Italo-Etiopiane. Midis 1936 dhe 1939, Musolini urdhëroi ndërhyrjen e suksesshme ushtarake italiane në luftën civile të Spanjës në favor të gjeneralit Francisco Franko

Në vitin 1939, forcat italiane pushtuan Shqipërinë. Më 10 qershor 1940 - me kapitullimin e Francës, Italia hyri zyrtarisht në luftë dhe përfundimisht pushtoi pjesë të Francës jug-lindore, Korsikën dhe Tunizin. Italianët pushtuan teritore të Egjiptit dhe bombarduan Palestinën. Në tetor 1940, Musolini dërgoi forcat italiane në Greqi përmes Shqipërisë duke filluar luftën greko-italiane, që qe një dështim në fazën e parë të luftimeve. Me fillimin e pushtimin gjerman të Bashkimit Sovjetik dhe sulmin japonez mbi Pearl Harbour, Musolini do të dërgonte një ushtri italiane prej miljona njerëzish në Rusi dhe do t'i shpallte luftë Shteteve të

Bashkuara, Anglisë etj. Në vitin 1943, Italia pësoi humbje të mëdha në frontin e Lindjes, deri në shkurt 1943 Ushtria e Kuqe kishte shkatërruar plotësisht ushtrinë italiane në BRSS; në maj 1943 Italia pësoi humbje të mëdha në Afrikën Veriore Më 9 korrik 1943 Aleatët pushtuan Siçilinë.

Si pasojë e dështimeve të mëdha në të dyja frontet në fillim të 25 korrikut, Këshilli i Madh i Fashizmit kaloi një mocion mosbesimi për Musolini; më vonë, po atë ditë, Mbreti e pushoi nga detyra si kreu i qeverisë dhe e vendosi atë në paraburgim. Emëroi Pietro Badoglio si Kryeministër.

Pasi Mbreti pranoi armëpushimin me aleatët, më 12 shtator 1943, Italia kapitulloi. Musolini u shpëtua nga arrestimi nga ndërhyrja në Gran Sasso e para-shutistëve gjermanë dhe komandot Waffen-SS të udhëhequr nga Majori Otto-Harald SS. Në fund të prillit 1945, në vazhden e humbjes së afërt totale të Gjermanisë naziste, Musolini dhe dashnorja e tij, Clara Petacci, u përpoqën të iknin në Zvicër, por të dy u kapën nga partizanët komunistë italianë dhe u ekzekutua. Trupi i tij më pas u dërgua në Milano, ku u var me kokë poshtë në një stacion treni për të konfirmuar publikisht vdekjen e tij.

2. Viktor Emanueli III (italisht: Vittorio Emanuele III; 1869-1947) ishte mbreti i Italisë në vitet 1900-1946. Njihet në historinë e Shqipërisë si sovran i kurorëzuar edhe me kurorën e Mbretërisë shqiptare, pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia më 1939; Mbretërimi i tij fashist në Shqipëri përfundoi më 1943 me kapitullimin e ushtrisë italiane. Qe, gjithashtu, në fronin perandorak të Etiopisë mes viteve 1936-1943.

Megjithëse ishte mbret me të drejta sovrani, Viktor Emanueli III mbeti vetëm udhëheqës simbolik i Italisë pas marrjes së pushtetit nga Benito Mussolini më 1922. Gjatë tërë kësaj kohe i pranoi qoftë në heshtje e qoftë përmes ceremonive politikat hegje-moniste të qeverisë fashiste të Musolinit. Më 1943, kur u bë e qartë se orientimi fashist do të sillte humbjen e Italisë, Viktor Emanueli III e shkarkoi Musolinin nga detyra e kreut të qeverisë dhe e burgosi atë. Megjithë orvatjet e tij për të ruajtur regjimin monarkik dhe abdikimin në favor të të birit më 1946, populli italian vendosi të shpallte republikën. Familja Savoja u dënua me dëbim nga Italia. Vdiq i mërguar në Aleksandri të Egjiptit.



Në ruajtje të kufirit. Ndezja e zjarrit lajmërues

3. Në maj 1941, pas kapitullimit të Jugosllavisë, popullsia shqiptare e Malit të Zi, në katundet Hot, Grudë etj i dërgon një memorandum Mbretit Viktor

Emanueli III-të e Duçes që shqiptarët e Malit të Zi t'i bashkoheshin Mbretërisë Italo-Shqiptare.

Mbas kapitullimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, territori i zotëruar i Malit të Zi nga Italia, ishte shumë më i vogël në sipërfaqe se Mali i Zi në ish Jugosllavinë komuniste. Malit të Zi ju morën teritore të banuar nga shqiptarët dhe ju bashkuan mbretërisë së bashkuar Italo-Shqiptare.

Italianët lanë për malazezët një territor të vogël që shkonte në jug nga Sanxhaku në Berane, duke përfshirë qytetet Prepoli, Bellopoja, Sjenica dhe disa fshatra rreth Tutinit dhe Rozhajes, duke përfshirë një pakicë muslimane që numëronte rreth 80,000 njerëz. Gryka e Kotorrit u aneksua si pjesë e Guvernoratit Italian të Dalmacisë dhe kufiri midis tyre dhe Malit të Zi ndoqi lumin në rajonin e Drinës deri në Hum, pastaj nëpërmjet Dobricevos në Adriatik.

Përgjatë vijës së tij bregdetare dhe kufijve juglindorë, Mali i Zi humbi Metohinë ndaj Mbretërisë Italo Shqipëtare, duke përfshirë Tivarin, një rrip toke në veri të liqenit të Shkodrës, qytetin e Ulqinit, një zonë në verilindje të Podgoricës përgjatë kufirit jugosllavoshqiptar dhe një pjesë të konsiderueshme të rrethit Andrijevisa, duke përfshirë Plavën dhe Gucisë.

Administrata e territori fillimisht ishte nën okupimin ushtarak, por italianët fillimisht synonin ta bënin Malin e Zi një shtet të pavarur me lidhje të ngushta me Italinë dhe emëruan Mazzolinin si komisioner për të trajtuar çështjet civile. Në 13 Korrik 1941 Malazezët u çuan në kryengritje e shpallën pavarësinë e Malit të Zi nga pushtimi italian. Në fillim malazesët korën fitore mbi garnizonet italiane. Kryengritësit ishin një kombinim i fuqive ushtarake komuniste e nacionaliste. Kundërofensiva nga më shumë

se 70.000 trupa italiane, e komanduar nga gjenerali Alessandro Pirzio Biroli, u ndihmua nga milicia mysli-mane e Sanxhakut, nën drejtimin e shqiptarit Osman Rastoderi etj. dhe nga forcat e parregullta shqiptare vullnetare nën bajraktarin Prek Cali etj. dhe forca e paregullta ushtarake të popullsisë nga Kosova, banorë të zonave kufitare midis Malit të Zi dhe Shqipërisë, e shtypën kryengritjen brenda gjashtë javësh.

4. Revista “Hylli i Dritës” ka filluar botimin e saj në vitin 1913 si revistë e katolikëve Françeskanë të Shqipërisë. Në thelb kjo revistë kishte frymën katolike të françeskanëve. Është ndaluar disa herë nga autoritetet shqiptare të kohës falë aktivizimit të saj në politikën shqiptare.

Revista “Hylli i Dritës” në një nga botimet e saj e konsideroi pushtimin e Shqipërisë në 7 prillin si fillimin e një “Epoke të re” e “Fatbardhë” për popullin shqiptar. Në faqet e saj kritikohej regjimi i mëparshëm i Mbretit Zog dhe himnizohej vendimi i Asamblesë Kombëtare për bashkimin e Shqipërisë me Italinë. Kjo revistë në kushtet edhe të imponimit Italian u vendos në shërbim të propagandës së regjimit të ri, duke botuar statutin e Partisë Fashiste Shqiptare, dekretligjin për krijimin e milicisë etj. Kjo revistë qe aktive në propogandën anti komuniste me synimin që të ndriçohej opinioni publik për këtë ideologji ekstremiste, gjë e cila nxiti goditjen hakmarëse e të menjëherëshme e shkatëruese të regjimit komunist, që u vendos në Shqipëri, duke e mbyllur revistën e duke dënuar autorët e shkrimeve në të. Revista rifilloi botimet e saj në vitin 1993.

5. *Luigj Gurakuqi (lindur në Shkodër, 20 shkurt 1879 – vrrarë në Bari të Italisë në 2 mars 1925) Aktiv-ist i çështjes kombëtare, nënshkrues i dokumentit të shpalljes së pavarësisë, ka pasur funksione të larta shtetërore e politike gjatë gjithë aktivitetit të tij.*

6. *Gjergj Fishta (lindi në Fishtë Lezhë 23 tetor 1871 – vdes në Shkodër, 30 dhjetor 1940) ka qenë frat françeskan, arsimtar, shkrimtar, poet, përkthyes vep-rintarë politik etj, ka qenë kryetar i komisionit për hartimin e alfabetit në Kongresin e Manastirit, anëtar i delegacionit të qeverisë me kryeministër Aqif Përmeti në Konferencën e Versajës, Zëvendëskryetar i legjis-lativit shqiptar më 1921 si dhe përfaqësues diplo-matik i shtetit shqiptar ndër disa konferenca ballka-nike gjatë viteve '30. Pas pushtimit italian, u zgjodh anëtar i Akademisë së Italisë, shkrimet e tij më pas u përdorën nga regjimi fashist për qëllime propagandi-stike.*

Me datën 30 prill 1940 A. Gjergj Fishta ka mbajtur në Milano në konferencën përkatëse “Veprimtaria e françeskanëve për misionin e Kishës Lindore me Kishën e Romës”. Mbas pushtimit fashist, Fishta botoi “Prosperita del popolo Skipetaro sotto L’Impero Roma-no” (Begatia e popullit shqiptar nën Perandorinë Ro-make)

Pas dekadës së dytë të shekullit 20, Fishta iu imponua kulturës shqiptare jo vetëm si shkrimtar (poet, dramaturg, prozator etj.), por edhe si kritik, historian i letërsisë dhe estet. Për një gjysmë shekulli ishte figura mbizotëruese e letërsisë shqipe, madje sa ishte gjallë u kurorëzua "Poet kombëtar". Për kontri-

butet e tij u nderua me urdhëra nderimi dhe dekorata nga autoritetet osmane, austro-hungareze, greke, kleri katolik dhe italianët. Pas vitit 1945, kur u vendos regjimi komunist, vepra e tij u ndaluan ndaj figurës së tijë publike u hodh shumë shpifje e të pa vërteta i mohuan veprat dhe rrolin e tij përkushtimor ndaj Shqipërisë. Figurën madhore e Gjergj Fishtës e lanë në hije deri kur ra diktatura komuniste. Sot në përgjithësi shqiptarët e shohin si një figurë e respektuar për kontributin e tij në çështjet fetare, kombëtare e letrare.

7. Dom Çiprian Nik, Meshtar katolik, Provincial i Françeskanëve, Guardian i Kuvendit Françeskan, publicist, lindi më 5 janar të vitit 1888, në Shosh të Shkodrës. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Kolegjin Françeskan në Shkodër. Studimet e larta teologjike i përfundoi në Austri dhe, më 26 korrik 1924 u shugurua meshtar në Romë, duke marrë emrin Çiprian. Me t'u kthyer në Shqipëri, u emërua profesor në gjimnazin e "Fretërve". Mori pjesë në orkestrën frymore të françeskanëve nën drejtimin e Atë Martin Gjokaj, si flautist. Ishte bashkëpuntor i revistave «Hylli i Dritës» dhe «LEKA», ku ka shkruar mjaft artikuj në fushën e filozofisë. Në vitin 1938 u zgjodh provincial i Provincës së Shqipërisë. Në vitin 1943 u zgjodh Guardian i Françeskanëve të Shkodrës. U arrestua më 17 nëntor të vitit 1946, me akuzën se kishte fshehur armë në altarin e Shën Ndout në kishën françeskane të Gjuhadolit. Më 28 dhjetor 1947 u dënua me vdekje, me pushkatim. U ekzekutua më 11 mars 1948. Më 26 prill të vitit 2016 u shpall Martir

i Kishës. 9 nëntor 2016, Presidenti i Republikësaj i dha dekoratën e lartë të «Flamurit të Kombit».

8. Me 12 prill 1939 u thirrën në Tiranë, nga zyrtarët e lartë italianë të pushtimit, përfaqësuesit e 10 prefekturave të Shqipërisë për të bërë de jure, faktin e pushtimit të Shqipërisë. Patër Anton Harapi i autorizuar nga konsultimi me françeskanët e tjerë i kërkoi autoritetit të lartë të pushtuesve italianë independencën e plotë të Shqipërisë me flamur të vet të paprekur, me gjuhë, shkolla e zhvillim arsimor; me administratë shtetëror të veten, ushtarake e civile; me përfaqësi para shteteve të hua e me gjithçka ishte në natyrë të një shteti e të një kombi sovran, me racë, gjuhë, histori, traditat e tagrat të veta. (Ernest Marku).

- Letra e Kol Bib Miraka e viti 1967, ish Ministër Sekretar i Partisë Nacionaliste Fashiste Shqiptare, drejtuar Abaz Armenin si kryetar i partisë Agrare në emigracion.(Polimika politike midis shqiptarëve në emigracion)

Vetëm përfaqësia e Shkodrës, ngurroi t'i përgjegjej asaj ftese, (Asamblesë Konstituente) e mbas dy ditë bisedimesh, në shtëpi të kapidanit të Mirditës, mbasi caktoi një program veprimi, arrijti në Tiranë, në mëngjes të 12 prillit 1939, e prime nga At Gjergj Fishta, At Anton Harapi e Gjon Marka Gjoni.

U ndaluen në hotel “Internacional” e kërkuen nga delegacionet tjera, që të dilshin nga parlamenti, për të ngulë kambë të gjithë sëbashku, siç kishte vendosë dërgata shkodrane; “mos me pranue bashkimin e Kunorës, por një Princ, të Shtëpisë Savoja, Mbret”.

Nuk iu përgjegjen thirrjes sonë, me që ato dërgata, e kishin pranue kërkesën e ministrit Ciano. Dërgata shkodrane, nuk pranoi të hynte në mbledhje,

pa u skjarue me përfaqësuesin e Italisë, mbi fatin e Shqipnisë. Ngarkuem At Anton Harapin dhe Gjon Markagjonin, për këtë skjarim e kambëngulje, në tezën tonë.

Dy përfaqësuesit tonë, u gjetën para fakteve: a. Të gjitha delegacionet tjera, kishin pranue formën e Unionit, (Bashkimit) pa asnjë kundërshtim; para vendosmënisë italiane që, ajo do të pranohej bashkimi i Kunorëve, ose do t'ishte diçka ma e randë. Para këtyne faktorëve, të pakalueshëm, të ngarkemit tonë, prap nuk e kishin dhanë fjalën e pranimit e, së bashku me kontin Ciano, e me Jacomonin, erdhën në sallën ku pritshim na të tjerët.

At Antoni, na shpjegoi të gjithë bisedimin e çeshtjen, tue na vue në dijeni se, Shkodra kishte ngelë vetëm, pse delegacionet tjera të gjitha e kishin pranue kërkesën e Italisë, pa hezitim. Erdhëm në një kompromis: Konti Ciano, përfaqësues i Italisë, n'emën të Mbreti Perandor dhe të Duce-s, të bante një deklaratë publike për ruejtjen e sovranitetit e t'integritetit të Shtetit Shqiptar, të pacenueshëm në këtë bashkim kunorash.

Ciano, e pranoi dhe e bani deklaratën e kërkueme, para popullit e përfaqësuesve të tij të rastit. Kthyeme prap në hotel dhe e stilizuem deklaratën, si vijon, të cilën, e lexoi në parlament, ish-anëtari i Këshillit të Naltë, shkëlqesa Ndoc Pistulli.

Deklarata: “Mbështetë mbi marrëdhajtet që na përfaqësuesat e krahinës së Shkodrës, që para zhdukjes së regjimit zogist, patëm me përfaqësuesit e Italisë fashiste, si edhe mbi Besën e dhanun, prej Ekselencës së Tij, Konte Galeazzo Ciano, i cili njiherë privatisht ia dha fjalën Princit Mirditës, z. Gjonit të

Markut, e mandej publikisht edhe para dërgatës shkodrane se:

Indipendenca e Shqipnisë, asht e garantueme në mënyrën ma absolute, me flamurin e vet, me gjuhë, shkolla e zhvillim të tyne, me administratë shtetnore të veten, ushtarake e civile, me përfaqësina para shteteve të tjera dhe me gjithçka asht në natyrë të një shteti e një kombi, me racë, gjuhë, histori, tradicione, e tagre të veta.

Na përfaqësuesit e krahinës së Shkodrës, pranojmë, që Mbreti Perandor i Italisë fashiste, të jetë njëheri edhe Mbreti i Shqiptarëve. Ky dokument u nënshkrue prej të gjithë delegacionit të Shkodrës me rradhë, si vijon: Kapidan Gjon Marka Gjoni, Ndoc Pistulli, Dom Mikel Koliqi, Patër Gjergj Fishta, Mark Kakarriqi, Kolec Deda, Daut Gjylbeg, Zejnel Broja, Asllan Bekteshi, Kolë B. Mirak, Zef Boriçi, Shaqir Omari, Taip Hilmija, Gjyl Gjylbegu.

Në të djathtë të dokumentit, figuron emni i At Anton Harapit, që ka shkruue dokumentin historik, me dorën e vet. Po t'ishin bashkue me këtë qëndresë morale edhe përfaqësuesit e krahinave të tjera të Shqipnisë, Italia, do t'ishite mendue shumë, para se me shkelë disa nga këto kushte, siç i shkeli, e që veprimi i mavonshëm i atyne që i queni tradhëtarë, e bani prap Italinë, t'ia kthejë këto të drejta Shqipnisë.

Në një libret të botuem në Uashington, në 1951, nga Costa A. Chekrezi, ai thotë: “Ata që kundërshtuan më rreptësisht, vendimin e Duçes, ishin krerët katolikë të Shkodrës”! Kostë Chekrezi, nuk ka kenë për-krahës i yni, por ka afermue një të vërtetë historike.

Na, e konsideruem çeshtjen kështu: Shtëpija ka marrë zjerm; mbrenda kemi familjen, pasuninë e gjithshka asht e denjë, për jetën e njeriut. Kush të jetë

burrë, duhet të hyjë në zjarm, me shpëtue çka të jetë e mundun, ose me u djegë edhe vetë. Nuk mujtëm me ndejë me duerkryq, tue ba sehir si disa “Superpatriotë”(!). Gjithshka u ba aty, e ma vonë, me protokolle të karakterit të së Drejtës Ndërkombëtare – Shtet me Shtet.

Në këto rrethana shtrënguese kombtarisht, filloi kolaboracionizmi ynë me Italinë fashiste, e për rrjedhim, me Boshtin Romë-Berlin, të cilit na të bindun se interesi i atdheut n’atë kohë, e lypte t’ishim leal, e ashtu qëndruem deri në fund; edhe kur i mbrami ushtar gjerman, po lente Shqipninë.

I ndejtëm lealë pse, mbas mendimit t’im, për me muejtë me ba politikë të dobishme për kombin, duhet me kenë dishka, e për me kenë dishka, duhet me pasë një forcë. Kjo forcë, ajo përbahet nga fuqia e armëve, ose nga fuqia morale, që vjen nga besnikija, nga lealiteti. Na si popull i vogël e, i pa mjete që jemi, nuk mund ta mbështesim politikën, në forcën e armëve e, aq ma pak në demagogjina e dredhina, po vetëm në Forcën morale.

*Informacion shtesë: *Nga ana tjetër, Benito Musolini i përgjigjej akuzave të shtypit në lidhje me pushimin e Shqipërisë, duke sqaruar se:*

1) Interesat e Italisë zinin vendin më të veçantë në Shqipëri gjatë një shekulli, fakt i njohur nga Konferenca e Ambasadorëve. (Në vitin 1921 fuqitë e mëdha të kohës, Anglia, Franca, Italia, Japonia vendosën që teritori i shtetit shqiptar është teritor i sigurisë së Italisë, Italia ka të drejtën të ndërhynte kur ky teritor nuk ishte i sigurtë për italinë Aj)

2) Italia kishte bërë shpenzime kolosale për shkolla, spitale, rrugë deri te pagesat për uniforma

ushtarake. Buxheti italian dhe shqiptar ishte gërshtuar pothuajse, por fondet italiane nuk ishin administruar mirë nga qeveria shqiptare. (propogandë pushtuesish, italianët kontrollonin e zotëronin menaxhimin e kredive të tyre në Shqipëri në mënyrë absolute Aj)

3) Mbreti Zog kishte tradhëtuar popullin dhe arratisja e tij tregonte mungesë besimi. (Mbreti Zog nuk e pranoi pushtimin dhe nuk dhe dorheqjen nga Froni Mbretëror Aj)

4) Ndihma italiane kundër qeverisjes së keqe të mbretit ishte kërkuar nga shumë elemente të popullit shqiptar dhe qeveria italiane po botonte letra të kësaj natyre nga paria e vendit. (Besoj se e ka fjalën për propogandën jashtë Shqipërie të emigrantëve antizogist Aj)

5) Shtetet fqinje, Jugosllavia dhe Greqia, ishin krejt të qeta. Beogradi kishte marrë sigurimet

Të sinqerta nga qeveria italiane. (Jugosllavia e Greqia e dinin se mbas Shqipërisë radha për tu pushtuar do i vinte atyre Aj)

6) Marrëveshja anglo-italiane nuk kishte pësuar asnjë Tronditje. (Me 2 janar 1937 u firmos në Londër “Gentlemen’s agreement” një marrëveshje me kushte të papërcaktuara mirë që sanksiononte njohjen e interesave italiane në Mesdhe (Renzo De “Felice Historia e shkurtër e Fashizmit f 120 ”)

7) Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste nuk paraqiste rrezik për paqen në Europë. (Në të vërtetë mbas disa muajsh filloi lufta botërore Aj)

• Me porosi të Kontit Ciano, më 12 prill 1939, Asambleja Kushtetuese Shqiptare dekretoi njësimin

e të drejtave civile dhe politike të qytetarëve italianë e shqiptarë.

Neni 1 i jepte ekzekutim të plotë konventës vazhduese ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj italiane, të angazhuara moralisht për bashkimin shpirtëror që ekzistonte midis dy shteteve, me qëllim që të bashkëpunonin më afër në kuadër të sovranitetit të shteteve përkatëse, si vijonte: “Qytetarët e Mbretërisë së Shqipërisë në Itali dhe qytetarët e Mbretërisë së Italisë në Shqipëri gëzonin të gjitha të drejtat civile dhe politike si në tokën e tyre kombëtare”.

1 Për të realizuar integrimin e Shqipërisë në perandorinë e re romake të Musolinit, Asambleja Kushtetuese u udhëzua të shpallte rrëzimin e monarkisë së Zogut dhe vendosi “Bashkimin personal”. (Vendim i paligjshëm i miratuar nga një organ i pa zgjedhur nga populli Aj)

2 Që përcaktonte statusin e Shqipërisë në lidhje me Italinë. Kjo formë nënkuptonte bashkimin e dy shteteve që nuk kishin karakteristika kushtetuese të përbashkëta, me përjashtim të personit të sovranit.

3 Në emër të mbretit Viktor Emanueli III, pushtetin do ta ushtronte Mëkëmbësi i Përgjithshëm, që u caktua Francesco Jacomoni, ish-ambasador i Italisë në Tiranë. Ai përfaqësonte autoritetin më të pushtetshëm në vend, ndonëse formalisht ekzistonte një qeveri shqiptare me kryeministër Shefqet Vërlacin Me qëllim që të mënjanonte ndërlikimet ndërkom-bëtare, Konti Ciano i shpjegonte ambasadorit britanik, Lordit Perth, se Shqipëria do të vazhdonte të ishte shtet i pavarur nën kurorën e mbretit Viktor Emanueli III, i cili nuk do të lejonte copëtimin e mëtejshëm të vendit. Përkundrazi, qeveria italiane premonte se në të ardhmen do të përpiqej për bashkimin e të gjitha

trojeve shqiptare, të mbetura jashtë kufijve politike të 1913-ës. Në të njëjtën audiencë, mbreti Viktor Emanueli III i dorëzoi delegacionit shqiptar dokumentin e statutit të ri të hartuar në Romë, që do të hynte në fuqi më 4 qershor 1939.

Statuti përfshinte 54 artikuj, të adoptuar kryesisht prej dispozitave që zbatoheshin në Itali.

Art. 1 - shpallte Shqipërinë monarki konstitucionaliste;

art. 2 - caktonte flamurin e ri kombëtar;

art. 3 - vendoste shqipen si gjuhë zyrtare të vendit;

art. 4 - garantonte lirinë e besimeve;

art. 5 - përcaktonte ushtrimin e pushtetit legjislativ nga mbreti në bashkëpunim me një “Këshill Korporativ”. Thirrja e Këshillit, përpilimi i rendit të ditës, emërimi i presidentit dhe zv. presidentit i rezervohej kurorës, e cila kishte mundësi të gjera influence. Pjesa tjetër e statutit ishte identike me atë të imperos.

9. Prokurori Misto Treska duhej të dinte se për t’u shqiptuar një dënim duhet të ekzistojë vepra penale, ose elementet e saj, siç janë: sjellja e njeriut (veprimi ose mosveprimi), rrezikshmëria shoqërore, përcaktimi i një vepre penale, pasoja, lidhja shkakësajore mes veprimit (mos veprimit) dhe pasojës, përgjegjësia penale. Një vepre penale, po t’i mungojë ndonjë nga elementet e mësipërme, vihet në pikëpyetje ekzistenca e saj, d.m.th. nuk kemi vepër penale, Botimet në revistën “Hylli i Dritës” duhej të ishin përcaktuar në ligj si vepër penale. Po që se dënimi nuk është i paraparë me ligj nuk mund të shqiptohet, ky element

është i njohur edhe në maksimën latine, NULLA POENA SINE LEGE,(ASNJË DËNIM PA LIGJ)

10. Në zgjedhjet e vitit 1936 për kryetar të bashkisë së Korçës kërkoi të kandidonte dhe komunisti Koç Xoxe. Qeveria e kohës nuk e miratoi kandidaturën e tij sepse ligji në fuqi nuk lejonte një person të burgosur të kandidonte për këtë post.

Demonstratë u organizuan nga sindikatat e komunistët e kohës kundër pabarazisë sociale e farfërisë që mbizotëronte në këtë kohë. Demonstrata u shtyp me forcë. Kjo demonstratë pati jehonë në shtypin e kohës dhe u trajtua nga këndvështrime të ndryshme. Shumica e shtypit e trajtoi këtë demonstratë si e motivuar nga fryma bolshevike. Propaganda e historiografisë komuniste e Enver Hoxhës e trajtoi këtë demonstratë si vepër e komunisteve shqiptarë. Në Korçë në vitet 1929-30 kishin lindur celulatat e para ilegale komuniste. Padër Anton Harapit ka mbajtur disa ligjerata nga 29 prilli deri më 4 maj të vitit 1936 me intelektualët e qytetit të Korçës, ku foli për vlerat shpirtërore fetare e atdhetare që ishin në kundërshtim me vlerat ateiste të shoqërisë komuniste.

11 . Pjesë nga fjalimi i Padër Harapit:” ...Nëse shteti dhe feja ndodhen në një konflikt të heshtur me njëri tjetrin, e ardhmja është e pasigurtë. Ju s’jeni të ndershëm e as jeni shqyptar në vështrimin e njëmendt, prej se jeni kundër shtetit. Kështu nuk kemi ma luftë mendimesh por krizë jete e revolucjon.

12. Dopolavore përshtatja në shqip: Pas pune, një nga format e edukimit të masave me idetë ekstremiste fashiste, në mendësi e formë janë të njëjta

me edukimin ekstremist komunist të masave në Shqipëri

13. *Shoqëria e Jezuit (lat. Societas Iesu) është një kongregacion ose urdhër fetar i Kishës Katolike që zanafillën e vet e ka në Spanjën e shek. XVI. Anëtarët e këtij urdhëri quhen Jezuitë (lat. Iesuitae).*

14. – *Besoj se letra që i referohet prokurori duhet të jetë lëtër drejtuar Françesko Jakomonit qu purfaqwsonte pushtetin mbretwror tw Perandorisw Italiane nw Shqipwri prandaj letra I drejtohej me emurteswn “Mbret” për probleme financiare, sepse në studimet Albanologjike nuk dokumentohet se Padër Gjergj Fishta të ketë pasur korospondencë direkt me Mbretin e Italisë Viktor Emanuelin e III-të. Janë në fokusin e studjuesve dy letra të Padër Gjergj Fishtës njëra drejtuar Betino Musolinit për ta ndihmuar financiarisht për botimet e tija letrare dhe një tjetra drejtuar Françesko Jakomonit për të ndihmuar Albanologun Norbert Joglin. Kwtw argument na e purforcon dhe pohimet e Mirash Ivanaj gjatw hetuesisw, i cili tregon: “se me rastin e proçesit të A. Harapit kemi komentue me Skwnder Laurasin ma tepër një dokument të shkruem prej Gj. Fishtës që i a drejtonte Jakomonit tue kërkue disa miliona”. Dosja gjyqwsore nr 1160 Mirash Ivanaj.*

• *Mu duk me interes për temën e arsimit në Shqipëri të jap dhe mendimet e Mirash Ivanajit për këtë problem, Mirash Ivanaj ish Ministër i Arsimit 1932-1933 deklaroi: “Qëllimi i klerit katolik të Shkodrës tue i shërbye Austrisë ishte që të mbajë*

popullin e kësaj krahine të ndamë (katolik-mysliman) duke shkaktuar herë-pas-herë trazime me anë të elementeve të ndryshëm fetare kështu që Austrija në raste të volitëshme të mundesh të ndërhynte, ashtu si ka ndërhy, duke e okupue, në 1876 Bosnien-Herzegovinën, të dy këto krahina hapën në Shkodër, nën mbrojtjen dhe me shpenzimet e Austrisë shkolla fillore, dhe ndonse kishin mundësi me mbajtë dhe shkolla ma të nalta, këto pak i hapën, për arsye se dojshin me mbajtë popullin n'injorancë. S'lejojshin që fëmijët katolik të Shkodrës të mershin bursa nga Austrija ose Italia, të vazhdojnë mësimë më të nalta se ato të njëj shkollë normale. Për me vertetue këtë mjafton të them se kurë u krijua Shqipnia, 1912-1913 nuk u gjet një i vetmi katolik i Shkodrës që të jetë profesionist i kryem (mjek, ingjnier, profesor, avokat).

Në mos gaboj në vjetin 1921 u bisedue në Parlament hapja e një liceu Shtetnor në Shkodër. Deputetët e Shkodrës (ndër këta Gjergj Fishta dhe Mazrekaj) kundërshtuan këto hapje, tue thanë se me një subvencion (2000 franga) që do tu jepej françeskanëve, këta do të bajshin liceun, pa qenë nevoja për një lice shtetnor. Qëllimi ishte me i mbyll shtegun këtij të fundit. Subvencioni u dha, liceu françeskan u hap, por siç ishte parapra, asnjë nga myslimanët nuk shkoj në të. Një vjet më vonë shteti u detyrua me hap liceun e vet, që u frekuntua vetëm nga myslimanët. Në liceun françeskan Italia dërgonte edhe mësues te vet , ndërsa liceu i Jezuitëve, dhe ky për katolikët, ishte tanësisht në duar të jezuitëve italianë. Shteti shqiptar asnjëherë nuk bani ndonji reafektim (reagim Aj). Mësimi ndër këto dy shkolla klerikale ishte, si kudo, shumë e cekët, tue pasë për qëllim vetëm edukimin fetarë dhe ç'dukjen e ç'do ndjenje nga mendët e rinisë katolike.

Besoj se edhe sot shumë katolik të Shkodrës, nxanës të dikurshëm të klerit thonë: më parë jam katolik pas-taj shqiptar.

Kleri katolik i përhapur në katundet e krahinës së Shkodrës, kurr nuk e ka mësue shkrimin dhe leximin një të vetmi. Kështu që ajo krahinë ka pas ngelë 100% analfabete.

Si bani për liceun në Shkodër (kurë e hapi të vetën tue pa se shteti donte me hap atë të shtetit) kështu kleri katolik veproj edhe kurrë në rininë e Shkodrës, pa dallim feje, u ndie nevoja për shoqni sportive ose letraro-kulturale (1920-1922) për me ja pre hovin bashkimit t'elementave në këtë fushë, kleri e mori si sportin ashtu çdo inisiative tjetër, tue u ba si vetë inisiatorë, udhëheqës dhe drejtues, por tue ekskluduar (përjashtuar Aj) nga ato shoqërina myslimanet.

Në vjetin 1933, kurë u mbyllën shkollat e klerit, në liceun shtetnур të Shkodrës s'kishte me se 2-3 të katolikëve. Po kështu dhe shoqërinat sportive-kulturale ishin të ndamë 100% sipas besimit.

Italia fashiste ka pas ba zakon që shkollave të veta jashtë Italis, t'u dërgoj në zarf të mbyllun një theme (temë) për t'u zhvillue ditën e 21 të Prillit (fjalimi në Romë i Musolinit për lëvizjes fashiste Aj) kjo theme u vinte rregullisht edhe shkollave klerikale të Shkodrës.

Botnisht dihej se konsullata Italiane në Shkodër i paguante rrogat mujore klerit katolik.

Pasi në vend t'Austrisë erdhi Italia, kleri filloj me ndjek politikën e ndarjes së krahinave të Shkodrës nga Shqipëria ose të paktën krijimin e një kantoni autonom. Besoj se këtij qëllimi dishrohesh t'arrihej, pak nga pak, trazinat e para në Mirditë si dhe krijimi

i grupit “Orave e maleve” krejt katolik, inisiatorët dhe drejtuesit e të cilit ishin Gjergj Fishta, Anton Harapi, Lazër Shantoja, Ambroz Merlaskaj.

Në 1933/34 kurë u shtetëzuan shkollat, ndonse liria e mësimit të besimit u dha të 6 kryetarëve të besimit katolik në Shqipëri (Ipeshkov dhe Arqipeshkov emërat nuk a u di) të shtytun nga Italia i u drejtun shoqnisë së kombëve me protest, tue thanë se flisnin në emër të minoritetit katolik të Shqipërisë. Mjafton të mendohet se Shqypnia qysh në 1921 kishte deklaruar nuk ka fe zyrtare, e pra nuk mund të kishte as minoritete fetare”. Mirash Ivanaj dosja Gjyqësore-Hetimore 1160

**Në vazhdim të temës së arsimit po ju jap të lexoni materialin e mëposhtëm: “Qeveritë shqiptare mbas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë i kushtuan një kujdes shumë të madh laicizimit dhe modernizimit të shkollës së re shqiptare në kushtet e një populli të pavarur e me shtetin e tij. Një konflikt i ashpër ndërmjet autoriteteve të Shtetit dhe Kishës Katolike shqiptare ndodhi për shkollat katolike të mbyllura nga Mbretëria Shqiptare më 1933 dhe të rihapura vetëm më 1936. Për tre vjet kleri katolik shqiptar e trajtuan mbylljen e shkollave fetare katolike të cënuara nga shteti dhe protestuan ashpër kundër qeverisë së Tiranës. Mbyllja e shkollave katolike dhe jo vetëm të katolikëve në Shqipëri u bë nën idenë shtetëzimit të të gjitha shkollave private dhe të hua që ndodheshin në Shqipëri. Në vitin 1932 ministri i arsimit, Hile Mosi në polemikë me francezkanët e "Hyllit të Dritës" shkruante: „... Shtetit, që*

është udhëheqësi i popullit do t'i siguroj një të drejtë dhe një kontroll më radikal në arsim, për të mos edukuar një rini me ndjenja materiale... por plot vetëmohim për shoqërinë dhe për kombin e vet.

** Ligji për arsimin i ministrit Mirash Ivanaj, më 11 prill 1933, kishte karakter të përgjithshëm dhe nuk cënonte të drejtat e minoriteteve. Kështu, pakicat greke mund të mësonin lirisht greqishten si gjuhë amtare në shkollat e shtetëzuara. Pasi, kjo masë konstitucionale e qeverisë shqiptare përfshinte të gjitha shkollat private, si: 1) ato amerikane, 2) shkollat e jezuitëve, të françeskanëve e kurset e natës italiane 3) shkollat private të minoritetit grek, të subvencionuara nga fonde që vinin përtej kufirit. Shteti shqiptar çmonte se konsolidimi i kombit buronte nga edukimi i të rinjve që administrohej nga institucionet vendase. Prandaj, ligji mbi shkollat përbënte një nga politikat e Shqipërisë për independencë të plotë dhe për të zhdukur ndikimet e huaja.*

“Nën pushtimin e Perandorisë Osmane, katolikët shqiptarë, lidhjet e tyre me Vatikanin i mbajtën përmes Propagandës Fide,(“Propaganda Fide” themeluar nga Papa Gregori XV më 6 janar 1622, organ i koordinimit të Selisë së Shenjtë për të ndihmuar Kishat vendore në të gjitha kontinentet.) me qendër në Romë. Perandoria Otomane i dha të drejta Austrisë, po ato të drejta të trashëguara më parë nga Venediku, për kujdesin e mbrojtjen e katolikëve të Evropës nën sundimin Osman, si dhe për të mbështetur financiarisht klerin katolik e për të hapur e drejtuar kishat e shkollat e tyre. Pas Luftës së Parë

Botërore, në vitin 1918 kemi shpërbërjen e Perandorisë Austro-Hungareze. Kjo i dha fund protektoratit mbrojtës e kulturor të Austro-Hungaris mbi katolikët shqiptarë. Në Shqipëri vepronin dy urdhra kryesorë katolikë: françeskanët dhe jezuitët. Vendosja e tyre u mundësua nga Konkordati (marëveshja) që ishte lidhur mes Vatikanit dhe Austrisë, në vitin 1855. Në Shkodër, me financimin e tyre, më 1857, u ndërtua seminari i jezuitëve, i cili në vitin 1862 u ngrit në rangun e një Seminari Papnor [ndërdioqezan]. Më 1861 u themelua seminari françeskan. Ata hapën një shtypshkronjë, ku u shtypën libra fetarë e laikë në gjuhën shqipe, si dhe nxorën organin periodik letrar kulturor “Hylli i Dritës”, Shkodër, (1913-1944). Jezuitët, hapën shtypshkronjën “Zoja e Papërlyeme”, kishin organin e tyre periodik “Elçija e zemrës së Jezu Krishtit”, (Fjala latine elegia nënkupton “elegji”, një formë poetike që shpreh ngushëllim, dhimbje apo përkujtim pas humbjes së dikujt. Ajo përdoret për të shprehur emocione të thella, zakonisht lidhur me vdekjen apo humbjen e të dashurve Aj). Shkodër, si dhe themeluan kolegjin “Saverian”, i cili e vuri theksin tek arsimimi në gjuhën shqipe, krahas as italiane. Nga kjo shkollë dolën figura kombëtare dhe shkrimtarë të njohur si Faik Konica, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Ernest Koliqi etj. Në vitin 1921, në Shkodër, duke imituar shkollat e Austrisë, u hap Gjimnazi Françeskan, gjimnaz klasik, me drejtor at Gjergj Fishtën.

**Mbas shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze në vitin 1918 ndihmat financiare për klerin katolik shqiptarë u ndërprejnë. Në vitin 1919 Vatikani aprovoi propozimin e bërë nga arqipeshkvia e Shkodrës që kisha katolike shqiptare të pranonte ndihma financiare nga shteti Italian. Për një periudhë*

kohe kisha katolike shqiptare për zhvillimin e aktivitetet e saj financohej, nga Vatikani, qeveria Italiane dhe një pjesë nga vet administrimi i të ardhurave që buronin nga aktivitetet e kishës. Mbas vitit 1925 qeveria shqiptare filloi të financonte klerin katolik dhe u ndërpreu financimet nga Italia.

Gjatë periudhës 1920-1939, shtetit shqiptar synoi në vendosjen e parimeve kombëtare për veprimtarinë e institucioneve fetare, por edhe një kontroll të përgjithshëm të shtetit mbi bashkësitë fetare. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe komuniteteve u lidhën me statute, që pasi miratoheshin nga organizmat përfaqësuese të komuniteteve fetare, kalonin në Këshillin e Ministrave për tu verifikuar nëse ishin në përputhje me normën dhe ligjet në fuqi. Qëllim ishte që të arrihej bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i të tria bashkësive fetare në Shqipëri, si dhe për t'i shndërruar institucionet fetare qëndra stabiliteti në Shqipëri. Shteti nxiti dhe mbështeti pavarësinë, administrative e financiare të feve të ndryshme në Shqipëri duke tentuar ndalimin e ndikimit të shteteve huaj mbi klerin shqiptar.

Sistemi arsimor në Shqipëri, pas Shpalljes së Pavarësisë 1912 deri në vitin 1939, iu nënshtrua ndryshimeve të vazhdueshme dhe rritjes së cilësisë së saj. Me gjithë vështirësitë dhe mungesat e shumta, ai u fut në rrugën e konsolidimit dhe të laicizimit. Nga reformat e ndërmarra sidomos gjatë viteve të mbretërimit të Ahmet Zogut, më e bujshmeja ishte shtetëzimi i shkollës shqiptare. Qëllimi ishte që “T”i jepej një prirje më homogjene shkollës kombëtare”. Ajo u shtri në të gjitha aspektet e sistemit shkollor, por “Pa u përgojuar feja në shkollë” duke respektuar ndjenjat

fetare të popullsisë si një e drejtë civile e pamohueshme. Në fakt, kjo reformë ishte një masë antiitaliane e anti greke dhe një riafirmim i pavarësisë së Shqipërisë përballë ndërhyrjes së shtetit Italian e grek. Zbatimi i Reformës së ministrit të arsimit Mirash Ivan, prill 1933, çoi në mbylljen e të gjitha shkollave private. Gjithsej 85 shkolla nga të cilat: 21 shkolla shqiptare private jo fetare; 14 shkolla klerikale myslimane; 4 shkolla klerikale ortodokse e 10 shkolla private të minoritetit grek, si edhe 19 shkolla të hua për shqiptarë. Të njëjtin fat patën edhe 17 shkolla katolike që i përkisnin jezuitëve, françeskanëve dhe motrave françekane stigmatine, në të cilat mësonin 2560 nxënës. 12 prej këtyre shkollave ndodheshin në Shkodër, ndërsa pjesa tjetër në Tiranë. U mbyllën 8 shkolla të vogla filllore me 160 nxënës, në zona ku nuk kishte as shkolla shtetërore.

Për përgatitjen e klerit u lejuan vetëm shkollat fetare të varura prej komuniteteve, me kusht që të mos zhvillonin propagandë antishqiptare. Në vitet 1933-1935, ipeshkvijnjtë katolikë shqiptarë iu drejtuan Lidhjes së Kombeve, duke kërkuar ndërhyrjen e saj pranë qeverisë shqiptare për heqjen e masave kundër shkollave të tyre. Pas dy viteshsh, çështja e shkollave private u kthye në një problem me karakter ndërkombëtar. Qeveria greke iu drejtua Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, e cila nuk vërejti shkelle të të drejtave të minoriteteve, por meqë çështja kishte karakter juridik ia drejtoi Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës, i cili me shumicë votash u shpreh kundër shtetëzimit të shkollave private. Qeveria shqiptare në zbatim të

vendimit të Gykatës Ndërkombëtare, rihapi shkollat katolike, si dhe ato private të minoriteteve greke etj shkolla private. Në prag të pushtimit italian, në Shqipëri kishte 22 kopshte për fëmijë, 40 edukatore, 647 shkolla fillore të sistemit me pesë klasë, në të cilat jepnin mësim 1340 mësues e mësonin 56932 nxënës. Arsimi i mesëm ishte i ndarë në dy cikle: i ulët dhe i lartë, me dy degë klasike dhe reale. Më të vjetrat ishin gjimnazi “Illyricum” i klerit françeskan dhe kolegji “Saverian” i etërve jezuitë. Krahas tyre vepronin edhe gjimnazi i shtetit po në Shkodër, liceu frëng në Korçë, liceu në Gjirokastër, gjimnazi i Tiranës, shkolla normale, Instituti Femëror “Nëna Mbretëreshë”. Shkollat profesionale ishin ajo teknike në Tiranë, tregtare në Vlorë dhe shkolla bujqësore në Kavjë. Po ashtu kishte edhe shkolla profesionale teknike, të ulëta pune etj.

Material i marë nga studimi i Blerina Kuqi: “Shkollat katolike gjatë pushtimit Italian prill 1939-shtator 1943”

15. Këtu ka kuptimin i pari i Françeskanëve të Shqipërisë.

16. Salavadore Meloni, konsull Italian në Vlorë 1922, Konsull Italian në Shkodër 1929-1939, Sekretar i Përgjithshëm i Luogotencës 1939-1943 në periudhën e pushtimit të Shqipërisë nga Italia

17. Padër Mati Prendushi, lindi në Shkodër, më 2 tetor 1882. Me vendim nr. 2, datë 8 janar 1948, Gjykata Ushtarake Shkodër e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me vdekje, humbjen përgjithmonë të të drejtave civile e politike, si dhe

konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme. U arrestua më 15 nëntor 1946 dhe u ekzekutua më 11 mars 1948, ora 05:00 e mëngjesit.

18.Françeskanët janë një grup urdhrash fetarë të ndërlidhur të krishterë brenda Kishës Katolike. Themeluar në vitin 1209 nga frati katolik italian Shën Françesku i Asizit, këto urdhra përfshijnë tre urdhra të pavarura për burra (Urdhri i Fretërve të Vegjël është rendi më i madh bashkëkohor i meshkujve), urdhra për gra fetare si Urdhri i Shën Klarës dhe Urdhri i Tretë, Urdhri i Shën Françeskut, është i hapur për anëtarët meshkuj dhe femra. Ata u përmbahen mësimëve dhe disiplinave shpirtërore të themeluesit dhe të bashkëpunëtorëve dhe ndjekësve të tij kryesorë, si Shën Klara e Asizit, Shën Antoni i Padovës dhe Shën Elizabeta e Hungarisë. Ekzistojnë gjithashtu disa urdhra më të vegjël protestantë françeskanë, veçanërisht në traditat anglikane dhe luterane (p.sh. Komuniteti i Francisit dhe Klarës)

19.Patër Geraldin Pali ? (Padër Bernardin Pali lindi në Shkodër, 2 tetor 1946 – vdes në 2 dhjetor 1946 frat françeskan, mbledhës folklori dhe poet. E arrestuan në Kuvendin e Rubikut më 22 tetor 1946. U akuzua si "Agjent dhe bashkëpunëtor i fashizmit". Vdiq në burg, para se të "Gjykohej" më 2 dhjetor 1946.)

20.Viceré Marchese Francesco Jacomoni di San Savino, në Shqipëri u njoh si Mëkëmbësi i Jacomonit (lindi në Reggio Calabria, 31 gusht 1893 – vdes në Romë, 17 shkurt 1973) ishte një diplomat italian gjatë sundimit fashist. Ai shërbeu si këshilltar i ministrit në

Tiranë nga 9 shtator 1936 deri në pushtimin italian të Shqipërisë në prill 1939. Më 17 prill 1939 ai u emërua ambasador në Shqipëri e më 22 prill bëhet Mëkëmbës i Përgjithshëm (Viceré, mëkëmbës i mbretit Vittorio Emanuele III) i Mbretërisë së Shqipërisë.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u gjykua së bashku me zyrtarë të tjerë të lartë të regjimit fashist. Më 12 mars 1945 ai u dënua me 24 vite burg, por u lirua shpejt në sajë të amnistisë nisur nga qeveria në qershor 1946. Dënimi i tij u ndryshua në fund mars 1948. Ka shkruar më pas një libër mbi politikën italiane gjatë pushtimit fashist të Shqipërisë. Vdiq në Romë, më 17 shkurt 1973.

21. *Mendoj se do jetë ndonjë artikull që do të jetë shkruar rreth viteve, kur revista drejtohej nga Padër Gjergj Fishta. Tema duhej të ketë qenë “Lëvizja e Dukagjinit” e vitit 1926 e cila ishte një lëvizje e armatosur antiqeveritare, e me frymë fetar, midis të tjerëve e drejtuar dhe nga prifti françeskan Dom Loro Caka i cili mbas dështoi kryengritja ai u arratis jashtë atdheut, u dënua me vdekje nga gjykata në mungesë. Prifti tjetër françeskan Dom Gjon Gazuli si një nga drejtuesit e pjesmarësit në këtë kryengritje u dënua me varje u ekzekutua në Shkodër. Është i vetmi prift katolik që është dënuar e ekzekutuar me vdekje gjatë qeverisjes së Ahmet Zogut si Kryeministër, President e Mbret. Gjatë rregjimit komunist priftërinjtë katolik u përballën me dhunën ekstreme të rriqimit si pushkatime, burgime, internime që çoi në rrënimin e institucionit katolik në Shqipëri.*

22. *Mas'har Bekteshi, komunist që nga koha e grupeve komuniste, gazetar në radio Shkodrën, spikër radio, gazetar në gazetën e P.P.Sh. Zëri i Popullit në Tiranë.*

23. *Kol Mëhilli ???*

24. *Dom Mëhill Jaku ???*

25. *Ernest Koliqi (lindi në Shkodër, 21 m 1901 – vdes në Romë, 15 janar 1975) ishte poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, dramaturg, albanolog, mësuës, politikan, botues. Cilësohet së bashku me Mitrush Kutelin si themelues i tregimit modern shqip-tar, me përmbledhjet “Hija e Maleve” (1929), “Tregtar flamujsh” (1935) dhe “Pasqyrat e Narçizit” (1936).*

Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia më 1939 u emërua ministër i Arsimit, ndërsa më 1942 u caktua Kryetar i Këshillit të Epërm Korporativ Fashist, legjislativi i kohës së pushtimit.

Me ardhejn e komunistëve në pushtet largohet nga Shqipëria e vendoset në Romë, ku vazhdoi jetën e tij intelektuale e politike. Bënte pjesë në Komitetin drejtues të Bllokut Independent. Themeloi dhe drejtoi disa revista të përkohshme, prej të cilave “Shëjzat” që më e rëndësishmja dhe më jetëgjata. Drejtoi katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në kryeqytetin italian, mbi bazën e së cilës pas 1957 u ngrit Instituti i Studimeve Shqiptare.

26. *Coridignano-n - Fulvio Kordinjano, jezuit, lindi më 19 tetor 1887, vdiq në 9 maj 1952, albanolog. Nga viti 1926 deri 1942 shërbeu si misionar në Shqipëri. Në vitin 1942, mbas disa polemikave publicistike që kishin lidhje me historinë e Shqipërisë, dhe*

reaksioni që u krijua ndër shqiptarët për studimin e tij, jezuitët e larguan nga Shqipëria. Ka botuar një numër studimesh për shqiptarët e Veriut. Prifti jezuit italian, albanologu Fulvio Cordignano, botoi një shkrim në “Revista d’Abania” në Mars 1941, ku i paraqiste shqiptarë nga një këndvështrim që s’u pëlqye nga opinioni publik shqiptar. Ky shkrim nxiti një reagim të madh sidomos në Shkodër, ku priftërinjtë fraçeskanë dhe intelektualët e Shkodrës iu përgjigjen me një sërë artikujsh e me një broshurë ku argumentonin të kundërtën. Këtij artikulli anti-shqiptar iu kundërvunë dhe At Gjergj Fishta, Dom Nikoll Mazreku, Lasgush Poradeci, gjuhëtari Eqerem Çabej e shumë të tjerë. Nga presioni i madh i shqiptarëve, që bënë një peticion të firmosur nga shumë njerëz të rëndësishëm të kohës, falë këtij reagimi, autoritetet klerikale jezuite e larguan nga Shqipëria autorin e shkrimit. Padër Anton Harapi ishte pjesë e autorëve që ju kundërvunë artikullit të Fulvio Cordignano dhe një nga nëshkruesit e peticionit për largimin si i pa dëshiruar të autorit të shkrimit.” Kritikues” ishte pseudonimi i Padër Anton Harapit

** Dy fjalë përdoruesit të sotëm të këtij Fjalori – Nga Ardian Ndreca – Botimi anastatik i Dizionario italiano-albanese i At Fulvio Cordignano*

Kontributi i At Fulvio Cordignano në lamijen e studimeve shqiptare asht i mirënjohun, edhe pse shpeshherë i errsuem prej një polemike të ushqyeme prej krajetave të një kohe të vështirë siç ishte ajo e Luftës së Dytë botnore, kur pakkush mbërrinte me ruejt gjykimin pa ryesni e hove pasionale.

Fulvio Cordignano ka lindë me 19 tetor 1887 në Moggio (Udine). Në majin e vitit 1905 hyn në Urdhnin

Jezuit dhe mbas provës dhe studimeve të para në Soresina e në Cremona e gjejmë në vitet 1912-1916 në Kolegjin Papnor të Shkodrës ku përveç studimit të gjuhës shqipe jep landë të ndryshme si besim të krishtenë, latinisht, greqisht, italisht, aritmetikë, algjebër dhe histori. Në vitin 1917 dërgohet në Velehrad ku fillon studimet teologjike që do t'i vijojë në Lion, Hastings, Dublin dhe do t'i përfundojë në Louvain. Në vitin 1921 ndodhet në Romë si student pranë Institutit Biblik dhe punon për të përkohshmen La Civiltà Cattolica.

Në vitin 1924 rikthehet pranë Kolegjit jezuit në Shkodër ku jep landët latinisht, greqisht, histori civile dhe kishtarë, gjuhë italiane dhe filozofi. Gjatë kësaj periudhe të qëndrimit në Shqipëri, pikërisht në vitet 1926-1941 merret kryesisht me studime historike dhe hulumtime në fushën e gjuhës dhe antropologjisë kulturore. Gjithashtu asht kujdestar i Muzeumit të Etënve jezuit. Ndërkaq në gusht të vitit 1928 merr edhe kushtin e katërt të Shoqnisë së Jezuit. Kthehet përfundimisht në Itali dhe kalon vitet 1942-'48 pranë kolegjit të Padovës dhe atij të Gorizia-s. Në vitin 1949 eprorët e dërgojnë në Palermo. At Cordignano vdes në Romë me datën 9 maj 1951.

*Ndër veprat e tija ma të randsishme përmendim: *Lingua albanese: (dialetto ghego): grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e proverbi*, Hoepli, Milano 1931; *Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande missionario italiano il P. Domenico Pasi S.I. (1847-1914)*, 3 vëll., Istituto per l'Europa Orientale, Roma 1933-'34; *Geografia ecclesiastica dell'Albania: dagli ultimi decenni del secolo XVII*, Pontificio Istituto Orientale, Roma 1934; me bashkëautor At Zef Valentinin: *Saggio di un regesto storico dell'Albania*, Shkodër*

1937-1940; *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese (il nuovo “Jungg”)*, Hoepli, Milano 1934; *Dizionario italiano-albanese*, Shkodër 1938; *Epopeja komtare e popullit shqyptar*, Shkodër 1925; *Vasha n’epopen kombtare të popullit shqyptar: Tringa e Malcis*, Shkodër 1939. Nuk mungojnë ndër këto vite edhe shkrimet e tija apologjetike dhe polemike.

27. Padër Anton Harapi ishte nga të paktët klerikë që tregoi një rezistencë të hapur ndaj Italisë. Kjo bëri që brenda një kohe të shkurtër të fillonin përpjekjet për largimin e tij nga Kuvendi me qëllim që gjimnazit françeskan t’i krijonin pengesa lidhur me programin dhe organizimin shkollor. Por krahas at Anton Harapit nuk munguan edhe emra të tjerë që u pozicionuan kundër fashizmit. Kështu , Athanas Geg OFM, Gjon Shllaku OFM dhe dom Lek Luli u burgosën ose u dëbuan nga vendi. (Pjesë të marura nga studimi i historianit Hasan Bellos: *Kisha dhe kleri në periudhën e pushtimit italian 1939-1943*)

28. Leonardo de Bello, prift françeskan, profesor. Ai ishte një françeskan nga Provinca Veneciane. Ai hyri në urdhërin françeskan në vitin 1897 dhe u shugurua meshtar në vitin 1905. Emërohet menjëherë mjeshtër i disiplinës dhe mësues i filozofisë, teologjisë, liturgjisë dhe këngës gregoriane, pastaj u zgjodh gjeneral provincial dhe vizitor. Në vitin 1933 u zgjodh ministër i përgjithshëm dhe u rikonfirmua deri në vdekjen e tij të papritur në vitin 1944.

29. Prokurori ankohet për internimet e dënimet që kanë bërë pushtuesit e huaj në Shqipëri, kur vetë rregjimi komunist shqiptar sapo mori pushtetin aktet

e para represive ish in dhe internimet e familjeve të kundërshtarëve të tyre politik, ata persekutuan shqiptarët, bashkëkombësit e tyre në mënyrën më ekstreme të mundëshme. “Në arkivin e Ministrisë së Brendshme të Republikës Popullore të Shqipërisë deri në vitin 1990 rezultojnë të dënuar 25 mijë të burgosur politikë, por duke qënë se mungojnë statistikat e të dënuarve të periudhës nga 1945 në 1946 dhe të dënuarve me dënime të vogla, besohet se të burgosurit politikë në Shqipëri kanë qënë mes 30.000 dhe 34.000. Sipas një raporti të publikuar më 2016 nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) në Shqipëri, të burgosurit politikë ish in 26.768 burra dhe 7.367 gra; Që prej vitit 1949, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, por nën kontrollin e rreptë të Komitetit Qendror të partisë komuniste Shqiptare, funksiononin komisione të posaçme, të cilat merrnin vendimet për masën e internim-dëbimit (Komisioni i Dëbimeve dhe Konfiskimeve 1945-1954); Komisioni i Internim-Dëbimeve 1955- 1976 dhe 1980-1990; Komisioni i Veçantë i Internim-Dëbimeve 1977-1979; Komisioni Qendror i Internimeve dhe Dëbimeve 1990.

Sipas një raporti të publikuar më 2016 nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) në Shqipëri, në periudhën 1944 – 1990 të internuarit ish in 59, 000 njerëz

30. Akuzat që rëndomtë ju bëheshin të akuzuarve në gjyqet komuniste formuloheshin nga “Komisionet hetimore të posaçme” të ngritura si strukturë në Kongresin e Përmetit 1944, për hetimin e krimeve e

krimenelëve të luftës. Këto ishin organe jo të ligjshme e të pavarura, të varura nga qeveria, pa arsimin e duhur profesional për këtë aktivitet. Ata u kthyen në organe abuzimi e shpifjesh. Mungesën e provave sipas kuptimit të ligjit e zëvendësuan me shpifje e dëshmitarë të pa besueshëm. Drejtësia komuniste shqiptare tërësisht e paligjshme nuk e kishte problem të dënonte kundërshtarët e tyre politik pa fakte, prova e pa logjikën më elementare të interpretimit të ligjit. Shtrembërimi i drejtësisë e vendosja e drejtësisë në shërbim të enverizmit ishte kthyer në normë morale. Veprimet e konsideruara si të dënueshme duhet të ndëshkoheshin sipas ligjit që ishte në fuqi në kohën e veprës penale, d.m.th ligjit të shtetit shqiptar para vitit 1944 dhe vetëm nëse akti ishte gjithashtu i dënueshëm sipas ligjit. Gjyqësori komunist shqiptar nuk duhej të dënonte një njeri në qoftë se ligji nuk e kishte parashkruar veprimtarinë e tij në kohën kur është kryer. Ligji nuk ka fuqi prapavepruese.

Diktaturën enveriste e ke të vështirë na analizosh e ta kuptosh sepse ajo në shumicën e rasteve bazohet në instikte e dhunë individuale e jo në logjikën juridike. Shteti i së drejtës është shtylla e çdo sistemi politik. Kur veprimet e shtetit bazohen në parimet e shtetit të së drejtës, populli është i prirur të ketë besim tek autoritetet dhe mes tyre të bashkëpunojnë si pjesë të së njëjtës shoqëri. Nëse mungon shteti i së drejtës, njerëzit veprojnë në mënyrë instiktive. Shteti i së drejtës nënkupton një sistem ligjor që funksionon mirë, i cili siguron drejtim mbi rregullat bazë që përcaktojnë funksionimin e organizimit shoqëror dhe që ndihmon në vënien e tyre në praktikë.

Pjesa e dytë Pushtimi gjerman



Trupat ushtarake gjermane në Tiranë shtator 1944

Pushtimi gjerman dhe “Pavarësi relative e shtetit shqiptarë në kushtet e një pushtimi” ¹

Italia ishte në prak të kapitullimit në vjeshtën e vitit 1943. Shtabi i Përgjithshëm Gjerman dhe personalisht Hitleri ishin të prokupuar mbi boshllëkun teritorial që do linte Italia fashiste në Itali, Greqi, Shqipëri, Mal të Zi dhe mori masat përkatëse për sigurimin e frontit të luftës në Itali e Ballkan. Pa kapitulluar Italia një njësi ushtarake gjermane e komanduar nga Gjeneral Bessel, nga ish Jugosllavia zbarkoi në teritorin shqiptar si pjesë e teritorit të Perandorisë italiano-shqiptare, nga ajri duke u ulur në aeroportet shqiptare, detyra e tyre ishte informimi i gjëndjes në Shqipëri. Realisht gjermanët pushtuan aeroportet shqiptare (Perandoria italo-shqiptare) duke dërguar batalionin tokësajore “Brandenburg” nga ajri me parashut e zbarkim avjonësh. Gjatë kësaj periudhe shtator 1943 gjermanët kishin filluar bisedimet me Shtabin Italian të luftës që ata gjermanët të zhvendoseshin në Ballkan e për pasojë dhe në Shqipëri me Korparmata e III-të. Italianët nuk pranorin. Në Shqipëri milicia, xhandarmëria e ushtria italo-shqiptare po dezertonte e kudo kishte shenja shturje e kaos. Italia shpalli armpushimin me Aleatët në 04.09.1943. në 08.09.1943 u bë publike. Një pjesë e ushtrisë italiane bashkëpunuan me gjermanët, një pjesë qëndroi asnjënjëse e kush nga ushtria italiane kundërshtoi ndaj tyre u përdor forca ushtarake gjermane që i trajtuan italianët si dezertorë.

Për të pasur një administrim ushtarak qendror dhe efektiv në zonën Juglindore të Europës, gjerman-

nët formojnë një "Shtab Drejtimi të Europës Juglindore" në rangun e një komande të një armate me komandë dhe shtab administrativ, me të drejtat e plota të një komande ushtarake territoriale për zonën Juglindore të Europës. Këtij shtabi do t'i vihen nën komandë shtabet ushtarake të Greqisë Jugore, të zonës Selanik-Egje, Serbisë, Kroacisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Gjermanët në këtë situatë të pakënaqëshme për ta, mbas kapitullimit të Italisë, shpallën njohjen e pavarësisë Shqipërisë në kufitë që kishin vendosur italianët në vitin 1941. Qëllimi i tyre ishte pakësimi i pakënaqësisë të shqiptarëve nga futja e trupave ushtarake gjermane në Shqipëri. Ministria e jashtme gjermane përgaditi një ekip negociatorësh për të biseduar me shqiptarët e derisa të qartësoheshin gjërat, pushtetin ekzekutiv do ta kishte Armata e II e tankëve. Duke parashikuar një zbarkim të Aleatëve në bregdetin e Shqipërisë, Malit të Zi, Hitleri urdhëroi të emërohet një "Gjeneral përgjegjës për Shqipërinë" K.S.F.A. (Komandën Supreme të Forcave të Armatosura) lëshon një urdhëresë për këtë. I plotfuqishmi gjerman në Shqipëri u emërua Gjenerali Theodor Geib, por fuqia egzekutive ju la komandës së lartë të Armatës II të tankeve (Gjenerali Lothar Rendulic).

Si rezultat i marrëveshjes së arritur midis Gjermanisë naziste e një pjesë e klasës politike shqiptare u arrit ajo që në historinë tonë do njihej si "Pavarësi relative e shtetit shqiptarë në kushtet e një pushtimi".

U zhvilluan dy struktura kryesore paralele administrative të shtetit që shumë herë ndërthureshin midis tyre e shumë herë konfliktoheshin. Krahas

autoriteteve shqiptare, që përbëhej nga Këshilli i Lartë i Regjencës, Parlamenti, Qeverisë – vigjilonin fuqishëm e rreptë institucionet gjermane të luftës, realisht “Zotëruesit e territorit të banuar nga shqiptarët” si Gjenerali Fuqiplotë Gjerman në Shqipëri (D.G.A.) Gjeneral Fitztum, për Wehrmacht (Shtabit gjerman të luftës), gjenerali komandues i korpusit të XXI Korpusi i Ushtrisë Malore, Gjeneral Fehn.



Regjenca e Parlamenti e Shqipërisë 1943-1944



Regjentët në takim me drejtuesit e ushtrisë gjermane



Nga e majta e fotografisë Fuat Dibra, Mihal Zallari, Mehdi Frashëri, Padër Anton Harapi, Rexhep Mitrovica, Vehbi Frashëri



Lothar Rendulic

Lothar Rendulic. Lindi në 23 Tetor 1887 vdiq në 17 janar 1971. Ai lindi në Austri në një familje austriake me origjinë kroate. Ai ishte një nga tre austriakët që u gradua Gjeneral Kolonel. Ka studjuar për drejtësi, ekonomi e Akademi Ushtarake. Ka qenë pjesmarës në Luftën e Parë Botërore. Nazist. Ka marrë pjesë në luftën e Dytë Botërore në betejën e Kurskut në B.R.S.S. Nga viti 1943 deri në 1944, Rendulic komandoi Ushtrinë e 2-të të Panzerit në Jugosllavi. Organizoi sulmin për arrestimin e Titos në Drvar dësh-toi me humbje të mëdha ushtarake. Në Qershor 1944 komandon trupat në Finlandë e Norvegji. Më 7 maj 1945, Lothar Rendulic i dorëzon amerikanëve komandën e ushtrisë së tij. Më 19 shkurt 1948 ai u shpall fajtor për krime lufte dhe u dënua me njëzet vjet burg. Ky dënim më vonë u reduktua në dhjetë vjet, dhe më 1 shkurt 1951 u lirua nga burgu ushtarak.



Jozef Fitzthum (1896-1945)

Josef Fitzthum lindur në 14 Shtator 1896 vdes në 10 janar 1945. Kombësia Austriake. Anëtar i lartë i partisë Naziste. Përfaqësues Special i Reichsführer-SS Heinrich Himmler në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fitzthum Nga tetori 1943 deri më 1 janar 1945 Fitzthum u emërua Përfaqësues Special i Reichsführer-SS nga Heinrich Himmler për të vepëruar si i plotfuqishëm i tij personal në Shqipëri. Si një ish-shefi i policisë së Vjenës, detyra kryesore e deklaruar e Fitzthum ishte rindërtimi i forcës policore shqiptare. Megjithatë, ai krijoi shpejt idenë për të ngritur një legjion shqiptar siç kishin bërë austriakët në Shqipëri, gjatë Luftës së Parë Botërore. Nga prilli deri në qershor 1944 Fitzthum organizoi rekrutimin dhe stërvitjen e Divizionit të 21 Malor SS Skënderbeut kjo nisëm e tij dështoi nga kundërshtimi i një pjese të klasës politike të shqiptarëve të kohës të cilët nxitën dezertimet e shqiptarëve. Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë e kësaj periudhe ishte kategorisht kundër këtij Divizioni që varej nga ushtria gjermane. Në paaftësinë për të ngritur një Divizion me shqiptar,

Himmler urdhëroi shkrirjen e divizionit. Gjenerali Fitzthum përfaqësuesi i Himlerit në Shqipëri erdhi në Tiranë gjatë Janarit 1944, mbasi ndenji në Kosovë e Shkodër disa kohë për orientim. Gjenerali Fitzthum, komandonte një organ urdhërues e cila merrej me politikën e brendshme të Shqipërisë, dhe me mbrojtjen e rendit. Komanda e tij ishte në hotelin “Kontinental”



Gustav Fehn

Gjeneral Fehn i Infanterisë, (këmbësorisë) komandant i korparmatës malore XXI në Tiranë. Gustav Fehn (21 shkurt 1892 - 5 qershor 1945) Gjeneral-Major. Ka marë pjesë në operacionin ushtarak për pushtimin e Polonisë, në luftimet në Jugosllavi e Greqi Ka luftuar në frontin Perëndimor, ka marë pjesë në luftën kundër B.R.S.S. ka luftuar në frontin e Afrikës Veriore ku dhe është plagosur. Në Janar 1943 rikthehet në Ballkan duke drejtuar Korpusin XV malor mbas kapitullimit të Italisë me trupat e tij futet në Shqipëri. Dekuruar me dekoratën Kalorësit i Kryqit të Hekurt. Pushkatohet nga partizanët Jugosllav në Lubjanë pa gjyq.

Përveç këtyre, ushtronin pushtet të fuqishëm përfaqësuesi special i Ministrisë së Jashtme gjermane për Evropën Juglindore - i cili ishte gjithashtu përgje-gjës për Konsullatën e Përgjithshme Gjermane dhe nga viti 1944, dhe për legatën gjermane në Tiranë Neubacher - si dhe përfaqësuesit e SS dhe Shërbimit të Sigurimit të ushtrisë (SD), të cilët ndoqën interesat e tyre të përcaktuar saktë nga shtabi i përgjithshëm i Europës Jug-Lindore në Berlin.



Hermann Neubacher

Hermann Neubacher emisar special i Ministrisë së Jashtme Gjermane për Evropën Juglindore. Përfaqësuesi politik i Hitlerit, Ministër fuqiplotë i cili qëndronte në Beograd. Organizatori e nxitësi i formimit të institucioneve qeverisëse shqiptare gjatë pushtim gjerman të Shqipërisë. Hermann Neubacher (1893-1960), Anëtar i Partisë Naziste në Austri, ishte kryebashkiak i Vjenës (mars 1938-dhjetor 1940) dhe më pas iu bashkua shërbimit të jashtëm gjerman si ekspert në çështjet ekonomike për Evropën Juglin-

dore. Ai u aktivizua në Rumani, Bullgari, Greqi (tetor 1942) dhe së fundi, në Beograd në gusht 1943 si emisar special i Ministrisë së Jashtme Gjermane për Evropën Juglindore.

Nga 11 shtatori 1943, pas rënies së Italisë, ai u vu përgjegjës edhe për Shqipërinë dhe punoi ngushtë me Wehrmacht-in deri në kapitullimin e Gjermanisë në 1945

Në Shqipëri situata e sigurisë ishte kaotike, ushtria italo-shqiptare nuk qe në gjëndje ta eliminonte Ushtrinë Nacional Çlirimtare në Jug të Shqipërisë në vitet 1942-1943. Realisht komunistë kontrollonin teritore të gjëra malore të Jugut të Shqipërisë. Në luftë me kundërshtarët e tyre politik në radhë të parë Ballin Kombëtarë ata patën superioritet. Vrasjet, atentatet e shthurja po mbizotëronte në vënd. Forcat shtarake të shteti Shqiptar po dezertonin duke krijuar panik e kaos në vënd. Në këtë situatë dëshpëruese shumë individ të nxitur dhe të ndihmuar nga gjermanët u organizuan e formuan Regjencë, Parlamentin e Qeverinë, e në anarkinë që kishte pllakosur në vënd u munduan të formonin ushtrinë shqiptare, xhandarmërinë e të bashkëpunonin me forcat vullnetare të udhëhequra nga prinjës lokal. Realisht dështuan. Në fund të dimërit 1944 komunistët morën pushtetin në Shqipëri.

Në 09.09.1943. Shtabi suprem gjerman njofton se ka për qëllim që Shqipërinë ta njohë si autonome. Ministria e Jashtme do dërgojë një ekip të posaçme që të qartësoj në vënd gjendjen. Derisa të sqarohet

kjo gjë, në Shqipëri do ta ketë pushtetin ekzekutiv Armata II e tankeve. Gjermanët dhe me ndihmën e shqiptarëve që po bashkëpunon me ta, pothuajse të gjithë një shumicë shqiptarësh gjermanofil, por dhe me shumë nga drejtuesit civil e ushtarak të periudhës së pushtimit italian, arrijnë të ngrejnë një administratë shqiptare me Regjencë, Parlament, Qeveri, ata premtuan ngritjen e një ushtrie prej 30,000 vetësh.

Në Shqipëri në vitet 1943-1944 pati në fillim kushte të përshtatshme për bashkimin e forcave ushtarake të rregullta dhe forcave ushtarake vullnetare e krahinore, kundra ushtrisë vullnetare të NAÇL – e udhëhequr nga komunistët, dhe ngritjen e njësisve ushtarake në përputhje me planin e Hermann Neubacher. U ideu dhe u bë e mundur ngritja e katër batalioneve këmbësorie, duke i furnizuar me armatim, paisje, oficerë të gjitha nga prodhimet italiane të luftës. U ideua bashkimi i të gjitha njësisve që ndodheshin nën udhëheqjen e krerëve të fiseve ose udhëheqësve të grupimeve politike në një ushtri kombëtare por dështuan.

Udhëheqja reale në Shqipëri ishte në dorën e Gjeneral-Morit dhe Komandant-Brigade SS Josef Fitzthum, i cili në dukje ishte këshilltar i Sekretarit të Shtetit Shqiptar për sigurinë kombëtare por realisht gjermanët kontrollonin e impononin vullnetin e tyre politik e ushtarak në Shqipëri. Komanda operacionale e njësisve ushtarake shqiptare të përmendura më lart në të gjitha çështjet e veprimit ushtarak, të vendndodhjes dhe kohës së veprimit të trupave ishte në vullnetin e komandës së përgjithshme të Korparmatës XXI gjermane në Tiranë.

Situata në frontin e Europës Lindore u bë shumë e vështirë për ushtrinë gjermane. Sovjetikët shpërthyen frontin në Rumani, Bullagaria shpalli asnjësinë e kërkoi largimin e trupave gjermane më vonë u fut në luftë kundër gjermanëve. Turqia vazhdoi me këmbëngulje asnjësinë e saj vetëm në 23 shkurt 1945, Turqia shpalli luftën daj Gjermanisë. Më 03.10.1944 Hitleri lëshon urdhërin për tërheqjen e trupave të tija ushtarake nga Greqia, Shqipëria Jugore dhe Maqedonia Jugore.



Njerëz jashtë sallave të gjyqeve komuniste

NË EMËR TË POPULLIT SHQIPTAR


Gjykata Ushtarake e Tiranës e formuar prej:

Major Irakli Bozos, Kryetar

Major Tonin Jakova, Anëtar

Major Gjon Banushi, Anëtar

Me pjesmarjen e Prokurorit të Popullit major Misto Treska e asistuar prej sekretarëve aspirant Thoma Rino e kapter Zalo Xhomaqi, sot në datën 2 Fruer (shkurt) 1946, të mbledhur në sallën e kino teatër “Kosova” për të gjykuar të pandehurin:



1. Padër Anton Harapi i biri i Loros dhe i Luçisë, lindur më 1888 në katundin Shirokë të Shkodrës, banues në Shkodër, fetar me arsim të lartë, i përfaqësuar nga Z.Av. Spiro Stringa

Prokurori: Lef Nosi ² me ardhjen e okupatorit Nazist në bashkëpunim me agjentat e Gestapos Fon Shger dhe Nubaher, mer inisiativën bashkë më të tjerët, për formimin e Komitetit Ekzekutiv ⁴, bëhet Kryetar i Asamblesë Kujslinge ⁵ i thërret Padër Anton Harapin dhe i telegrafon Papës në Romë për ti dhënë këtij leje në bashkëpunim me gjermanët që të bëhet Anëtar i Regjencës, ndërsa dhe vetë Padër Anton Harapi në marveshje të plotë me Lef Nosin dhe i

njëmejtimit me pjesën reaksionare të Klerit katolik dhe me autorizimin e tyre vihet në krye të tradhëtisë. Shpallin nën okupacionin nazist “Indipendencën dhe neutralitetin e Shqipërisë” dhe me autorizimin e tyre vihet në krye të tradhëtisë.



NIGRIS LEONE GIOVANNI BATTISTA (1884-1964)

I pandehuri: Kur isha në Shkodër Mora një letër nga Lef Nosi me anën e së cilës më ftonte për të ardhur në Tiranë, unë erdha këtu dhe u bana Regjent. Kur kam ardhur në Regjencë kam kenë unë Provincial. Unë lejen për Regjent e kam kërkuar prej Papës konform me dispozitat e kodit kishtar që thotë që për të marë një funksion shtetnor duhet marë pëlqimi i Vatikanit. Lejen e kërkoja vetë nëpërmjet Qeverisë, si e dërgoi qeveria unë nuk e di. Nuk e

kërkova me anë të klerit mbasi nuk kish mundësi mbasi nuk kishte lidhje n'atë kohë. Për marrjen e barës si regjent jam këshillue me të gjithë pjestarët e Kuvendit. Midis të cilëve ishte dhe Leon Igrî ⁶, Emzot Thaçit ⁷, ja kam tregue këtë çështje, por nuk ishte në favor, (Thaçi) por nuk di nëse ishte kundra, mbasi ky nuk mund të më urdhëronte mua. Leja e Papës thoshte se nuk kemi kundërshtime që të pranosh detyrën e Regjentit, kjo leje u kthye përsëri nëpërmjet qeverisë dhe këtë mua ma dorzuan nga ana e Ministrisë së P. Brëndëshme, këtë ja u paraqita Delegatëve Apostolik. Unë nuk di se si Papa e ka pranue këtë gjë por tekstin e pranimit të tij ja u thashë se nuk ishte kundra.⁸

Prokurori: Si është e mundur që duke qenë okupatori mbrënda këta të shpallnin idipendencën dhe si është e mundur të ngrinin Regjencë? Komedia e Asambleve ka pasur dy tradhëtira, atë të 12 Prillit ⁹ dhe këtë që thotë i pandehuri.

I pandehuri: Populli se kishte njohur bashkimin me Italinë, po ishte mbledhur një Asamble e cila zyrtarisht shpalli bashkimin e Shqipërisë me Italinë, atëhere ishte nevojë të mblidhej një asamble tjetër dhe të anulonte atë bashkim. Për këtë Asamble nuk u bënë votime se vendi ishte nën okupacionin e huaj. Nga Lëvizja Nacional Çlirimtare nuk kishte pjestarë n'Asamble mbasi këta ishin ilegal. Neve bajshim një gjë të mirë të Shqipërisë. Delegatët kanë ardhë nga çdo krahinë e Shqipërisë. Lufta Nac. Çl. Ishte një udhë e drejtë që bani populli kundra okupatorëve por neve nuk u bashkuam, mbasi nuk mund të

delshim të gjithë për të marë pjesë në luftë. Duhej të veprime me çdo mënyrë nga jashtë e nga brenda.

(Në 13.10.1943. Qeveria italiane e gjeneralit Pietro Badoglio i shpall luftë Gjermanisë. Mbreti i Italisë heq dorë nga titulli “Perandor i Etiopisë” dhe “Mbret i Shqipërisë”. (Ditarët e luftës të Komandës Supreme të Forcave të Armatosura Gjermane (Kriegstagebuch des Oberkommandos der Wehrmacht, KTB OKW) Përkthyer nga Ana Kolevica Faqe 1197)

Prokurori: Unë nuk mund ta marë vesh qysh është ky neutralitet, kur brenda kishte një okupator, këta duhej të mernin shembulla dhe provat nga populli dhe nga patriotë e tjerë si Fan Noli ¹⁰ i cili me një mesazh e ftonte popullin të hidhej në luftë kundër okupatorit gjerman gjithashtu dhe Kuartieri i Mesdheut veprimet e bëra prej këtyre i konsideronte si veprime tradhëtare.¹¹

I pandehuri: U shtërnguam të mblidhnim Asamblenë e të formojmë Qeverinë për shkak se gjermanët nuk deshnin një qeveri por një Komitet dhe dirizhimi të ishte në dorën e tyre, n’Asamble shpallëm dhe neutralitetin e Shqipërisë

Prokurori: I pandehuri Patër Anton Harapi ka propoganduar të ngrejë me çdo kusht një aparat shtetnor kuisling dhe për këtë gjë nxiti gjithë popullin të bashkohet kundër ushtrisë dhe lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke tentuar të përçajë Frontin Nacional Çlirimtar simbas propogandës së Goebels-it ¹², duke e cilësuar luftëtarët e lirisë si terorista e të shitur në të huaj. Kjo gjë provohet nga fjalimi i tij që u dëgjua dhe që është shumfishuar në gazetarinë dhe në

broshura të shtypit t'okupatorit. *(Në dosje nuk gjendet këto prova që thekson prokurori)* Po të mos e thotë ose të mos dojë t'a thotë Patër Anton Harapi, ua them unë: Gjenerali Fitzum e Feld kanë qenë organizatorë t'ushtrisë e të gjindarmërisë në dispozicion të Regjencës. Mandej prokurori këndon një pjesë të deklaratave që ka bërë Gjeneral Mirdashi ¹³, *(Gjeneral Mirdash në jetshkrimin e tij në hetuesi, nuk shkruan fjalët që citon prokurori)* të cilat të vërtetojnë lidhjet e Regjencës me gjermanët.

I pandehuri: Regjenca s'ka kërkuar ndihmë nga Gjermanët, Komandat Ushtarake mund të kenë kërkuar. Komandat mvareshin nga Regjenca.

Këndohet (lexohet) një pjesë e deklaratave që i pandehuri ka bërë para Komisionit Hetimor në lidhje me marrëdhënjet e Regjencës me Gjermanët të cilët i pandehuri i pranoj. *(Në dosje nuk ka deklaratat që citon prokurori)* Gjeneral Fitzum e kam njohur që kur u bëra Regjent. Gjeneral Feld e kam njohur në të pamë por ndonji lidhje s'kam pasur me të. Unë di se n'ushtri ka pas oficera gjermanë, të cilët ishin vue për me disiplinue ushtrinë; sipas mendjes t'ime në bazë të statutit mundet me marrë instruktorë të huaj për t'organizue ushtrinë t'onë. N'atë kohë gjermanët ishin në vëndin t'onë si okupator. Në një mbledhje që ka ba Regjenca me Qeverinë s'ka qenë ndonjë gjerman. Mehdijs (Frashëri) ka thanë se gjermanët i kishin thanë këtij se na po të dëshironim ushtarë gjermanë ata na jipnin. Gjeneralin Fitzum, e kishim për ushtrinë si organizator dhe për gjindarmërinë Gjeneralin Feld, nuk e di për ç'qëllim. Regjenca nuk ka patur lidhje me gjermanët. Unë nuk mbaj

mënd të vinte në Regjencë gjenerali gjerman Fitzum. Regjenca kishte për detyrë vetëm të dekretonte dhe të vepronte në favor të popullit shqiptar. Ligji mbi Regjencën e bëri Asambleja. Përgjegjësinë e kishte Qeveria e cila ishte përgjegjëse para popullit dhe para Regjencës.

Prokurori: Patër Anton Harapi ka qenë mbi të gjitha politikat, kundra Lëvizjes Nacional Çlirimtares dhe luftës së popullit Shqiptar, krahas me Hausding-un, Fitzutua-in etj oficer të Gestapos, siç provohet dhe nga përmbtja e letrës e nga fotografia.

I pandehuri: Ardhjen e gjermanëve e konsiderova si okupacion. Iku një okupator dhe erdhi një tjetër. Detyra e popullit shqiptar ishte të vazhdonte luftën. Edhe unë vetë si shqiptar duhej ta bëja këtë detyrë. Me popullin isha por vetë nuk luftova, populli luftoj. Okupatori gjerman ka pasur vegla, siç ka natyrisht çdo okupator. Ishin përshembull vegël e okupatorit Xhafer Deva ¹⁴ po jo Ibrahim Biçaku ¹⁵. Nuk besoj që në qeveri të kishte vegla t'okupatorit me qëllim tradhëtie. Me Gjermanët nuk kam bërë politikë afrimi me qenë se unë e dija që këta do t'iknin nga Shqipëria

Prokurori:- I tregon të pandehurit një fotografi në të cilën ay ka dalë bashkë me gjeneralë gjermanë në kohën që ishte Regjent.



I Pandehuri tha: Kam dalë me 28 Nanduer me rastin e pritjeve. Nuk ua mbaj mend emrat gjeneralëve. Na u ngarkue Regjenca për me mbajtë autoritetin shqiptar, fuqia na u desh për me e mbajtë qetësinë e vendit. Na duhej të mbanim një autoritet e një shteti shqiptar. Rrezik i brendshëm ka qenë kundërshtimi i partinave, rrezik i brënshtëm ishte se ishin gjithë farë rymash, ishte lëvizja Nacional-Çlirimtare, ishte Balli Kombëtar, Legaliteti, Grupi Indipendent. Ma vonë Balli u afrue dhe u pranue në qeveri tre ministra të Ballit. U ba organizimi i gjindarmërisë me instrukturë gjerman. U ba me instrukturë gjerman simbas kodit tonë.

Prokurori:- Si përgjigjet pyetjes pse këtu qëndron poshtërsija e tradhëtisë së tij. Hiqet si njeri i vogël dhe sikur s'di gjë. Ky ka shkruar qysh në vjetin

1936 për fashizmin. Patër Anton Harapi ka mbajtur konferencë në vjetin 1936 fill mbas demonstratës së bukës në Korçë,¹⁶ dhe këndon një copë të fjalimit që ka mbajtur Patër Anton Harapi në një konferencë në Korçë ky ka shkruar qysh atëhere për fashizmin. (*Në dosje nuk është fjalimi i Patër Harapit i mbajtur në Korçë*)

I Pandehuri: Prokurori flet për një gja që është shkruar qysh në vjetin 1936. Rethanat e at'hershme me rrethanat e sotshme janë krejt të ndryshme. Unë kam thanë se duhet një autoritet dhe këtë e them dhe sot.

Prokurori: Padër Harapi i ka pritë gjermanët me kra hapët.

I Pandehuri: Unë se kam prit gjermaninë kra hapët as me pushkë por dije se gjermanët do të iknin. Gjermania ishte armike e Shqipnisë dhe lufta e gjermanëve ishte luftë agresion. Përmbi luftën botnore s'mund të shprehem, unë s'mund ti përgjigjem pyetjes përse shikon luftën botnore, unë s'jam njeri i madh. Kam qenë në dijeni për luftën ndërmjet Anglisë, Bashkimit Sovjetik e Gjermanisë. Ishin interes e popujve të ndryshëm. Lufta e aleatëve ishte e drejtë pse gjermania bëri agresion, detyra e popujve ish të luftonin Gjermaninë. Prokurori po thot pse jam ba Regjent dhe prand e kam prit Gjermaninë me kra hapët. Unë po i them mejtimit tim: Dikush luftonte me pushkë e dikush moralisht. Lëvizja Nacional Çlirimtare i luftonte gjermanët. Unë s'di të kem qenë kundërshtar i lëvizjes Nacional Çlirimtare, po isha i mejtimit t'i paksoja vuajtjet popullit pse gjermanët do të bajshin keq. Forcat ushtarake që u krijuan nën Regjencën, na i kena

këshillue të mos banin gjak-derdhje e të mos shty-heshin në ofensiva. Në datën 13 kallnuer (janar) 1944 ¹⁷ kam mbajtur një fjalim, ka asistue në këtë fjalim oficeri gjerman që ishte konsull ¹⁸, nuk di kush tjetër ka qenë.

Prokurori: Pse të lodhemi me procesverbale? Kemi fjalimin e Patër Anton Harapit. Vendos një pllakë gramafoni ku dëgjohet fjalimi i Patër Anton Harapit. *(Në dosje nuk ka pllakë gramafoni)*

I pandehuri: Po ky asht fjalime em.

Prokurori: Sado që fjalimi s'ka nevojë për komentim por aty shihet gjithë vija politike e Patër Anton Harapit se këto fjalë ai i kthehu më vonë me vepra. E dinte Anton Harapi se do të komentohej keq pse nuk kishte popullin pas, po bajonetat e gjermanëve, ky ka qenë koishent i veprës së tij. Kishte ardhur në Tiranë, Neu Baherri përfaqësonjës i Hitlerit për Evropën Jug-Lindore, d.m.th. Ballkanin dhe ky ja hariti qëllimit: formoj Asamblenë, Qeverinë, Regjencën. “O anarhi o me heq dorë nga çashtja kombëtare” bërtiste Patër Anton Harapi. Në gjyqin special ¹⁹ u provua nga vetë eksponentët e Ballit të Legalitetit e të Qeverisë se kush ishin anarhista, i pandehuri vlla-vrasjen na e atribon neve. Dhe kur pyet “Si mos me u gjet burra në Shqipni që për të mirën e atdheut të flijojnë vet-hen” këtu i pandehuri shitet demagog. Ky në këtë fjalim i quan spekulator ata që qëndronin jashtë preherit të Gjermanëve.

I pandehuri:- Lutem që konferenca e mbajtur prej meje të meret në tanësinë e saj e jo pjesërisht për me i nxjer kuptimin. Pranova detyrën e Regjentit

për me ba sakrificë, për me shpëtue popullin shqiptar brënda e jashtë dhe deshëm të mereshin vesh gjithë partitë.

Prokurori: Të gjitha rrymat politike dhe partitë tradhëtare e antipopullore u bashkuan për të luftuar lëvizjen Nac. Çl. Dhe kështu formuan qeverinë, mbas ardhjes së ushtrisë gjermane. Por i pandehuri don ti fshehë këto.

I Pandehuri: Regjenca nuk kishte lidhje me Ballin Kombëtar e me partit e tjera. Unë di që Regjenca ishte e ndarë në veprimet e saj ndaj grupimeve politike. Nuk di në se është bërë nonji shpallje nga Regjenca për t'u bashkuar Ballin Kombëtar me Legalitetin. Këtë mund ta ketë bërë Mehdi Beu por unë nuk kam dijeni. Balli dhe Legaliteti kanë luftuar kundra Lëvizjes Nac.Çl. por këto parti nuk kanë patur të bënin me Regjencën, me Qeverinë mund të kishin bashkëpunuar por unë nuk di, Regjenca shikonte dekretimet dhe veprimet e emnimeve, por kopetencat e tjera i kishte qeverija. Unë nuk dinja që Bahri Omari ²⁰ dhe Kol Tromara ²¹ ishin në qeveri si pjestarë të Ballit, por ma vonë u muar vesh nga veprimtaria e tyre.

Prokurori: Regjenca formon tre qeveri kujslinge: 1) Rexhep Mitrovicën ²², 2) Të Fiqri Dines ²³, qeverinë e krijuar në Tufinë, ku ka marë pjesë, Padër Antoni Harapi, Lef Nosi, Mehdi Frashëri, Mitat Frashëri për Ballin Kombëtar, Abaz Kupi e Fiqiri Dineja për Legalitetin dhe për Indipendentët Gjon Marka Gjoni ²⁴, i shoqëruar gjer në Tiranë prej Maliq Bush-

atit që ishin të një mendimi, të gjithë së bashku kurdisën qeverinë e koalicionit të të gjithë reaksionit të brëndshëm.

I Pandehuri:Mbas mbledhjes së Tufinës, qeverin e formoi Fiqiri Dineja që ishte i Legalitetit dhe me sa dihet unë në këtë qeveri mori pjesë edhe Balli Kombëtar. Për çështjen e Tufinës ²⁵ dhe mbledhjen që u bë atje dihet se një ditë Mehdi Frashëri më thirri e më tha se duhet të shkojmë në Tufinë me bisedue me Gjon Marka Gjonin, përfaqësues i Grupit Indipident,²⁶ me Mid'hat Frashërin, përfaqësuesin e Ballit dhe me Bazin e Canes, përfaqësuesin e Legalitetit. Të Nac. Çli. nuk ka pas. Nuk kam pa që atje, të ndodhej nonji oficer gjerman. Ata na propozuan që Fiqeri Dineja të merte kryesinë e të formonte qeveri bashkimi. Na kënaq dash që fill mbas ngjarjes së 4 Fruerit (Shkurtit) me e rrëzue qeverinë e kryesime nga Rexhep Mitrovica.



Idhome Kosturi (Korçë, 1873 - Durrës, 5 nëntor 1943) Veprimtar politik. Lindi më 1873, në Korçë. Studioi për histori në Boston SHBA dhe Gjermani. Komandante çete gjatë Luftës së Parë Botërore. Anëtar i komitetit Përparimi. Delegat i Kongresit të Durrësit 1918 dhe Lushnjës 1920. Zv/kryeministër i qeverisë së Lushnjës 1920. Kryeministër i Shqipërisë 1921, qeveri e përkohshme. Fanolist, jetoi në mërgim shumë kohë. Deputet i Korçës 1943. Kryetar i Kuvendit Kushtetues Kombëtar Shqiptar 1943. Ky kuvend prishi marrëveshjen e bashkimit të Shqipërisë me Italinë, i riktheu Shqipërisë pavarësinë sipas statusit të 1928, shpalli botërisht asnjëanësinë e Shqipërisë në luftë. U vra më 5 nëntor 1943, nga një siti guerril i Durrësit. Atentatori, Kol Laku, u arrestua më 24 shkurt 1944 dhe u dënua me vdekje nga Gjyqi i Përhershëm Ushtarak.

Prokurori: I pandehuri, si anëtarë të regjencës, ka aparovuar ndëshkimin me varje të Kol Lakut ²⁷ si dhe Gysh Gjonin e persona të tjerë. kjo akuzë provohet me pohimin e tyre dhe me atribuinin (*thelbësor*) të Mahmut Golemit ²⁸. *(Në dosje nuk ka ndonjë deklaratë nga ana e Mahmut Golemit*

I pandehuri: Për vrasjen e Kol Lakut e Gjysh Gjonit nuk di gjë se unë në Regjencë kur hyna pata për qëllim mos me dënue njeri me vdekje. Për dënimin me vdekje që janë dhanë ashtë vendos me shumicë votash.

Për këto dënime është pyetur Lef Nosi, i cili tha: Dënimin i Gjysh Gjonit ishte vendosur nga gjyqi dhe qeveria na e referoj (paraqiti me shkrim) sipas rregullit dhe unë e Mehdi Frashëri e aprovuam por Patër Anton Harapi s'ka qenë. *(Gjysh Gjoni komunist nga*

Shkodra nuk gjej informacion për të se përse është dënuar me vdekje)

Prokurori: Është përgjegjës direkt për financimin e miliona franga që i ka bërë okupatorit gjerman dhe organizatave tradhëtare duke shfrytëzuar në kurriz të popullit të varfër.

I Pandehuri: Përsa shikon dhanja e pareve gjermanëve unë di se këtyne u kemi dhënë të holla një herë u kemi dhanë 6,000,000 Fr. Shqiptare ²⁹. Ata na kanë kërkuar qindra milionë. Rikardi (?) ka ardhë me forcë në Regjencë për këtë punë. Neve i dhamë hua gjermanëve me anën e një dekreti që morëm por nuk mbaj mënd sa të holla u dhamë. Këtë mund ta dijë Ministria e Financave dhe Banka. Regjenca kishte për detyrë vetëm të dekretonte dhe të vepronte në favor të popullit shqiptar. Hua që u dhamë gjermanëve ishte në favor të popullit mbasi gjermanët mund të nxirnin markën e tyre dhe kështu shteti damtohej shumë.

Regjenca nuk kishte lidhje me Ballin Kombëtar e me Partit e tjera; hua mund të ketë marë nga Ministria por jo nga Regjenca. Nuk di sa të holla ka marë Balli e Legaliteti ³⁰. Neve nuk ishim përgjegjës në se Ministria jepte të holla Ballit, mbi këtë është përgjegjës Kryeministri i cili kryesonte qeverinë.

(Ditarët e luftës të Komandës Supreme të Forcave të Armatosura Gjermane (Kriegstagebuch des Oberkommandos der Wehrmacht, KTB OKW) Faqe 1289 – 17.11.1943. Në Shqipëri ka vështirësi sepse ushtarëve nuk u paguhet dot rroga në monedhën vendase, sepse qeveria shqiptare nuk pranon të japë shumën e nevojshme për këtë dhe ne nuk duam të bëjmë presion më të fortë. I dërguari Hermann Neubacher po për-

piqet për një zgjidhje të problemit. Përkthyer nga Ana Kolevica)

Prokurori: Ka urdhëruar të bëhen arrestime dhe internime në masë si dhe operacionin e Dimërit dhe të Qershorit në bashkëpunim me okupatorin. Këto operacione i kushtoj popullit t'onë mijra të vrarë dhe dëme të pa llogaritëshme. Si anëtarë i Regjencës ky ka frymëzuar dhe aprovuar operacione me stil të gjërë kundra forcave t'Ushtrisë Nacional Çlirimtare që njëkohësisht patën reperkusione edhe karshi popullatës së pafshme të të gjithë Shqipërisë.

I pandehuri: N'operacionin e qershorit unë kam qenë në Gjermani për me ba kurra dhe nuk mbaj mend që të kem qenë këtu. Operacioni është kryer nga gjysma e qershorit. Unë kur u ktheva nga Gjermania mora vesh qi ishte ba ky operacion në krahi-nën e Dibrës dhe këtë e ka ba Hysni Dema ³¹ me shokë, i cili ishte Komandanti i Përgjithshëm i Gjindermarisë. Gjindermaria varesh nga Regjenca, na nuk morëm nonji masë mbi ata që kishin ba këtë operacion me gjith që i kishim nën urdhën, por ata kishin veprue sikurse kanë dashtë. Nuk di në se për kryem-jen e këtij operacioni kishin bisedue me Mehdi Frashërin qi ishte Kryetar i Regjencës. Përse i përket operacionit të dimërit regjenca ka dhanë direktiva me ba qëndrim defensiv për qetësinë e vendit. Na atëhere pak fuqi, që kishim i përdornim për me mbajtë qetësinë e vendit. Gjindarmërinë e përdornim për me mbajt qetësinë kundra hajdutëve dhe kriminelave ordiner Gjindarmaria ashtë hudhe

n'ofensivë pa vullnetin e Regjencës por me vullnetin e qeverisë e të Xhafer Devës si dhe të Komandës ushtarake. Ministrat e Qeverisë kanë vepruar me mendjen e vetë. Na duhej të ruanim popullin që ishte nëpër qytete nga gjermanët, edhe ne mund dhe kishim për detyrë të paksonim vuajtjet e popullit.

Prokurori: Të pandehurit Lef Nosi, Patër Anton Harapi e Maliq Bushati kanë vazhduar rrugën e tradhëstisë deri në fund, me gjithë që janë këshilluar si prej aleatëve të mëdhenjë, dhe prej frontit Nacional Çlirimtar.

I Pandehuri: Regjenca me qeverinë në fillim bëm një mbledhje po skemi caktuar ndonjë vijë politike për të ndjekur, vetëm vepronim në bazë të vendimeve të Asamblesë. Ne vendosëm të mbajmë neutralitetin. Me gjermanët nuk kemi bashkëpunuar.

Politika e Regjencës ishte ruajtja e Indipendencës dhe ikja e okupatorit, kundrejt aleatëve regjenca mbante një qëndrim asnjëanësie. Pse shtypi fliste kundra aleatëve përgjegjësinë e ka qeveria. S'besoj të jetë shkruar kundra aleatëve ndonjë gja e hapët. Aleatët luftonin kundra gjermanëve. Peteni ³² në Francë kishte bërë aleancë me gjermanët. Regjenca nuk mori ushtri tua dorëzonte gjermanëve për të luftuar aleatët.

Përfaqësonjësi mbrojtës i të Pandehurit Z. Av. Xoxa tha: Simbas statutit t'as kohe regjentët duhet të mernin në tre muaj një herë kryesinë kjo gjë nuk u bë, të pyetet i pandehuri si ndodhi që nuk u bë.

I Pandehuri: Kjo ligjë kështu ishte por nuk u zbatua, kur vajtëm për herë të parë te kryetari Mehdi Frashëri, ay na tha unë dua të bëhem kryetar dhe

kjo ligjë duhej të prishet, unë i thashë që ta propozonte prishjen e ligjës. Ay e mori me pahir kryesinë e Regjencës dhe u bë si dikatator, neve s'kishim ç'i bënim. Ay kishte mani. Faj bëmë që e lamë atë kryetar.

Prokurori: Ky fakt tregon se këta kanë përgjegjësi akoma ma të rëndë pse kur panë se ligja u shkel prej kryetarit vetë ç'bënë, këta e lanë Mehdi Frashërin, kryetar pse ay ishte më i guximëshmi dhe më i vendosuri e jo se e mori me forcë, këta duhej të jepnin dorëheqjen.

Vendim: Trupi gjykues bashkërisht vendosi mbylljen e seancës gjyqësore dhe shtytjen e gjykimit për në datën 4/Fryer/ 1946 paradreke duke e njoftuar të pandehurin present dhe përfaqësuesin e tij mbrojtës.

Sot, në datën 4 /Fryer/ 1946 ora 9 gjyqi i formua nga:

Major Irakli Bozo Kryetar

Major Tonin Jakova Anëtarë

Major Gjon Banushi Anëtarë

Me pjesmarjen e prokurorit major Misto Treska duke qenë i asistuar prej sekretarëve Thoma Rino e kapter Zalo Xhomaqi, filloi rigjykimi i çështjes botërisht, faqësisht e me dyer të çelura në sallën e Kino-Teatër “Kosova”

U soll nga burgu të pandehuri Padër Anton Harapi dhe u vu në vëndin e tij të posaçëm duke qenë i

asistuar dhe nga përfaqësuesi i tij që u sipër shënuan.

Patër Anton Harapi i biri i Loros dhe i Luçisë vjeç 58, lindur në katundin Shirokë të Shkodrës, banues në Shkodër, fetar

Prokurori: Është e qartë se këta mbroheshin nga gjermanët dhe këtë po na e pohon me gojën e vet i pandehuri Patër Anton Harapi. Kur ka qenë Patër Anton Harapi Regjent, frontet në Shqipëri ishin të ndarë në dy, fronti Nacional Çlirimtar dhe fronti kundra lëvizjes Nacional Çlirimtares, fronti që luftonte për liri dhe fronti tradhëtar. Të gjitha këto në përgjithësi u pohuan prej të pandehurit si dhe kolegut të tij Lef Nosit. Me fjalimet e tij dhe artikujt e ndryshëm ka qenë axhitatori dhe propogandisti më i mirë për okupatorin duke u munduar të përçajë luftën e popullit shqiptar. Ekstremisëm është 4 shkurti. Padër Harapi është përgjegjës për masakrimet e 4 shkurtit ³³

I pandehuri: Fronti Nacional Çlirimtar e kam pa si një parti kombëtare shqiptare po në fjalimin tim kam folur kundra komunistave këtë e kam thënë dhe e them akoma sot, pse unë s'kam qenë dhe nuk jam i mendimeve ekstremiste. Gjermanët nuk e kanë ba në Shqipëri atë që kanë ba në Beograd e në Athinë. 4 shkurtin e banë shqiptarët. Këtë e banë Xhelal Staravecka me shokë kurse unë dhe Lef Nosi nuk kemi patur fare dijeni, nuk di nëse ishte në dijeni të këtij veprimi Mehdi Frashëri. Nuk di se çfarë ka ba Ministria e Brëndëshme dhe Xhafer Deva dhe nësa këta e kanë lajmëruar komandën gjermane për veprim-

met e kryera më 4 shkurt, por di se këto veprime i kanë ba pa dijeninë t'onë. Gjindermaria mvaresh nga Regjenca dhe se kjo ka marë pjesë në 4 shkurtin, por këtë terror të 4 shkurtit e ka ba Xhelal Staravecka me Xhafer Devën, unë për vet-hen t'eme nuk kam qenë në dijeni të këtij veprimi. Nuk di gjithshtu nëse kanë kenë ose jo civila në terrorin e 4 shkurtit. Pasi ikën gjermanët nuk ishin ma të zot të banin 4 shkurtë pse kur ikën gjermanët autoriteti i shtetit u çkatarua.

Për veprën e 4 shkurtit të vitit 1944 Xhafer Devës i hoqëm vërejtje edhe për 27 shkurtin i hoqëm vërejtje. Fjalët “ Ma mirë një rke gjak sot se një lumë gjaku nesër” dij sak (e sigurt) se nuk e kam thanun unë. Ditën e 4 Shkurtit mund të më ket ardhë Haritua (*Qirako Harito*). Unë e kam pasur mik të fortë Hariton dhe më ka ardhë keq për të. (*Harito Harito vëllai i Qirakos është një nga të vrarët e 4 Shkurtit 1944*)

(Në Shqipëri në këtë kohë kemi shumë vrasje pa gjyq për terror nga komunistët. “Në afërsi të fshatit Shipskë pranë Voskopojës zbulohet një varrezë masive me 170 kufoma të vrarë nga komunistat.

Studjuesi Italian Antonio Magagnino, në portalin “VOX News me titullin ”Masakra e kolonës Gamucci”, viti 2005, ka një shkrim kushtuar pushkatimit mizor nga partizanët e Brigadës së Parë S. të 129 robër karabinierë italianë ekzekutuar pa gjyq prapa Gurit të Muzhaqit në Çermenikë.

Në librëri e tij me kujtime Xhelal Staravecka me titull “Përpara gjyqit të historisë”, Tiranë 2012 e

pranon se ka qenë pjesmarës në këto vrasje. Në faqen nr 291 në kapitullin “Pushkatimi i karabinierëve dhe oficerëve Italian” ai shkruan: Pas katër ditëve në Labinot, më thirrën në Shtab e më thanë të merja batalionin e të shkoja në Çermenikë afër Martaneshit pranë një qëndre të formuar nga Kadri Hoxha për të pushkatuar një sasi karabinierësh dhe oficerësh Italian. Atje kur arrita ia vura në dispozicion batalionin Kadri Hoxhës, duke e porositur nënkomandantin tim t’i ekzekutonte urdhërat e Kadriut, përpikmërisht në ekzekutimin e të dënuarëve... numëri i të cilave i kalonte qindin. Xhelal Staravencka është dënuar nga shteti italian me burg për këto vrasje. Po në këtë libër në faqen 294 Xhelal Staravecka shkruan: Mehmet Shehu pushkaton në Golem të Lushnjës, 69 katundarë vullnetarë të njësisë ushtarake të Isa Manasterliut që u dorëzuan pa shkrehur asnjë pushkë, pa gjyq.

Gazetarit amerikan Peter Lucas në librin e tij me titull, “Misioni amerikan në Shqipëri. Operacionet sekrete të OSS-it dhe bashkëpunimi me partizanët komunistë gjatë Luftës së Dytë Botërore” shkruan: “Para fillimit të sulmit final për çlirimin e Tiranës me datën 11 nëntor, së paku 125 gjermanë u dorëzuan në duart e misionit amerikan në rrethinat e Tiranës dhe më pas iu kaluan partizanëve dhe fati i tyre mbrapa asnjëherë nuk u mor vesh. Partizanët vazhdonin politikën e tyre të filluar me kohë të ekzekutimit të robërve të luftës, një veprimtari e mirëfilltë terroriste. Një raport i OSS tregon se disa prej gjermanëve të vdekur ishin gjermanë të plagosur që u vranë nga

partizanët: “Politika e UNÇSH nda gjermanëve të plagosur ishte të mos kishte të tillë. Kështu shumica e gjermanëve që u gjetën të plagosur u vranë pamëshirshëm, pa një pa dy. Burimi thotë se nuk ka parë të jetojë ndonjë gjerman i plagosur. Shumë pak robër u mbajtën nga UNÇSH”.)

Prokurori: Frymëzojnë dhe nxisin gjithë reaksionin që në bashkëpunim të ngushtë me forcat e okupatorit nazist të bëhen operacione në stil të gjërë për çfarosjen rrënjësisht të lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke kombinuar me nazistët arrestime dhe internime në masë, si në Durrës, Vlorë Korçë, Gjirokastër, Tiranë, Shkodër, etj për në kampet e vdekjes të gjermanisë të Prishtinës³⁴. Janë përgjegjës për çkatarimin e pasurisë të shtetit e të popullit (Molave, urave, rrugëve, kantierëve dhe uzinave elektrike) për djegjen dhe rrënimin e mijrave banesave të popullit si dhe për çdukjen e madhe të bagëtive. *(Në dosje nuk ka as dhe një dokument të vetëm që të provohet që qeveria apo Regjenca kanë dhënë urdhër për akuzat e radhës të fantazisë ideologjike të prokurorit)* Qeveria ka lëshuar komunikatë para se moli i Durrësit të hidhej në erë. Këta duhej ta ndalonin një veprim të këtillë por këtë nuk e bënë pse kanë qenë në marveshje qysh ma herët. *(Në dosje nuk ka ndonjë marveshje)* Organizuan shpërnguljen e detyrueshme të popullsisë në mes të dimërit, të detyruar të strehohen nëpër shpella

I pandehuri: Për sa i shikon marjen nga burgu të të burgosurve dhe çumjen e tyre në Prishtinë na

nuk dinim gja. Gjermanët vet i kishin zanë vet i morën. Mbi tërheqjen e vretjes nga ana jonë qeveria protestoj. Regjenca atë që duhej të bante e bani, s'kishte fuqi të merte prej veshi gjermanin e ta çonte jashtë. Nuk kam pasë dijeni mbi internimet që gjermanët kanë ba në Durrës rreth ditëve të festës së 28 nanduer të vjetit 1943 . Unë e Lefi (Nosi) jemi mundue me pështue dhe kena pështue disa prej tyre. Sa për t'internumit të Prishtinës unë në Shkodër e kam marë vesh Për portin e Durrësit e kam marë vesh kur e lexova në gazetë, ashtë ba pa aprovimin e Regjencës prishja e Portit. Nuk e di nëse qeveria e ka aprovua Përsa i përket prishjes së Portit të Durrësit e mora vesh kur u hodh në erë. Gjermanët nuk na kanë lajmëruar më parë se do ta prishnin. Në qoftë se qeverija ka shpalluar hedhjen në erë të Portit të Durrësit ajo është përgjegjëse. Gjermanët ishin njerëz që për interes e tyne nuk pyetnin. Kjo vepër na u duk një vepër e damshme, katastrofale. Si tërhoqëm vërejtje qeverisë sepse nuk e bëri kjo. ³⁵

Prokurori: Prokurori lexon një copë të fjalimit mbajtur nga Pater Anton Harapi kundër komunistave. (*Në dosje nuk është fjalimi*)

I Pandehuri: Unë në fjalimin tim jam shpreh kundra vlla vrasjes. Vlla vrasje banin Nacional Çlirimtarët me ballin. Të luftosh kondra gjermanit nuk është vëlla vrasje, unë në fjalimin tim nuk kam thanë se Nacional Çlirimtarja po vrasin Ballin Kombëtar ose Balli Kombëtar po vret Nacional Çlirimtarët, por kam thanë se është dam me u vra vllau me vllaun.

Unë për veten time thom se më parë duhet me formue ndërgjegjen kombëtare e mandej ndërgjegjen ndërkombëtare. Komunistat ishin ekstremista. Unë kam folë me disa të Nacional Çlirimtares, kush më ka thanë se jam Nacional Çlirimtar e kush komunist, këtë dallim e kam konstatue prej tyre.

Prokurori: I pandehuri Patër Anton Harapi është marë qysh me kohë me politikë dhe këtu kemi fakte që i nxjerrim parasysht dhe mandej fillon (prokurori) të lexojë një letër të Marka Gjon Marka drejtuar Fratit të Gomsiqes (*Harapi ka punuar në Gomsiqe si prift*) (*Në dosje nuk është letra që prokurori i referohet*)

I Pandehuri: Nga letrat që këndoi z. prokuror del në shesh që unë nuk kam qenë bashkëpunor i Mark Gjon Markut. Mbas mbledhjes së Tufinës, Qeverin e formoi Fiqiri Dineja që ishte i Legalitetit dhe me sa di unë në këtë qeveri mori pjesë edhe Balli Kombëtar. Në Tufinë kam kenë dhe kam aprovuar marjen e qeverisë nga Fiqiri Dineja, por kur u formua qeverija isha në Gjermani, ku kam shkue me ba kura, (*Dr. Shyqyri Basha i burgosur politik në kujtimet e tia thotë se gjatë gjykimin e qëndrimit në burg Padër Anton Harapi ka qenë i sëmurë dhe unë në kushtet e burgut jam munduar ta kuroj.*) atje kam shkue me aeroplanin e Nuebaher-it qi ishte përfaqësues i Hitlerit për Evropën Jug-Lindore. Në gjermani kam qindrue një muaj dhe u ktheva përsëri mbi kërkimin e parlamentit dhe të shtypit, por nuk asht e vërtetë qi t'më kenë detyruar gjermanët mu kthye. Unë nuk mora pjesë ma në regjencë, mbasi m'ishte mërzitë

zyra; në fillim e mora mbasi ishte tjetër dhe në mbarim tjetër ³⁶.

Prokurori: Ky në këtë fjalim i quan spekulator ata që qëndronin jashtë prehërit të gjermanëve. Kërkon ta ndalojmë luftën, ashtu siç bëri Mustafa Kruja. Në gojën e Pater Anton Harapit shikojmë paru-llat e Mustafa Krujës të ballit e të fashizmit. Kjo është vazhdimi i politikës së Mustafa Krujës ³⁷, për ti futur një pykë bllokut antifashist

Vendim: Seanca gjyqësore shtyhet për në datën 4.2.1946 ora 9 para dite tue ju njoftuar të pandehurëve dhe përfaqësuesve të tyre mbrojtjese present.

U soll nga burgu të pandehuri Padër Anton Harapi dhe u vu në vëndin e tij të posaçëm duke qenë i asistuar dhe nga përfaqësuesi i tij.

Prokurori: Si anëtarë i regjencës ky ka frymëzuar dhe aprovuar operacione kundra forcave t'ushtrisë Nacional Çlirimtare që njëkohësisht patën rep-erkusione edhe karshi popullatës së pafjshme të të gjithë Shqipërisë.

I pandehuri: Të gjithë n'atë kohë e dijshim se Gjermania e kishte hup luftën dhe se unë siç kam thanë edhe në ligjeratën time, u përpoqa me e përdorë fuqinë morale për me muejt me shpëtue ç'ka mundej me shpëtue. Unë nuk kam dasht me shkue fuqina kundra lëvizjes Nac-Çl. Porse kam dhanë urdhën qi forcat të qëndrojshin në difensivë e jo në ofensivë. Por ata kanë veprue sipas mendimit të tyne. Unë jam marë ma tepër me institusionet e shtetit shqiptar dhe nuk di si i bajshin këto veprime.

Prokurori: Gabimi në politikë është tradhëti.³⁸ Për këto vepra i pandehuri është përgjegjës moralë, mbasi ky në pozitën e tij kanë qëndruar në kulmin e tradhëtisë. Pretendon gjithashtu z. avokat se Patër Anton Harapi nuk është politikan, por nja letrarë, një idealist, porse nga i gjithë realiteti i gjykimit u provua se Patër Anton Harapi ka qenë marë me politikë bile me politikë të lartë. Pretendon gjithashtu z. avokat se Patër Anton Harapi hyri në kurth dhe s'e kuptoi dot përgjegjësinë me rastin që hyri në Regjencë. Kjo rrëzohet në mënyrë të katërçipt, mbasi Patër Anton Harapi jo vetëm që u konsultua me klerikët reaksionar katolik porse rëzohet edhe nga përmbajtja e fjalimit të reçituar (e them me zë) në disk. Pretendon gjithashtu Z. Avokat se Patër Anton Harapi nuk figuron anëtar i Ballit, i Legalitetit dhe i Indipendentëve dhe se kjo gjoja u vërtetua nga letra qi drejton Javer Hurshitit, porse Patër Anton Harapi ka qenë mbi të gjitha politikat, kundra lëvizjes nacional çlirimtares dhe luftës së popullit shqiptar, krahas me Hausding-un, Fitzutua-in etj oficer të gestapos, siç provohet dhe nga përmbajtja e letrës e nga fotografia.

Pater Anton Harapi i ka nderjt besnik gjermanëve deri në fund. Për të organizuar forcat e mbeturinat e reaksionit në Veri të Shqipërisë, me anë të të “Lidhjes së Shkodrës” në bashkëpunim dhe me forcat Çetnike ³⁹.

Vendim: Seanca gjyqësore shtyhet për në datën 6/fruer/ 1946 ora 9 paradite tue ju njoftue të pandehurit dhe përfaqësuesit të tij mbrojtës prezent

***Plotësuese e pjesës së dytë:**

1. Nojenbaher: “Unë, njeriu i Hitlerit në Tiranë”

Pjesë të shkëputur nga libri me titullin e mësipërm:

Nëse guxoj për të gjykuar, Mehdi bej Frashëri është njëri ndër themeluesit e kategorisë së re të drejtësisë ndërkombëtare. Ai më propozoi që Gjermania të pranojë neutralitetin e Shqipërisë. Sipas fjalës së tij kjo kishte të bënte me një “Neutralitet garant”. Kështu Shqipëria i konsideron forcat e armatosura gjermane, që vetëm nevoja ushtarake i ka sjellë në vend, si mysafirë, pa dëme për pavarësinë e saj në mes të palëve ndërluftuese. Qeveria shqiptare do t'i kundërvihet secilit veprim të agjentëve që do të rrezikonin rendin e brendshëm të vendit. Por, nëse armiqtë e gjermanisë do të sulmonin përmes njësitëve të armatosura luftarake, atëherë qeveria shqiptare do të mbetej neutrale.

Për këtë, nga ana ime, e kam përcaktuar realitetin shqiptar, si “Realitet relativ”. Si mike e popullit shqiptar, fuqia e armatosur gjermane kërkon qëndrim miqësor në një vend ku ka hyrë vetëm nga nevoja luftarake. Gjermania e pranon sovranitetin e qeverisë shqiptare. ajo do t'i kundërvihet kësaj qeverie, vetëm në se kjo e fundit përkrahte armiqtë e saj në luftë. Ndaj, sovraniteti i Shqipërisë, për shkak të sigurisë së forcave tona, ishte “Relativ”.

Ne ramë dakord me këtë formulim dhe qendra jonë e pranoi pa problem “Pavarësinë relative të shqipërisë”.


Me qendrën kryesore gjermane ishte e lehtë, kur kishte të bëje me çështjen shqiptare. Atje, askush s'kishte ndonjë koncept të qartë për këtë vend inte-

resant të Europës. Kështu puna ime bëhej më e lehtë. Kësaj i shtohesh edhe simpatia shumë e zgjeruar për këtë vend të panjohur në Gjermani.

Arkivi I MPJ të Shqipërisë viti 1943-1944:

- Relacion i Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar Ministrit Fuqiptotë të Reçhut për Europën Jug-Lindore në Beligrad që të ndërmeretësojë pranë Qeverisë Gjermane për aprovimin e vendimit të patriotëve shqiptarë për njohjen e Komitetit Ekzekutiv Provizor, thirrjen e një asambleje kombëtare për krijimin e një kushtetute dhe të një qeverie politike të re

- Gjermanët planifikuan të ndërtonin një Shqipëri të pavarur neutrale e kontrolluar nga një qeveri miqësore ndaj gjermanëve. Në një letër të datës 24 shtator 1943 dërguar qeverisë shqiptare nga Berlioni zyrtar thuhej: "Qeveria e Rajhut përshëndet vendimin e patriotëve shqiptarë që kanë marrë përsipër punët e qeverisë në Shqipërinë e Pavarur." Letra iu dorëzua Biçakçiu personalisht nga Nojbahehi. Biçakçiu do t'i shprehte Nojbahehit simpatinë që sipas tij shqiptarët ushqenin për Gjermaninë dhe Hitlerin. Asambleja Kombëtare, e përbërë nga 243 anëtarë, filloi të funksionojë më 16 tetor 1943, duke zgjedhur një Këshill të Lartë të Regjencës prej katër anëtarësh për të qeverisur vendin. Asambleja anuloi vendimet ligjet dhe dekretet e kohës së pushtimit italian dhe zgjodhi Këshillin e Lartë të Regjencës të përbërë nga Mehdi Frashëri, Lef Nosi, Padër Anton Harapi dhe Fuat Dibra, dhe formoi një qeveri në krye të së cilës u vu Rexhep Mitrovica.



2. Elefther Nosi i njohur si Lef Nosi (Elbasan, 9 prill 1877 - 13 shkurt 1946) ka qenë nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, ministër i Postë-Telegrafes (4 dhjetor 1912- 21 shkurt 1914), kryetar i Asamblesë Kombëtare (1943), anëtar i Regjencës (1943 - 1944), folklorist, etnograf, numizmat e arkeolog shqiptar. Njihet si babai i filatelistë shqiptare, personalitet me interesa të gjëra kulturore. Veprimtaria e tij politike-shoqërore ishte pothuse e pandarë me atë personale. Në Arkivit Qendror Shtetëror tërësia e letrave të ardhura në adresë të tij arrin më tepër se 1200, mes tyre edhe me Norbert Joklin, Holger Pederesenin etj

3. Franz Scheiger, jetoi në Shqipëri nga viti 1916 deri në 1944; në Luftën e Parë Botërore ishte në Shqipëri nga viti 1916 në fillim si oficer austro-hungarez, pastaj si inxhinier i rrugëve. Nga viti 1923 ishte anëtar i Ambasadës Gjermane në Tiranë si atashe tregtar dhe nga viti 1929 ishte shtetas gjerman.

Scheiger fliste rrjedhshëm shqip dhe shoqërohej me figurat më të rëndësishme shqiptare në kulturë dhe politikë dhe për këtë arsye ishte i dobishëm për

synimet gjermane në vitet 1940. Për këtë u emërua këshilltar politik në Ministrinë e Jashtme në Berlin. Në vitin 1943, gjatë përgatitjes për futjen e ushtrisë gjermane të Shqipërisë, aftësitë e tij diplomatike u njohën dhe u vlerësuan brenda një kohe të shkurtër. Ai u dërgua në Kosovë, për të vendosur kontakte me krerët e çetave dhe politikanët shqiptarë dhe për t'i ftuar ata të bashkoheshin me gjermanët kundër italianëve.

I interesuar dhe i arsimuar për kulturën, historinë dhe politikën, Scheiger shkroi një monografi mblo-dhi botime periodike mbi historinë e Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Biblioteka e tij ndodhet në Institutin Leibniz për Kërkimet e Evropës Lindore dhe Juglindore. Kishte gjithashtu një koleksion të rëndësishëm monedhash në pasurinë e tij.

4. Pas vendosjes së trupave gjermane në Shqipëri, filloi puna për ngritjen e organeve qeverisëse të cilat do të drejtoheshin nga shqiptarët por nën survejimin e gjermanëve. Me interesimin direkt të Nojbaherit, një grup prej 22 personash me orientim pro-gjerman u mbledhën në Tiranë me 14 shtator 1943 dhe krijuan Komitetin Ekzekutiv të Përkohshëm të kryesuar nga Ibrahim Biçaku. Komiteti shpalli të rrëzuar "Qeverinë e ditëve të robërisë" dhe bëri të ditur për opinionin publik se qe kthyer "Pavarësia dhe sovraniteti kombëtar". Komiteti u bënte thirrje shqiptarëve që të mos i kundërviheshin ushtrisë gjermane. Këto veprime u vlerësuan nga Hitleri. Në një letër të datës 24 shtator 1943 dërguar qeverisë nga Berlioni zyrtar thuhej: "Qeveria e Rajhut përshëndet vendimin e patriotëve shqiptarë që kanë marrë përsipër punët e qeverisë në Shqipërinë e Pavarur." Letra iu dorëzua

Biçakçiu personalisht nga Nojbahehi. Biçakçiu do t'i shprehte Nojbahehit simpatinë që sipas tij shqiptarët ushqenin për Gjermaninë dhe Hitlerin

5. *Asambleja Kombëtare, më 10.11.1943 merr emrin Kuvend Kombëtar (Parlamenti).*

e përbërë nga 243 anëtarë, filloi të funksionojë më 16 tetor 1943, duke zgjedhur një Këshill të Lartë të Regjencës prej katër anëtarësh për të qeverisur vendin. Asambleja anuloi vendimet, ligjet dhe dekretet e kohës së pushtimit italian dhe zgjodhi Këshillin e Lartë të Regjencës të përbërë nga Mehdi Frashëri, Lef Nosi, Anton Harapi dhe Fuat Dibra, dhe formoi një qeveri në krye të së cilës u vu Rexhep Mitrovica. Regjencia është përdurur nga politika shqiptare kur u krijua vakumi Institucional nga largimit nga fronti i Shqipërisë i Pric Vidit. Regjencia e vitit 1943 zëvendësoi Mbretin.

6. *Leone Giovanni Battista Nigris (27 gusht 1884 – 21 shtator 1964) ishte një prelat italian i Kishës Katolike që punoi në Shqipëri. Ai u bë kryepeshkop në vitin 1938.*

7. *Gaspër Thaçin (23 janar 1889 – 25 maj 1946), vinte nga radhët e shtresave të mesme të qytetit të Shkodrës. Mësoi së pari në shkollat kishtare të vendlindjes e më pas, shkoi të plotësonte kulturën e tij filozofike, teologjike e humane në Insbruck të Austrisë. Meshën e parë e kremtoi më 21 nëntor 1911 e menjëherë nisi shërbimin si famullitar në dioqezën e Sapës, në Nënshat, Dajç e në Qelëz, ku do të ngrinte*

flamurin shqiptar më 8 dhjetor 1912. Më 19 mars 1936 delegati Apostolik imzot Giovanni Della Pietra shuguronte ipeshkv Gaspër. Thaçin vdes më 25 maj të vitit 1946, pas një sëmundje të gjatë

8. Në studimin tim, lidhur me aprovimin e kërkesës së Padër Anton Harapit për tu bërë Regjent drejtuar Vatikanit, e pashë me interes për studimin, të dimë se si ishin raportet e Vatikanit në drejtimin e Papës Piu XII (1939-1958) me brutaliteti, nazist të udhëhequr nga Hitleri. Megjithse Vatikani kishte statusin e qytetit të hapur në të vërtetë në vitin 1943 qeverisej nga komandat gjermane. Feldmarshalli Albert Kesselring, komandant i frontit Jugor, emëroi në krye të Gestapos së Romës, duke i dhënë direkt kontrollin e rendit publik në qytet, zyrtarit të SS, Herbert Kappler. Ky do të formonte edhe spiunazhin kundër Vatikanit. Pavarësisht tentativave të shumta, Rajhu i tretë nuk do të arrinte gjithmonë të njihte orientimin e Papës. Gazetari e autor i librit “Papa dhe Hitleri” britaniku Xhon Kornuell pretendon se Papa Piu XII ishte peng i Hitlerit. Më vonë ai modifikon hipotezën e tij e shkruan se “Papa kishte aq pak hapësirë veprimi sa është e pamundur të gjykosh motivet e heshtjes së tij gjatë luftës”, (Studimi i britanikut është i fokusuar te holukasti dhe rroli i Vatikanit) Vatikani nuk e ka shpjeguar kurrë qëndrimin e heshtur të Papës Piu XII gjatë periudhës naziste.

Në vazhdën e sudimit tim për Padër Anton Harapin vazhdoj: Më 10 tetor 1943 u mblodhën në Shkodër, në Kuvendin e Gjuhadolit, arqipeshkvi i Shkodrës Padër Gaspër Thaçin (23 janar 1889 – vdes në burg 25 maj 1946), arqipeshkvi i Durrësit, Vinçenc Prennushin. (Shkodër, 4 shtator 1885 - Durrës, vdes

në burg 19 mars 1949) delegati Apostolik i Papës, Leon Negris, Pater Anton Harapi, (Pushkatuar) Patër Mati Prendushi (Lindi në Shkodër, më 2 tetor 1882 u pushkatua më 11 mars 1948). Pater Çiprian Nik, (Lindi më 5 janar të vitit 1888, në Shosh Më 28 dhjetor 1947, u pushkatua) Padër Pal Dod (Janjevë Kosovë, 3 shtator 1880 – vdes në burg 5 shtator 1951) për të shqyrtuar dhe vendosur mbi propozimin e kryetarit të Asamblesë Lef Nosit, për pjesëmarrjen e Pater Anton Harapit si përfaqësuesi klerit katolik në Regjencë. Mbas shumë diskutimesh, mbledhja, nuk mori një vendim unifikues, Pater Anton Harapin vendosi me vendim personal të bëhej anëtar Regjence.

Nuk e dokumentojmë se a u lajmërua Vatikani për këtë vendim dhe a u aprovua nga Vatikani ky vendimi personal. Gjithashtu një pikë e rëndësishme e pa dokumentuar është dhe roli i gjermanëve në këtë akt politik. Padër Pal Dod në ditarin e tij shkruante se letra e ardhur nga Vatikani që u lexua e u përkthye nga Padër Anton Harapi në Gjuhador ishte e shkruar në gjermanisht. Pyetja që lind natyrshëm është pse Vatikani kthen përgjigje në gjuhën gjermane? Në mungesë të dokumentacionit për të vërtetuar kërkesën drejtuar Vatikanit, hamendësojmë se gjermanët ose kanë bërë shantazh mbi Vatikanin ose e gjitha është një “lojë” i gjermanëve që u interesonte një situatë stabile në Shqipëri me Regjencë etj si të dëshirueshëm për ta

Xhafer Deva, ish Ministri i Brëndshëm kujton: Njëpërmjet të Ambasadorit të Gjermanisë në Romë, pëlqimi i Papës (Për Padër Anton Harapin si Regjent)

mbrini mjaftë shpejt “Fragment i marë nga libri i Idriz Lam “Xhafer Deva”

Në vazhdën e studimit tim për Padër Anton Harapin vazhdoj: Fragmente të shkëputura nga studimi i Hasan Bellos “Kisha katolike në vitet e luftës së Dytë Botërore”

Pesë ditë pas pushtimit, në mbledhjen e organizuar në shtëpinë e prijësit katolik të Mirditës ,(në Shkodër) Gjon Marka Gjonit, i cili nuk dëshironte të ndërmernte asnjë hap pa mbështetjen e klerit katolik ishin të pranishëm at Anton Harapi dhe përfaqësuesi i argjipeshkvit dom Mikel Koliqi. Për arsye se Gjon Marka Gjoni shprehu gadishmërinë për të bashkëpunuar me Italinë, at Anton Harapi deklaroi: “Çuditem për ju, mor e burra, se ne na keni thirrë vetëm kur asht puna me vorrue të vdekunit”. Sipas Donat Kurtit, Harapi u tregua një përfaqësues i shkëlqyer i intereseve të shqiptarëve kundër aneksimit italian. Pak kohë më vonë gjatë bisedimeve zyrtare në Tiranë në praninë e ministrit të jashtëm, Kontit Ciano (Çiano) dhe Francesco Jacomoni-t (Françesko Jakomoni), Harapi do të këmbëngulë për një deklaratë për pavarësinë e Shqipërisë dhe një bashkim të mirëfilltë të dy mbretërive, siç ishte rasti i Irlandës me Anglinë. At Anton Harapi ishte nga të paktët klerikë që tregoi një rezistencë të hapur ndaj Italisë. Kjo bëri që brenda një kohe të shkurtër të fillonin përpjekjet për largimin e tij nga Kuvendi Fraçeskan. Por krahas at Anton Harapit nuk munguan edhe emra të tjerë që u pozicionuan kundër fashizmit. Kështu, Athanas Geg OFM, Gjon Shllaku OFM dhe dom Lek Luli u burgosën ose u

dëbuan nga vendi. Aktivitetet e rinisë antoniane u penguan nga sekuestrimi i instrumenteve muzikorë. Për të qetësuar disi situatën gjenerali françeskan dërgoi nga Roma një ndërmjetës, i cili i këshilloi etërit françeskanë që të ishin më të kujdesshëm. Për të eliminuar paragjykimet ndaj Italisë, në Romë u dërguan për të studiuar edhe disa seminaristë. Në krye të qëndresës pasive ishin françeskanët, disa prej të cilëve krijuan një “Celulë antifashiste”, e cila sipas një raporti të konsullit italian në Shkodër Meloni, u mposht falë arrestimeve, pezullimit të ndihmave ekonomike ndaj urdhrit fetar, transferimeve të detyrueshme, arratisjes së ndonjë kleriku në Jugosllavi apo ndërprerjes për pak kohë të revistës Hylli i Dritës. Në shkollat e drejtuara nga françeskanët dhe të motrave stigmatine të lidhura me to, shfaqeshin, sipas autoriteteve italiane, “Ndjenja nacionalizmi të ekzagjeruar, antipatie dhe urrejtje ndaj Italisë”. Një nga fretërit që dallohej në këtë drejtim ishte patër Anton Harapi, i cili pas 8 shtatorit 1943 do të jetë protagonist i skenës politike shqiptare përkrah gjermanëve.

Pas kapitullimit të Italisë, më 9 shtator 1943 u zhvillua një takim mes delegatit apostolik, Leone Nigris dhe argjipeshkvit Gaspër Thaçi, ku u vendos se duke bashkëpunuar me prijësit katolikë duheshin marrë të gjitha masat për parandalimin e marrjes së pushtetit nga komunistët. Kjo derisa të mbërrinin forcat gjermane dhe të stabilizohej situata politike brenda vendit. At Anton Harapi dhe ish Kryeministri Maliq Bushati e shihnin si problem kryesor kaosin e krijuar në vend dhe vakumin e pushtetit pas tërheqjes

së Italisë. Në mesin e shtatorit, Shqipëria ishte një vend pa qeveri, por me kryengritës (komunistë) të organizuar mjaft mirë.

Me instalimin e administratës ushtarake gjermane në Shkodër, argjipeshkvi Gaspër Thaçi dhe at Anton Harapi si provinciali françeskan në detyrë, kontaktuan menjëherë me gjeneralin SS Hausding për të diskutuar lidhur me mbarëvtjen e situatës.

Paria katolike vendosi që, për interesat e vendit, të merrte pjesë në Asamblenë e 1943-ishit. Megjithatë ata nuk mendonin të merrnin pjesë në qeveri, me përjashtim të provincialit françeskan, patër Anton Harapi që mori detyrën si anëtar i Regjencës, duke ruajtur kështu traditën e krijuar nga Kongresi i Lushnjës me nga një përfaqësues për çdo komunitet. Më 23 tetor patër Antoni u nis nga Shkodra drejt Tiranës me një avion gjerman.

Në ditarin e tij, at Pali shkruan: e nuk dihej nëse ai do ta pranonte këtë detyrë pa lejen e Selisë së Shejnitë, duke pasur njëkohësisht funksionin e provincialit françeskan. Por emërimi i tij vërtetonte, sipas at Palit, mosbesimin që kishin tek ai, njerëzit e regjimit të kaluar, domethënë, bashkëpunëtorët e Italisë fashiste. Por edhe Pater Antoni kishte rezerva kundrejt at Palit, të cilit i kërkonte më 10 nëntor 1943, me cilësinë e anëtarit të Regjencës dhe jo si OFM, që ta takonte në Shkodër. Më 11 nëntor, provinciali françeskan patër Antoni thirri në Kuvendin e Gjuhadorit për konsultim të gjithë klerikët e provincës. Ai kërkoi mendimin e tyre për zgjedhjen si anëtar i Regjencës. Sipas at Palit, tek provinciali vihej re kënaqësia dhe vendimi i

patundur për t'u bërë pjesë e Regjencës, duke mos marrë parasysh rrezikun për jetën. Për pjesën më të madhe të pranishmëve në këtë mbledhje, ky rrezik krijonte të vetmen pengesë, ndërsa në fakt, thekson at Pali, nuk ishte vetëm ky. Kleri katolik, duke marrë në konsideratë perspektivën e forcave të Boshtit, ishte i vetëdijshëm për pasojat që mund të kishte pas përfundimit të.

(Pjesë nga ditari i at Pal Dod shënim i datës 10 tetor 1943.)

Po aty, shënim i datës 15 tetor 1943. “U zgjodh Këshilli i Naltë i Regjencës me misa shkëlqesat M. Frashëri, F.Dibra, L.Nosi, A.Harapi”, Kombi, nr.16, Tiranë: 23 tetor 1943, f. 1. 62 AQSH, F. 734, D. 164/1.

Pjesë nga ditari i at Pal Dodt:- shënim i datës 23 tetor 1943. Po aty, shënim i datës 10 nëntor 1943.

Prand, ai (Harapi) i trembej implikimit të mëtejshëm në organet drejtuese të qeverisë kuislinge të krijuar nga gjermanët. Në këtë takim, Pater Antoni lexoi dhe përktheu nga gjermanishtja instruksionet e Selisë së Shenjtë lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur. Sipas saj, kleri katolik duhej t'i përmbahej pëlqimit të argjipeshkvit të Shkodrës. Ai lexoi edhe letrën që kryetari i Asamblesë, Lef Nosi, i kishte drejtuar kardinal Maglione-s (Maljone-s) dhe gjeneralit të Urdhrit Françeskan, ku i lutej që të aprovonin kërkesën që pater Antoni të pranonte funksionin e anëtarit të Regjencës. Argjipeshkvi Thaçi ishte shumë i shqetësuar për emërimin e një kleriku katolik në Regjencë dhe e kundërshtonte këtë. Ai nuk kishte ndërmend të

jepte pëlqimin e tij pa atë të ordinarëve. Ndërsa nga ana tjetër, kishte frikë se me qëndrimin e tij negativ, do të ndeshje me zemërimin e shtetit dhe të komandës gjermane. Edhe argjipeshkvi i Durrësit, Mati Prendushi i kishte kërkuar pater Antonit që të largohej nga Tirana, duke e qortuar për pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e Regjencës pa mbërritur përgjigjja e Selisë së Shenjtë që e miratonte këtë vendim. Argjipeshkvi Thaçi ankohej për pater Anton Harapin që nuk e kishte vendosur në dijeni për zgjedhjen e anëtarëve të Regjencës. Argjipeshkvi kishte frikë nga një reprezalje e anglo-amerikanëve kundër Shkodrës dhe katolikëve për shkak të implikimit të patër Antonit si anëtar i Regjencës. Kjo tregon qëndrimin e dyzuar të drejtuesve të klerit katolik rreth çështjes nëse duhej ose jo të përfshiheshin në organet drejtuese të shtetit shqiptar gjatë pushtimit gjerman. Pater Antoni me gjithë kundërshtimin e imzot Thaçit, për emërimin e tij si anëtar i Regjencës, ishte i vendosur për ta pranuar këtë detyrë dhe i lexoi at Palit një pjesë nga letra që i kishte dërguar argjipeshkvit duke shtuar “Aq ma mirë nëse argjipeshkvi nuk ma lejon, por e gjithë përgjegjësia do të bjerë mbi të. Ai mendonte se, nëse ai do të tërhiqej nga Regjenca, ekzistonte rreziku që edhe anëtarët e tjerë të tërhiqeshin dhe vendi do të hynte në kaos.)

8. Pal Dod (Janjevë Kosovë, 3 shtator 1880 – Shkodër, 5 shtator 1951) qe frat françeskan, publicist, kronikan, mësues, bibliotekist dhe përkthyes. Ditari i tij me vrojtime vetjake mbushur me përshkrime e kronika nga ngjarjet të cilat përjetoj, përbën

një nga dëshmitë më të afërta për të vështruar shtetformimin e Shqipërisë.

9. *Mbas pushtimit të Shqipërisë italianët mblodhën Asamblenë Konstitucionale në datën 12 prill 1939, Asambleja Konstitucionale vendosi me unanimitet:*

1. *Rrëzimin e dinastisë Zogu dhe të regjimit të tij*
2. *Ofrimin e kurorës mbretërore Viktor Emanuelit III, Mbret i Italisë e Perandor i Etiopisë, si mbret i shqiptarëve në një bashkim personal mes dy vendeve*
3. *Ruajtjen e flamurit, indipendencës dhe të sovranitetit shqiptar.*

Për zhvillimet e fundit në vend u njoftuan edhe legatat e huaja të akredituara pranë Mbretërisë Shqiptare. Ky vendim u mundua të transmetonte mesazhin se në Shqipëri nuk kishte ndodhur një okupacion ushtarak, por vetëm një ndryshim në kreun e shtetit shqiptar.

10. *Fan Noli shkruiti në gazetën Dielli në datën 11 gusht 1943: "Lufta në Shqipëri nukë pushoj kur shkelnë italianët Shqipërinë të Premten e Zezë. Populli shqiptar nukë dha armët atë ditë të zezë; i fshehu a i hodhi mi sup dhe mori malet."...*

11. *"Kolaboracionistët e fashizmit: Kleri, bejlerët, braktarët"*

Harry Fulc (shefi i Zyrës për Shqipërinë, i Sherbimit të Inteligjencës Amerikane gjatë Luftës), në raportin që i dërgon Uashingtonit në shtator 1944 shkruan: "...Duke qenë tepër feudalë në pikëpamjet e tyre, i përziejnë ato me metodat fashiste dhe naziziste..."

Këto gërshetohen mirë, prandaj nuk është e rasit që anëtarët e një grupi të tillë përkrahën planet

fashiste, duke krijuar një truall të përbashkët me nazistët gjermanë, ata nuk i besojnë popullit të tyre me pretekstin se është injorant dhe primitiv, ndërsa në të njëjtën kohë adaptojnë masa të cilat e mbajnë në kushte injorance, varfërie dhe primitiviteti... Ata preferojnë që njerëzit të jenë të nënshtruar...ata nuk kanë hezituuar dhe nuk hezitojnë të përdorin mjetet më vicioze dhe më të ashpra për ta mbajtur popullin në kushtet e nënshtrimit dhe frikësaj.

Anëtarët e këtij grupi me pozita shtetërore, nuk kanë hezituuar t'i venë emrin komuniste, çdo shfaqjeje të pakënaqësisë, apo çdo shprehjeje të dëshirës për kushte më të mira. Elementë të këtij grupi janë:

1. Bejlerët, pronarët e mëdhenj të tokave në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut: Vërlacët, Vlorat, Libohovat, Vrionët etj.

2. Bajraktarët, dhe kapedanët mysliman të Matit, Dibrës, Lumës: Dinet, Elezët.

3. Katolikët fashistë të Mirditës, Shkodrës, Dukagjinit: Markagjont, Krujat, Bushatët, Çobat, Harapët.

4. Elementët ballistë, shumica e të cilëve, ka dalë nga grupet e mësipërme si dhe shtresa e bejlerëve të mesëm e të vegjël, kasta e oficerëve profesionistë të ushtrisë dhe xhandërmarisë, zyrtarët profesionistë dhe tregtarët e pasur, doktorët dhe gjykatësit e privilegjuar, me ndonjë përjashtim të vogël shumica, janë me prirje nazifashiste dhe përfaqësojnë interesat thelbësore më antidemokratike të vendit”.

(Dokumenti original në arkivin e DASH: A. maj 1211/16/875.01/9-2244)

**Një fragment nga raportet e përgatitura nga të dërguarit e Aleatëve në Ballkan, mbi luftën guerrile dhe strategjitë e luftës së Ballit Kombëtar*

“Në një raport zyrtar të datës 23 dhjetor 1943, hartuar nga përfaqësuesi amerikan i Zyrës për Shërbime Strategjike dhe atyre të Veprimeve Speciale, dërguar komandës qendrore, lidhur me veprimtarinë e rezistencës në Shqipëri shkruan:

“Ballistët” nuk luftuan as kundër italianëve, dhe as kundër gjermanëve. Në fillim, politika e tyre ishte: “Të lëmë Aleatët të luftojnë për ne.” Tani që LNÇ-ja i ka forcuar pozitat e saj, dhe kur duket se ka shanse të mira që të marrë drejtimin e vendit pas luftime, ballistët janë trembur dhe po thërrasin gjermanët të luftojnë për ta, në mënyrë që të zhdukin LNÇ-në, pa luftuar vetë. Sido që të ndodhë, duket se zotërinjtë ballistë, siç quhen nga LNÇ-ja, janë të vendosur të mos luftojnë me ndershmëri. Ata do të bëjnë ndonjë sulm të rafinuar dhe ndoshta ndonjë vrasje të bujshme, dhe më pas, disa do ta quajnë këtë luftë civile, por ata nuk do të ngrihen të luftojnë. Të paktën, të gjitha gjasat në këtë përfundim të çojnë.”

Materiali i cituar më sipër është marë nga:

Mësimdhënja e Historisë Moderne të Europës Juglindore gjatë Luftës së Dytë Botërore

Materiale Mësimore Plotësuese Lufta e Dytë Botërore. faqe 40.

**(E ke të vështirë të kuptosh Britaninë e Madhe dhe SHBA që gjatë Luftës së Dytë Botërore përkrahën Ushtrinë Nacional Çlirimtare të udhëhequr nga komunistët dhe refuzuan e i trajtuan si të papërshtatshëm moralisht për ta kundërshtarët e komunistave në Shqipëri dhe mbas dy vjetësh në vitin 1946 u bënë kundërshtarë të komunistave në Shqipëri dhe ata*

njerëz që ata gjatë luftës nuk i dëshironin dhe i injoronin tani të ikur nga Shqipëria nga dhuna komuniste i dëshiruan i organizuan dhe i përgaditën për të luftuar komunistët nëpër kampet e tyre ushtarake!!!!.AJ)

12. Goebbels, Joseph (1897--1945), Ministër nazist i propagandës. Goebbels lindi në Rheydt, Gjermani, besimi katolik shtresë e varfër. Fitoi një doktoraturë në letërsi dhe filozofi, u bashkuar me nazistët në 1924 dhe u bë redaktori i gazetës së partisë Naziiste. Së shpejti, Goebbels fitoi një reputacion si një folës dinamik dhe propagandist. Më 1926 u emërua kryetar i partisë së rrethit të Berlinit - i tij. Detyra ishte të fitonte kryeqytetin për Partinë. Në vitin 1928, Goebbels u bë shefi i propagandës së partisë dhe ishte ai që koordinoi fushata zgjedhore e nazistëve e solli Hitlerin në pushtetin kombëtar në janar 1933. Në mars 1933, Goebbels u emërua Ministër i Propagandës dhe Publikut Informacion. Qëllimi i tij ishte të "Nazifikonte" artin dhe kulturën e Gjermanisë. Prand, ai urdhëroi djegien e të gjithë librave "Jo gjermanë" më 10 maj 1933.

Goebbels përdori radio dhe filma propagandistikë për të fituar përkrahësit. Ai ishte gjithashtu përgjegjës për krijimin e kultit të personalitetit të Hitlerit. Gjatë luftës, Goebbels drejtoi luftën psikologjike të nazistëve e fushatë propagandistike. Ai arriti të manipulonte popullin gjerman kundër "Armiqëve" të Gjermanisë duke krijuar gënjeshtër dhe përhapur urrëjtje. Goebbels ishte një admirues e adhurues fanatik i Adolf Hitlerit. Goebbels dhe grua e tij ndoqën shembullin e Hitlerit për vetvrasje, pasi urdhëruan ekzekutimin e gjashtë fëmijëve të tyre.

13. *Gustav Von Myrdacz* i biri i *Paolo dhe Ema Zettel* lindi në Vjenë më 12 Korrik 1874 i martua me *Ida Heller-Fiedler* pa fëmijë. Shkolluar për ushtarak në Akademinë e luftës në *Wienerneustad* Vjenë. Një prej akademive ushtarake më të vjetra në botë, *Akademia Ushtarake Theresian*, e cila u krijua nga *Perandresha Maria Theresa* e Austrisë në 1751 për të trajnuar oficerë për ushtrinë austriake. Në luftën e Parë Botërore ai ishte dekoruar me medaljen kalorës i Urdhrit të *Leopoldit*, Urdhërit të *Franz Jozefit* dhe Urdhërit të *Kurorës së Hekurt* dhe kishte gradën e nënkolonel. Gjatë detyrës së tij ushtarake në Shqipëri në peridhën e luftës së Parë Botërore ai takon e njihet me politikanin shqiptar *Ahmet Zogu*, i cili drejtonte një grup vullnetarësh në krah të *Austro-Hungarisë*.

Vjen në Shqipëri në 5 Tetor 1921 i ftuar nga *Mehdi Frashëri*, Ministër i Punëve Botore, bashkë me 12 inxhinjera Austriak për me Organizuar Ministrinë e Botores. Në Prill 1922 mbasi mori nënshtetësinë shqiptare u emërua në Ministrinë e Luftës si Organizator e Inspektor me gradën N/Kolonel. Në vitin 1928 emërohet Kryetar i Shtatmadhërisë së ushtrisë shqiptare me gradën Gjeneral Brigade. Në kohën e pushtimit italian ishte në dispozicion të Komandës së Përgjithshme. Në nëntor 1943 Këshilli i Lartë e gradoi Gjeneral Divizioni, dhe u emërua Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë. Në tetor 1944 emërohet Ministër e Mbrojtjes i Shqipërisë. Arestohet në 1 Nëntor 1944. Gjykata Speciale e dënoi me vdekje ai u ekzekutua në korrik 1945.

14. *Xhaferr Deva* lindi në *Mitrovicë*, 21 shkurt 1904 – vdes në *Palo Alto*, *Kaliforni* SHBA 25 m 1978,

ka qenë llogaritar, inxhinier pyjesh, sipërmarrës, nëpunës, Ministër i Brendshëm i Shqipërisë në vitin 1943-1944, veprimtari nacionaliste e antikomuniste në Kosovë, Shqipëri e në mërgim.

15. Ibrahim bej Biçakçiu lindi në Elbasan, 10 shtator 1905 – vdes në Elbasan në 4 janar 1977 ishte pronar i madh tokash, agronom, sipërmarrës, Ministër dhe Kryeministër shqiptar. Djali i vetëm i Aqif Pash Biçakçiut (Elbasani) Arsimin fillor e kreu në qytetin e lindjes. Më pas ndoqi në Vjenë, shkollën e mesme, studioi në dy fakultete, atë të në Akademinë Tregtare të Vjenës për Agronomisë dhe për Shkenca Politike. Zotëronte gjuhët Gjermanisht, Italisht, Turqisht, Anglisht.

16. Demonstratë e organizuar nga sindikatat e kohës kundër pabarazisë sociale. Demonstrata u shtyp me forcë. Kjo demonstratë pati jehonë në shtypin e kohës dhe u trajtua nga këndvështrime të ndryshme. Shumica e shtypit e trajtoi këtë demonstratë si e motivuar nga fryma bolshevike. Propaganda komuniste e Enver Hoxhës e trajtoi këtë demonstratë si vepër e komunisteve shqiptarë. Në Korçë në vitet 1929-30 kishin lindur celulata e para ilegale komuniste. Padër Anton Harapit ka mbajtur disa ligjërata nga 29 prilli deri më 4 maj të vitit 1936 me intelektualët e qytetit të Korçës, ku foli për vlerat shpirtërore fetare e atdhetare që ishin në kundërshtim me vlerat ateiste të shoqërisë komuniste.

17. Në fjalimin e tij në 17 maj 1944 në kinema Kosova, Padër Anton Harapi shprehet pse e pranoi detyrën e regjentit: “E pranova detyrën se nuk mujshem m’ë pamun Shqypninë të pushtueme prej anarkijet...nuk dojshem të krijohej një Babiloni shqyptare

me luftë vllavrare qi zhgatrronte katundet, të humbej bagtija e të zhgatrrheshin familjet...ndjeva mëshirë, si për popull e gjithashtu edhe për Shqypni...Si mund të preferojshem m'e pshtue jetën t'eme për çashtjen e përbashkët? Le të ndodhë ajo qi ka me ndodh, thashë me vedi, rroftë populli edhe pa mue, rroftë Shqypnia!...E fillueme me një poezi e po e përfundojmë me një tragjedi me iu dhimbtë kujdo...e vetmja gja m'u bamun asht m'e pshtuemun shqypninë edhe popullin. Mjafton t'i paralizojmë fajtorët të mos bajnë ma dame...

Nuk duhet të ekzistojnë filogjerman, anglofila apo italofila. Duhet t'jena veç shqyptarë...”.

18. Martin Schliep: Lindi më 16 prill 1891 në Berlin; vdiq më 27 maj 1964 në Wiesbaden ishte një diplomat gjerman i dërguar në Shqipëri në vitet 1941-1944.Vazhdoi karrierën e tij diplomatike dhe mbas luftës së Dytë Botërore në shërbim të Gjermanisë.

19. Gjyqi Special për Kriminelët e Luftës dhe Armiqtë e Popullit i njohur ndryshe si “Gjyqi Special” ishte një nga proçeset e turpëshme e famë keqe të gjykatave komuniste që vepruan në pranverën e vitit 1945.

Në nëntorin e 1944 komunistë morën pushtetin dhe menjëherë nisën arrestimet dhe pushkatimet e figurave publike që ata i konsideronin kundërshtarë të tyre, ata u akuzuan se kishin bashkëpunuar me pushtuesin e armiq të popullit. Gjyqi Special u ideua nga regjimi komunist i porsaardhur në fuqi kundrejt kundërshtarëve të tyre politik që ata i etiketuan "Armiqtë e popullit" dhe "Kriminelët e luftës".

Trupi gjykues përbëhej nga 9 veta, kryetar i saj u emërua gjeneral lejtant Koçi Xoxe dhe anëtarë: kol. Hysni Kapo, nënkol. Beqir Balluku, kap. i Parë Hajdar Aranitasi, partizan Gaqo Boboshtica, dr. Medar Shtylla; Faik Shehu, anëtar i Këshillit Nacional-çlirimtar; Halim Budo, gjykatës, sekretar i përgjithshëm i ministrisë së Drejtësisë; Gaqo Floqi, gjykatës. Prokuror i Gjyqit ishte Bedri Spahiu, gjeneralmor. Më 10 mars 1945, u emëruan si ndihmësgjyqtarë të Gjyqit Special për kriminelët e luftës edhe Bilbil Klosi, major Gjon Banushi dhe major Haki Toska.

Gjyqi dënoi 17 vetë me pushkatim, 8 me burgim të përjetshëm, 10 me 30 vjet burg, 3 me 20 vjet burg, 5 me 15 vjet burg, 5 me 10 vjet burg, 5 me 5 vjet burg, 2 me 3 vjet dhe 3 me 2 vjet burgim. Vetëm dy persona u shpallën të pafshëm.

Të dënuarit qenë:

Me vdekje

Aqif Përmeti (politikan, ministër)

Bahri Omari (ballist, ministër)

Beqir Valteri (deputet, antizogist)

Daut Çarçani (prefekt)

Dik Cami (zogist, ushtarak)

Fejzi Alizoti (nënshkrues i Shpalljes së Pavarësisë, disa herë ministër)

Gustav Mirdash (ushtarak austriak, shef i shtabit i ushtrisë shqiptare)

Hilmi Leka (politikan, ministër)

Ismail Golëmi (ushtarak, ballist)

Javer Hurshiti (nëpunës, ministër)

Kolë Tromara (ballist, ministër)

Kostandin Kote (ushtarak, ministër)

Reshit Merlika (deputet)
Shyqyri Borshi (ushtarak)
Tahsim Bishqemi (ushtarak)
Terenc Toçi arbëresh, jurist, politikan)
Zef Kadarja (nëpunës karriere, drejtor i Zyrës
Sekrete, drejtor i përgjithshëm i Policisë)

Me burgim
Abdurrahman Telqiu
Abedin Xhiku (ushtarak)
Akile Tasi (nëpunës, ministër)
Anton Kosmaçi (nëpunës, ministër)
Bram Pustina (ushtarak)
Bilal Nivica (ushtarak)
Dedë Jakova (qark-komandant i Tiranës)
Emin Toro (ministër)
Et'hem Cara (ekonomist, ministër)
Fiqri Llagami (gazetar)
Gjergj Bubani (gazetar)
Ibrahim Biçakçiu (agronom, pronar tokash, krye-
ministër)
Ihsan Libohova (nëpunës)
Ismet Kryeziu (nëpunës, ministër)
Jakov Mil (veteriner, ministër)
Koço Tasi (ish-ministër)
Kostaq Kotta (kryetar i Kuvendit, kryeministër)
Lazër Radi (jurist, gazetar)
Luigj Fil (pianist, përkthyes)
Mahmut Golëmi (kryetar i xhandarmërisë)
Manush Peshkëpia (ballist,)
Mihal Sherko (arsimtar, ministër)
Mihal Zallari (mësues, kryetar i Kuvendit)
Ndoc Naraçi (ministër)
Nedin Kokona (avokat)

Qemal Vrioni (politikan, ministër)
Rifat Begolli (ministër)
Rifat Tartari (funksionar shtetëror)
Rrok Gera (diplomat, ministër)
Rrok Kol (ministër)
Sami Koka (prefekt)
Sami Visoka
Shuk Gurakuqi (financier, ministër)
Sokrat Dodbiba (nëpunës, ministër)
Sylejman Vuçitërna (ushtarak)
Tefik Mborja (diplomat, ministër)
Vangjel Goxhomani (anëtar i Këshillit të Shtetit)
Xhavit Leskoviku
Xhevat Kortsha (arsimtar, ministër)
Zef Benusi (ministër)
Zef Shiroka (ministër)
Zenel Prodani (nëpunës karriere)
Zija Bejleri (ballist)

20. Bahri Omari lindi në Gjirokastrë, në 10 shkurt 1889 - Pushkatohet në 13 prill 1945. Ishte publicist, nëpunës, botues, ministër dhe veprimtar i Ballit Kombëtar. Ishte anëtarë i grushtit të shteti në vitin 1924. Mbas rrëzimit të grushtit të shteti emigron jashtë Shqipërisë. Kthehet në Shqipëri e i bashkohet organizatës “Balli Kombëtarë” Në vitin 1943 bëhet Ministër i jashtëm i qeverisë Rexhep Mitrovica. Dënuar me vdekje nga “Gjyqi Special” i vitit 1945

21. Kolë Tromara lindi në Devoll në 15 m 1885 – pushkatohet në 13 prill 1945 farmacist, veprimtari atdhetarë, nëpunës në funksione të larta të shtetit, mer pjesë në grushtin e shtetit 1924. Mbas dështimit

të grushtit të shtetit aratiset jashtë Shqipërisë. Kthehet në vitin 1939. Veprimtar i organizatës Ballit Kombëtar, në vitin 1943 ministër në qeverinë Rexhep Mitrovica si ministër i kulturës. “Gjyqi special” i vitit 1945 e dënon me vdekje

22. Rexhep beg Mitrovica lindi në Mitrovicë, 18 janar 1888; vdes në Stamboll, 21 m 1967; nënshkruet i Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, nëpunës, ministër dhe kryeministër e ministër i kulturës të Shqipërisë gjatë viteve 1943-1944. Në maj 1944 jep dorëheqjen si kryeministër dhe kthehet në Kosovë. Me marjen e pushtetit nga komunistët largohet jashtë atdheut, në fillim në Austri për kurim, past në Itali e në fund në Turqi ku dhe vdes.

23. Fiqri Dine lindi në Maqellarë, Dibër në vitin 1897 vdes në Bruksel, 26 Nëntor 1960. Ushtarak Kolonel. Legalist (Zogist). Në vitet 1943-1944 Ministër i Brëndshëm dhe Kryeministër i Shqipërisë

24. Gjon Marka Gjoni lindi në Orosh, 15 gusht 1888 – vdes në Romë, 28 prill 1966. Ishte Kapidan (Udhëheqës) i banorëve të Mirditës. Në vitin 1921, mirditorët të udhëhequr nga Marka Gjoni u rebelua kundër qeverisë shqiptare dhe shpallën Mirditën të pavarur por u rrëzua me armë me shpejtësi nga qeveria shqiptare më 20 nëntor 1921. Marka Gjoni u strehua të Jugosllavi u fal nga qeveria shqiptare, ju njojtën postet e meritat dhe vazhdoi të udhëheq Mirditën. Pushtimin e Shqipërisë nga Italia e përkrahu. Ishte ndër njerëzit që aprovuan dhe ja dërguan Kurorën e Skënderbeut Viktor Emanuelit të III. E emëruan senator të Perandorisë Italo-Shqiptare. Anëtarë i partisë fashiste shqiptare. Ishte antikomunist dhe ka luftuar me armë

me ta. Ishte një nga bashkë themeluesit e grupimit politik “Bllokut Independent” që aktivitetin e saj politik e vazhdoi në emigracion qëndrën e kishin në Romë.

25. Të frikësuar nga rritja e fuqisë ushtarake të Lëvizjes Nacional Çlirimtare në Shqipëri, shumë politikanë antikomunistë vendosën ti bashkojnë forcat ushtarake për të përballuar fuqinë komuniste. Në Tufinë në 22 maj 1944 u mblodhën përfaqësues të Regjencës, dhe përfaqësues të organizatave politike të Legalitetit, Ballit Kombëtar, Independentët. Abaz Kupa kërkoj që Kryeministër të jetë Fiqiri Dine. Qeveria e Fiqiri Dines pati mbështetjen e të gjithë forcave politike pjesmarëse në takim.

26. “Blloku Kombëtar Independent”. Fillimet e tij si organizatë politike “Grupi Kombëtar Independent” i ka mbas kapitullimit të Italisë. Aktivitetin politik në Shqipëri e ka në vitet 1943-1944 Mbas marrjes së pushtetit nga komunistët një pjesë e këtij formacioni politik largohen nga Shqipëria. Në emigracion në Itali anëtarët e këtij grupimi e quajtën formacionin e tyre politik “Bllok Kombëtar Independent”

Disa nga emërta kryesor të këtij formacioni politik janë si më poshtë:

Ismail Vërlaci Kryetar i Bllokut Independent (Djali i Shefqet bej Vërlacit)

Afëz Ali Kraja, Afiz Ali Tahiri, Ali Vrioni, Asllan Libohova, Avdulla Kazazi, Dom Frano Karma, Eduard Liçi, Egerem, Libohova, (Ish Kryeministër) Egerem Vlora (Ministër), Ernest Koliqi, (Ministër) Gjon Marka Gjoni (Ministër), Hafiz Ali Tari, Hysni Mulleti vëllai i Qazim Mulletit, Jak Koçi, Jorgji Ruço, Kadri Myftiu,

Kapllan Libohova, Kol Bib Mirak, (Ministër) Lin Shkreli, Luigj Gergjolla, Maliq Bushati (Ish Kryeministër), Milto Goxhamari, Mustafa Kruja (Ish Kryeministër), Namik Resuli Ndue Gjoni Mark, Nebil Dino (vëllai i Xhemil Dinos), Nexhmedin Vrioni, Oso Kopliku, Pandeli Papalilo, Qazim Mullet, (Prefekt) Ruzhdi Preza, Safa Vlora, Shaqir Omari, Shaqir Preza, Shuk Gurakuqi, Sotir Kozma, Spiro Sherko, Stefan Gazulli, Sulçe Begu, Theofan Greani, Theofan Qezari, Xhelal Mitrovica, Xhemil Dino (Ministër), Zef Sereqi Shuk Gurakuqi, etj Pothuse të gjithë kanë qenë funksionar të lartë të qeverisë shqiptare në vitet 1939-1943 Gjithashtu shumica kishin qenë anëtarë të Partisë Fashiste Shqiptare

(Materiali i mëspërm i është referuar dokumentave nga dosja e Qazim Mulletit Aj)

27. Kol Jovan Laku komunist me banimi Durrës në 5 nëndor 1943 vret Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë e Idhomeno Jovan Kosturit në Durrës. Më 24 Shkurt 1944 arestohet Kol Laku Gjykata Speciale Ushtarake, mbasi Kol Laku pranoi vrasjen që kishte bërë, me 1 mars 1944 shpalli vendimin me vdekje për Kol Lakun e dy të tjerë.

Drejtësia komuniste dënoi me varje kryetarin e Trupit Gjykues që gjykoj Kol Lakun, rusin e Bardhë Mihal Sergio Krasenski midis të tjerave edhe me akuzën se përse ke dënuar me vdekje vrasësin e Kryetarit të Parlamentit Shqiptar.

28. Mahmut Golemi ushtarak i i xhandermarisë Lindi në vitin 1896, në fshatin Golëm të Gjirokastrës.

Më 14 prill 1945, Gjykata Speciale e dënoi si "Armik të popullit" me 5 vjet heqje lirie.

29. 27 dhjetor 1943 Nënshkruhen marrëveshjet shqiptaro-gjermane për problemet ekonomike financiaro-bankare midis përfaqësuesve të Qeverisë Gjermane, kryesuar nga Karl Hudeczek dhe përfaqësuesve të Qeverisë Shqiptare, kryesuar nga Dhimitër Berati. Këto marrëveshje parashikonin masat e mëposhtme:

1. Mbi arin shqiptar Që në fillim të pushtimit gjerman, qeveria shqiptare e kohës ka kërkuar kthimin e arit të shtetit shqiptar, që ky të depozitohet në një bankë zvicerane. Me këtë rast, qeveria shqiptare ka marrë zotimin për të financuar brenda mundësive të saj një pjesë të shpenzimeve ushtarake gjermane.

2. Mbi huatë Në fakt, pala gjermane duke përfutuar nga kjo kërkesë e qeverisë shqiptare siguroi një financim të vazhdueshëm të trupave gjermane me monedhë shqiptare në formën e kredive. Deri në fund të vitit 1943, shuma e kredive dhënë trupave gjermane llogaritej 50.000.000 franga shqiptare.

3. Mbi kursin ndërmjet frangut shqiptar dhe markës gjermane. Përpara kapitullimit të Italisë, 1 frang shqiptar ishte baraz me 0,85 marka gjermane. Në fillim të bisedimeve shqiptaro gjermane, raporti mes dy valutave ishte 1 frangë shqiptare baraz me 0,8219 marka gjermane. Bisedimet shqiptaro-gjermane zgjatën rreth një muaj. Nuk u pranua kërkesa e Qeverisë Shqiptare për sjelljen e arit në Shqipëri. Ari u vendos të mbahej në Reichsbank.

Premtimet e palës gjermane për kthimin e huave në të vërtetë nuk u plotësuan, përkundrazi u vendos që qeveria shqiptare të vazhdonte financimin. Kursi u caktua 1 frang shqiptar=0,81 marka. Marrëveshjet shqiptaro - gjermane i hapën rrugën përdorimit të sistemit tonë monetar për nevojat e ushtrisë gjermane

Qeveria shqiptare duhej të zgjidhte problemin e financimit të ushtrisë gjermane. Në shkurt 1944 në bazë të premtimeve të reja të dhëna nga gjermanët, qeveria shqiptare mori vendim të dërgonte një delegacion në Berlin. Delegacioni kryesohej nga Vehbi Frashëri, Zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe kishte në përbërje të tij edhe dy funksionarë të Bankës Kombëtare Shqiptare, Sandro Bresani e Loro Muzhani. Takimi zgjati nga data 4-6 prill 1944. Në këto bisedime u vendos që ari shqiptar të mbetej në Berlin. shkurt 1944. Duke patur parasysh që sasia e kartëmonedhave u pakësajua mjaft, konsullata gjermane kërkoi emetimin e një sasive të re kartëmonedhash, punë që iu ngarkua bankës kombëtare serbe. 6 prill 1944.

U nënshkrua një protokoll sipas të cilit ari shqiptar do të depozitohet jo në Zvicër por në bankën gjermane Reichsbank, në emër të Shqipërisë.

21 prill 1944 Kryekonsullata gjermane i dërgoi një memorandum qeverisë së Tiranës ku parashikohet financimi i nevojave të ushtrisë gjermane, të cilat llogariteshin në 30 milionë franga shqiptare në muaj.

5 maj 1944 Në Beograd u nënshkrua Protokoll i parë i Beogradit, ku ndër të tjera thuhej se shpenzimet monetare për financimin e ushtrisë gjermane, për

ndërtim fortifikatash, për shfrytëzimin e minierave etj., llogariteshin në 30 milionë franga ar në muaj (për muajt maj-korrik) dhe do të mbuloheshin 7 milionë nga qeveria shqiptare (kushtet e shlyerjes do të përcaktoheshin me një protokoll të veçantë) kurse pje-sa tjetër nga gjermanët duke sjellë napolona ar, mallra etj.. Po ashtu u vendos që deri më 1 gusht, duhe-shin emëtuar kartëmonedhat e reja në një shtypshkronjë të Vjenës të cilat do shërbenin për financimin e ushtrisë gjermane. Në rast mosplotësimi të këtij kushti do të bëhej një protokoll tjetër. 11 tetor 1944.

Me urdhër të Ministrit gjerman për çështjet ekonomike Karl Gsostenbauer, togeri i Gestapos Franz Janko bëri kontrollin e Thesarit të Bankës Kombëtare të Shqipërisë në 30 tetor 1944 Sipas “Procesverbali i tërheqjes së depozitave të Tiranës” (Verbale di prelevamento giacenze di Tirana) –AQSH, Fondi i BKSH gjermanët morën komplet thesarin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë 2.740.000 franga shqiptare dhe 13.519 napolona ar të cilat me kursin rreth 510 franga shqiptare napoloni kishin një vleftë 6.894.690 franga shqiptare. Gjithsej 9.634.690 franga shqiptare.

Marë nga HISTORIA E BANKËS QENDRORE NË SHQIPËRI Periudha 1943-1944

30. Materiali i mëposhtëm është marë nga Jetëshkrimi i Gjeneral Divizioni Gustav Von Myrdacz.

Ndihmat për çetat: Si përmendova (përmenda) edhe çetat kan qenë e kan veprue nën urdhër të gjermanëvevet. Sa për ndihmat e dhanuna kam për me thanë: Këshilli i Naltë e Qeverinat e kanë kuptue me

kohë se në bazë të vullnetit i cili frymëzon e karakterizon sidomos ushtrinë N.Çl. s'mund të fitojë një mbështetje në popullin shqiptar. Donte atherë me zavëndësue vullnetin me pare tue krijue në atë mënyrë jo vullnetare por mercenare me gjithë të metat e tyne tue zavandësue vullnetimin e luftimit me dëshirën e fitimit. (autori don me treguar se çetat e krijuara nga njerëz me influencë në zonat e tyre ishin mercenare e jo vullnetare e si të tilla ju mungonte dëshira me luftuar për ideal a frymë patriotike por luftonin për fitim personal).

Në konsiguencë (si pasojë) janë paguar shuma të konsiderueshme pa një kontratë tepër të imët, (pa dokumentacion të rregullt ligjor) Kadri Cakranit, Hysni Demës e gjeneral Mark Gjonit për forcat e tyne relative. Shumat e nevojshme kanë qenë parapamë nëpër buxhetet 43-44 dhe 44-45 edhe aprovuar nga qeveria. K.M.K. funksiononte sipas një zakoni i vjetër me Interbelancën (kërkesë e veçantë) te zyra administrative, një punë e cila logjikisht i përkiste Ministrisë së Punëve të Brëndëshme.

Asnjë pagesë asht bamun pa urdhërin e Këshillit të Naltë respektivisht Kryeministrit si i deleguem e Gjeneralit (Previzi) përveç 10,000 franga të cilën kam paguar Beqir Valterin si Komisar i Naltë mbi insistimin (këmbënguljen) e përsëritun. Mbi këtë pagesë kam lajmëruë Kryeministrin. Intendanca (institucion mbrapavije ushtarake që merret me financat) ka pregatit formalitetet e pagesave simbas rregullave kërkuese prej Këshillit Kontrollues edhe Ministria e Financave.

Një ingerenza (ndërhyrje arbitrare) mbi pagesat K.M.K nuk ka pas. Megjith këtë kam thanë një herë Ministrisë së Fianancës se këto pagesa janë të kota

ose Kryeministrit, se këto forca (formacione ushtarake) nuk kanë me u bind urdhënavet.

Prap me urdhër supreiore janë blemun nga 1000 opinga (këpucë) për çetat e grumbulluëm në mes Peqinit e Durrësit edhe prap me urdhër të Këshillit Nalt janë dërgue në kohën e Gjeneral Previzit disa oficerë si këshilltarë e administratorë të forcave Balliste. Unë nuk kam dërguar gjatë zavandësimit e Komandës asnjë oficer jashta. Sa për pagesat në kohën e zavandësimit riorganizova një lloj kontrollimi tue dërgue komisonet për zbatimin e pagesave. Urdhënova edhe Interpelancën (ma llanë llogari) mos me lëshue mandatet të reja përpara se nuk janë vërtetue shpenzimet e përparshme. S'due me përsërit se K.M.K. nuk ka pas mundësi me disponue me forca vullnetare as me formue planet me mundësi konkrete-tëzimi. Kuer (kurr) s'kam qenë dërgue prej Mehdi beut ke Shtabi Madhor i Korparmatës XXI, s'kam pas takime me shtabin, si do të jetë e nevojshme për një bashkëpunim si pretendohet.

31. Hysni Dema Nënkolonel (Xhandarmëri) lindi në Homesh, Dibër vdes në vitin 1951, Llovro, Greqi. Ushtarak i lartë i Monarkisë me gradën nënkolonel. Internuar nga fashistët Italian. Komandant i xhandërmarisë shqiptare në kohën e okupacionit gjerman. Me marjen e pushtetit komunistët aratiset më 1944 drejt Greqisë duke luftuar me armë me formacionet ushtarake komuniste, kaloi pjesën e mbetur të jetës në kampin e Llovros në Greqi. I dënuar nga regjimi komunist si "Kriminel luftime". Vdiq në emigracion.

32. Henri Philippe Bénoni Omer Joseph Pétain (24 prill 1856 - 23 korrik 1951), i njohur më mirë si

Philippe Pétain ose Marshal Pétain, ishte një gjeneral francez që komandoi ushtrinë franceze në luftën e Parë Botërore e luftën e Dytë Botërore. Marshalli Philippe Pétain ishte një gjeneral fitimtar që komandoi ushtrinë franceze në luftën e Parë Botërore. Në luftën e Dytë Botërore mbasi ushtria franceze u shpartallua nga ushtria gjermane në kreu i regjimit kolaboracionist të Vichy Francës, nga viti 1940 deri në 1944,

Ai udhëhoqi ushtrinë franceze drejt fitores në luftën e Parë Botërore në betejën nëntë-mujore të Verdunit , për të cilin u quajt "Luani i Verdunit". Ai u emërua Komandant i Përgjithshëm dhe ia doli të rivendoste kontrollin e tij mbi ushtrinë. Pétain qëndroi në komandë për pjesën më të madhe të luftës dhe u cilësua si një hero kombëtar. Më 16 qershor 1940, me rënien katastrofike të Francës dhe dëshirës e qeverisë për një armëpushim, kryeministri Paul Reynaud dha dorëheqjen, duke i rekomanduar Presidentit Albert Lebrun që të emëronte Pétain në vend të tij, gjë që bëri atë ditë, ndërsa qeveria ishte në Bordo. Më pas qeveria vendosi të nënshkruë marrëveshje armëpushimi me Gjermaninë dhe Italinë. E gjithë qeveria më pas u zhvendos për një kohë të shkurtër në Clermont-Ferrand, më pas në qytetin e Vichy në Francën Qendrore. Ajo vendosi për të transformuar Republikën e Tretë Franceze, në shtetin francez, i njohur më mirë si Vichy France, një regjim autoritar kukull që u lejua të qeveriste Juglindjen e Francës dhe që bashkëpunoi me fuqitë e Boshtit. Pasi Gjermania dhe Italia pushuan të gjithë Francën në nëntor 1942, qeveria e Pétain mbas humbjes katastrofike të Francës nga ushtria gjermane bashkëpunoi me gjermanët. Në 24 tetor 1940 Pétain takohet me Hitlerin. Shumë hebre

në Francë u persekutuan dhe u dërguan në Gjermani gjatë qeverisë së Petain.

Pas luftës, Pétain u gjykua dhe u dënua për tradhti. Fillimisht ai u dënua me vdekje, por për shkak të moshës dhe shërbimit dhe kontributit të dhënë për Francën në Luftën e Parë Botërore dënimi i tij u ndryshua me burgim të përjetshëm. Metamarfoza e tij nga heroi i Francës gjatë Luftës së Parë Botërore, te sundimtari kolaboracionist gjatë Luftës së Dytë Botërore, e bëri pasardhësin e tij Charles de Gaulle të deklaronte se jeta e Petain ishte "Vazhdimisht banale, pastaj e laudishme, pastaj e mjerueshme, por kurrë mediokre".

Qeveria e përkohshme, e kryesuar nga De Gaulle, e çoi Petainin në gjyq për tradhti, gjyqi u zhvillua nga 23 korriku deri më 15 gusht 1945. I veshur me uniformën e një Marshalli të Francës, Pétain qëndroi i heshtur gjatë pjesës më të madhe të proceseve pas një deklarate fillestare që i mohonte të drejtën Gjykatës së Lartë siç ishte krijuar për ta gjykuar. Vetë De Gaulle më vonë kritikoi gjyqin, duke thënë: Shumë shpesh, diskutimet merrnin pamjen e një gjyqi partizan, ndonjëherë edhe të hesapeve, kur e gjithë kjo çështje duhej të ishte trajtuar vetëm nga pikëpamja e mbrojtjes dhe e pavarësisë kombëtare.

Në fund të gjyqit të Petain, ai u dënua për të gjitha akuzat. Juria e dënoi atë me vdekje. Për shkak të moshës së tij të vjetër, gjykata kërkoi që dënimi të mos zbatohej. De Gaulle, i cili ishte President i Qeverisë së Përkohshme të Republikësaj Franceze në fund të luftës, e ndryshoi dënimin me burgim të përjetshëm për shkak të moshës. Pas dënimin të tij, gjykata i hoqi Petainit të gjitha gradat dhe nderet ushtarake, përveç titullin Marshall i Francës.

Gjatë viteve të burgut, avokatët e Petain dhe shumë qeveri dhe personalitete të hua, duke përfshirë Mbretëreshën Mari dhe Dukën e Windsor, iu drejtuan qeverive të njëpasnjëshme franceze për lirimin e Petainit, por duke pasur parasysh gjendjen e paqëndrueshme të politikës së Republikësaj së Katërt franceze, asnjë qeveri nuk ishte e gatshme të rrezikonte jopopullaritetin duke liruar atij. Që në qershor 1946, presidenti i SHBA Harry S. Truman ndërmjetësoi më kot për lirimin e tij, madje duke ofruar azil politik në SHBA. Një ofertë e ngjashme u bë më vonë nga diktatori spanjoll gjenerali Francisco Franco.

Më 8 qershor 1951, Presidenti Vincent Auriol, i informuar se Pétain nuk kishte më shumë për të jetuar, e ndryshoi dënimin e tij në izolim në spital.

Pétain vdiq në një shtëpi private në Port-Joinville në Île d'Yeu më 23 korrik 1951, në moshën 95-vjeçare. Trupi i tij u varros në një varrezë lokale

Një figure nacionale franceze, që në Francë dhe sot shihet me dy standarte; një pjesë e quajnë tradhëtar e një pjesë e vlerësojnë për arritjet e tij në luftën e Parë Botërore dhe shmangjen e dëmeve të mëdha që do përjetonte Franca gjatë pushtimit nazist.

• *Informacione për dënimet e kolaboracionistëve:*

“...Sipas të dhënave të vendeve të ndryshme, në periudhën 1945-1955 në Europë janë zhvilluar 13,607 procese gjyqësore kundër tyre. Vendi që ka vutur më së shumti nga kolaboracionizmi ka qenë Franca, prandaj aty edhe qëndrimet ndaj tyre e dënimet kanë qenë radikale. Për të vendosur mbi baza ligjore dënimin e tyre, Asambleja Konsultative e Francës, në gusht-shtator 1944, aprovoi dy ligje për dënimin e

atyre që “I kishin dhënë ndihmë Gjermanisë dhe aleatëve të tyre, që kishin dëmtuar unitetin kombëtar, të drejtat dhe barazinë e shtetaseve francezë”. Sipas të dhënave zyrtare, në Francë u zhvilluan 170 mijë procese gjyqësore ndaj kolaboracionistëve, ku 120 mijë vetë u dënuan, nga të cilët, 4,785 vetë me vdekje. Vetëm 4 muajt e parë, mbas çlirimit të Parisit, janë dënuar me vdekje 6,763 vetë nga të cilët 1,500 prej tyre janë ekzekutuar menjëherë... Sipas shifrave që japin studiues të ndryshëm, në Francë janë ekzekutuar me gjyqe të rregullta, gjyqe të shpejtuara ose pa gjyqe, 20-30 mijë kolaboracionistë”.

“Statistikat flasin qartë për urrejtjen dhe qëndrimet të pafalshme ndaj kolaboracionistëve në Norvegji, Belgjikë dhe Holandë. kështu në qoftë se në Francë janë dënuar 12 vetë ndër 10 mijë banorë, në këto vende janë dënuar nga 40 deri në 64 vetë për 10 mijë banorë. Tepër të prerë e kategorikë kanë qenë holandezët ndaj kolaboracionistëve. Qeveria Holandeze që ndodhej në Londër prej disa vitesh, kishte filluar përgatitjet për “Spastrimin e madh” Që në Londër ajo kishte bërë ndryshimet e duhura në Kodin Penal. Për këtë qëllim ishte ndryshuar dhe përfshirë në kodin e ri dënimi me vdekje për tradhtarët e atdheut... Norvegjia konsiderohet vendi ku kolaboracionistët janë dënuar më rëndë se kudo në Europë. Megjithëse një vend me popullsi prej rreth 3.3 milionë banorë, në Norvegji u akuzuan për kolaboracionizëm 92 mijë vetë, u nxorën para gjykatave 46 mijë kolaboracionistë, nga të cilët 37,150 vetë u dënuan me afate të ndryshme burgimi, ndërsa 60 vetë u dënuan me

vdekje (kryeministri Kuisling u dënua me vdekje dhe u ekzekutua në sy të turmave që kërkonin me ngulm ta shihnin me sytë e tyre vdekjen e tij). Viktima të urrejtjes popullore u bënë edhe 50 mijë vza e gra që kishin pas marrëdhënie intime me oficerë apo ushtarë gjermanë, 14 mijë prej të cilave kishin lindur fëmijë nga këto marrëdhënie. Ato u arrestuan dhe 5 mijë prej tyre u dërguan nëpër kampe përqëndrimi.

Në Danimarkë menjëherë mbas çlirimit u arrestuan 20 mijë vetë të akuzuar për kolaboracionizëm. Më 1 qershor 1945 parlamenti danez, ratifikoi një ligj të ri që parashikonte dënime të rënda për bashkëpunëtorët e pushtuesve. Para gjyqit dolën dhe u dënuan 15,742 vetë, nga të cilët 3,641 vetë me mbi 4 vite burgim, 62 vetë me burgim të përjetshëm dhe 78 vetë me vdekje

Në Belgjikë kolaboracionistët u ligjëruan “Me shtetësi të humbur”, madje u vu në përdorim një term i ri, “Joshtetas” (pa shtetësi). Para gjykatave u nxorën 57 mijë vetë, nga të cilët u dënuan 23,584 vetë për “kolaboracionizëm politik”, 31,831 vetë për “Ndihmë ushtarake” pushtuesve, ndërsa 20,652 personave ju hoqën të drejtat civile. 42 vetë u dënuan me vdekje, disa prej tyre u ekzekutuan në prani të turmave. Rreth 2 mijë vetë u dënuan me burgim të përjetshëm, ndërsa rreth 5 mijë vetë u dënuan me nga 10 deri në 20 vjet. Tërheq vëmendjen një fakt interesant. Për disa vite mbas lufte, çdo belg që donte të zinte një vend pune, ka qenë i detyruar të merrte një çertifikatë garancie politike, ku kryesorja ishte qëndrimi i tij gjatë luftës... Në Luksemburgun e vogël, janë dënuar për kolabora-

cionizëm rreth 10 mijë vetë, nga të cilët 12 prej tyre me vdekje. Tepër ashpër u sollën me kolaboracionistët në Çekoslllovakia, madje ekzekutimi i tyre kishte filluar pa mbaruar lufta... Gjatë dëbimit të tyre nga Çekoslllovakia, në vitet 1945-1947, janë vrarë 20 – 30 mijë vetë, por numri më i madh i tyre janë eliminuar, ditët e para mbas largimit të pushtuesve gjermanë, apo siç është quajtur, gjatë “Dëbimit të egër”. Në Austri u shpallën 130 mijë vetë në kërkim, nga të cilët 23 mijë iu nënshtruan proceseve gjyqësore, ku u dënuan 13.600 vetë, ndër të cilët 43 vetë me vdekje...”

33. Po japim me shkurtime pjesë nga studimi i Astrit Jegenit për 4 shkurtin 1944

Gazeta "Bashkimi" në datën 3.2.1945 në faqen e parë në fund djathtas me shkrim të theksuar jep këtë lajmërim si më poshtë

“Ftohen familjet, far e fis, ose shokët, dhe çdo qytetar, që di emrat e martirëve të 4 shkurtit 1944, t'i njoftojë brënda ditës së sotme pranë Këshillit Nac.Çl. të qytetit të Tiranës”

Kjo ftesë e gazetës për qytetarët e Tiranës për të dhënë të dhëna për ngjarje e 4 shkurtit 1944 është një tregues se poshteti komunist nuk ka një informacion të saktë rreth kësaj ngjarje, thjesht deri tani ajo e ka propaganduar këtë ngjarje me anën e trakteve për qëllimet e sa politike duke shfrytëzuar efektet emocionale e tronditës që ka lënë kjo ngjarje te kryeqytetasit, e në të vërtetë nuk di as numrin e të vrarëve, as shkaqet e as emrat e viktimave të kësaj dite. Thjesht dihet se janë bërë vrasje në Tiranë, e pashembullt deri në atë ditë të luftës që është bërë në Shqipëri nga

krahu kundërshtar i komunistëve me ato përmasa që u propogandua.

Një artikull tjetër emocional për kujtimin e 4 shkurtit, të firmosur nga Demo Koti (Petro Marko) me titullin "Kush mungon, kush u vra" jepen këto emra si më poshtë e të vrarëve të 4 shkurtit 1944: Fadil Rada, Xhemal Sojli, Davi Koen, Sitki Çiço, Petro Prifti, Vasil Muzina, Gjergji Marangosi, Haki Huta, Dr. Pano, Emurdha Korra, Mihal Jani Koça, Rag. Ravesi, Sulejman Vrapit, Sokrat Tako, Ramiz Treni, Vangjel Cako, Harrito Harrito, Ali Visha, Mina Toma, Todi Shkurti, Gjergj Legisi, Islam Halla, Shyqëri Grablleshi, Hasan Rexhepi, Dhimitër Thoma.

Në këtë listë që shkruan gazeta janë gjithsej 25 njerëz të vrarë.

Shkrimi është produkt i një hetimi sipërfaqësor gazetaresk mbi këtë çështje.

Kjo listë që është botuar në gazetën "Bashkimi" lë shteg për shumë hamendësira për vërtetësinë e saj, sepse është produkt i një gazetari dhe jo punë profesionale e një organit kompetent. Në asnjë rast autorët e shkrimit në gazetë nuk na reforojnë dokumentat ku bazohet shkrimi ose ndonjë të dhënë tjetër besueshmërie për ato që shkruajnë.

Dokumentet gjermane të kësaj periudhe e përshkruanë këtë ngjarje si një dukuri normale në një situatë lufte me një përshkrim të thatë e të saktë.

*I Deleguari Special për Juglindjen,
Nojbaheri
Ministrisë Së Punëve Të Jashtëme*

*Telegram i Shifruar - Beograd, më 17 shkurt
1944*

Nr. 358

I deleguari special për Juglindjen

Shqipëri

Edhe për mjetet e informimit.

Situata në Shqipëri edhe më tej mund të konsiderohet e volitëshme. Shkatërrimi i bandave komuniste po vazhdon edhe më tej. Në vetë qytetin e Tiranës, me aksione të vrazhdëta të pastriimit nga ana e forcave nacionale, është shkatërruar aparati partiak komunist. Qeveria po fiton hapsirë, po jetësohet formimi i policisë dhe i xhandarmërisë, me ç'gjë po vazhdon konsolidimi i mëtejshëm.

Nojbaheri

Isuf Shaban Deva për vrasjet e 4 Shkurti të vitit 1944 tregon:

Unë Isuf Deva kamë qenë Sekretar i Ministrisë të Brëndshëm Xhafer Deva..., në datën 3 Shkurt 1944 komunistët i bëjnë atentat dhe vrasin nipin e Xhafer Devës, Fahri Ibrahim, (djali i dës) i cili kishte ardhur në Tiranë për punë dhe nuk merrej me politikë. Me rastin e atentatit që ju bë nipit të Xhafer Devës në Hotel Dajti, në përgjigje të këtij terrori u arrestuan 320 vetë të cilët qëndronin pranë Ministrisë së Mbrëndëshme nëpër burgjet e saj. Pushkatimi i këtyre filloj në orën 1 mbas mes nate dhe nëpër rrugët e lagjeve të ndryshme për qëllim paniku nëpër elementë të Lëvizjes Nacional - Çlirimtare. Viktimat e këtij terrori u lanë nëpër rrugët e qytetit deri në mbrëmjen e 4

Shkurtit. Në 4 Shkurt unë kam marrë vesh se janë vrarë rreth 80 vetë e mbi 200 të tjerë u arrestuan e u burgosën. Si është bërë terrori, ne nuk kemi bërë ndonjë mbledhje për të bërë ndonjë llogari mbi veprimtarinë që ishte bërë. Nga të gjithë ata që kanë vrarë më tepër në terrorin e 4 Shkurtit ka qenë Xhelal Staravecka, por sa ka vrarë, nuk ma ka thanë. Mbas kryerjes së terrorit të 4 Shkurtit, midis Qeverisë Mitrovica e Ministrisë të Mbrëndëshme Xhafer Deva lindën kontradikta, qeveritarë të ndryshëm të kësaj qeverie e kritikonin aktin e 4 Shkurtit.

Musa Gjylbegut tregon për vrasjet e 4 Shkurtit 1944:

Me 3 Shkurt 1944 në Tiranën e re, Kadri Cakranit i bënë një atentat, ku ju vranë dy djem që i kishte pas vetes dhe një i plagosur nip, a kushuri nuk e di se ç'e kish. Aty vritet dhe nipi i Xhafer Devës, djali i vëllait që ishte me automobilin e Xhaferit, që e kishte marrë ai.

Unë atëhere shkova te Kryeministri Rexhep Mitrovica dhe ai më foli për vrasjet që janë bërë dhe past me tha: Djemtë e Kadri Cakranit për hakmarje të atentantit, janë çuar e kanë bërë disa vrasje. Ministria e Brëndëshme mbasi nuk kishte forca të mjaftueshme e pa të nevojshme që të marrë masa mbrojtëse për ata që ishin të dyshimtë dhe për t'i siguruar, i mori dhe i futi në burg, mandej e pyeta se sa të vrarë ka kjo punë, e ai me tha pesë gjashtë vetë, por hollësi nuk kam akoma, por do t'i marr shpejt.

Kur erdhi mbas tre - katër ditëve Xhafer Deva në Këshillin Ministrues ku ishte dhe Këshilli i Naltë, Xhaferi tha: Çështja e 4 Shkurtit ngjau nga disa djem të Kadri Cakranit që sot nuk gjenden këtu fare, këta e banë për hakmarje për atetatin e 3 Shkurtit. Ministria e Brendëshme, mbasi nuk kishte forca të mjaftueshme t'i siguronte jetën jashtë, i arrestoi dhe i futi mbrënda një sasi njerzish të dyshimtë.

Njerzit që janë vra janë shtatë-tetë vetë, jo më shumë. Ju tha Xhafer Devës se opinionioni publik flet për ty dhe se janë tetëdhjetë e sa vetë dhe jo sa thua ti. Ai thoshte se këto fjalë nuk janë të vërteta. Opinionin publik dhe Këshilli i Naltë ishte i mendimit që këtë punë e bëri ai me Kadri Cakranin.

Xhelal Staravecka tregon për ngjarjen e 4 shkurti të vitit 1944:

Pjesë nga libri i Xhelal Staraveckësaj me titull “Përpara gjyqit të Historisë” ...në atë masakër nuk kam marë pjesë, pasi komandën e xhandarmërisë së kryeqytetit e mora në 13 shkurt. E në sa i takon as çështje, kam dëgjuar se edhe qeveria e Tiranës e regjimit të sotëm nuk më ka dënuar. Atë gjak e ka bërë regjimenti “Kosova” i urdhëruar nga Ministri i Brendshëm Xhafer Deva, në bazë të një liste përgaditur për të gjatë ditës në bashkëpunim me Ballin. Ministrin të Brëndshëm Xhafer Devës, njësitin komunist i vrau xhaxhain dhe komandantin të përgjithshëm të ballit, Kadri Cakranit, i vrau një nga shërbëtorët e tij. Meqenëse Tirana ishte stan pa qen, Kadri Cakrani dhe

Xhafer Deva ishin të mjaftueshëm të bënin atë masaker që bënë. Nga aksioni komunist u bë ajo kasapanë atë natë që iu kushtoi jetën më tepër se shtatëdhjetë personave të pafshëm.

Fragmente nga libri për “Ing. Xhafer Devën” shkruar nga Idriz Lam

Dr. Rexhep Krasniqi shkruan për 4 shkurtin: Në një dosje të tij ndodhen dy letra të miat ku shihet se i kam bërë presion (Xhafer Devës) të shkruante rreth 4 Shkurtit dhe Regjimentit Kosova. Më bënte përshtypje heshtja e tij ndaj akuzave rreth masakrës së 4 shkurtit dhe gjoja rreth krimeve që kishte bërë ai. Xhafer Deva heshte dhe në qetësinë më të madhe shihej se nuk iu jepte asnjë rëndësi akuzave në fjalë. Vazhdimisht thonte: "Rexhepi i dinë të gjitha, ato janë shpifje, na nuk duhet të mirremi me gënjeshttrat e komunistëve."

Në një letër dërguar Krasniqit (8.12.1971) Xhafer Deva shkruan: "Idrizi ngul kambë se këto nuk janë ma shpifje por akuza. Ai nuk po e bân dallimin midis shpifjes dhe akuzës dhe asht i mendimit se heshtja ime përforcon akuzën. Ai thotë: "Ju duhet patjetër të jepni versionin tuej dhe të shpjegoni rrethanat e ngjarjeve për të cilat akuzoheni, të pakten aq sa dini dhe aq sa mbani mend". Idrizi i shkretë, nuk i dinë intrigat që janë thurë kundër nesh, nga të dy palët, nacionalistët dhe komunistët!. Idrizi nuk dinë shumë gjana të as kohe..., etj." Unë nuk arrita ta bindë Devën të shkruante më tepër, megjithëse dy-tre herë përmën-

dë në letrat e tij: "Nji ditë do të ulemi bashkë dhe do të shtrojmë muhabetin për këto çashtje."

Mbas vdekjes së Xhafer Devës, me insistimin tim, Dr. Rexhep Krasniqi shkroi diçka për 4 Shkurtin, në librin që përgatitëm për Devën: ... Fushatë e tërbuar kundër Kosovës ... U vunë në qarkullim gjithfarë shpifjesh të ndyra, si bie fjala se kosovarët janë një masë injorante që kishin për të rrezikue ekuilibrin e përbërjes së popullsisë shtetërore shqiptare, se ata janë katila, vrasin rininë tonë të pafshme, ç'nderojnë vajzat tona, plaçkisin tregtarët dhe fshatarët", e njëmijë të zeza të tjera. Edhe për aksionin e spastrimit që u krye me 4 shkurt 1944, kundër partizanëve komunist që përditë terrorizonin banorët e Tiranës e të krahinave të tjera me atentate brutale, me aksione plaçkitjesh të magazinave tregtare dhe të depove me ushqime e mallra të shtetit. Propaganda komuniste vjet për vjet mbushë botën me ulurimë dhe akuza hipokrite kundër kosovarëve dhe sidomos kundër Xhafer Devës. Doemos se aksioni në fjalë është kryer me pëlqimin e Ministrisë së Mbrendshme që kryesohej prej Xhafer Devës, por e vërteta është se Regjimenti Kosova atë natë ka kryer vetëm detyrën e rojes së zakonshme në qytet dhe nuk ka marrë pjesë në aksionet që ju kushtoj jetën disa komunistëve dhe terroristëve të njohur të tyre. Aksionet në fjalë, gjithkush e dinë, në realitet janë kryer prej një grupi luftarësh që nuk ishin në shërbim të qeverisë dhe kryesoheshin prej z. Xhelal Staravecka, ish oficer shqiptar që ka qenë ndër udhëheqësit më aktiv të partizanëve komunist, në një shkallë me shokët

Mehmet, Enver, siç e vërteton edhe Dushan Mugosha, njëri prej organizatorëve jugosllav pranë partisë komuniste shqiptare, në kujtimet e veta me titull: "Kur kam qenë në Shqipëri". (Xh. Deva - Jeta dhe Veprimtaria, N.Y. 1980, fq. 42 85-86).

Kadri Cakrani tregon:

Në vazhdën e dëshmimeve për këtë ngjarje po citoj një përskrim nga libri i Kadri Cakrani "Të vërtetat e luftës time" Në librin e tij autobiografik shkruan midis të tjerave dhe për 3-4 shkurtin 1944. Faqe 384-394 (përmbledhje) Ishja në Tiranë dhe ishte kaluar dreka... e vajtëm në kafenen "Kursal" E kishja pirë kafënë për gjysëm kur dëgjova disa të shtëna e krisma dhe një breshëri plumbash, jo shumë larg... kishin sulmuar maqinën time duke kujtuar se unë ishja aty, shoferi im ishte vrarë e nipi im Isa Xhindoli ishte plagosur por po qëllonte me pistoletë. Nga shkëmbimi i zjarrit midis antetatorëve e njerëzve të mij e xhandarmërisë që po patrullonte në rrugë u vranë 4 antetatorët. Erdhi Ministri i Brëndshëm Deva e tha: i gjetëm kush ishin, janë nga Fieri ishin nisur për tju vrarë juve, por kjo u shoqërua dhe nga antetatorët e Tiranës që i kishin bërë antetat makinës së Ministrisë të Brëndshëm Deva. Nga shkëmbimi i zjarrit me ta mund të kem dhe unë dy të vdekur tha Deva. Antetatorët kishin bërë antetat dhe makinës së Xhafer Devës dhe kishin plagosur rëndë nipin e tij që më vonë vdiq.

Xhafer Deva në debat me Kadri Cakranin i tha atij:-Unë si Ministër jam kategorikisht kundër përzierjes së forcave të Ballit që është një organizatë dhe nuk ka lidhje me qeverinë. Ja ku i kam emrat i ke nesër të gjithë pas hekurave. U shpall “Copri fuoci” (ndalim qarkullimi). Gjithë natën të shtënat nuk pushuan, ku terroristët hidhnin dhe ndonjë bombë, pasi xhandermëria e kishte të ndaluar ti përdorte bombat. Atë natë ata që kishin dalur natën në “Copri fuoci” ishin goditur në vënd, si shkelës së saj, të kuq apo jo. Operacioni meqense ishte lajmëruar me radio të gjithë të kuqtë kishin ikur nga Tirana. Gjatë natës u vranë nja 7-8 vetë dhe ne i vramë katër vetë në shkëmbimin e zjarrit me ta kur na bënë atentat. Të nesërmen në mëngjez copri fuco u mbyll më vonë. Tirana atë të premtë mezi doli për pazar nga frika. Komunistët mbushën traktet dhe fletushkat e tyre me masakra e terror, me afro 100 vetë të vrarë... miletin i futën frikën për Ministrin Deva, vetë që e nisën me të vrarë, bënë sikur ishin viktima duke ç’pikur dhe shtuar vetë sa u vranë. Komunistët për intrigë, nuk kishte njëri që tu dilte.

- Nexhmedin Spaihu tregon:

Një tjetër informacion interesant është në pjesën e mëposhtëme të shkrimit, ku në pyetjen time drejtuar Prof. Nexhmedin Spahiut, për ngjarjen e 4 shkurtit, Prof. Spahiu nga Mitrovica e Kosovës kujton: Kam pasë takuar dy ish xhandarë nga Mitrovica që tani kanë vdekur por që kanë marrë pjesë në ngjarjen e 4 shkurtit si pjesë e regjimentit “Kosova” ata më kanë

thënë: “Ne kishim urdhër të mos qëllojmë, vetëm në rast vetmbrojtje e sipas rregullave të qëllohet mbi agresorin. Komunistët në natën e 4 shkurtit 1941 në ikje e sipër nga frika e arsetimit ose vrasjes hidhnin bomba dhe vrisnin njerëz të pafshëm vetëm për të shpëtuar veten e tyre, e në një rast e kanë vrarë njeriun e tyre që ne e kishim arrestuar nga frika se mos i spijunonte. Këta dy xhandarë më kanë treguar për 8 të vrarë gjithësej në natën e 4 shkurtit 1944, pa llogaritur 5-6 atentatorë të një dite më parë të datës 3 shkurt që janë vrarë nga xhandarmëria e njerëzit e Kadri Cakranit në vetmbrojtjen e tyre ndaj atentateve kundër Kadri Cakranit e kundër Xhafer Devës. Nga atentatet e komunistëve u vranë shoferi i Kadri Cakranit dhe djali i dajës së Xhafer Devës.

34. *“4 shtator 1944, sulmi mbi autokolonën e të sëmurëve e të plagosurëve gjermanë.”. Ish majori i ushtrisë gjermane Herman Frank, në librin e tij “Lufta e çetave në Shqipëri” tregon për vrasjet nga partizanët e “Brigadës së Pestë” që sulmuan në pritë trupat të ushtrisë gjermane të sëmurë nga malarja. Gjermanë të sëmurë që po iknin në Gjermani me makina të kryqit të kuq ku shenjat e kryqit të kuq ishin të qarta. Gjithashtu dhjetë ditë më parë tek Hani i Laçit në Kukës qenë partizanë vendas ata që sulmuan nga një pritë një autokolonë që në mes kishte një autobus, ku kishte gra gjermane.*

Midis infermerëve të vrarë u plagos dhe grua e Konsullit Gjerman në Tiranë, zonja Shliep, që shërbente të sëmurët bashkë me të tjera infermiere.

Partizanët vrasin të sëmurët dhe infermeret gjermane disa i marin robër.

Komanda Gjermane si përgjegje të këtij krimi e mosrespektimin e Ligjit Ndërkombëtar të Gjenevës, urdhëron ushtrinë gjermane për hakmarje ata menjëherë shkojnë tek burgun i Tiranës, Shkodrës etj dhe marin 200 të arrestuar komuniste etj e me kamionat e ushtrisë i dërgojnë në kampin e Prishtinës në Kosovë. Nga ana tjetër ushtria gjermane rrethon katundet shqiptare ku ndodhi krimi dhe u jep ultimatum banorëve që të dorëzojnë infermeret gjermane, përndryshe ushtria gjermane do t'i vriste të gjithë banorët dhe do t'i vinte flakën shtëpijave të tyre. Katundarët, për t'i shpëtue këtij lloj ndëshkimi kërcënuan çetën komuniste me vrasjen e mbarë çetës që kreu sulmin mbi të plagosurit gjerman.

Komunistat i dorëzuan infermeret gjermane. Sipas Herman Frank, ushtria gjermane krye një operacion të veçuar ndaj partizanëve duke e asgjësuar grupin e pritës pothuaj plotësisht. Nga të burgosurit e Shkodrës gjermanët në vëndin ku u krye goditja e kollonës gjermane me të sëmurë ata pushkatuan 26 njerëz të tjerët i dërguan në Prishtinë. Në Prishtinë sipas shifrave të internuarëve atje janë pushkatuar më shumë se 100 njerëz të kombësisë shqiptare. Nga fundi i luftës Xhelal Mitrovica deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe gazetar me njerzit e tij rrethoi kampin e Prishtinës dhe i dha ultimatum komandës së kampit që në qoftë se doni të ikni të lirë lironi kampin, gjermanët liruan kampin dhe të internuarit u liruan.

35. *Material i marë nga Arkivi Historiko – Diplomantik Inventari i Dokumentacionit i Vitit 1944 M.P.J*

Notë-verbale e Ministrisë së Punëve të Jashtme Shqiptare drejtuar Konsullatës Gjermane dhe korrespondencë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kryeministrinë, Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare etj, mbi lutjet e përfaqësuesve të popullit së Durrësit për lejimin e kthimit në qytet të banorëve të shpërngulur nga qyteti.

- Lutje e parisë së Lezhës, raporti i Shoqërisë "Lata" drejtuar Kryeministrisë, shkëmbim notash verbale ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Legatës Gjermane si dhe korrespondenca me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komandën Gjermane etj., mbi bombardimet e kryera nga ushtria gjermane në Lezhë, Librazhd, Pejë dhe dëmet e shkaktuara në këto vende, si dhe mbi minimin e Portit të Durrësit.

- Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Ministrinë e Punëve të Brendshme, e Komandën Gjermane mbi djegie shtëpish, dyqanesh etj, nga ushtria gjermane si dhe shkresat e personave për likuidimin e demit.

Gjermanët të bindur se bregu i detit i Shqipërisë së Mesme mund të jetë objekt i zbarkimit të trupave Aleate largojnë banorët e zonave nga Kepi i Rodonit-Durrës duke i trajtuar këtë rajon si rajon luftime. Me ndërhyrjen e Priftit të Bizës (Kepi i Rodonit) Padër Klement Miraj pranë komandës gjermane banorët e fashatrave të Kepit të Rodonit rikthehen në banesat e tyre. Në Tetor 1943 filloi largimi i banorëve të Durrësit nga gjermanët për asrsyet e tyre ushtarake. Qyteti u boshatis, shumë qytetar u rikthyen për të kontrolluar shtëpitë e pasuritë e tyre, ushtria gjermane i arestoi dhe i internoi shumë nga këta qytetar që u kthyen, sepse kundërshtuan urdhërin e ushtrisë gjermane. Në

Durrës nuk u lejua që banorët të kthehen derisa gjermanët u larguan nga Durrësi. Në port gjermanët minojnë e shkatërojnë disa pjesë të portit dhe disa objekte industrial të Durrësit.

36. *Tanush Mulleti më tregonte: Kisha Françeskane afër shkollës së “Kuçe” është ndërtuar nga Patër Anton Harapi. Tanushi thotë se kur u inagurua kisha nuk kishte karrike në sallën ku do bëhej meshë. Banorët e lagjes mysliman, ortodoks e katolik morën karrike nga shtëpitë e tyre dhe salla u mbushë me ndenjësjet për besimtarët. Patër Antoni megjithse ishte Regjent kur dilta nga zyra shkante te kjo kishë dhe aty ushqehej me supë dhe aty flinte. Megjithse e këshillonin që të mos shkante te kisha se do ta vrisnin komunistët ay nuk prononte të largohej nga kisha e tij që e kishte, zyrë, fjetore e siguri shpirtëror.*

37. *Letra e Mustafa Krujës. “Pse bashkëpunova me fashistët” viti 1952 Aleksandri Egjypt*

Në fjalimin tim të fundit publik si kryeministër shqiptar mbajtur më 22 nëntor 1942, thashë se Bashkimi Sovjetik i tradhtonte aleatët e vet sapo nuk kishte më nevojë për ta, dhe se nëse përfundimi i luftës do ta gjente Shqipërinë komuniste, ajo do të shndërrohej në një provinckë të perandorisë sllavo-komuniste që do të shtrihej nga deti i Japonisë deri në Adriatik. Isha në prag të dhënies së dorëheqjes. Si kryetar qeverie, desha t’i hidhja këtë paralajmërim të fundit bashkatdhetarëve të mi. Njeriu verbohet nga pasionet, bëhet shurdh, humb ndërgjegjen. Por jam i sigurt që në Shqipëri janë të shumtë ata që tani e kujtojnë atë paralajmërim. Pra, pa marrë pjesë aktive në lëvizjen shqiptare, ngaqë shihja qartë që kjo do të çonte ujë në

mullirin e komunizmit, u orvata, sidoqoftë, ta ndihmoj, e ndihmova. Asnjë kundërshtar nacionalist nuk e pa derën e burgut për veprimtari politike për sa kohë qeverisa. Pas dorëheqjes, i dhashë tërë mbështetjen time Lëvizjes Legaliste në lidhje të ngushtë me kreun esaj Z. Abas Kupi, tanimë anëtar i Komitetit “Shqipëria e lirë”. Mendoj se kuadri politik që dua të nxjerr në pah me këtë paraqitje mbi Shqipërinë nën pushtimin e huaj gjatë luftës së fundit, nuk do të ishte i plotë nëse nuk flisja shkurt edhe për politikën, në e nëpër atë vend, të dy grupeve të fuqive luftarake dhe të politikës të secilës. Pasi është pikërisht politika e tyre ajo që ka luajtur një rol kryesor në përcaktimin e ndjenjave dhe, si pasojë të qëndrimeve të patriotëve shqiptarë. “Më mirë një Shqipëri gjysmë e pavarur por me Kosovën, se sa një Shqipëri krejt të pavarur pa Kosovën”

38. *Prokurori Treska e vlerson veten sipas racionalitetit dhe ndjenjave të tij thelbësore e kjo e bën atë brutal, diskriminues dhe shtypës ndaj veprimeve të një personi që po gjykohet. Diskriminimi i mëtutjeshëm e vazhdon me etiketime diskriminuese e fyese e për pasojë gjykimi është irracional që reflekton një qëndrim mbizotëruese të fanatizmit anti social. Prokurori karakterizohet nga demonstrimin e brutalitetit, paragjyqimeve, armiqësisë dhe urrejtjes iracionale ndaj të pandehurit ai shfrytëzon me qëllim mendësinë stereotipe popullore për “Tradhëtinë e patriotizmin” Në thelb, komunistët shqiptarë nuk e pranonin dot, madje as e koncepton dot figurën e kundërshtarit politik; e vetmja mënyrë që ata zgjodhën për ta ishte*

ti trajtonin ata si "Tradhëtarë të kombit e ti asgjësonin fizikish"t.

39. Organizatë nacionaliste Serbe (Çetnik) u krijua në vitin 1902, qëllimi i krijimit për të luftuar Perandorinë Otomane e pavarësinë e Serbisë. Mbas kapitullimit të Jugosllavisë në Luftën e Dytë Botërore u organizuan formacione ushtarake Çetnike si forcë guerile e nacionalistëve serbë. Ata zhvilluan një luftë guerile kundër gjermanëve, komunistëve të Titos, kundër popullsisë kroate, boshnjake e shqiptare. Më e spikatur nga këto farmacione ushtarake ishte ajo e Kolonelit Dragoljub Mihaloviç (Drazha). Midis formacioneve ushtarake shqiptare dhe çetnikëve serbë janë zhvilluar luftime të ashpra e të përgjakshme gjatë Luftës së Dytë botërore.

Fundi i pushtimit fashisto-nazist dhe fillimi i diktatit komunist



10 Shtator 1944 Hitleri urdhëroi tërheqjen e trupave gjermane nga Ballkani

Tërheqja e trupave gjermane nga Shqipëria.

Pjesë nga Ditarët e luftës të Komandës Supreme të Forcave të Armatosura Gjermane (Kriegstagebuch des Oberkommandos der Wehrmacht, KTB OKW), që në vitet 1940-1945, u mbajtën nga Zyra e Mbrojtjes

Kombëtare pranë Shtabit të Operacioneve të Forcave Ushtarake gjermane (Abteilung Landesverteidigung im Wehrmachtführungsstabamt).:

Kështu edhe lëkundjet (politike) e Turqisë dhe ndryshimi i qëndrimit (politik) në Bullgari, ajo (Bullgaria) u shpall asnjëse më 26.08.1944 dhe kërkoi largimin e trupave gjermane e më vonë sulmoi trupat gjermane, sollën ndryshimin në rajonin juglindor të Europës. Pozita e mëparshme gjermane në këtë rajon, nuk mund të ruhej më: më 26.08.1944 Komanda e Lartë Jug-Lindore, mori urdhërin e përgatitjeve për tërheqje të tërë trupave dhe pajisjeve në jug të linjës; Korfuz-Janinë-Kalabaka-Olimp, kështu braktisja e Detit Egje dhe Greqisë, filloi.

.... Pak më ngadalë, u krye tërheqja nga zonat bregdetare të Malit të Zi dhe Shqipërisë, gjë e cila lidhej ngushtë me tërheqjen e Grup-Armatës ‘E’ Deri në javën e parë të Tetorit 1944, qëllimi i komandës gjermane, ishte që me Grup-Armatën ‘E’ (e cila mori më 03.10.1944, urdhrin për t’u tërhequr nga Greqia, Shqipëria Jugore dhe Maqedonia Jugore), e ndodhur në “Linjën blu”; Shkodër-Shkup-Këlcyrë dhe me Grup-Armatën “Serbia”, e ndodhur në linjën; Negotin-Danub (që nga 01.10.1944) dhe atë; Vlasotince-Bela Palanka-Zajeçar-D. Milanovac (që nga 05.10.1944), të mbahej zona kroato-malazeze-shqiptaro Veriore dhe serbe. Por shumë shpejt u pa se pjesa më e madhe e Serbisë, ishte humbur. Me 10.10.1944, u dha urdhëri për tërheqjen përtej lumit të Moravës.

Faqe 701. Në javën e parë të nëntorit, u qartësua plotësisht se cilat ishin qëllimet e udhëheqjes sovjetike: Armatat sovjetike kishin

filluar ofensivën në Hungari, kurse detyra e bullgarëve dhe e njësive të Titos, ishte shkatërrimi i pozicioneve gjermane në zonën kroato-malazeze-shqiptaro-veriore dhe në atë mënyrë, të futej nën kontrollin sovjetik, pjesa Perëndimore e Gadishullit Ballkanik, pak a shumë sipër linjës Shkodër-Velesh të Maqedonisë, në përputhje me ndarjen e zonave në Moskë.

Faqe 704. Lëvizja komuniste shqiptare, që ndoshta me sa duket pat filluar me nismën vendase, gjatë verës [1944] u bë pjesë e qëndrueshme e organizatës së Titos, si “Shtab Qendror për Shqipërinë”. Krijohet përshtypja se për ca kohë, ka ekzistuar edhe plani për ta futur Shqipërinë në federatën jugosllave (Libri i Situatës 25.07.1944).

Faqe 706. Në pritje të një ofensive të përgjithshme dhe mjaft kërcënuese të aleatëve, shtimi i veprimeve të kryengritësve në rajonet e Europës Jug-Lindore, akoma nën zotërimin gjerman dhe dështimi i krijimit të qeverive në Mal të Zi dhe Shqipëri, ri shtruan pyetjen: nëse të paktën organizatat vullnetare serbe dhe lëvizjet politike prapa tyre, duke marrë më shumë ndihmë në armatime dhe furnizime, a do mund të bëheshin një forcë ndihmëse edhe luftarake për ushtrinë gjermane edhe për të krijuar një zonë sigurie për të gjithë?!

Faqe 707. I dërguari i posaçëm për zonën Jug-Lindore, Hermann Neubacher, u ndodh në Prill 1944, për ca kohë në shtabin qendror të udhëheqjes, për të diskutuar çështje të kohës. Ndër të tjera: d) Dhënien e 120 kamionëve, të cilët siç është përmendur më herët, ishin kërkuar më parë për të mënjanuar problemet e furnizimit të popullsisë në Shqipëri dhe Mal të Zi, ku kërcënonte uria. Kjo kish rëndësi sepse, shtimi i veprimtarisë së bandave, kishte lidhje

edhe me mungesën e ushqimeve. Me ato masa i dërguari i posaçëm, shpresonte të organizonte forcat kombëtare shqiptare, me qëllim që të arrinin një numër prej rreth 20.000 vetash.

Përkthyer nga Ana Kolovica e Redaktuar nga Saimir Lolja

Fragmente nga kujtimet e dr. Martin B. Schliep (Ambasadori gjerman në Shqipëri)

Me krijimin e përshtypjes të krijuar nga propaganda armike (Anglo-Amerikane-BRSS) mbi një zbarkim të afërt dhe sidomos për informacionet e këqija që vinin nga fronti Lindor në mars 1944, situata filloi të përkeqësohej. Fluturimi i reparteve të rënda bombarduese (Avjonëve), si dhe sulmet në lartësi të ulët mbi trafikun rrugor demonstronin një epërsi ajrore të armikut, si dhe shkaktonte nervozizëm dhe tension te popullsia. Në prill 1944 doli në pah kriza e parë e qeverisjes, ankesat kryesore të saj ishin mbi mungesën e ndihmës nga ana gjermane për sa i përket furnizimit me mallra të domosdoshme për jetesë, si dhe për furnizimin me pajisje ushtarake. Shqipëria e Mesme ishte pa bukë dhe mielli e artikuj të tjerë ushqimorë kishin mbaruar. Në Shqipërinë e Jugut mbizotëronte uria dhe refugjatët e uritur u përqendruan në Shqipërinë e Mesme, ku ata mund të furnizoheshin. Kamionët nuk mund të përdreshin për arsye të mungesës së gomave. Si pasojë e mungesave, punës së tepërt dhe shqetësimit, Kryeministri ishte i lodhur nga pozicioni i tij. Ai bëri të ditur që nuk ia kishte arritur të rivendoste sigurinë dhe rregullin, si dhe se situata e transportit dhe furnizimit e bënte dhe më të vështirë gjendjen.

Mes tij dhe Mehdi Frashërit ishin krijuar mosmarrëveshje të mëdha. Ndërsa Shqipëria e Veriut dhe Shqipëria e Mesme ishin në përgjithësi ende të qeta, zonat e Shqipërisë së Jugut ndodheshin në dorë të grupeve luftarake komuniste, të cilat ishin të drejtuar dhe organizuara mirë. Ata kërkuan një “Qeveri republikane sovjetike të Shqipërisë” dhe ishin të vendosur të bashkonin popullsinë me idetë e komunizmit. Nga ana tjetër, ballistët si pasojë e mungesës së organizimit kishin humbur reputacion. Fitztum vuri re që katër batalionet shqiptare të Wehrmachtit nuk ishin të aftë për mision për arsye të dështimit të komandave të mbrojtjes së vendit. Nga trupat gjermanë pati dezertorë që shkuan te komunistët. Njësitë turkmene të dërguara në Shqipëri për përforsim, të cilat ishin formuar nga robër lufte rusë, dezertuan dhe kryen masakra tek ushtarët gjermanë. Drejtuesi SS u caktua si i plotfuqishëm nga Hitleri, për të ndërtuar në Shqipëri një batalion alpin SS “Skanderbeg” me qendër Prizrenin, për të luftuar partizanët brenda kufijve të vendit. Qeveria shqiptare ishte dakord, duke qenë se nga kjo ajo shpresonte të krijonte bazat e një strukture të mirëtrajnuar për forcën luftarake dhe xhandarmërinë e së ardhmes. Kryeministri i dobët, i sëmurë nga mushkëritë, Rexhep Mitrovica, nuk mund të vazhdonte dot dhe në korrik të vitit 1944 dha dorëheqjen. Mbas një krize të vështirë të qeverisë, e cila zgjati disa javë, këshilli zgjodhi një anëtar të katërt (Regjenca) në korrik, Cafo Beg Ulqini¹, i cili zëvendësoi Fuat Dibrën, i cili kishte vdekur. Përpjekjet e Neubacherit për marrjen e Xhafer Devës në kabinet, pasi zonës së Kosovës nuk i ishte kështuar vëmendja e nevojshme, dështuan për shkak të kundërshtimeve të Mehdi Frashërit. At Harapi, i cili

për këtë çështje ishte dërguar jashtë vendit dhe kishite udhëtuar për në Tirol me Neubacherin, pas disa javësh u kthye, për të marrë përsëri postin e tij. ²

Qeveria e fundit shqiptare u formua më 6 shtator 1944 me Ibrahim Bej Biçakçiun si kryeministër. Gjendja e brendshme mbizotërohej nga paniku për një marshim sovjetik ³ dhe nga shqetësimi, nga fuqia e madhe e akumuluar nga komunistët, të cilët tashmë kishin filluar të sulmonin në Tiranë jo vetëm natën, por edhe ditën.

Qeveria ishte e pafuqishme si pasojë e pasivitetit të administratës. Dy anëtarë të qeverisë lanë qytetin. Por Mehdi Frashëri qëndroi në Tiranë deri në tërheqjen e trupave gjermane dhe më pas bashkë me Eqrem Vlorën ⁴ dhe personalitete të tjera u prit nga qeveria gjermane në Tirol, nga ku shkoi për në Itali para marshimit të aleatëve. Siç u përmend edhe më lart, at Harapi refuzoi të largohej nga vendi dhe ra në duar të komunistëve, të cilët e varën. Ibrahim Biçakçiu nuk arriti ta linte vendin në kohë, u dënua me vdekje dhe më vonë ky dënim u këmbye me një dënim me burg. Shumë tregtarë shkuan në Shkodër, me qëllim që më pas të çonin familjet e tyre në një vend të sigurt. Neubacher la Beogradin më 6 tetor 1944 dhe, duke qenë se në qeverinë shqiptare kishte gjithnjë e më shumë shenja të shkrirjes, detyra ime ishte tashmë pa objektiva. Ministria e Punëve të Jashtme urdhëroi largimin tim dhe unë fluturova për në Vjenë së bashku me Scheiger ⁵ dhe refugjatë shqiptarë në natën e datës 16 për 17 tetor 1944 me avionin e fundit. Këshilltari Lippert, ⁶ konsulli Merfels (*Josef Merfels konsulli i zyrës konsullore në*

Tiranë) dhe kancelari Wegner ishin larguar tashmë nga Tirana. Ata pak anëtarë të mbetur pjesërisht u tërhoqën nga Wehrmachi.

dr. Martin B. Schliep



Tirana mbas luftës së Dytë Botërore 1945



Parakalimi i ushtrisë Nacional Çlirimtare

Aleatët e Mëdhenj SHBA, Angli e B.R.S.S. kishin filluar bisedimet për të vendosur mbi rregullimet e botës së pasluftës. Mungesa e një qeverie shqiptare të njohur nga Aleatët në mërgim, e lehtësonte edhe më shumë rrugët drejt pushtetit për drejtuesit e PKSH-së. Kërkesat e vazhdueshme të Mbretit Zog në emigrim për njohje e përkrahje u injoruan nga Fuqitë e Mëdha.

Në Shqipëri, Lëvizja Nacionalçlirimtare e kishte rritur së tepërmi fuqinë e saj ushtarake, komunistët shqiptar po zbatonin tezën e Leninit se nuk ka lëvizje revolucionare nacional çlirimtare në qoftë se nuk drejtohet nga komunistët. Ndryshe nga rivalët e saj, komunistët u treguan konsekuente në luftë kundër pushtuesit e dëshirës për pushtet. Ata siguruan simpatinë, por edhe mbështetjen e SHBA e Britanisë së Madhe. Një pikë tjetër që gjeti përkrahjen e Aleatëve


të Mëdhenj ishte kundërshtimi i nacionalizmit irrendentist, dhe e propogandimit të lirisë të Shqipërisë nga pushtuesit, dhe vendosja e drejtësisë sociale e shoqërore.

Komunistët që drejtonin Frontin Nacional Çlirimtar në tërësi nuk u mbështetën në elitat politike të Shqipërisë por në shtresat marginalizuara, fshatare, punëtore të varfëra e pa pristigj shoqëror. Ata me sukses propoganduan ideologjizimit komunist të Luftës Nacional Çlirimtare duke premtuar zgjidhje të çështjeve sociale, propoganduan urrejtjen për beun e agajn, tregtarin, kapitalistin, klasën politike, klerin, etj të cilët fajësoheshin edhe si shkaktare për humbjen e pavarësisë së Shqipërisë.

Premtuan një Shqipëri të Re, për një pushtet të popullit, për një shoqëri të drejtë e të barabartë e cila rriti ndjeshëm mbështetjen për ta. Komunistët shfrytëzuan me efikasitet gabimet e kundërshtarëve të tyre politik si: pasivitetin, indiferentizmin, krahnizmin, konfliktet fetare, naivitetin e tyre, egon personale për pushtet e fuqi, paqartësi në qëndrime politike, Ata shfrytëzuan me lehtësi mungesën e vizionit politik të kundërshtarëve të tyre, të cilët gabuan duke bashkëpunuar me fuqi ushtarake europiane humbese të Luftës së Dytë Botërore. Komunistët aritën ti defaktorizojnë kundërshtarët e tyre në luftën për marjen e pushtetit. Kongresi i Përmetit vuri bazën e pushtetit të ardhshëm në Shqipëri duke i vënë shqiptarët dhe Aleatët përpara faktit të kryer.

Shqipëria antikomuniste në kolaps.

Fragmente nga proçesi gjyqësor:



Me pjesmarjen e prokurorit të Popullit major Misto Treska e asistuar prej sekretarëve aspirant Thoma Rino e kapter Zalo Xhomaqi, sot në datën 6 Fruer (shkurt) 1946, të mbledhur në sallën e kino teatër “Kosova” për të gjykuar të pandehurin:

U soll nga burgu i pandehuri Padër Anton Harapi dhe u vu në vëndin e tij të posaçëm duke qenë i asistuar dhe nga përfaqësuesi i tij që u sipër shënuan.

Prokurori: Pater Anton Harapi i ka ndejt besnik gjermanëve deri në fund. Për të organizuar forcat e mbeturinat e reaksionit në Veri të Shqipë-

risë, me anë të “Lidhjes së Shkodrës” ⁷ në bashkëpunim dhe me forcat Çetnike ⁸

I pandehuri: Patër Anton Harapi tha: “Kur u formua “Beslidhja e Shkodrës” unë s’kam qenë, në të tjera mbledhje kam qenë. Këtë e formuan Gjon Marka Gjoni, Mid’hat Frashëri e Ndoc Çoba”.

Për të qartësuar situatën historike e psikologjike të kohës më duken me interes të jap për lexuesit pohimet e Maliq Beg Bushatit në pyetjen që ju bë në këtë gjyq për “Beslidhjen e Shkodrës” nga prokurori Misto Treska.

Maliq Beg Bushati në këto rëfimet e tij në procesin e tij gjyqësor na tregon me detaje situatën anarkike në Shkodër ku ndodhej elita politike e tradicionale shqiptare në periudhën kur forcat gjermane po largoheshin nga Shqipëria e Londrës e lëvizja Nacional Çlirimtare e drejtuar nga komunistët po përparonte pa hasur ndonjë pengesë serioze nga kundërshtarët e tyre politik e ushtarak. Ai na jep me qartësi dërmuese një situatë alarmante, e pafuqishmërie të elitës qytetare e jo qytetare të Shkodrës ku ndodhej qyteti e ku ishin grupuar e po grupoheshin shumë individ nga gjithë Shqipëria që po mundoheshin të gjenin një zgjidhje personale ose politike momentale e cila po binte ndesh me interesin e një grupim qytetarësh shkodran që po mundoheshin të organizonin një grupim politik ushtarak për të mos u viktimizuar Shkodra si nga ushtria Nacional Çlirimtare ashtu dhe nga njësitë ushtarake Malazese e Çetnike Serbe që po ushtronin terrorin e tyre në dyert e Shkodrës.

Maliq Beg Bushati tregon: Gjatë fundit të okupacionit nazist, për ti ardhur në ndihmë Qeverisë së Xhelal Mitrovicës kundra forcave Nc.Çl. ose grupeve komuniste anarkiste në Shkodër, në janarit 1944 erdhi në Shkodër Mit-hat Frashëri, Kryetari i Ballit Kombëtar, Faik Quku,¹⁰ profesor Vasil Andoni¹¹ Sekretar i përgjithshëm i Ballit Kombëtar, për me rekrutue forca në Prefekturën e Shkodrës, të cilat do të përdreshin për me luftuar ushtrinë Nacional Çlirimtare në Jug të Shqipërisë, në Shkodër këta personat ranë në kontakt me Sulçe Beg Bushatin dhe Gjon Marka Gjonin, ma vonë Sulçe Begu më informoi mue (Bushati) se Mit-hat Frashëri u kishte propozuar krijimin e një fuqije për me e vëre në dispozicion të Ballit Kombëtar për me luftue lëvizjen Nacional Çlirimtare, kjo përpjekje e krenëve të Ballit dështoj. Mit-hat me shokë u nisën në Tiranë dhe u kthyen prap mbas nja dy javësh në Shkodër me një plan të ri, që kishte për qëllim bashkimin e forcave të Legalitetit, të Ballit Kombëtar dhe të Grupit Indipendent Kjo nisëm nuk u pranua nga organizata e individ të ndryeshme të Shkodrës, dhe u vendos që në një mbledhje në stil të gjërë t’anëtarëve të grupeve të ndryeshme politike të Shkodrës për të rënë dakord mbi sa deklaronte Mit-hat Frashëri për shkrirjen. Në këtë mbledhje muar pjesë Gjon Marka Gjoni, Sulçe Begu, Oso Kopluku¹², Afëz Ali Kraja¹³, Avdulla Kazazi¹⁴ dhe unë si Indipendent. Nga Balli Kombëtar ishin Mit-hat Frashëri, Lec Kurti¹⁵, Jup Kazazi¹⁶, Prof. Vasil Andoni, nga ana e Legalitetit ishin, Ndoc Çoba, Shefqet Muka,¹⁷ mbasi u rahën probleme të ndryshme u vendos shkrirja e të tre grupeve të nalt përmendura në një parti që u quajt “Beslidhja e Shkodrës”.

Kryesia e “Beslidhjes” përbëhej prej Sulçe Begut e Gjon Marka Gjonit. Si anëtarë e organizatës të Beslidhjes u thirrën Lec Kurti, Jup Kazazi, Ndoc Çoba, Afëz Ali Kraja. Kjo kryesi me këta anëtarë u mblodh kur Rexhep Mitrovica dërgojë në Shkodër për të kërkuar një forcë vullnetarësh të cilët do të cilët do të operonin kundër partizanëve në Jugë. I dërgumi i Rexhep Mitrovicës ishte Musa Gjylbegu ¹⁸ i cili erdhi në Prill të 44-es. Mbledhje u bë në shtëpinë e Gjon Marka Gjonit i cili kërkojë caktimin e rrogave dhe shpërblimin e forcave që do, të shkonin n’operim. Më vonë Rexhep Mitrovica u muar vesh direkt me Ded Nikollën ¹⁹ e Gjelosh Lulin ²⁰, të cilët dërguan batalionet e tyre për operasione në Vlorë. Kjo mbledhje vazhdoi 1 orë e gjysëm dhe bisedën e hapi Mit-hat Frashëri, i cili paraqiti një projekt për shkrirjen e tre grupeve të nalt përmendura me programin e poshtë shënuar:

Programi i ”Beslidhjes së Shkodrës” u caktua si më poshtë:

1) Me përkrah Qeverinë qendrore në Tiranë, ku-shdo që të ishte kryetar i saj.

Me ndjek e me luftue anarshinë

2) Formimi i Komitetit Ekzekutiv i përbërë prej 5 vetash

3) Të ftohen të gjithë rrethet e Qarkut Shkodër për një bashkëpunim me “Beslidhjen”

Nga kjo mbledhje e përgjithshme u përpilua ky protokoll:

4) Komiteti Ekzekutiv i Shkodrës në çdo rast e për çdo gjë ka me ju drejtue “Këshillit të Beslidhjes” të Malsisë Madhe me Merranxa e Postrinë

5) “Lidhja e Shkodrës” nuk ka me marë asnjë vendim me rëndësi përsa i takon anës sonë pa pëlqimin e Këshillit të Beslidhjes të Malsisë Madhe, Merranxa e Postrinë

6) “Lidhja e Shkodrës” do tja dali mbrojtjes t’atdheut, ka me sigurue armë, municion dhe ushqime sa më shumë të jetë e mundur

7) Ka me na siguru mundësisht një spital me qëndër në Tuz dhe një tjetër në Këlmend me qëndër në Vermosh, me doktora dhe infermera që ka me u pa e nevojshme, sidomos në kohë lufte.

8) Në rast kushtrimi do të na vërë në dispozicion sa ma shumë mjete të transporti për me çue vullnetar nga kufini, me mbajt të plagosurit për në Shkodër etj.

9) Në rast se qitet kushtrim Shkodra do të na vijë në ndihmë me sa fuqi të ketë.

10) Malcia e Madhe, Merranxa (Ranxa?) e Postrinë nuk njef e nuk pranon tjetër grup ose parti përveç “Lidhjes së Shkodrës”.

11) Malcorët e Shkodrës nuk duhet të kenë asnjë ndryshim me vllaznit e vet të Malsisë së Madhe

12) Përsa u përket komunistave ka me u marë masa kundra tyre gjithmon në marveshje të përbashkët. Kërkesat t’ona dëshirojmë të na jipen me shkrim

13. Me mbrojt kufit e Shqipërisë Etnike dhe Indipendencën e saj, mbas bisedimesh të ndryeshme u firmua një protokoll dhe u lidh Besa nga të pranishmit, protokollin n'emër të tre grupeve u nënshkrua prej Sulçe Beg Bushatit, Gjon Marka Gjonit nga Grupi Indipendent, Ndoc Çoba, Shefqet Muka nga ana e Legalitetit; Lec Kurti e Jup Kazazi në emër të Ballit Kombëtarë.

Aty nga maji 1944 Unë (Bushati) Lec Kurti dhe Ndoc Çoba shkum në Tiranë dhe i paraqitëm Kryeministrit Rexhep Mitrovica tekstin e vendimit të "Beslidhjes". Rexhep Mitrovica u kishte premtuar gjithë përkrahjen e qeverisë si materiale dhe morale. Komiteti Ekzekutiv i Beslidhjes finançohej pjesërisht tue tatue pjesërisht me forcë, pjesërisht me vullnetin e tyre tregtarët e Shkodrës, por aktiviteti i "Beslidhjes" nuk u zgjerua mbasi qeveria nuk e ndihmoi sa duhesh.

Nga mbarimi i tetorit 1944 u ba mbledhja e dytë në lokalitetin e Bashkisë e Komitetit Ekzekutiv të "Beslidhjes së Shkodrës" e provokume nga Prefekti Mynir Tërshana ²¹, në këtë mbledhje mernin pjesë: Patër Anton Harapi, Gjon Marka Gjoni, Abdulla Kazazi, Caf Beg Ulqinaku, Sulçe Beg Bushati, Ndoc Çoba, Shan Deda²², Hys Draçini ²³, Lec Shkreli²⁴, Musa Gjylbegu, Shefqet Muka, Luigj Mjeda ²⁵, Kolonel Luigj Mikeli, ²⁶ Ramko Renkoviç²⁷ Naum Plevnishti ²⁸ dhe një prift që nuk ja di emërin por që mund të ishte dhe Dom Tom Laca ²⁹. Patër Anton Harapi si anëtar i Regjencës kryesonte mbledhjen dhe kërkoi nga të pranishmit që të formohesh një

komision që të mbështetej Qeverija me të holla dhe me forca mbasi Qeveria kërcënohesh nga një situatë anormale pse çetat e Nacional Çlirimtares kishin haritun në Mirditë. Ishte rrezik pse thonin që ata të lëvizjes Nacional Çlirimtare vrisnin, prisnin e banin terror.

Qeveria nuk e ndihmojë në material dhe në sunvesionim e mjaftushëm, sepse ky lloj organizimi nuk i përshtatej interesit të qeverisë dhe këta donin ta shkataronin. (Patër Anton Harapi shprehet: Këta donin të krijonin qeveri mbi qeverinë)

Patër Anton Harapi ishte dërguar në Shkodër nga Regjenca për këtë punë. Në këtë mbledhje foli dhe Gjon Marka Gjoni i cili tha: “Kam ardhur fill prej frontit të Mirditës dhe e shof veten se jam lodhur shumë me kso ngjarjesh; prandaj sonte dua me u gjet a jeni të mendimit me luftue kundra komunistave apo jo?. Në rast se doni të luftoni duhet që sonte të vendosim këtu dhe si të vendoset ashtu të mbetet, në rast të kundërt ose në qoftë se nuk doni të luftoni komunistat ç’faqni mejtimin që të di dhe unë ç’të bëj dhe të veprojë si të mendoj për Mirditën t’eme. Po ju lajmëroj se në Shpal ³⁰ kamë lanë si të rrethuar nga ana e komunistave 500 burra të Mirditës. Duhet të çfaqim mënyrën e përgaditjes për me u ba ballë këtyre çetave që të mbrojmë Shkodrën se nga një ditë në tjetrën mund të na futen brënda. Me kaq e përfundojë.

Mbas këtij e mora fjalën unë duke paraqitur situatën kritike dhe kam folur: “Jemi në kohën ma të vështirë, fuqitë partizane komuniste i janë afruar

Shkodrës, flitet se këta terrorizojnë, plaçkitin e rekrutojnë vajza. Për të tana këto është e domosdoshme formimi i një komisioni për të evituar çdo të papritur etj.

Mbasi dështojë dhe kjo tentativë e fundi, Sulçe Begu dhe Gjon Marka Gjoni muar frenat në dorë duke marë njëkohësisht dhe administratën në dorë. Këta filluan të rekrutojnë ushtarë për të bërë një forcë prej 500 vetësh e të përballonin situatën duke mejtuar se do të vinin forcat aleate e në bashkëpunim me këta të hynin përsëri në qeveri. Ata krejt zonën e Veriut e quejshin të influencës së tyre³¹. Elementët kryesor të kësaj rezistence kanë qenë: Sulçe Begu, Xhemal Bushati, Gjon Marka Gjoni, Enver Bushati ³², Tahir Kolgjini³³, Halil Alija ³⁴, Kol Bib Mirak ³⁵

Vazhdimi i procesit gjyqësor:

Prokurori: Këndon një shkresë mbi t'ashtuquturën “Beslidhje” e bërë në Shkodër.

I Pandehuri: Patër Anton Harapi tha: Kur u formua “Beslidhja e Shkodrës” unë s’kam qenë. Këtë e formuan Gjon Marka Gjoni, Midhat Frashëri e Ndoc Çoba

Prokurori: Këto fakte (Prokurori i referohet deklaratave të dëshmitarëve) provojnë dhe nxjerin në shesh veprimtarinë e të pandehurit Patër Anton Harapi që zhvillonte duke qenë i lidhur me fretnit e tjerë në Malsi ma të nalta.

I Pandehuri: Në Malsi kam ba një mbledhje për shkak se Sulçe Beg Bushati e Gjon Marka Gjoni

mershin nga Prefektura 1500-2000 racione me pretekst se gjoja përdorshin për Grupin Indipendent tue ua dhanë malsorëve të Postdrimës. Na me mbledhjen tonë e ndaluem këtë gja.

Prokurori: Lexon një deklaratë tjetër: *(Në dosje nuk është deklarata)*

I pandehuri vazhdon: Sikurse thashë, “Beslidhjen e Shkodrës” e kanë ba Sulçe Begu, Gjon Marka Gjoni e Ndoc Çoba si dhe Mid’hat Frashëri. Në mbledhjen qi asht ba në Bashkinë e Shkodrës kohët e fundit t’okupacionit nazist kam qenë dhe unë. Kjo u provokue nga Prefekti Mynir Tërshana me qëllim që t’afronim popullin midis të tjerëve, këtu ndodheshin edhe Sulçe Beg Bushati, Maliq Bushati, e Eqerem Telaj³⁶

Prokurori: Na trego për mbledhjen që ke bërë në Kinema Rozafa. Prokurori lexon një deklaratë të Seksionit të Hetuesisë së Kriminelave të luftës: *(Në dosjen gjyqësore nuk është deklarata)*

I pandehuri: Te kinema Rozafa u mblodhën Xhemal Bushati unë, Cafo Beg Ulqinin, Tahir Kolgjinin etj që si mbaj mend dhe formuem “Bashkimin” në Shkodër. Mbledhja qi u ba në Kinema “Rozafa” në Shkodër kishte për qëllim prishjen e marveshjes e “Beslidhjes së Shkodrës” dhe këtë e ç’katarruem³⁷.

Prokurori lexon një letër që Gjon Mark Gjoni ja dërgon fratit të Gomsiqes. *(Në dosjen gjyqësore nuk ndodhet letra)*

I Pandehuri: Nga letra që lexoi prokurori del në shesh që unë nuk kam qenë bashkëpuntor i Gjon Marka Gjonit

Prokurori: Këndon letrën që Patër Anton Harapi i ka dërguar Javer Hurshitit e cila bën fjalë mbi dy persona të dorzuar. (*Në dosje gjyqësore nuk ndodhet letra*)

I Pandehuri: Na tue mos desh me lejue shtet mi shtet dërguam si prefekt në Shkodër, Eqerem Telhan, mirpo ky ra në konflikt me Marka Gjonin dhe u largue. U dërgua si Prefekt në Shkodër me qenë se Gjon Marka Gjoni, mbas krymjes së një vrasjeje e mori gjithë fuqinë në dorën e tij. Atëhere dërguam JaverHurshitin qi ishte mik i Gjon Marka Gjoni dhe se ky e rregulloi punën e për këtë veprim i kam ba një letër ku, midis të tjerave i kam shkruie edhe këto fjalë : “Të lumtë”

Dëshmitari i akuzës Mark Ndoja vjeç 33 deklararon: Padër Anton Harapi ka pasur takime të shpeshta me Gjon Mark Gjonin

I pandehuri: Unë kam shkue te Gjon Marka Gjoni vet. Atje kam gjet Gjeneralin gjerman Fitztum. Unë shkojsha me qenë se Gjoni ishte kryetar i një krahine dhe po të donte mundej me ba dam. Prand duhej me shkue.

Prokurori: Edhe mbas çlirimit të Shqipërisë i pandehuri ka qëndruar i arratisur ³⁸ dhe ka qenë në lidhje me kriminela lufte të cilët kanë tentuar të sabotojnë pushtetin si për shembull tentativa e sulmit mbi Koplík e Shkodër ³⁹, për të shkaktuar ndërhyrjen e reaksionit të jashtëm dhe për të krijuar një luftë civile. Kjo provohet me faktin se këta u kapën mbas një viti (*Se ç’lidhje ka fakti që janë arrestuar mbas një viti dhe i lidh me tentativën*

për kryengritje vetëm prokurori mund të na sqaroj në këtë absurditet juridik, prokurori nuk na tregon asnjë provë që Padër Harapi është pjese e kryengritjes së Koplikut.) dhe nga deponimet (term në drejtësi. Të gjitha ato që thotë një njeri në gjyq ose përpara organeve të tjera shtetërore) e dëshmitarit Mark Ndoja për sa i përket të pandehurit Patër Anton Harapi.

I Pandehuri: Unë shkova nga Tirana në Shkodër bashkë me Cafo Beg Ulqinakun. Ma vonë erdhën edhe Lef Nosi me Mehdi Frashërin. Kur kanë ardhë këta unë kam dal në malsi. Atje u mblodhëm në se duhej me ik jashtë a po me qëndrue. Unë me Lef Nosi vendosëm me qëndrue. Dhe qëndruem. Na dhamë dorheqjen para gjermanëve. Unë Lefin e dorëzova tek i pari i Françeskve dhe vetë ika në Malsi në katundin Kir. Kurse Lefin e lashë në Shkodër. Ma vonë erdhi dhe Lefi në Malsi. Mirpo këtu nuk ndej ma shumë se dy-tre ditë pse u mërzit nga shkaku që s'mund të rrinte dhe mandej iku për n'Elbasan.⁴⁰

Unë nuk shkova jashtë me Mehdi Frashërin e me të tjerë për shkak se: e para nuk kam dash me u përzi me politikë dhe e dyta pse nuk kam njof vedin si kriminel.

Dëshmitari i akuzës Mark Ndoja thotë: Unë këto informata mi kanë dhënë katundarët, kur unë isha ndër katunde. Ky (Padër Anton Harapi) ka shkue ilegal në Shkodër dhe ka agjitue në popull për me marë pjesë në lëvizjen e pregaditur prej Llesh Marashit⁴¹

Tue i thanë popullit se duhej me u çue pse vetëm kështu do të ndërhyshin aleatët. Mbi “Beslidhjen e Shkodrës” unë s'kam dijeni, për shkak se n'atë kohë isha ilegal, i pandehuri Patër Anton Harapi ka patun takime të shpeshta me Sulçe Beg Bushatin e

me Gjon Mark Gjonin. Gjithshtu ka marë pjesë në mbledhjen qi u ba për ekzekutimin e Dr. Panos. ⁴² (*Deklaratë e rrejshme një prift nuk dënon njëri me vdekje, Dr Pano se ka vra kush e ka bërë karjerë në rregjimin komunist*)

Gjykata mori Vendim: Mbasi apollojia (Mbrojtja) e të pandehurit mori fund, gjykata bashkërisht vendosi të dëgjojë dëshminë e akuzës dhe atë të mbrojtjes për të pandehurin Padër Anton Harapi:

Dëshmitarë të akuzës janë caktuar këta persona:

Për të pandehurin Patër Anton Harapi:

- 1) Gjovalin Luka
- 2) Mark Ndoja
- 3) Arif Gjyli
- 4) Hajdar Delvina
- 5) Abdyl Këllezi

Gjithashtu Gjykata vendosi të ftojë përfaqësorin mbrojtës të të pandehurëve të caktojnë dëshmitarët mbrojtës.

Pas shpalljes së këtij vendimi, përfaqësorin mbrojtës i të pandehurit Patër Anton Harapi, Av. Spiro Stringa tha: dëshminë e mbrojtjes të të pandehurit që përfaqësoj na do t'a paraqesim me shkrim mbasi dëshmitarët nuk kemi mundësi për arsye të ndryshme t'i sjellim para gjyqit prandaj po u paraqes deklaratat e lëshuara nga dëshmitarët:

- 1) Gabriel Meksi
- 2) Ejell Matija

- 3) Age Gjon Gruda
- 4) Këshilli i katundit Laç
- 5) Angjelin Luka
- 6) Anton Mazreku
- 7) Prof. Injac Gj. Ndoj
- 8) Zoja Lic Osmani
- 9) Besim Vlladi

Të nëndë copë deklaratat u bashkuan me aktet për t'u kënduar sipas rregullit. (*Në dosje nuk janë asnjë nga deklaratat e dëshmitarëveve pro Padër Anton Harapit.*)

U muar me radhë dëshmitarët e akuzës dhe prej tyre u thirr e u prezantua në ngarkim të të pandehurit Patër Anton Harapi:

Dëshmitari: Mark Ndoja vjeç 33 banues në Shkodër, i cili mbasi u betua, deklaroi: Padër Anton Harapin e njoh qi në kohën e Zogut, por e kam njoftun sidomos në kohën e fashizmit. Kur u okupua Shqipëria nga ushtria Italiane unë kam ndodh në Korçë por kur u ktheva në Shkodër dëgjova se Patër Anton Harapi kur kishte shkue me Asamblistat në Tiranë i kish thanë Konte Ciano-s se “Fjalët nuk i kena pas kështu ” Nga kjo del në shesh se Patër Antoni ishte i lidhur me italianët dhe me organet e fashizmit në Shqipni si me Melonin, etj. Patër Antoni i sugjeronte djelmënisë shqiptare me u largue nga lufta dhe bile kur rinija filloi demonstratat ky, me anë të predikimeve të tij, ka dasht t'a largonte tue u thanë se kishte ra në kaos. Kur ra qeveria e Vërlacit,

Patër Antoni erdhi në Tiranë për me pregadit marjen e qeverisë nga ana e Mustafa Krujës. Unë të pandehurin, kur kam qenë në Shkodër, i kam kërkuar ndihmën e tij për me shkruar kundra Cordignano-s por ky refuzoi, tue më thanë: “Shko te frenin e tjerë, mbasi unë kam punë dhe do të shkojë tek Sulçe Beg Bushati për me mbledhë firma për bashkimin e disa krahinave t’andej kufinit më Shqipninë. Unë i thashë: Mor e Patër nuk ashtë koha me ba ksi punësh.

Dëshmitari Zija Dibra: Unë i autorizuem prej Frontit, shkova ke Patër Antoni për me i shtruar vijën politike të Lëvizjes Nacional Çlirimtare, masi ky si një eksponent qi ishte, luate rol për mobilizimin e popullsisë në luftë kundra Lëvizjes Nacional-Çlirimtare, por Patër Antoni nuk pranoi dhe ma së fundi më ka thanë: “Vija juaj asht anarqiste, por duhet një tjetër vijë qi të ketë një organizim dhe dirizhim nga naltë. Njëkohësisht na tha: unë kam simpatizue Ballin Kombëtar qi administrohet nga naltë.

Patër Anton Harapi ka qenë shkaktari qi ka larguar nga fronti Nacional-Çlirimtar djalin e bajraktarit, të quejtunin Preng Deda tue përdor predikimet fetare. Ktj i ishte betuar mi kryqin se komunistat nuk kanë fe.

Patër Anton Harapi ka marrë kontakte me Lulash Gjeloshin dhe këto informata m’i kanë dhanë katundarët kur unë isha ndër katunde. Ky ka shkue ilegal në Shkodër dhe ka agjitue në popull për me marrë pjesë në lëvizjen e pregaditun prej Llesh Marashit, tue i thanë popullit se duhej me u çue pse vetëm kështu do të ndërhyshin aleatët. Mbi “Besli-

dhjen e Shkodrës” unë s’kam dijëni, për shkak se n’atë kohë isha ilegal.

I pandehuri Patër Anton Harapi ka patur takime të shpeshta me Sulçe Beg Bushatin e me Gjon Marka Gjonin. Gjithashtu ka marë pjesë në mbledhjen qi u ba për ekzekutimin e Dr. Panos dhe në vendime të tjera ksilloj.

Mbi pyetjen e të pandehurit Patër Anton Harapi, *(Në dosje nuk është pyetja e Padër Harapit)* dëshmitari tha: Kur ashtë rëxue qeveria Vërlaci unë kam kenë në Shkodër. Atëhere Patër Anton Harapi qëndroi në Tiranë dy javë kohë. Nga kjo u publikue se Patër Anton Harapi ka kontribue shumë në formimin e qeverisë së Mustafa Krujës. Nuk di që Patër Anton Harapi ti jetë përgjigjur Patër Cordiganos mbi artikullin e tij. Këtij i janë përgjigjur profesorët e Shkodrës.

U thirr dhe u prezantua dëshmitari i akuzës po në ngarkim të Patër Anton Harapit:

ARIF GJYLLI, vjeç 33, lindur dhe banues në Shkodër, i cili pasi u betua, deklaroi e tha: “Kur ushtria italiane i qe afruar Shkodrës dhe ndodhej te Ura e Bahçallëkut, një N/Toger shqiptar nga Kosova, emnin nuk ja mbaj mend, kishte zënë vënd të rezikshëm në kalanë e Shkodrës, për me luftue kundra kësaj ushtrie dhe bile ka vra një oficer Italian që hyni i pari. Atëhere krenët e Shkodrës si Sulçe Begu e Padër Antoni ishin mundue mbrënda në Shkodër me ndalue rezistencën që i bahej okupatorit. Ky është akt i Padër Anton Harapit, bashkëpuntor me elementa fashist e pro-fashist të Shkodrës. Kur shkoi

nji komision tek Konte Cianoja, shkoj dhe Patër Anton Harapi dhe në popull u dëgjua sikur ky i kish thënë Konte Cianos, “Si kena pas fjalët kështu”. Ma vonë këtë fjalë e ka folë edhe Kol Bib Miraka për Padër Antonin⁴³. Na kemi pas dëgjue se Padër Antoni, Ernest Koliqi, Gjon Marka Gjoni, Maliq Bushati, Shaqir Omari ⁴⁴ etj do të banin një kryengritje në Veri, do të hynin brëmnda në Shkodër, pasi ta mernin këtë do të mernin Shëngjinin ku do të vinte ndihma nga Italia. Këta kanë pasë lidhje me Girron e me Melonin. Maliq Bushati që kurse që zanë me Hiqmet Delvinën⁴⁵ ishte fut në Konsullatën Italiane, prej së cilës u sigurue e mandej fliste hapur në popull kundër regjimit të Zogut dhe nuk e prekte njeri.

Padër Antoni ka shëtiti malësitë e Shkodrës dhe ka marë kontakt me Lulash Gjonin⁴⁶ e me të tjerë dhe kanë përhap parulla kundër lëvizjes Nacional Çlirimtare, tue thanë se kjo ashtë pa fe etj. Ka shkue në Dukagjin ku ka marë kontakte me Ndok Gjeloshin⁴⁷ e me krenë ushtarak Italian.

Fashizmi me anën e njerëzve të zgjuet si Padër Antoni hodhi një parullë adapte për Veriun “Kanë ardhë pllumbat Katolik” e do të shpëtojnë katolizmin, kjo na ka damtue shumë. Ky ka punue për një sulm kundra forcave t’Ushtrisë Nacional Çlirimtare në Jug, për me çlirue Ulqin e Tivar, siç ka thanë Shefki ??? para Komisionit Hetimor të kriminelave të luftës në Shkodër, në të cilin Komision unë kam ba pjesë; ka qenë në “Komisionin e Shkodrës” për dënimin e komunistave; ashtë një nga inisatorët që ka pregaditur “Lidhjen e Shkodrës”. Padër Antoni i

ka pas dhanë një letër Ndue Palit ⁴⁸ agjent i fashizmit, për në Malsi për me pasë ndihmën e malsorëve; Ndue Pali ka pas një çetë reaksionare

Ushtria Kombëtare
Gjykata Ushtarake e Tiranës

Prokurorija
Gjykatës Ushtarake Tiranë
Akt Akuzë
Kondra: Padër Anton Harapi

Prokurori i kësaj Gjykate (major Misto Treska,) me akt-akuzën datë 31 janar 1946 na deferon (lat. Do të na shtyjë) për gjykim bashkë me aktet tre të pandehurit

- 1) Lef Nosi nga Elbasani
- 2) Patër Anton Harapi, nga Shkodra dhe
- 3) Maliq Bushati po nga Shkodra,

T'akuzuar pse si kriminela lufte dhe armiq të popullit: dy të parët me cilësinë e tyre anëtarë të Regjencës në kohën e okupacionit nazist, kanë bashkëpunuar dhe i kanë shërbyer këtij okupatori në dëm t'interesave të larta t'atdheut dhe janë përgjegjës për të gjitha krimet, çkatarimet dhe dëmet materiale të kryera në vëndin tonë dhe i treti ka përgaditur, në bashkëpunim me tradhëtarët të tjerë terrenin për okupimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste, ka sabotuar rezistencën e popullit shqiptar, në cilësinë e tij Kryeministër (Maliq Bushati) në kohën e okupacionit fashist ka bashkëpunuar më mënyrë më të ngushtë me okupatorin në dëm të popullit shqiptar dhe ka

mobilizuar e sunvencionuar forca armate për kundra luftës nacional Çlirimtare etj, etj.

Patër Anton Harapi vjeç 56 nga Shkodra ka bashkëpunuar me organizatën tradhëtare “Bashkimi Kombëtar”, para 7 Prillit 1939 për të prurë okupacionin fashist dhe ka qenë përfaqësues i saj në Shkodër.

Gjatë okupacionit fashist është munduar të bashkëpunoj tërthorazi dhe me parullat e tij helmone është munduar ta paraqesë okupacionin fashist si një çlirim. Ka lejuar që revista e klerit katolik “Hylli i Dritës” (*Revista si organ letrar i Françeskaneve ishte një shtypi të lirë ku çdo autor mund të botonte shkrime e tij revista nuk mund të mbaj përgjegjësi për pikpamjet e autorëve të shkrimeve që botoheshin te kjo revistë*) të ishte organi më i mirë propogandistik për fashizmin dhe organizatat tradhëtare që organizoj. Ka qenë mik i ngushtë i Jakomonit, (*Padër Anton e mohon e thotë: Jakomoni më ka ardhë në kishë e kam prit si të tanë, që vinë në kishë*) të cilin e ka shoqëruar në Malësinë e Shkodrës, duke e paraqitur si shpëtimtar të Shqipërisë. Se sa me gëzim të math Patër Antoni e pret Jakomonin tregon kjartasi fotografija qi është në dosjen. (*Në dosjen gjyqësore nuk ka ndonjë fotografi*). Mbas kapitullimit t'Italisë, Patër Antoni e heq maskën dhe bëhet organi ma i ndërgjegjshëm i nazizmit gjerman. Anëtar i Regjencës. (*Padër Harapi thotë: kam pranue me hy në Regjencë me shpëtu jetë njerzish*) Asht inisiator i Komitetit Ekzekutiv Kuisling (*në dosje nuk ka asnjë provë që Padër Antoni ka lidhje me këtë akuzë*) dhe

t'ashtu qujtur "Asamble Kombëtare" të cilat legjitim-ojshin okupacionin gjerman, në Shqipëri dhe përça-nin rezistencën e popullit shqiptar. Në bashkëpunim me okupatorin nazist kanë organizuar forca merce-nare si milicia, kuesturë e xhandarmeri (*Padër Hara-pi i përgjigjet akuzës: kemi krijuë xhandarmerinë me mujt me mbajt rregull e qetësi në anarkinë që e kishte pllakos vendin*) për të luftuar rezistencën e popullit shqiptar për liri. I pandehuri Padër Anton bashkë me anëtarët e tjerë të Regjencës është insiprator dhe inisiator për bashkimin e gjithë organizatave tradhë-tare në bashkëpunim me forcat e okupatorit të tero-rizonin popullin e pafjshëm. Mbledhja e Tufinës, "Beslidhja e Shkodrës".(*Padër Harapi e mohon që ka organizuar këtë organizatë*) Është përgjegjës direkt për financimin e miliona franga që i ka bërë okupa-torit gjerman dhe organizatave tradhëtare duke shfrytëzuar në kurriz të popullit të varfër.(*Padër Ha-rapi kundërshton akuzën duke thënë se Regjenca nuk jipte kredi, qeveria mund të jepte*) Ka urdhëruar të bëhen arrestime dhe internime në masë si dhe ope-rationin e Dimërit dhe të Qershorit në bashkëpunim me okupatorin.(*Padër Harapi thotë: Gjermani nuk na pyeste ne, se kur i fillonte operacionet ushtarake*) Këto operacione i kushtoj popullit t'onë mijra të vrarë dhe dëme të pa llogaritëshme. Të gjitha këto në për-gjithësi u pohuan prej të pandehurit si dhe kolegut të tij Lef Nosit.(*Nuk na rezulton nga leximi i dosjes që Padër Harapi ka pranuar këto akuza*) Me fjalimet e tij dhe artikujt e ndryshëm ka qenë axhitatori dhe propogandisti më i mirë për okupatorin duke u

munduar të përçajë luftën e popullit shqiptar. Patër Anton Harapi ka qenë përfaqësuesi i “Bashkimit Kombëtar” për qarkun e Shkodrës. Kjo akuzë provohet me atribuimet (*këtu ka kuptimin e thënjeve*) e Kol Tromarës, Javer Hurshitit si dhe me pohimin e tërtortë të Maliq Bushatit. (*Padër Harapi i përgjigjet: Është hera e parë që dëgjoj për këtë organizatë, “Bashkimi Kombëtar” Kol Tromarën se kam pas njohë kurrë, e njoha kur hyni në qeveri*). Me fjalimet e tij dhe artikujt e ndryshëm ka qenë axhitatori dhe propogandisti më i mirë për okupatorin duke u munduar të përçarë luftën e popullit shqiptar. (*Padër Harapi mohon se ka shkruar ndonjë artikull pro fashizmit, prokurori nuk na tregon ndonjë shkrim pro fashist të shkruar nga Padër Harapi*) Mbas 7 prillit 1939 të pandehuri ka bashkëpunuar me okupatorin fashist duke sabotuar pushtetin e populli, kanë pritë ushtrinë fashiste italiane në Shkodër si çlirues siç e pohuan dhe vetë (*Padër Harapi e mohon që ka pritë ushtrinë italiane në Shkodër*) Patër Antoni ka ardhur në Tiranë si delegatë i klerit Katolik për të marë pjesë në Asamblesë për ofrimin e Kurorës së Skëndërbeut, Viktor Emanueli, (*Padër Harapi e mohon se ka qenë pjesë e Asamblesë Kombëtare e vitit 1939*) Ndërsa Patër Anton Harapi mbrënda në Kuvendin Fraçeskan bën pjesë në Redaksinë e Revistës Hylli i Dritës (*Pse është fajsi të jesh pjesë e radaksisë së një reviste në një periudhë të caktuar kohor?*). Dhe propagandonte parullat e mëdha dhe helmatojnë të fashizmit. Mashtronte popullin shqiptar për një Shqipëri të Madhe, i ngrinte lavdi Duçes dhe Mbretit Viktor Em-

anuel, *(Padër Harapi e mohon kategorikisht që ka shkruar ndonjëherë për Musolinin apo për Viktor Emmanuelin prokurori thjesht fanazon ai kishte detyrë të na servirte prova dhe jo demagogji)* nxiste popullin e Malsisë së Shkodrës për tu kundravu Malit të Zi në interes të fashizmit Italian (memoran-dumi i drejtuar Duçes e Viktor Emanuelit nga popullsia Hot e Grud) *(këtë akuzë Padër Harapi e pranon e thotë që dhe sot unë them që Hot e Grud duhet të jetë të Shqipërisë)*. Lef Nosi bëhet kryetar i Asamblesë Kuislinge, thërret Patër Anton Harapin dhe i telegrafon Papës në Romë për ti dhënë këtij leje në bashkëpunim me gjermanët që të bëhet Anëtarë i Regjencës *(Prokurori nuk na paraqet ndonjë provë dokumentare që të provojë që Papa i ka dhënë leje Padër Harapit të bëhet Regjent, ai thjetht spekullon)* Si anëtarë i Regjencës ky ka frymëzuar dhe aprovuar operacione me stil të gjërë kundra forcave të Ushtrisë Nacional Çlirimtare që njëkohësisht patën reperkusione edhe karshi popullatës së pafjshme të të gjithë Shqipërisë. Gabimi në politikë është tradhëti *(Të gabosh është njerzore të qërtosh dikë tjetër është politikë. Akuzat prokurori nuk i shoqëron me prova dokumentare thjesht ai bën propogandë por nuk faktin asgjë nga akuzat që ngren.)* Për këto vepra i pandehuri është përgjegjës moralë, mbasi ky në pozitën e tij kanë qëndruar në kulmin e tradhëtisë. Se Patër Anton Harapi ka qenë konsumuent në vijën e tij antipopullore e anti përparimtare, qysh në vjetin 1936 çfaqet për një diktaturë fashiste, bën pjesë në “Bashkimin Kombëtar” që ka si parim marveshjen e lidhur

midis “Bashkimit Kombëtar”, përfaqësuar prej Qazim Koculi e Ali Këlcyrës dhe Grupit të Zarës i përfaqësuar prej Mustafa Krujës (Shif dokumentin e botuar në gazetën “Roja Kombëtare” nr 7 datë 13 prill 1943 që riprodhon tekstin e marveshjes), (*Në dosje nuk është gazeta “Roja Komëtare”*) bashkëpunon me klerin fashist deri në fund sado që avokati i mbrojtjes kërkon që në gojën e Kont Ciano-s të kallazojë se gjoja ideja e bashkimit personal të Shqipërisë me Italinë gjeti kundërshtarë nga ana e klerit katolik të Shkodrës, porse Z. Avokat nuk na paraqiti nonjë dokument për këtë çështje, nga ana tjetër dokumentat e “Hylli i Dritës” Pater Anton Harapi i ka ndejt besnik gjermanëve deri në fund. Për të organizuar forcat e mbeturinat e reaksionit në Veri të Shqipërisë, me anë të “Lidhjes së Shkodrës” në bashkëpunim dhe me forcat Çetnike. (*Nuk ka asnjë provë në dosje që “Lidhja e Shkodrës ka bashkëpunuar me Çetnikët e kundërta është e vërtetë*) Kanë urdhëruar vrasjen e shumë elementave të lëvizjes Nacional Çlirimtare me anë të kriminelit Hasan Isufi. Këto provohen me deponimet e dëshmitarëve Mark Ndoja, Arif Gjyli, me deklaratën e Gjovalin Lukës , me letrën e Patër Anton Harapit drejtuar Javer Hurshitit, me katër letrat e Mark Gjon Marka drejtuar Patër Palit (*Në dosje nuk ka as dhe një letër të vetëm që të kemi mundësinë ta lexojmë e ta kuptojmë akuzat e prokurorit*) Në programin e “Beslidhjes” i firmosur nga Maliq Bushati etj me deklaratën e Ulqinakëve, me deklaratat e Shefqet Dibrës, Ismail Barbullushit, Avokat Bojaxhiut, Sadedin Mandisë dhe Muhamet

Lahit e Muhamet Uruçit etj. *(Këto deklarata janë dhënë kundër Maliq Bushatit jo kundër Padër Harapit por prokurori i lejonte vetes të shpifte me mllef për akuza që nuk egzistonin, për të ai ishte “Armiku” e për të vdekja është pak)* Edhe mbas çlirimit të Shqipërisë i pandehurit ka qëndruar i arratisur dhe ka qenë në lidhje me kriminela lufte, të cilët kanë tentuar të sabotojnë pushtetin si për shembull tentative e sulmit mbi Koplík e Shkodër, për të krijuar një luftë civile. *(Padër Harapi e mohon kategorikisht që kishte dijeni për sulmin e Koplíkut)* Kjo provohet me faktin se ky u kapën pas një viti dhe nga deponimet *(term në drejtësi. Të gjitha ato që thotë një njeri në gjyq ose përpara organeve të tjera shtetërore)* e dëshmitarit Mark Ndoja për sa i përket të pandehurit Patër Anton Harapi. Nga analizimi i provave të paraqitura prej përfaqësuesit e të pandehurit rezulton se ky ka mundur më të radhë, t’i sjellin miqve të tij nonji favor krejt personal, porse ky favor nuk është veçse një pikë uji në mes të oqeanit të tradhëtisë që kanë kryer në dëm të atdheut dhe të mjerimeve e të çkatarrimeve që i kanë sjedhë krejt popullit mbarë. Këto favore nuk janë të një natyre e grade sa të lehtësojnë të pandehurit nga llomi i tradhëtisë që është futur, deklaratat e deponimet e atyre pakë dëshmitarëve që janë prezantuar përmbajnë frymën e miqësisë, të regjionalizmës ose janë bërë në mënyrë të atillë që këta dëshmitarë të justifikojnë veprimtarinë e tyre antipopullore e kolaboracioniste. Ky së bashku me Lef Nosi, e Maliq Beg Bushati kurdisën qeverinë e koalicionit të të gjithë reaksionit të brëndshëm.

Grumbullojnë elementa bashibazuk të Ballit Kombëtar, Legalitetit e të Gjon Marka Gjonit dhe formojnë regjimentin “Kosova”(prokurori gënjen, nuk dokumentohet që regjimenti “Kosova” është krijuar nga qeveria shqiptare e kohës ose nga ushtria gjermane. E ashtuquajtura Regjimenti “Kosova” dhe Regjimenti “Peja” është një bashkim vullnetar i shqiptarëve të ish Jugosllavisë e organizuar nga “Lidhja e Dytë e Prezirenit”për tu mbrojtur nga sulmet vrastare të çetnikëve serb e malazes e fuqive ushtarake të komunistëve të Titos mbi këto popullsi, detyra e saj ishte të vetmbroheshin nga sulmet e grupeve të armatosura sllave nacionaliste e komuniste. Ata drejtoheshin pjesërisht nga ushtarak e pjesërisht nga prinjës fisnor e lokal. Në raport me sigurinë e familjeve të tyre këto “Regjimente” mobilizonin nga 300 deri 1,500 njerëz nën armë të cilët me të mbaruar rreziku shpërndaheshin nëpër shtëpitë e tyre. “Regjimenti Kosova” nuk ishin një formacion i mirëfillit ushtarak. “Regjimenti Kosova” si fuqi ushtarake vullnetare ka vepruar në teritorin e Shqipërisë së Londrës nga tetori i vitit 1943 e deri në fund të shkurtit 1944 ku u kthyen në Kosovë për të mbrojtur kufitë e Kosovës nga dhuna e invazionit sllav mbi popullsinë shqiptare).

Frymëzojnë dhe nxisin gjithë reaksionin që në bashkëpunim të ngushtë me forcat e okupatorit nazist të bëhen operatione në stil të gjërë për çfarosjen rrënjësisht të Lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke marrë parasysh gjithë çkatarimet, humbjet në njerëz e në material që do ti vinte popullit shqiptar (opera-

cioni i math i dimrit dhe ay i qershorit si dhe gjithë operacionet e tjera lokale.) Financojnë hordhitë e Hitlerit, të Ballit Kombëtar e të Legalitetit. Kombinuuan me nazistët arrestime dhe internime në masë, si në Durrës, Vlorë Korçë, Gjirokastrë, Tiranë, Shkodër, etj për në kampet e vdekjes të gjermanisë e të Prishtinës (*Padër Hanton përgjigjet: Arestimet dhe internimet janë bërë nga ushtria gjermane pa pyetur qeverinë shqiptare kjo ka protestuar për këto arrestime e internime*). Organizuan terrorin e madh të 4 shkurtit (*Padër Harapi e mohon kategorikisht që Regjenca e ka bërë 4 Shkurtin, ai thotë se unë të nesermen e mora vesh ngjarjen dhe ne si Regjent i tërhoqëm vërejtje qeverisë që nuk mbrojtë rendin në kryeqytet*) si dhe shpërnguljen e detyrueshme të popullsisë në mes të dimërit, që u detyruar të strehohen nëpër shpella. Janë përgjegjës për çkatarimin e pasurisë të shtetit e të popullit (Molave, urave, rrugëve, kantierëve dhe uzinave elektrike) (*Në dosje nuk ka as dhe një dokument të vetëm që të provohet që qeveria apo Regjenca kanë dhënë urdhër për akuzat e radhës të fantazisë ideologjike të prokurorit*) për djegjen dhe rrënimin e mijrave banesave të popullit. (*shifra të rejshshme të pa dokumentuar nga ndonjë studim specifik*) i pandehuri, si anëtarë i Regjencës, ka aparovuar ndëshkimin me varje të Kol Lakut (*Provohet nga thënja e Lef Nosit se Padër Harapi nuk ka pranuar të jetë në mbledhjen ku është firmosur aprovimi i vendimit të gjykatës për personin në fjalë*) si dhe dy personave të tjerë, kjo akuzë provohet me pohimin e tyre dhe me atribuimin (*thelbësor*) të Mahmut Golemit. (*Në*

dosje nuk ka ndonjë deklaratë nga ana e Mahmut Golemit) i pandehuri Patër Anton Harapi ka propoganduar të ngrejë me çdo kusht një aparat shtetnor (*Padër Harapi i përgjigjet: Na duhej të mbanim një autoritet e një shteti shqiptar për të mbajtur rregullin e qetësinë në vënd*) kuisling dhe për këtë gjë nxit gjithë popullin të bashkohet kundra ushtrisë dhe lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke tentuar të përçajë frontin Nacional Çlirimtar simbas propogandës së Goebels-it, duke e cilësuar luftëtarët e lirisë si terori-sta e të shitur në të huaj. Kjo gjë provohet nga fjalimi i tij që u dëgjua dhë që është shumfishuar në gazetarinë dhe në broshura të shtypit t'okupatorit. I pandehuri Patër Anton Harapi ka vazhduar rrugën e tradhëtisë deri në fund, me gjithë që janë këshilluar si prej aleatëve të mëdhenjë, e prej frontit Nacional Çlirimtar. Imagjinoni tani Zotërinj Gjyqtarë, mijra motra e nëna shqiptare të mbuluara në të zi, lot e dhimbjet e tyre, vuajtjet e kalamancheve, fëmijët e masakruar barbarisht ose të hedhur të gjallë në zjarr, turma të mëdha asish të mbetur pa strehë e jetimë. Sillni ndërmend Prishtinën, 4 Shkurtin, Borovën, Kukësin, Kurveleshin, Skraparin, Vlorën, Pezën e të tjerë emëra që sjellin me vehte kujtimin e terrorit më të zi, të krimeve më të poshtëra dhe veprat e brigandazhit (*banditë*) më të fëlliqur, të kryer nga okupatori dhe bandat tradhëtare dhe do të keni parasysh një pasqyrë të tmershme të katastrofës që pllakosi Shqipërinë që nga 7 prilli 1939 e deri çlirimin e plotë të Atdheut.

Sidomos nga vet ngjarjet që janë zhvilluar në kurriz të popullit e të atdheut gjatë pesë vjetëve okupacioni dhe që jo vetëm kanë hyrë në dijeninë e Trupit Gjykues por dihet botërisht: 50,000 të vrarë e të plagosur nga popullsia civile e nga radhët e ushtrisë nacional Çlirimtare, 18,000 shqiptarë të internuar ose të burgosur në burgjet e në fushat e internimit të nazismit gjerman 47,000 shtëpi për banim të djegur ose të rënuara, me mijra bagëti të trasha ose të vogla të plaçkitura, gati krejt ekonomia, financat e komunikacioni të çkatarruara ⁴⁹ Edhe oratoria më e zgjedhur mbetet e venitur përpara shifrave dhe statistikave, prand po ua e lë vëndin këtyre. Ja se çfarë flasin shifrat:

28,000 të vrarë e të plagosur nga popullsia civile, pa zënë në gojë të vrarët e të plagosurit që bënin pjesë në radhët e lavdishme të Ushtrisë sonë heroike.

18.800 shqiptarë të internuar ose të burgosur në Shqipëri, Itali dhe Gjermani ⁵⁰ e gjetkë ku vuajtën torturat më të tmershme dhe më çnjerëzore. Disa mijra të tjerë nuk u kthyen nga këto fusha çfaronjëse ku u përdorën mënyrat më shtazarake dhe më djallëzore për të prurë vdekjen e milionave njerëzëve të pafjshëm (*prokurori në asnjë rast nuk na tregon se ku i ka marë shifrat që i thotë, është e pamundur që në dhjetor të vitin 1945 shteti shqiptar të kishte aftësinë të bënte rregjistrimin e vrasjeve, e të tjerë dëme që sjedh lufta edhe sot në vitin 2024 është objekt debatesh pa fund për shifrat që ka përdorur historiografija enveriste për dëmet e luftës së dytë botërore në Shqipëri në asnjë rast kjo histori nuk mbështetet në prova*

e dokumenta. Akuzohet Padër Harapi për miljona njerëz të pafshëm e të vdekur ai ishte një nga Regjentët i një shteti prej 900,000 banorësh?!).

Në përmbledhje, më shumë se 50,000 shqiptarë u vranë ose u plagosën, (*fantazia peverse e prokurorit nuk nje kufi*) u masakruan ose u pushkatuan nga armiku dhe tradhëtarët, vdiqën nën tortura dhe mundime të tmershme në kampet e llahtarshme të Dachausit, të Mathausen-it e të Prishtinës në ishujt e shkretë të Italisë e gjetkë. (*Shifra totalisht të rrejshme të pa bazuar në asnjë studim në teren apo në dokumentacionin e kohës as sot në vitin 2024 nuk kemi një studim shterues për këtë problem*)

Kush është përgjegjës për të gjitha këto krime e masakra në kurris të popullit shqiptar. A mos është vetë populli shqiptarë që i zbardhi faqen historisë së tij me luftën antifashiste, për të fituar lirinë dhe demokracinë që gëzon sot ⁵¹. Jo, për të gjitha vuajtjet, vrasjet, masakrimet, plaçkitjet, grabitjet, turpërimet që pësoi populli shqiptar janë përgjegjës direkt okupatorët fashist, qeveritë kuislinge, organizatat tradhëtare të Ballit Kombëtar e të Legalitetit dhe të gjitha klasat e tjera të fshehura nën maska të ndryeshme ⁵². Jo vetëm kaq, tradhëtarët e vendit pregaditën dhe organizuan okupimin e Shqipërisë nga bandat fashiste. Disa prej këtyre tradhëtarëve, qi shpëtuan dorës së popullit, brënda e jashtë Shqipërisë vazhduan e vazhdojnë akoma tradhëtinë e tyre. Ata duan me çdo kusht që të përmbysin pushtetin popullor dhe të përsëritin edhe një herë tragjedinë e atdheut tonë. Në përmbledhje, më shumë se 50,000 shqiptarë u vranë ose u plagosën, u masakruan ose u pushkatuan nga armiku dhe tradhëtarët, vdiqën nën tortura

dhe mundime të tmershme në kampet e llahtarshme të Dachausit, të Mathausen-it e të Prishtinës në ish-ujt e shkretë të Italisë e gjetkë 47,000 shtëpi për banim ose për bujqësi të djegura e të përvëluara krejtësisht. Qytete e katunde të Shqipërisë të shkretuar dhe të bëra rrafsh me tokën. Me mijra familje të mbetur pa streh, në mes të katër rrugëve, të vdekur dhe të raskapitur nga uriya dhe vuajtjet. Qindra mijë bagëti të trasha e të holla, kuaj, mushka etj. Të plaçkitura të therrura dhe të prishura. Qindra mijë kuintal bereqet, i vetmi mjet jetesë për popullin, të grabitur dhe të djegur. Gati të gjithë urat e mëdha dhe të vogla të vendit tonë u hodhën në erë ose u shkataruan. Skelat tona kryesore dhe veçanërisht ajo e Durrësit u shkataruan krejtësisht. Bankat dhe financat tona të grabitura deri në santimin e fundit. Ekonomia jonë e çkataruar që nga themele, shkatërrimi i rrugëve, centraleve elektrike, rrjetave telefonike që i plotë. Minierat tona në Kuçovë, në Patos, në Selenicë, në Rubik në Pishkash etj u hodhën në erë me dinamit.

(Në fakt, në Shqipëri po instalohet diktatura komuniste. Ky është drejtimi ku po shkon vëndi për momentin. Në Shqipërinë tonë, nuk do të ketë fare emociione, përveç frikës, zemërimit, triumfit dhe poshtërimit. Jemi në vitin 1946 dhe prokurori me një mendësi psikopatike shpik shifra të dalë nga mëndja e tij e sëmurë pa u bazuar në asnjë statistikë ose studim për zërat që thotë, sot në vitin 2024 janë me gishtat e një dore studjuesit që janë marë me këtë temë studimi dhe nuk arrijnë të nxjerrin një shifër të saktë e të besueshëm për vrasjet, plagosjet, djegjet, dëmet ekonomike etj probleme që lë një luftë.

Prokurori duhej të dinte së njerëzimi është organizuar në shoqëri pikërisht për të shmangur arbitraritetin, për të gjetur mënyra kolektive të të bërit drejtësi, duke u bazuar në parime që janë të dobishme për shoqërinë si të tërë dhe nëpërmjet një sistemi të paanshëm të shmangen eksceset emocionale në përcaktimin e sanksioneve penale.”

Para jush, në bankën e të akuzuarve, Zotërinj Gjykatës, keni tri fytyra më të shëmtuara të tradhëtisë së shëmtuar: Lef Nosin, Patër Anton Harapin O.F.M. dhe Maliq Bushatin të cilët populli ju a ka prurë këtu për t’i gjykuar për krimet që kanë bërë në dëm të tij. Emërat e këtyre tre tradhëtarëve lidhen shumë ngushtë me torturat, vrasjet, grabitjet dhe shkatërrimet që janë bërë sepse këta kanë qenë inspiratorët, organizatorët dhe ekzekutorët e ndërjegjshëm të kësaj tragjedie të tmershme. Dita e sotme ka një rëndësi të veçantë për popullin tonë se në gjyqin e tij dalin që të japin llogari tri koka të tradhëtisë:

Një ish Ministër e Kryeministër u fashizmit dhe dy anëtarë të së ashtu quajturës Regjencë, së gestapos.

T’Akuzuar: Sipas akt-akuzave të prokurorit, si kriminela lufte, armiq të popullit dhe sabotatorë të pushtetit, në bazë të neneve 14 e 15 të Ligjës Nr 41 datë 14 janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe nenit 1 të ligjës nr 21, datë 15 Dhjetor 1944 mbi sabotatorët e luftës e të pushtetit.

T'akuzuar si kriminela luftime dhe armiq të popullit: Dy të parët në cilësinë e tyre anëtarë të Regjencës në kohën e okupacionit nazist, kanë bashkëpunuar dhe i kanë shërbyer këtij okupatori në dëm të interesave të Atdheut dhe janë përgjegjës për të gjithë krimet, çkatarrimet dhe dëmet materiale të kryera në vëndin tonë dhe i treti ka përgaditur, në bashkëpunim me tradhëtarët të tjerë, terrenin për okupimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste. Ka sabotuar rezistencën e popullit shqiptar, në cilësinë e tij si kryeministër në kohën e okupacionit fashist ka bashkëpunuar në mënyrën më të ngushtë me okupatorin në dëm të popullit shqiptar dhe ka mobilizuar e suvenzionuar forca armate për kundër luftës Nacional Çlirimtare, etj.etj.

Aktet u regjistruan nën Nr.24 të Librit Themelor të këtij vjeti dhe për ditë gjykimi të çështjes u caktua data 1 Fror (shkurt) 1946, ora 9, duke iu njoftuar të pandehurëve që ndodhen të arrestuar

Tiranë 9 Fruer (Shkurt) 1946

Gjykata Ushtarake e Tiranës e formuar prej:

Major Irakli Bozos Kryetar
Major Tonin Jakova Anëtarë
Major Gjon Banushi Anëtarë
Prokuror Misto Treska

U pyet për herë të fundit i pandehuri Padër Anton Harapi dhe tha:

Falenderoj drejtësinë e popullit që më jep fjalën e fundit në këtë kohë të kritikshme për mue, fjala ime e fundit është kjo:

Nuk shembet Shqipnia nëse gjykohet për dek, Pater Anton Harapi. Gjithashtu nuk priset Shqipnia, nësa nuk gjykohet për dek, Patër Anton Harapi. Kur para 40 vjetësh në Shkodër u përpiqsha me ba Shqipnin shumë gjysa (*njerëz me mendësi të vjetër*) na thonin se nuk e duam Shqipninë na nuk i kemi vu në litar këta.

S'kërkoj Zotni kryetar një tolerancë, unë sipas mundit kam derdh djersë me ba Shqipninë. Franca e qytetërume ashtë shembëlla e revolucioneve popullore dhe gjykon Petain dhe e fal por këtë nuk ja njoftin për të keq por ia njoftin për të mirë. Kujtoj se dhe Shqipnia kur gjykon Regjenta besoj se sikur ti falë këto nuk ka me qenë ligësi për Shqipninë por besoj se ka me qenë mirë.

Unë qi kurse kam hy në gojën të ujqërve Hausdig-ut etj jam përpjek ma ba mirë e me mujt me shpëtue ndonji jetë prej egërsinave, por me qenë se ishin bisha të egra nuk kam mujt me i zbut por prap me mundin tim kam pështue mjaft. A ka pas shqiptar të marrë si unë që për me shpëtue njerëz me shkue e me u fut në gojën të ujkut!. Ka pak që sakrifikohen moralisht, këtë e kam thanë dhe në ligjeratën time.

Mua më shtyhu maria me shkue e me u përpjek për me lehtësue vuajtjet disa familjarëve dhe kam ba mjaft punë morale, sikurse jua qi asht materiale gjatjetër nuk kam. Rrnoftë Shqipnia!

V E N D I M

NË EMËR TË POPULLIT SHQIPTAR

Gjykata Ushtarake e Tiranës e formuar prej:

Major Irakli Bozos Kryetar

Major Tonin Jakova Anëtarë

Major Gjon Banushi Anëtarë

Me Pjesmarjen e Prokurorit të Popullit major Misto Treska e asistuar prej sekretarëve aspirant Thoma Rino e kapter Zalo Xhomaqi, sot në datën 12 Fruer (shkurt) 1946, e mbledhur në sallën e kino teatër “Kosova” duke gjykuar të pandehurin

3. Padër Anton Harapi i biri i Loros dhe i Luçisë, lindur më 1888 në katundin Shirokë të Shkodrës, banues në Shkodër, fetar me arsim të lartë, i përfaqësuar nga Z.Av. Spiro Stringa

I A K U Z U A R:

Sipas akt-akuzave të prokurorit, si kriminel lufte, armik i popullit dhe sabotatorë të pushtetit, në bazë të neneve 14 e 15 të Ligjës Nr 41 datë 14 janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe nenit 1 të ligjës nr 21, datë 15 Dhejtor 1944 mbi sabatatorët e luftës e të pushtetit.

G J Y K A T A :

Pasi shqyrtoi akt-akuzat e proçes -verbalet e prokurorit

Pasi shqyrtoi proçes-verbalet mbajtuar nga Komisioni Hetues për krimet e kriminelave dhe ato të Mbrojtjes së Popullit

Pasi dëgjoi apollojinë e të pandehurit

Pasi ndëgjoi dokumentat që vërtetojnë akuzat e të pandehurit

Pasi dëgjoi deponimet e dëshmitarëve të mbrojtjes e t'akuzës të bëra me betim para gjyqit

Pasi dëgjoi pretencën e Prokurorit

Pasi dëgjoi mbrojtimet e avokatëve

Pasi dëgjoi fjalën e fundit të të pandehurit

Pasi studjoi të gjitha dokumentat e tjera që ndodhen në dosjen e tij

Pasi studjoi dhe mejtoi çështjen në fakt e në të drejtë

O B S E R V O N : (kupton nga mënyra e të folurit, ligjërimit)

Nga tërësia e e provave të marrura gjatë zhvillimit të gjykimit, u provua në mënyrë të plotë se i pandehuri Padër Anton Harapi, ka pregaditur okupacionin fashist, para datës 7 Prill 1939 duke ardhur në kontakt dhe në marveshje me agjentët e fashizmit Meloni dhe Giovani Girron që ndodheshin në Shqi-

përi dhe nga jashtë me tradhëtarët e grupit të Mustafa Krujës dhe (Organizatës) “Bashkimi Kombëtar”⁵³ si Bahri Omari, Kol Tromara, Qazim Koculi etj, për të përmbysur Zogun dhe për të sjellë një Mbret nga shtëpia e Savojës. Padër Anton Harapi ka qenë përfaqësuesi i “Bashkimit Kombëtar” për qarkun e Shkodrës. Kjo akuzë provohet me atribuimet (*Thënje thelbësore*) e Kol Tramarë, Javer Hurshiti si dhe me pohimet e tërthortë të Maliq Bushatit

Mbas 7 Prillit 1939 i pandehuri ka bashkëpunuar me okupatorin fashist duke sabotuar pushtetin e popullit ka pritur ushtrinë fashiste italiane në Shkodër si çlirues siç pohoj dhe vetë, duke kërcënuar luftëtarët e lirisë të mos luftojnë siç provohet nga deklarata e Qemal Mato Alikaj (*xhandar nga Kuçi i Vlorës që ndodhej në Shkodër në kohën e pushtimit të Shqipërisë nga Italia, deklaratën e tij e ka kundër Maliq Bushatit gjykata e përdor kundër Padër Harapit!*) Padër Anton Harapi ka ardhur në Tiranë si delegatë i klerit Katolik për të marrë pjesë në Asamblenë për ofrimin e Kurorës së Skënderbeut Viktor Emanueli.

Padër Anton Harapi brënda në Kuvendin Francëskan bën pjesë në redaksinë e revistës “Hylli i Dritës” dhe propogandonte parulla e mëdha dhe helmatojnë të fashizmit. Mashtronte popullin shqiptar për një Shqipëri të Madhe, i ngrihte lavde Duçes dhe Mbretit Viktor Emanuelit, nxiste popullin e Malsisë së Shkodrës për tu mobilizuar kundra Malit

të Zi n'interes të fashizmit Italian (*Memoradumi dërguar Duçes e Viktor Emanuelit nga popullisia shqiptare Hot e Grud Mal i Zi*) (në dosjen gjyqësore nuk ka ndonjë dokument me titull Memoradumi).

Lef Nosi me ardhjen e okupatorit Nazist në bashkëpunim me agjentat e Gestapos Fon Shajger dhe Nubaher, mer inisiativën bashkë me të tjerët për formimin e Komitetit Ekzekutiv, bëhet Kryetar i Asamblesë Kujslinge i thërret Padër Anton Harapin dhe i telegrafon Papës në Romë për ti dhënë këtij leje në bashkëpunim me gjermanët që të bëhet anëtar i Regjencës,⁵⁴ ndërsa dhe vetë Padër Anton Harapi në marveshje të plotë me Lef Nosin dhe i njëmejtimit me pjesën reaksionare të klerit katolik dhe me autorizimin e tyre vihet në krye të tradhëtisë. Shpallin nën okupacionin nazist “Indipendencën dhe neutralitetin e Shqipërisë” dhe me autorizimin e tyre vihet në krye të tradhëtisë. Formojnë dy qeveri kujslinge: 1) Rexhep Mitrovicën, 2) Të Fiqri Dines, qeverinë e krijuar në Tufinë, ku ka marë pjesë, Padër Antoni Harapi, Lef Nosi, Mehdi Frashëri, Mitat Frashëri për Ballin Kombëtar, Abaz Kupi e Fiqiri Dineja për Legalitetin dhe për Indipendentët Gjon Marka Gjoni, i shoqëruar gjer në Tiranë prej Maliq Bushatit që ishin të një mendimi, të gjithë së bashku kurdisën qeverinë e koalicionit të të gjithë reaksionit të brëndshëm.

Grumbullojnë elementat bashibozuk të Ballit Kombëtar, Legalitetit e të Gjon Marka Gjoni dhe formojnë Regjimentin “Kosova” Frymëzojnë dhe nxisin

gjithë reaksionin që në bashkëpunim të ngushtë me forcat e okupatorit nazist të bëhen operacione në stil të gjërë për çfarosjen rrënjësisht të Lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke marrë parasysh gjithë çkatarrimet, humbjet në njerëz e në material që do ti vinin popullit shqiptar (operacioni i math i dimërit dhe ay i qershorit si dhe gjithë operacionet lokale) Financojnë horrdhitë e Hitlerit, të Ballit Kombëtar e të Legalitetit. Kombinuan me nazistët arrestime dhe internime në masë si në Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastër, Tiranë, Shkodër, etj për në kampet e vdekjes të Gjermanisë e të Prishtinës. Organizuan terrorin e math të 4 Shkurtit si dhe shpërnguljen e detyrueshme të popullsisë në mes të dimërit, të cilët u detyruar të strehohen nëpër shpella. Është përgjegjës për çkatarrimet e pasurisë të shtetit e të popullit (molave, urave, rrugëve, kantjerëve dhe uzinave elektrike) për djegjen dhe rrënimet e mijrave banesave të popullit si dhe për çdukjen e madhe të gjësë së gjallë.

I pandehuri, si anëtarë të Regjencës, ka aparovuar ndëshkimin me varje të Kol Lakut si dhe dy personave të tjerë kjo akuzë provohet me pohimin e tyre dhe me atribuinin (thënje thelbësore) të Mahmut Golemit (*Në dosje nuk ka ndonjë deklaratë të Mahmut Golemit*). I pandehuri Padër Anton Harapi ka propoganduar të ngrejë me çdo kusht një aparat shtetnor kuisling dhe për këtë gjë nxit gjithë popullin të bashkohet kundra Ushtrisë dhe Lëvizjes Nacional Çlirimtare, duke tentuar të përçë Frontin Nacional

Çlirimtar simbas propogandës së Goebels-it, duke e cilësuar luftëtarët e lirisë si terorista e të shitur në të huaj. Kjo gjë provohet nga fjalimi i tij që u dëgjua në disk dhe që është shumfishuar në gazetërinë dhe në broshura të shtypit t'okupatorit.

I pandehuri, Padër Anton Harapi ka vazhduar rrugën e tradhëtisë deri në fund, me gjithë që është këshilluar si prej aleatëve të mëdhenjë, prej Frontit Nacional Çlirimtar dhe prej patriotëve si Fan Noli, dhe kur pjesa më e madhe e atdheut ishte çliruar prej forcave të Nacional Çlirimtarëve u ka qëndruar besnik gjermanëve deri në fund. Për të organizuar forcat e mbeturinave të reaksionit në Veri të Shqipërisë, me anë të “Lidhjes së Shkodrës”, në bashkëpunim me forcat çetnike. Këto provohen me deponimet e dëshmitarëve Mark Ndoja, Arif Gjyli, me deklaratën e Gjovalin Lukës, me letrën e Padër Anton Harapit drejtuar Javer Hurshitit, me katër letrat e Gjon Mark Gjonit drejtuar Padër Palit me “Programin e Beslidhjes” .

Edhe mbas çlirimit të Shqipërisë i pandehuri ka qëndruar i aratisur dhe ka qenë në lidhje me kriminelat lufte, të cilët kanë tentuar të sabotojnë pushtetin si për shembull tentativa e sulmit mbi Koplik e Shkodër, për të shkaktuar ndërhyrjen e reaksionit nga jashtë dhe për të krijuar një luftë civile. Kjo provohet me faktin se ky u kapën mbas një viti dhe nga deponimet e dëshmitarit Mark Ndoja për sa i përket të pandehurit Padër Anton Harapi.

Nga analizimi i provave të paraqitura prej përfaqësuesve të të pandehurit rezulton se ky ka mundur më të radhë t'i sjellin miqve të tij nonji favor krejt personal, porse ky favor nuk është veçse një pikë uji në mes të oqeanit të tradhëtisë që ka kryer në dëm të atdheut dhe të mjerimeve e të çkatarrimeve që i kanë sjedhë krejt popullit mbarë. Këto favore nuk janë të një natyre e grade sa të lehtësojnë të pandehurin nga llomi i tradhëtisë që ishte futur, deklaratat e deponimet e atyre pakë dëshmitarëve që janë prezantuar përmbajnë frymën e miqësisë, të regionalizmës ose janë bërë në mënyrë të atillë që këta dëshmitarë të justifikojnë veprimtarinë e tyre antipopullore e kolaboracioniste. Përmbajtja e deponimeve dhe e dëshmitarëve mbrojtësa të të pandehurit përgenjështrohen në mënyrën më kategorike nga vetë pohimet e të pandehurit, nga dokumentat e shumta që u përmendën në trupin e këtij vendimi dhe që këto nuk janë veçse një pjesë fare e vogël e dokumentave të ndodhura në arkivat e ndryshme ose të zhdukura, përgenjështrohen sidomos nga vetë ngjarjet që janë zhvilluar në kuriz të popullit e të atdheut gjatë pesë vjetëve okupacioni dhe jo vetëm që kanë hyrë në dijëni të Trupit Gjykues por dihet botërisht: 50,000 të vrarë e të plagosur nga popullsia civile e nga radhët e ushtrisë Nacional Çlirimtare, 18,000 shqiptarë të internuar ose të burgosur në burgjet e në fushat e internimit të nazismit gjerman 47,000 shtëpi për

banim të djegur ose të rënuara, me mijra bagëti të trasha ose të vogla të plaçkitura, gati krejt ekonomia, financat e komunikacioni të çkatarruara.

Për këto vepra i pandehuri është përgjegjës moral, mbasi këta me pozitën e tij ka qëndruar në kulmin e tradhëtisë. Në analizimin e mbrojtjes të Avokat Z. Stringa Gjykata Observon: se Padër Anton Harapi ka qenë konsumuent në vijën e tij antipopullore e anti përparimtare, qysh në vjetin 1936 çfaqet për një diktaturë fashiste, bën pjesë në “Bashkimin Kombëtar” që ka si parim marveshjen e lidhur midis “Bashkimit Kombëtar”, përfaqësuar prej Qazim Koculi e Ali Këlcyrës dhe “Grupit të Zarës” i përfaqësuar prej Mustafa Krujës (Shif dokumentin e botuar në gazetën “Roja Kombëtare” nr 7 datë 13 prill 1943 që riprodhon tekstin e marveshjes), *(Në dosje nuk egziston një dokumenti i tillë)* bashkëpunon me klerin fashist deri në fund sado që avokati i mbrojtjes kërkon që në gojën e Kont Ciano-s të kallazojë se gjoja ideja e bashkimit personal të Shqipërisë me Italinë gjeti kundërshtarë nga ana e klerit katolik të Shkodrës, porse Z. Avokat nuk na paraqiti nonjë dokument për këtë çështje, nga ana tjetër dokumentat e “Hylli i Dritës” të gjithë kohës s’okupacionit fashist italian e përgënjeshtroan në mënyrë kategorike dhe me kot përpiqet Z. Avokat që artikullin “përgjigje Cordignano-s” (Fulvio Cordignano) kërkoi t’ia vishte Padër Anton Harapit gjoja me pseudonimin “Kritiku-esi” kurse para këtij gjyqi nuk doli as më e vogla

indicje që të provojë se më të vërtetë i pandehuri Padër Anton Harapi ka shkruar me pseudonimin “Kritikuesi” .

Pretendon gjithashtu z. Avokat se Padër Anton Harapi nuk është politikan, por nja letrarë, një idealist, porse nga i gjithë realiteti i gjykimit u provua se Padër Anton Harapi ka qenë marë me politikë bile me politikë të lartë. Pretendon gjithashtu Z. Avokat se Padër Anton Harapi hyri në kurth dhe s’e kuptoi dot përgjegjësinë me rastin që hyri në Regjencë.

Kjo rrëzohet në mënyrë të katërçipt, mbasi Padër Anton Harapi jo vetëm që u konsultua me klerikët reaksionar katolik porse rrëzohet edhe nga përmbajtja e fjalimit të reçituar (*rregjistruar*) në disk. Pretendon gjithashtu Z. Avokat se Padër Anton Harapi nuk figuron anëtar i Ballit, i Legalitetit dhe i Indipendentëve dhe se kjo gjoja u vërtetua nga letra qi drejton Javer Hurshitit, porse Padër Anton Harapi ka qenë mbi të gjitha politikat, kundra lëvizjes Nacional Çlirimtares dhe luftës së popullit Shqiptar, krahas me Hausding-un, Fitztum-in etj oficer të Gestapos, siç provohet dhe nga përmbajtja e letrës e nga fotografia.

Veprimtaria e të pandehurit u provua plotësisht dhe parashikohet prej neneve 14 e 15 të Ligjës nr 41, datë 14 janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatave ushtarake, dhe prej nenit 1 të ligjës në 21, datë 15 Dhjetor 1944.

Me qenë se i pandehuri nuk përfiton nga shkaqet lehtësorë të nenit 16 të ligjës Nr 41

P R A N D A J:

Në bazë të neneve të naltëpërmendura Gjykata e konsideron fajtor si kriminel lufte, armiq të popullit dhe sabotatorë të pushtetit popullor dhe në bazë të nenit 18, gërma “g” të ligjës Nr 41, conform me kërkimin e prokurorit

V E N D O I:

Ndëshkimin e fajtorit: Padër Anton Harapi, i biri i Loros dhe i Luçisë, lindur më 1888 në Shirokë të Shkodrës me VDEKJE, humbjen e të drejtave qytetare e politike dhe konfiskimin e pasurisë së luajtëshme e të paluajtëshme

Ky vendim, në bazë të nenit 31 të ligjës nr 41, datë 14 janar 1945, i dërgohet gjykatës së Lartë Ushtarake për aprovim

Tiranë, më 12 Fruer (*shkurt*) 1946

Sekretari
Zalo Xhomaqi
(Firma)

Kryetari
Irakli Bozo
(Firma)

Vdekje Fashizmit

Liri Popullit

P. T.

GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

Tiranë

I nënshkruari Patër Anton Harapi, kam nderin me parashtruar sa ma poshtë:

Gjykata Ushtarake e Tiranës, me vendimin e së datë 12 të muajit vazhdues, më ka ndëshkue me vdekje.

Tue përsërit gjitha ç'ka kam thanë gjatë rrjedhimit të gjykimit, dhe për sa të tjera që do të konstatoj në dobinë t'ime ajo e nderta Gjykatë, lutem të keni mirësinë me vendos që të më falet jeta, në rast të kundërt t'i propozohet Asamblesë Kushtetontjës falja e jetës s'eme

Tiranë, më 12/2/1946

Me nderime:

(Patër Anton Harapi)

(firma)

Vdekje fashizmit - Liri Popullit

Republika Popullore e Shqipërisë
Ushtria Kombëtare Shqiptare
Komanda e Përgjithshme
Gjykata e Naltë ushtarake

Numëri i Vendimit 9

A K T - G J Y K I M
N'EMËR TË POPULLIT SHQIPTAR

Gjykata e Naltë Ushtarake e formueme prej:
N/Kolonel Gaqo Floqi Kryetar
Major Frederik Nosi Anëtar
Kapitetn I-rë Veledin Zejneli Anëtar

Në prezencën e prokurorit N/Kolonel Pëllumb Deshnica dhe me asistencën e sekretarit Aspirant Thoma Rinos, sot me datën 14.2.1946 mori në shqyrtim aktet e padisë Penale kundra të dënuarve

1) Lef Nosi, i biri i Stilianit dhe i Anës, vjeç 73, lindun e banues në Elbasan;

2) Patër Anton Harapi i biri i Loros dhe i Luçisë vjeç 58, lindur në katundin Shirokë të Shkodrës, banues në Shkodër, fetar

3) Maliq Bushati, i biri i Hysejnit dhe i Qamiles, vjeç 56, lindur e banues në Shkodër, pronar:

Të cilët me akt-gjykimin Nr 24 datë 12.2.1946 të Gjykatës ushtarake të Tiranës, janë dënuar me VDEKJE në bazë të neneve 14,15 e 18 të Ligjës Nr.41 datë 14 janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave Ushtarake dhe prej nenit 1 të Ligjës Nr.21 datë 15 Dhjetor 1944, mbasi janë cilësuar si kriminelat lufte armiq të popullit dhe sabotator të Pushtetit

G j y k a t a :

Mbas shqyrtoj akt-akuzat e proçes-verbalet e Prokurorit të gjykatës së faktit;

Mbasi shqyrtoj proçes-verbalet e mbajtur nga Komisioni Hetues për krimet e kriminelave të luftës dhe ato të Mbrojtjes së Popullit.

Mbasi shqyrtoj dokumentat që vërtetojnë akuzat e tre të pandehurëve,

Mbasi shqyrtoj deponimet e dëshmitarëve të mbrojtjes e t'akuzëz të bëra në betim para gjyqit

Mbasi mori mejtimin e prokurorit i cili kërkon të vendoset aprovimi i akt-gjykimit të sipërme si me vend dhe i bazuar në dispozitat ligjore përkatëse;

Mbasi shqyrtoj çështjen nga pikpamja e faktit dhe e ligjit

O b s e r v o n :

Me fakte: Patër Anton Harapi vjeç 56 nga Shkodra ka bashkëpunuar me organizatën tradhëtare

“Bashkimi Kombëtar”, para 7 Prillit 1939 për të prurë okupacionin fashist dhe ka qenë përfaqësues i saj në Shkodër.

Gjatë okupacionit fashist është munduar të bashkëpunoj tërthorazi dhe me parullat e tij helmone është munduar ta paraqesë okupacionin fashist si një çlirim.

Ka lejuar që revista e klerit katolik “Hylli i Dritës” të ishte organi më i mirë propogandistik për fashizmin dhe organizatat tradhëtare që organizoj.

Ka qenë mik i ngushtë i Jakomonit, të cilin e ka shoqëruar në Malësinë e Shkodrës, duke e paraqitur shpëtimtar të Shqipërisë. Se sa me gëzim të math Patër Antoni e pret Jakomonin tregon kjartasi fotografija qi është në dosjen. *(në dosje nuk është fotografia që i referohet gjykata)*

Mbas kapitullimit t’Italisë Pater Antoni e heq maskën dhe bëhet organi ma i ndërgjegjshëm i nazizmit gjerman. Anëtar i Regjencës.

Asht inisiator i Komitetit Ekzekutiv Kuisling dhe t’ashtu quajtur “Asamble Kombëtare” të cilat legji-timojshin okupacionin gjerman, në Shqipëri dhe përçanin rezistencën e popullit Shqiptar.

Në bashkëpunim me okupatorin nazist kanë organizuar forca mercenare si Milicia, Kuesturë e Xhandërmari për të luftuar rezistencën e popullit shqiptar për liri.

I pandehuri Patër Anton bashkë me anëtarët e tjerë të Regjencës është insiprator dhe inisiator për bashkimin e gjithë organizatave tradhëtare në bashkëpunim me forcat e okupatorit të terrorizonin popu-

llin e pafshëm. Mbledhja e Tufinës, Beslidhja e Shkodrës

Është përgjegjës direkt për financimin e miliona franga që i ka bërë okupatorit gjerman dhe organizatave tradhëtare duke shfrytëzuar në kurriz të popullit të varfër. Ka urdhëruar të bëhen arrestime dhe internime në masë si dhe operacionin e Dimërit dhe të Qershorit në bashkëpunim me okupatorin.

Këto operacione i kushtoj popullit t'onë mijra të vrarë dhe dëme të pa llogaritëshme. Është përgjegjës për masakrimet e 4 Shkurtit. Të gjitha këto në përgjithësi u pohuan prej të pandehurit si dhe kolegut të tij Lef Nosit.

Me fjalimet e tij dhe artikujt e ndryshëm ka qenë axhicatori dhe propogandisti më i mirë për okupatorin duke u munduar të përçajë luftën e popullit shqiptar.

Ka bashkëpunuar me kriminelat ndërkombëtar gjerman Gjeneralin Fizhtum dhe Hauzding Komandantin e Përgjithshëm të Gestapos me Fehen, Komandantin e përgjithshëm të ushtrisë naziste në Shqipëri. Me Nendaher, Grussen (??) dhe Konsullin Schllip. Se sa dashuri ndjente Patër Antoni kur takohesh me këta kriminela mjafton të shifet fotografija që ndodhet në dosje.

Mbas shlirimit të Shqipërisë prej forcave të ushtrisë N.Ç. i pandehuri qëndron i arratisur në mal dhe në bashkëpunim me kriminelat e tjerë mundohesh të sabotonin e të rrëxonin pushtetin e popullit.

Veprimtaria e tij provohet në mënyrë bindëse nga proçes-verbalet e mbajtura prej Prokuroria e Gjykatës së faktit nga proçes-verbalet e mbajtura prej Komisionit Hetimor dhe të Mbrojtjes së Popullit, nga deponimet e dëshmitarëve të akuzës të bërë me betim para gjykatës së faktit, nga akt akuzat dhe një shumicë dokumentash që ndodhen në dosje që vërtetojnë akuzat e të pandehurit, nga pohimet e bëra para gjykatës së faktit dhe nga rrjedhimi i gjykimit të zhvilluar para gjykatës së faktit.

NË LIGJË:

Vendimi i gjykatës së faktit është i bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, sasija e ndëshkimit caktuar me VDEKJE për të dënuarin është i drejtë dhe në përpjestim me fajet dhe veprat e kryera prej tij.

P R A N D A J:

Gjykata e Naltë duke pëlqyer dhe mendimin e Prokurorit në bazë të nenit 31 të Ligjës nr 41 datë 14 janar 1945 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës ushtarake

VENDOSI:

Aprovimin e akt-gjykimit Nr 24 datë 12.2.1946 të Gjykatës ushtarake të Tiranës, me të cilën është vendosur ndëshkimi me VDEKJE i të pandehurit PATËR ANTON HARAPI lindur në Shirokë të Shkodrës, humbjen e të drejtave qytetare dhe politike si dhe konfiskimin e pasunisë të luajtëshme e të paluajtëshme simbas dispozitave ligjore në fuqi.

Tiranë 14.2.1946

Sekretari
Thoma Rino
(firma)

Kryetari

Gaqo Floqi
(firma)

Reflektim:

Vazhdmisht në çdo gërmë të këtij studimi, pyetja që më mundonte ishte: A jam i drejtë, a jam i lirë të shkruaj të vërtetën. “ E vërteta, a është një çështje politike, ashtu si drejtësia, barazia, liria? Të lexosh, të dëgjosh, ti klasifikosh dijet, ti qartësosh ato për tju ofruar raportin tonë të komplikuar me të vërtetën për të pasur një instrument të dobishëm që të mund të krijojmë një qartësim sa më të mundshëm për të kaluarën tonë për të mos gabuar drejt të ardhmes”

Drejtësia si virtyt i shoqërisë

Amerikani John Bordley Raws ishte një filozof moralist, ligjor dhe politik. Rawls është përshkruar si një nga filozofët politikë më me ndikim të shekullit të 20-të

“Teoria e Rawls për "Drejtësinë si drejtësi" rekomandon liri të barabarta themelore, barazi të mundësive dhe lehtësimin e përfitimit maksimal për anëtarët më pak të avantazhuar të shoqërisë në çdo rast kur mund të shfaqen pabarazi.

Unë gjykoj se drejtësia si koncept ka ndryshuar e ndryshon jo vetëm në përcaktimet që i kanë dhënë autorë të ndryshëm të filozofisë, por edhe nga një individ në tjetrin. Ajo është lidhur shpesh me konceptin e paanësisë dhe të barazisë në dhënien e së drejtës që nga lashtësia e deri më sot. Pos kësaj, po të pyesim njerëz të ndryshëm se çfarë kuptojnë ata me drejtësi, mund të na japin përgjigje krejt të ndryshme ose deri diku të ndryshme. Prandaj ka qenë e vështirë për shumë studiues të japin që në fillim të një studimi se çfarë kuptojnë me këtë koncept.

Për shembull, tjetër gjë kuptonte Platoni me drejtësinë, tjetër Aristoteli. Për Platonin drejtësia ishte virtyt i përsosmërisë që arrinte shpirti, që rregullon marrëdhëniet individuale mes njerëzve.

Ndërsa Aristoteli i jep drejtësisë edhe kuptimin si ligjshmëri, kurse në raport me virtytet (moralin) Aristoteli mendon se “Te drejtësia përfshihet çdo virtyt”. Ai (Aristoteli) thoshte se para se të vendosim se si duhet të jenë të drejtat e njerëzve ose rregullimi ligjor tyre, duhet të përcaktojmë se cilin lloj shteti e cilën mënyrë të të jetuarit duan më shumë njerëzit që kanë aftësi për të vendosur për të mirën e të drejtën e tyre. Platoni i ofrohet pak Aristotelit duke thënë: “Qëllimi ynë është të mësojmë se cila formë e komunitetit politik është më e mirë për njerëzit që

janë të aftë për të kuptuar idealin e tyre në jetë”. Aristoteli e kupton drejtësinë si rend juridik e shoqëror.”

Pytjes që më është dashur të ngre dhe të verifikoj duke studjuar këtë material historik -juridik është: Çfarë rrolli luajti e drejta (ligji) në shoqërinë tonë komuniste? A ishin njerëzit e drejtësisë në shoqërinë enveriste qenie me vullnet të lirë, që vendosin vetë, që nuk pranonin imponime nga autoritete politike, që nuk kishin frikë të jipnin drejtësi ose të tjera arsye pafund të sistemit të drejtësisë. A arsyetuan ata mbi bazën e vlerave të tyre morale dhe botëkuptimore në qoftë se kishin?. A e dha drejtësia komuniste e tipit enverist bazën e ideve se si mund të bëhet më e mirë dhe më e drejtë shoqëria shqiptare në sistemin e vlerave moral shoqërore komuniste? Koha tregojë se qe një dështim katastrofik!

Gjendja psikike fillestare që përjeton kur lexon këtë dosje gjyqësore është se në drejtësinë tonë komuniste sundonte pandershmëria, pala që merr vendim, është palë e paarsyeshme që nuk përfillin konsensusin shoqëror ata zbatuan vetëm urdhërit e partisë dhe të instiktit të tyre vrastarë. Ata njerëzit e drejtësisë komuniste nuk dinë e nuk donin të dinin që të bënin dallimet që mund të kenë qenjet njerzore. Ata se konceptuan dot e nuk e pranonin mendimin që qytetarët janë të lirë dhe të barabartë në të gjitha drejtimitet e rëndësishme të jetës së tyre, dhe këto të drejta është i detyruar ti njohi, ti ofrojë e ti mbrojë shteti e shoqëria. Fatkeqësisht shteti i Enver Hoxhës

u kthye në një “Kobure” që godiste pa mëshirë majtas, e djathtas. Ndërsa shoqëria shqiptare u tulat nga dhuna e paarsyeshme.

Një shoqëri me rendin e duhur nënkupton disa gjëra që për mua janë thelbësore:

1) Që është një shoqëri në të cilën qytetarët pranojnë (jo me dhunë po me arsye) të njëjtat parime të drejtësisë.

2) Që institucionet e saj themelore politike e shoqërore bashkëveprojnë vetëm mbi bazën e këtyre parimeve dhe jo mbi bazë private ose partiake.

3) Që edukimi e veprimi i pushtetarëve etj. të kenë një sens drejtësie të tillë, që nuk duhet të mendojnë vetëm për vete, për partinë, ose për grupe të vogla shoqërore por edhe për bashkësinë e gjërë ku jetojnë, për komunitetin e plotë.

Së pari unë e ndjej me të tëra shqisat e mia, mungesën absolute në këtë gjyq, e teorisë për drejtësinë si paanshmëri, e cila e bën jo funksionale e të dhunëshme jetesën në një shtet të së “Drejtës e demokratik” siç pretendon me hipokrizi qesharake prokurori i çështjes.

Leximi e studimi i kësaj dosje ma çoi vëmëndjen te dy konceptet kyçe, asaj të filozofisë e të së drejtës filozofisë politike. Identifikimi i qartë i këtyre koncepteve ka nevojë për dije të qartë historike të kombit tonë. I kushtova një vëmëndje formës së argumentimit të mendimeve të ndryshme që ballafaqohen me këtë dosje për të gjetur disa parime bazë të së drejtës, ku mbështetet një shoqëri komuniste pavarësisht nga vendi dhe koha. Procesi i mendimit ndërlikohet,

sepse më duhet të marrë parasysh se njerëzit që jepnin drejtësi në këtë shoqëri të “Re komuniste” ishin qenie pa vullnet të lirë, nuk zgjedhin vetë, pranojnë imponime nga autoritete politike e arsyejnë mbi bazën e vlerave të tyre morale dhe e botëkuptimore aspak civilizuese e mbi të gjitha ju mungonin një arsimim profesional e përgjegjësi qytetarie. E ke të vështirë ta pranosh logjikën e kësaj lloj “Barbarie”

Për një gjë jam i sigurtë se jam para një mizaskene e një imagjinate artificiale ku velloja e padijes egërsisht po impononte një realitet tashmë të dhunshëm skajshmërisht në Shqipëri. Pyetja që kam për ta e për vete është: Si mund të ndërtohen institucionet e një shoqërie me rendin e duhur, në mënyrë që qytetarët të kenë lirinë maksimale të mendimit e veprimit nga njëra anë, dhe të mos përjashtohen nga sistemi për shkak të bindjeve politike e satusit ekonomik dhe duke u trajtuar si qenie pa dinjitet.

Drejtësia si paanshmëri është një konceptim politik i drejtësisë. Ajo gjen zbatim së pari në strukturën bazë të shoqërisë që buron nga e drejta e popujve për kushte të barabarta dhe nga ndershmëria si vlerë morale.

Kur pretendohet të ndërtohen parime për drejtësinë për njerëz tërësisht të ndryshëm nga pikëpamja e mendimeve, botëkuptimeve morale, fetare etj., rregullimi i vetëm i tyre bëhet nëpërmjet pjesës politike të së drejtës, pra ligjeve të shkruara të cilat janë njëlloj për të gjithë qytetarët e një vendi, që nga kushtetuta e deri poshtë në hierarki, të cilën në këtë dosje nuk e gjejmë gjëkund.

Shënime plotësuese:

1. *Mustafa Ali Begu i njohur Cafo Beg Ulqini lindi në Ulqin, 1893 – Vdes në Shkodër në datën 24 dhjetor 1977. Shërbeu si kryetar i Bashkisë së Ulqinit në vitet 1941–44, si dhe deputet i Ulqinit në Parlamentin shqiptar. U zgjodh anëtar Këshillit të Lartë të Regjencës nga parlamenti, pas vdekjes së Regjentit Fuat Dibra. Pushteti komunist e dënoi me me 5 vite burgim mbas burgut ka jetuar në Shkodër*

2. *Kjo frazë e diplomatit Gjerman të lë të nëkuptosh që Padër Harapi ishte kundër Xhafer Devës për tu bërë ministër në qeverinë e re të Fiqiri Dines, këtë na e vertetojnë dhe akuzat që ai hedh ndaj Xhafer Devës për ngjarjet e 4 Shkurtit në këtë dosje. Gjermanët e preferonin Xhafer Devën dhe për të manipuluar numërin e votave të Rengjencës për votimin e Xhafer Devës ata shrytëzua sëmundjen e Padër Anton Harapit që kishte shkuar dhe me dëshirën e gjermanëve në Tiroi, Austri për kurim. Gjithsesi Xhafer Deva nuk u zgjodh më ministër dhe me këmbënguljen e Medi Frashërit i cili nuk e pëlqente mënyrën si e drejtoi Ministrinë e Brëndëshme Xhafer Deva, sidomos në rastin e 4 Shkurtit. Xhafer Deva është shprehur: Mua nuk më donin as komunistët e as nacionalistët.*

3. *Në datën 6.6.1944 Trupat aleate zbarkuan në Normandi. Në datën 25 Gusht 1944 çlirohet Parisi. Në fillimet e vitit 1944 trupat ushtarake sovjetike korrën një fitore të madhe në betejën e Kruskut. Trupat ushtarake gjermane u tërhoqën nga territori i BRSS Në nëntor 1943 çlirohet Kievi nga gjermanët. Tërheqja e ushtrisë gjermane ariti në kufitë e gjermanisë etnike.*

4. *Eqerem (Ekerem) bej Vlora lindi në Vlorë, 1 dhjetor 1885 – vdes në Vjenë, në maj 1964 ishte nëpunës i Perandorisë Osmane, veprimtar i çështjes shqiptare, diplomat, politikan, shkrimtar dhe historian. Firmëtar i shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Nën-punës i lartë i Monarkisë Shqiptare. Ishte një nga firmëtarët e dërgimit të Kororës së Skënderbeut Viktor Emanueli III-të Perandor i Italisë. Mbas prillit 1939 përfaqëson pref. e Vlorës në Asamblenë Kushtetuese gjer në shtator 1943, kur Asamblea u shpërbë. Gjatë periudhës së pushtimit Italian të Shqipërisë ka qenë Kryetar i Zyrës së Punëve Civile, Kryetar i Zyrës Ceremoniale në “Luogotenenca” Tiranë. Gjatë qeverive në peridhën italiane të pushtimit ishte bashkë me Dimitri Popan, Gjon Marka Gjonin një nga tre anëtarët shqiptarët të këshillit të kancelarisë së urdhërave “Besa dhe Skënderbeu” nën sovranitetin e perandorit të Italisë. Në prillin e 1940 u bë pjesë e Institutit të Studimeve Shqiptare. Me Dekret Mëkëmbësor nr. 333, datë 3 dhjetor 1941, në qeverinë e tiranës u krijua Ministria e Tokave të Lirueve, të cilën ky e drejtoi një kohë e cila ekzistoi deri në shkurt 1943. Në 7 maj 1942, Mustafa Kruja si kryeministër e emëroi atë ministër për Kosovën, Dibrën, Plavën e Gucinë që iu bashkuan Shqipërisë "Së vjetër". Në verën e vitit 1944, ai u bë ministër i Jashtëm dhe i Drejtësisë para se të shkonte në mërgim në Itali me ardhjen e komunistëve në pushtet. Qëndroi për 10 vite në Itali derisa u shpërngul në Austri. Vdiq në Austri. Në marsin e 2014 u muar vendimi i Këshillit të Ministrave të shtetit shqiptar për t'ia riatdhesuar eshtrat dhe mundësoi varrosjen e tij në vëndlindjen e tij Kaninë të Vlorës.*

5. *Franz Von Scheiger (1891 - 1960) diplomat gjerman ka punuar në Shqipëri në vitet e luftës së Dytë Botërore. Ka qenë në Shqipëri që në luftën e Parë Botërore si pjesë e ushtrisë Austro-Hungareze. Njohës i mirë i mentalitetit e kulturës shqiptare. Kishte njohje të mirë me shumë burra shteti shqiptar. Në vitin 1962 biblioteka e institutit për Studime të Europës Juglindore bleu 500 vëllime nga donacioni i inxhinjerit dhe diplomatit Franz von Scheiger. Fokusi i koleksionit të tij ishte historia e Shqipërisë dhe shteteve fqinj. Koleksioni përmban literaturë dhe numizmatikë*

6. *Bernhard Gustav Lippert lindi më 7 tetor 1904 në Salzburg Austri vdes në 10 tetor 1946 në një aksident automobilistik. Ishte një diplomat gjerman. Më 1 maj 1933, Lippert iu bashkua NSDAP (Partia naziste). Pas marrjes së nënshtetësisë gjermane, ai u pranua në shërbimin e Jashtëm të Rajhut Gjerman më 8 maj 1934 me ndërmjetësimin e xhaxhait të tij Ernst Röhm - shef i shtabit të Sturmabteilung (SA), ushtria e Partisë Nacional Socialiste, njeriu më i fuqishëm në Gjermani pas Hitlerit. Nga 29 korriku 1941 u punësua zyrtarisht në departamentin politik të Ministrisë së Jashtme në Berlin. Ndërkohë 1943 /1944 Lippert ishte anëtar i Wehrmacht. Nga 30 korriku 1944 deri më 6 tetor 1944 punon me titullin zyrtar Këshilltar Legate pranë Legatës në Tiranë, nga 15 nëntor 1944 punësohet në Departamentin Politik të Ministrisë së Jashtme (Departamenti IV Bullgari, Rumania, Serbia etj.*

7. Rrëfimi i Sheuqet Muka: Në fillimin të vitit 1944 u formua në Shkodër, “Besa Shqiptare”. Inisiatorët e kësaj organizate qenë Ndoc Çoba, Tef Gera, Kol Kiri, Hysen Lohja, Hys Draçini, Xhemal Naipi, dhe unë Sheuqet Muka. Mbledhjen e parë për të organizuar këtë organizatë e kemi bërë në shtëpinë e Ndoc Çobës, në mbledhjen e parë kanë qenë këta persona, Ndoc Çoba, Sheuqet Muka dhe Hysen Lohja. Bisedat e para ishin këto: Mbi nevojën e bashkimit. Mbrojtja e atdheut, evitimi i vëllavrasjes, vumjen e besës për gjak.

Kemi vendos në mbledhje që të bëhet propogandë dhe axhitacion në popull për të shtuar radhët e kësaj organizate, dhe nga ana tjetër anëtarët e organizatës të jenë atdhetarë të mirë.

Organizata jonë ka pasur karakter lokal, dhe dojshim të mbanim larg popullin, nga vëlla vrasja, ne nuk kemi dash të merrnim pjesë në vëllavrasje, për të mos pësuar ato, që pësoi Jugu (i Shqipërisë) “Besa” nuk kishte drejtim politik, por ishte një organizatë që punonte deri sa të çlirohej atdheu, programi i saj ishte pa qëllim politik. Si pikë kryesore kishim bashkimin e popullit, dhe me qenë gati me çlirimin të atdheut. Largimin nga vëlla-vrasja dhe pajtim gjagjesh.

Nga mbarimi i muajit mars të vitit 1944 me qëllim që tu dilet përpara grindjeve dhe gjëndjes së krijuar dhe të mos lihet shkak për vëlla-vrasje, është ba një marveshje ndërmjet këtyre organizatave, “Besa Shqipëtare”, “Grupi Nacional Independent” dhe “Ballit Kombëtar”. Marëveshje ka qenë në këto pika: Me i qëndrue larg vëlla- vrasjes dhe e dyta bashkimi në rast mësymje nga jugosllavët. Në mbarim të luftës organi-

zatat do të jenë të lira të tregojnë aktivitetin e tyre sipas programit që kanë patur.

Nga “Besa Shqipëtare” si përfaqësues kanë shkuar Ndoc Çoba, dhe unë, nga “Grupi i Nacional Independentës” kanë qenë si përfaqësues Afiz Ali Tahiri dhe Marku i Gjon Markut, prej “Ballit Kombëtar” Lec Kurti dhe Jup Kazazi. Kjo mbledhje është bënë në shtëpinë e Gjon Marka Gjonit, këtu u krijua dhe u vendos “Lidhja e Shkodrës”. Rreth pesë-gjashtë muaj që ka qenë kjo lidhje mund të jenë bënë rreth 20-30 mbledhje. Unë nuk kam marrë pjesë në të gjitha mbledhjet, mbasi isha i zanë me punë, vendin tim e zinte Hys Draçini, ku ky lajmërohej nga Ndoc Çoba për të shkuar në mbledhje.

Për të shtuar radhët e saja, “Lidhja e Shkodrës” ka dërguar anëtarët e saj nëpër nën prefektura e Qarkut të Shkodrës, për të bërë të njoftun lidhjet e organizatave të mësipërme në një organizatë të vetme sipas programit të përcaktuar. Populli që kishte marrë pjesë në këto mbledhje e priti mirë këtë lajm, dhe dha fjalën se do të çojë përfaqësuesit e vetë në Shkodër.

Mbledhja e Shkodrës ashtë bënë nga mbarimi i majit të vitit 1944 në kinema Rozafat. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e “Ballit Kombëtar” që përfaqësoheshin nga Lec Kurti e Jup Kazazi, nga grupi Nacional Independentës, Shuk Gurakuqi dhe Hafiz Ali Tari, nga “Besa Shqipëtare” Ndoc Çoba dhe Shefqet Muka, si dëgjues ishin ftuar mjaftë pari. Mbledhja e të tre organizatave ka pasun për qëllim bashkimin e gjithë qarkut të Shkodrës për të qenë gati për kohën e ardhëshme dhe për të evituar vëlla-vrasjen.

Mbledhjen e çeli përfaqësuesi i “Besës Shkodrane”, Ndoc Çoba, këtu u përcaktuan dhe format organizative e “Lidhjes Shkodrane”. “Lidhja e Shkodrës” ka pasur karakter lokal.

“Lidhja e Shkodrës” u shkatarua aty nga mesi i muajit shtator, shkaqet e shkatarimit qenë gjendja e keqe që u krijua.

Në kohën e formimit të “Lidhjes së Shkodrës” kanë ardhur në qytetin tonë një delegacion i “Lidhjes së Prizerenit” i cili përbëhej nga katër vetë, nder ta njof vetëm Kol Margjinin. Arsyeja e ardhjes së tyre ishte me thirrë parinë dhe krenët e vendit për me shkue në Prizeren, ata na kërkuan një delegacion prej 70-80 vetësh për të asistuar në një mbledhje që do të bëhej në Prizeren e që kishte si qëllim mbrojtjen e Kosovës. Meqen se neve ishim krijuar rishtas dërguem si delegat këta tre persona, Hys Draçinin, Shuk Gurakuqin, dhe Jup Kazazin. Kur u kthyen delegatët tanë nga Prizereni i paraqitën kryesisë një raport në lidhje me organizimin e “Lidhjes së Prizerenit”, mbi forcat që ato dispononin dhe qëllimin e tyre. Tendenca e kësaj “Beslidhje” në Prizeren ka qenë çlirimi i Kosovës nga Jugosllavija dhe me u bashkue me Shqipërinë. Përveç kësaj marveshje nuk di të jetë bërë marveshje tjetër.

8. Mundësia që “Lidhja e Shkodrës” të këtë lidhje me çetnikët serb është tërësisht e pa logjikëshme. Prokurori komunist nuk e di ose nuk do ta dijë që shqiptarët e Veriut armik të genit të tyre kanë serbët. Fishta ka një thënje të saktë “Në urrejtje të njani tjetrit kena le” Objektiv i çetnikëve serb në trojet e shqiptarëve ishte vrasjet e tyre por edhe anëtarët e popullsiive të tjera joserbe, kroatët, boshnjakët etj. Në varësi të

interesave të momentit ata kalonin shpesh nga bashkëpunimi me ustashët kroatë, gjermanët, me komunistët e Titos në krimet ndaj shqiptarëve. Pavarësisht se ata operonin shpesh në grupime të ndara, duke mos iu bindur një komande qendrore, në krimet ndaj shqiptarëve ata bashkoheshin, me dëshirën për ti shfarosur në rastin më të parë. Duke filluar nga muaji maj 1944, pjesa veriore e Kosovës u sulmua nga çetat partizane të Titos, të koordinuara njëkohësisht me njësitë çetnike. Lidhja e Dytë e Prizrenit organizoi popullsinë shqiptare për mbrojtjen e kufijve etnikë. Në mbrojtje të kufijve u mobilizuan të gjithë burrat prej moshës 18 e deri në moshën 50 vjeçare. Më 30 tetor 1944, për të gjithë shqiptarët u lëshua një thirrje për mobilizim ushtarak për ta mbrojtur kufirin.

9. Ndoc Çoba lindi në Shkodër, 27 korrik 1870 - vdes në burg 6 Mars 1945 ka qenë publicist, deputet, ministër dhe atdhetar shqiptar. Për arsye se mbështeti grushtin e shtetit e qershorit 1924, u arrestua më pas përmbysjes së grushtit të shtetit dhe u mbajt në burg deri më 12 shkurt 1925.

Në vitet 1928-1936 u zgjodh Kryetar i Asamblesë Bashkiake të Shkodrës, kurse më 27 gusht të 1937 e deri më 24 qershor 1939 qe Kryetar i Bashkisë së qytetit. Si përfaqësues i zogistëve së bashku me Abaz Kupin, mori pjesë në mbledhjen e Pezës më 16 shtator 1942. Pas Konferencës së Pezës, Çoba u zu dhe u arrestua në kohën e qeverisë Kruja dhe internohet në Ventotene, ku qëndroi deri me kapitullimin e Italisë. Mori pjesë si delegat në formimin e Partisë Lëvizja e Legalitetit në shtator 1943 në Tufinë të Tiranës.

Me të marë pushtetin komunistët, u arrestua janarin e 1945 dhe pas tre mush torturash ndërron jetë në mars të 1945.

10. Faik Quku lindi në Shkodër, 1895 – vdes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 19 korrik 1963 profesioni e arsimimi ushtarak. Anëtarë i Kryesisë së Organizatës Balli Kombëtar. Me ardhjen në fuqi në Shqipëri të komunistave emigron jashtë vëndit.

11. Vasil Andoni lindi në Lagjen “Kala” Elbasan në vitin 1901 vdes në Itali në vitin 1994. Ka mbaruar shkollën amerikane “Robert College” në Stamboll dhe studimet e larta në Strasburg Francë. Aktivist kundër pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Më 1942 është mësues në Normalen e Elbasanit më pas transferohet në Kosovë, Prishtinë si drejtor gjimnazi. Më 1943 u kthye në Tiranë, i bashkohet organizatës Ballit Kombëtar. Në 1944, në kongresin e parë u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Ballit Kombëtar, detyrë që e mbajti derisa vdiq. Me marjen e pushtetit në Shqipëri nga komunistët emigroi në Itali. Vdiq në Itali. Varrimi u bë në qytetin e lindjes, në Elbasan.

12. Oso Kopluku?

13. Hafiz Ali Kraja ose Hafiz Ali Tari lindi në Shkodër, 1900– vdiq në Shkodër 1973 ka qenë hoxhë, publicist. Kreu shkollën ruzhdien dhe medresen në Shkodër. Në Kajro mbaroi studimet teologjike në Universitetin e Al-Azhar. Është internuar nga pushtuesit italian në Porto Palermo. Antikomunist. Me marrjen e pushtetit nga komunistët Hafiz Aliu doli në ilegalitet deri më 1947 kur u dorëzua duke besuar nga amnistia që u dha nga rregjimi komunist. U dënuan me

vdekje, por duke përfitur nga amnistia u dënua me burgim të përjetshëm, me vendimin nr. 213, datë 8.6.1947, kthyer në 25 vjet burg; nga një amnisti e dytë përfitoi zbritje dënimi, kështu që doli nga burgu më 12 tetor 1965 Bëri 18 vite burg.

14. Abdulla Ali Kazazi lindi më 1884, në Shkodër. Më 1 dhjetor 1947, me vendim nr. 455, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor "Për krimin e agjitacion e propagandës kundër luftës Nacional Çlirimtare dhe pushtetit popullor" e dënoi me vdekje dhe konfiskimin e pasurisë. Në 11.3.1948 pushkatohet.

15. Lec Kurti lindi në Shkodër, 9 maj 1884 – vdes në Romë, 1948 ishte diplomat, kompozitor dhe kryetar i Ballit Kombëtar për Shkodrën. Studjoj për muzikë në Liceun e Pesaros Itali dhe në Akademinë e Arteve të Bukura në Venedik, gjithashtu studio Shkencat politike në Romë. Ka bërë karjerë në diplomacinë shqiptare të kohës. Në vitin 1942 është një ndër themeluesit e Ballit Kombëtar. Antikomunist. Me marjen e pushtetit nga komunistët aratiset e vendoset në Itali ku dhe aty vdes.

16. Jup Kazazi - lindi në Shkodër, 17 gusht 1905 – vret veten në 17 Shtator 1946 Arsimi Ekonomik, nëpunës, ministër në qeverinë e Mustafa Krujës, udhëheqës ushtarak i Ballit Kombëtar dhe organizator i Luftës së Reçit. Shkollimi fillor dhe atë të mesëm e kryen në vendlindje, të mesmen pranë Gjimnazit të Shkodrës. Vazhdon studimet e lartë në Beograd, si anti serb dëbohet e i vazhdon studimet në Torino Itali. Është një nga organizatorët e luftës së Reçit në Malë-

sinë e Madhe në gusht të 1943. Mbas kryengritjes së Postribës kundër komunistave i rrethuar nga komunistët, Jup Kazazi vret veten më 17 shtator 1946.

17. *Shefqet (Sheuqet) Muka u lind më 13 shtator të vitit 1887 në qytetin e Shkodrës vdes në janarin e vitit 1967. Rjedh nga familjet e njohura qytetare të Shkodrës. Shefqeti Muka mbaroi me rezultate të larta gjimnazin turk të qytetit (shkollë ushtarake) aty nga viti 1910. Duke parë nevojën e madhe që kishte në atë kohë për mësues, në vitin 1910-të Shefqeti u emërua në shkollat e para kombëtare që u hapën asokohe në qytetin e Shkodrës. Ka qenë mësues e drejtor shkolle për shumë vjet. Aktivist shoqëror për mbrojtjen e Shkodrës nga sulmet malazese e serbe, antikomunist. Arestohet e dënohet nga komunistët me burgim të përjetshëm ja ulin dënimin dhe ai bën 20 vjet burg.*

18. *Musa Gjylbegu lindi në Shkodër, 15 shtator 1904 - vdes në Burgun e Tiranës, 10 dhjetor 1950. Më 1927 u diplomua për Agronomi në Mynih të Gjermanisë, qe nëpunës në zyrën e statistikës në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare. Më 1941-1942 u caktua shef i statistikës pranë po këtij dikasteri. Në vitet 1942-1943 u emërua drejtor në Drejtorinë Qendrore të Statistikave pranë Kryeministrisë. Më 1943 qe inxhinier agronom pranë Ministrisë së Ekonomisë. Më 1 tetor 1943 u emërua zëvendës drejtor i përgjithshëm i drejtorisë në fjalë. U bë ministër i Punëve Botore në qeverinë e Rexhep Mitrovicës, nga 5 nëntori i 1943 gjer më 16 qershor 1944 si dhe në qeverinë e Fiqiri Dines nga 18 korriku deri më 28 gusht 1944. Pas marrjes së pushtetit nga komunistët, u dorëzua më 21 tetor 1946 duke besuar te amnista që shpallën*

komunistët. Gjykata Ushtarake Tiranë e dënoi me burg të përjetshëm, konfiskim pasurie dhe punë të detyruar. Vdes në burgun e vjetër të Tiranës më 10 dhjetor 1950.

19. *Ded Nikollën nuk gjej informacion për këtë person. Në listën e ushtarakëve që ju bashkëngjitën ushtrisë italianë në vitin 1939 nuk është.*

20. *Gjelosh Luli u lind në vitin 1912 të në fshatin Traboin të Malsisë së Madhe, kushëri me Dedë Gjon Lulit. Shkolluar për ushtarak në Torinë të Italisë. Në vitin 1940 është në shërbimin ushtarak permanent me gradën toger si pjesë e efektivit të komësorisë dhe artilerisë. Në kryengritjen që bëri Masia e Madhe kundër komunistëve është vrarë në përpjekje me forcat e ndjekjes.*

21. *Mynir Tërshana ushtarak. Në vitet e Luftës së Dytë Botërore ka qenë Prefekt në Tetovë e Shkodër. Mbas marrjes së pushtetit ngas komunistët largohet jashtë Shqipërisë*

22. *Shan Deda. Tregtar. (Skam informacion të besueshëm) Informacion më të plotë kam për Pjetër Shan Dedën, djali i Shan Dedës anti-fashist dhe anti-komunist. Ai ishte një nga organizatorët e lëvizjes së armatosur antikomuniste në Postrinë, duke mobilizuar zonën e Gurit të Zi të zhvilluar në shtator 1946. Pas dështimit të lëvizjes së bashku me gruan strehohen në male. Në dhjetor 1946 në katundin Meshkallë rrethohet nga forcat komuniste. Lufton e vritet së bashku me gruan.*

23. *Hysen (Hys) Ndraçini Lindi në Shkodër, më 16 maj të vitit 1884. Më 6 gusht 1945, Gjykata Ush-*

tarake e Shkodrës e dënoi me tre vjet heqje lirie për "Krime kundër shtetit".

24. Lec Shkreli tregtar në Shkodër.

25. Luigj Pashko Mjeda ka lindur në Shkodër në vitin 1892, ka vdekur në Shkodër në vitin 1962. Redaktor i gazetës "Ora e maleve" dënohet në periudhën Mbretërore të Shqipërisë me 9 muaj burg për shkrimet e tij. Aktivist shoqëror e politik në Shkodër. Preferenca e tij artistike aktrimi e teatri. Në 3.7.1946 dënohet nga regjimi komunist me 10 vjet burg.

26. Luigj Palok Mikeli lindi në... ushtarak grada Kolonel "Beslidhja e Shkodrës" e caktoi Kryetar i Shtabit të forcave të armatosura. Në 30 janar 1945 gjykohet nga drejtësia komuniste. Kam mungesë informacioni

27. Ramko Renkoviç (Ranko Çerenkoviç) Avokat Ndër avokatët e parë që punonin në Shkodër.

28. Naum Plevenishti besimi ortodoks. Ka qenë delegatë i Shkodrës në kongresin e dytë të Kishës Orthodhokse Shqiptare që u mbajtë në Korçë në 1929. Nuk gjej informacion ma të plotë

29. Dom Tom Laca. Klerik katolik. Studjojë për Theologji Romë Lindi në vitin 1898. Vdes në vitin 1962. Arestuar në vitin 1946 Në fillim u dënua me pushkatim pastaj ju ul dënimi në i përjetshëm. Mbas faljeve të dënimit lirohet nga burgu në vitin 1960

30. Aty nga fundi i pranverës së vitit 1944, kur forcat partizane që përbëheshin nga Brigada e VI-të, e VII-të dhe e XVII-të, nisën operacionet ndëshkomore kundra krahinës së Mirditës, Gjon Markagjoni dha kushtrimin që të mblidheshin të gjithë burrat nën

armë. Në katundin Shpal afër Katundit Gëziqe Mirditorët i bën rezistencë të ashpër forcave partizane të shumtë në luftime. Në këtë vënd vitin 1949 Komunistët pushkatuan pa gjyq mbi 14 mirditas kundërshtar të tyre.

31. Shkodra është një qytet unikal në Shqipëri për rolin e saj historik e pozicionin gjeografik: I shtrirë mes tre lumenjve (Kir, Drin, Bunë) dhe Liqenit të Shkodrës. Qyteti ndodhet vetëm pak kilometra nga deti Adriatik, e po ashtu, pak orë larg nga Alpet Shqiptare. Shkodra është një qytet mijëravjeça,. I çmuar ndër kohëra të ndryshme si nujë me rëndësi gjeostrategjike prej afërsisë mes malësive, liqenit, detit dhe rrugëve me rëndësi në kuadrin e Shqipërisë Veriore. Shkodra me zhvillimin e saj ekonomik, kulturor ka qenë dhe vazhdon të jetë e rëndësishme në ndikim në të gjithë Veriun e Shqipërisë e ma gjërë. E ky pozicionim ndikues i Shkodrës në Veriun e Shqipërisë nuk mund të kuptohet pa vlerat e elitës qytetare Shkodrane

32. Enver Bushati ka lindur në Shkodër në vitin 1912 ka vdekur në Itali në 14 Korrik 1945. Aksidentalisht është vrarë gjatë ndërhyrjes për të ndaluar një sherr midis shkokëve të tij. Studimet i ka bërë në Shkodër. Ka kryer shkollën ushtarake në Tiranë. Ka qenë pjesë e administratës së Shqipërisë. Me pushtimi e Shqipërisë nga Italia fashiste aktivizohet si anëtar i Ballit Kombëtar dhe ishte një nga drejtuesit e Degës së Shkodrës për këtë organizatë. Ka marrë pjesë në luftën e Reçit ku drejtues ishte Jup Kazazit, ka drejtuar një formacion ushtarak të Ballit Kombëtar. Një nga njerëzit aktiv të “Beslidhjes së Shkodrës” Pas marrjes së pushtetit nga komunistët në datën 27 nëntor

largohet jashtë atdheut në Itali. (Informacionin i dhënë nga nipi i tij Fatbardh Boriçi)

33. *Hafiz Tahir Kolgjini lind në Lusen Kukësaj, 24 prill 1903 – vdes në Stamboll, 12 dhjetor 1988. Ishte hoxhë, studiues, shkrimtar, poet, historian dhe nëpunës shqiptar. Ka shërbyer në Shqipëri e Kosovë. Në gusht të 1943 caktohet prefekt i Shkodrës ku shërbeu gjer në shtator 1944. Me marjen e pushtetit nga komunistët, largohet nga Shqipëria, në fillim në Itali e ma vonë në Turqi, Stamboll. Në mërgim vazhdon veprimtarinë e tij politike si anëtar i Bllokut Kombëtar Independent. Ka shkruar shumë artikuj, punime, studime në fusha të ndryshme, në gjuhë të ndryshme, me përmbytje letrare, politike, historike, kulturore e shkencore. Këto janë botuar nëpër gazeta e revista nëpër Evropë, Amerikë.*

Veprat kryesore të tij janë si më poshtë:

Shpalime rreth Lahutës së Malcís, mbi 300 faqe, Stamboll, 1969.

Esad Pashë Toptani dhe akuzat q'i bahen, Stamboll, 1977.

Të vërtetat shqiptaro-greke, (Arnavutluk ve Yunistan Gerçekleri), Stamboll, 1968. Kjo vepër u përkthye në gjuhën shqipe e ribotua në Tiranë, më 1997, me një parathënje shkruar nga Dr. Hysamedin Feri.

Fjalët turkisht në Lahutën e Malësisë, "Shëjzat", Romë, Itali, 1962.

Luma dhe luftat e saj, Stamboll, 1970.

Po vajtojmë Gjon Gjinin, Stamboll, 1979.

Poezi, Tiranë, 1993 (është vepra ku janë të përbledhuna vjershat e tij nën kujdesin e Agim Spahiut).

Tahir Kolgjini 1-8, përmbledhja e të gjitha veprave, Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, 2023.

34. Halil Selim Alia u lind më, 15 korrik të vitit 1910, në fshatin Fushë-Alie të Peshkopisë. Mbaroi Mejtepin në Kalis të Kukësit Kreu shkollën konviktore 6 vjeçare Internat Dibra, në Kastriot, të cilën e mbaroi në vitin 1929. Më 1933 kreu Shkollën Mbretnore Ushtarake, Dega Artileri, në Tiranë. Halil Alia u caktua komandant i Baterisë 75/13 në Shkodër. Në, 11 maj 1942 u zgjodh deputet i Tokave të Lirue me. Më 8 korrik 1944 u zgjodh unanimitisht kryetar i Besëlidhjes Antikomuniste, që u mbajt në Fushë-Alie me pjesëmarrjen e më shumë se 5000 burrave. Në nëndor 1944 Halil Alia ishte në Shkodër si zëvendësi i Mark Gjon Markut i forcat e armatosura të “Beslidhjes së Shkodrës” Vritet në përleshje me forcat komuniste në datën 23.12.1944 në Kolesian.

35. Kol Bib Mirak lindi në Iballe Pukë në vitin 1899, vdes në 17 maj 1968 në Itali. Arsimi Shkollën Noramale Elbasan Ka punuar mësues. Pjesmarës në grushtin e shtetit e organizuar në vitin 1924. Pjesmarës në kryengritjen e Dukagjinit. Dënohet në mungesë me vdekje. Aratiset në Jugosllavi. Në vitin 1932 amnistohet e kthehet në Shqipëri punon mësues. Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste anëtarësohet në partinë fashiste Shqiptare. Me 12 Prill 1939 është pjesë e Ansamblesë Kushtetuese për dorëzimin e Kororës së Shqipërisë Mbretit Viktor Emuele III. Më 1941 merr pjesë si drejtues i trupave të milicisë fashiste, përkrah ushtrisë italiane në luftën kundër Jugosllavisë, ku edhe plagoset. Më 1942-1943 bëhet ministër e drejtues i Partisë Nacionaliste Fashiste shqiptare. Më 1943 emërohet ministër i Brendshëm në qeverinë Bushati. Ka dhënë një ndihmë të madhe për shpëtimin e çifutëve që ndodheshin në Shqipëri.

Largohet nga Shqipëria në prag të Çlirimit. Më 1946 është ndër emrat kryesorë të Bllokut Kombëtar Independent në Romë

36. *Eqrem Mehmet Telhaj lindi në Vajzë të Vlorës 20 Gusht 1912 dhe vdiq në Itali 1999 i diplomuar në Akademinë Ushtarake të Modenës Itali, në Shqipëri ka qenë ushtarak, Prefekt i Shkodrës, nëpunës dhe anëtar i ngarkuar me Punët Botore, pas kapitullimit të Italisë ishte me detyrë në këshillin e Lartë të Shtetit. Largohet nga Shqipëria në fund të vitit 1944 dhe u vendos në Itali gjersa vdiq.*

37. *“Belidhja e Shkodrës” u formua nga paria e Shkodrës si një reagim mbrojtës në një kohë ku lufta vëlla vrasje ishte në dyert e Shkodrës e kur ushtria e nacional çlirimimtare e drejtuar nga komunistët po afrojo dhunshëm drejt Veriut duke krijuar panik, siç pohon Shueket Muka: “Beslidhja e Shkodrës u krijua, mbi nevojën e bashkimit, mbrojtja e atdheut, evitimi i vëllavrasjes, vumjen e besës për gjak. Organizata jonë ka pasur karakter lokal, dhe dojshim të mbanim larg popullin, nga vëlla vrasja, ne nuk kemi dash të merrnim pjesë në vëllavrasje, për të mos pësuar ato, që pësoi Jugu. (i Shqipërisë).*

Karakter i lokal e i izoluar në Shkodër e rrethina i kësaj organizate nuk pëlqej nga qeveria e Tiranës e drejtuar nga Rexhep bej Mitrovica, në Shkodër shkuan dy Regjentët e Shqipërisë Padër Anton Harapi e Cafo Beg Ulqini, ministri Musa Gjylbegu etj të cilët krijuan një organizatë tjetër rivale që e quajtën “Bashkimi”. Padër Anton Harapi shprehet në gjykatë” arritëm ta çkataronim këtë organizatë (“Beslidhja e Shkodrës”)

38. *Marrë nga libri me tituli “Dhimbje 5 “të autorës Fatbardha Saraçi Mulleti*

Kujtimet e Kolë Verrit për Patër Anton Harapin

Vjeshtë 1945 Brigadat e të pafeve komuniste mbasi kaluan nëpër Shalë e Shosh po i drejtoheshin Bajrakëve të Pultit duke bërë shantazhe dhe reprezalje. (Kërkonin me arrestuar Patër Anton Harapin) më 5 Dhjetor 1945 Shytan Lulashi merr Patër Harapin i cili kishte ardhur nga Shkodra e ishte strehuar në katundin Kir te frati i këtij katundi dhe e strehon në katundin Plavra të Planit. U vendos për siguri të strehohej Padër Harapi te shtëpia e Prek Marash Verri... Qëndrimi në Plavra u bë në shtëpinë tonë, sepse kulla ishte më afër malit dhe ishte mundësia më e mirë me u larguar. Na lajmëruan se po vinin forcat e ndjekjes dhe e largonim Patër Antonin nga shtëpia bashkë me bagëti në mal. Ai i veshur me gëzhup (lëkurë deleje) me një kësulë në kokë ecte mbas dhive (duke u maskuar si bari). Në janar bora kishte ngrirë dhe ishte e pamundur të dërgohej në mal Patër Anton Harapi dhe u detyruam me hap një bodrum i cili ishte si varr dhe i sikletshëm të jetoje në të, mbasi duhej të qëndroje disa orë i mbyllur në dhe (nën tokë) i mbuluar me rrasë guri dhe sipër mbuluar me pleh. Mbasi iknin forcat e ndjekjes e nxirrnim Patër Antonin nga dheu e kjo punë u përsërit sa herë që forcat e ndjekjes vinin për kontroll. Në kohën që në shtëpinë tonë erdhi Patër Anton Harapi u lajmërua dhe Frati i Planit, që në atë periudhë ishte patër Daniel Gjeçi. (u arratis dhe vdiq në emigracion, varrimi ju bë në Shkodër mbas vitit 1991 me të gjithë nderimet e duhura) Ai erdhi e takoi,

por vinte radhë. Ai i dërgoi rrobat që i nevojiteshin për të celebrue meshë në shtëpinë tonë. Në 4 Qershor 1945 forcat e ndjekjes kishin rrethuar shtëpitë ku ishte strehuar Patër Harapi, kontrolluan shtëpitë, mbasi nuk e gjetën Patër Harapin arrestuan pjestarët e fisit dhe u larguan. Patër Harapin e nxorën nga bodrumi dhe e larguan në pyll. Pjestarët e familjes i torturuan për vdekje por ata nuk treguan për Patër Anton Harapin. Në mëngjes Patër Anton Harapi ka thanë: “Due me u dorzue vullnetarisht, tue marë parasysht se nuk kam ba ndonji të keqndajatdheut dhe askujt, veçse kam predikue tanë jetën paqe dhe dashni për njerzimin” Sa u dha lajmi se Patër Anton Harapi është dorzuar, nga forcat e ndjekjes krisi pushka te Kisha e Planit dhe në të gjithë krahinën ishin shpërndarë forcat ndëshkimore komuniste. U kryen arrestime masive në fshat e përreth. Për ti dërguar në Degën e Punëve të Mbrëndëshme Patër Antonin dhe të arrestuarit e katundit në dy mushka ku te njëra vendosën Prek Marash Verrin i torturuar keq e në pamundësi të ecte në tjetrin Patër Anton Harapi si i moshuar që ishte të tjerët të lidhur me litar e të ratur keq e gjithë gjak i kanë vendosur në rrjesht duke udhëtuar mbi 10 orë në një rrugë të keqe deri në Theth ku i priste karvani i makinave për ti dërguar në degën e Punëve të brëndëshme Shkodër. Strehuesit e Patër Anton Harapit u dënuan me pushkatim, e burgosje deri 101 vjet. Klavari i vujtjeve të familjes që strehoi Padër Antonin ishte i pafund deri sa sistemi komunist kapitulloi.

39. Dhuna e sistemit komunist ishte rritur. Pushkatimet arrestimet, internimet u bënë të padurueshme . Populli reagoi. Luftime të ashpra u bënë në Koplík dhe Postribë zona të Shkodrës. U sulmua Shkodra me qëllim rrëzimi i pushtetit komunist duke shpresuar

mbështetje nga jasht. Lëvizja dështoi. U vranë pa gjyq dhjetra njerëz dhe u dogjën shtëpitë e pjesëmarrësve në revoltë.

40. Lef Nosi tregon: Në Shkodër ishin gjermanët, në Dukagjinë nuk kishte forca armate (gjermane), ma vonë erdhën nja 1000 veta shqiptarë, në katundin Kirr ku qëndroja unë. Kur partizanët erdhën në Dukagjin, unë isha në ikje e sipër, prej Shkodre erdha në Elbasan. Kur isha në Shkodër para ikjes së Gjermanëve unë s’banja takime as në Malsi. Në shtëpinë e një fashatari rinja. Me Patër Anton Harapin në vjesh-tën e tretë jemi ndarë. Në shtëpin e fashatarit hanim ushqim që hanin katundarët dhe s’vinte gjë nga Shkodra. Në famullinë e Kirrit mund të kish dijeni që ne ishim në fshat po unë nuk di, kur u ndava nga Patër Anton Harapi i thashë se nuk mund të rri më atje, për shkak se isha plak. Tjetër gjë nuk kemi folur. Kisha qëllim të dorzohesha. Kur u ktheva nuk u takova me njeri as në Tiranë e as në Elbasan.

41. Llesh Marashi, lindi në Shkodër, shkollimi ush-tarak, drejtoi në vitin 1945 kryengritjen e Malësisë së Madhe, e qatur ndryshe kryengritja e Koplikut. Kryengritja dështoi. Kalon në ilegalitet. Mbasi rretho-het e lufton në fund dorzohet. Dënohet me vdekje me varje në në Shkodër në vitin 1946.

*Fragment i marë nga shkrimi i Hamza Kazazi
“Kryengritja e Postribës”*

Në relacionin e tij drejtuar Komitetit Qëndror të partisë Komuniste në Tiranë, Spiro Pano Drejtues i Komitetin Qarkor të Partisë komuniste në Shkodër në 3.10 1946 shkruan:

Jup Kazazi në janar 1945 ka organizuar Kryengritjen e Koplikut të drejtuar nga Llesh Marashi, Preng Cali etj. kriminelë. Po kështu me 9 shtator 1946 në lidhje me kriminela të tjerë dhe organizatën e deputetëve tradhtarë të Ballit, dhe Klerin Katolik organizoi një forcë kriminelash dhe sulmoi Shkodrën për tu dhënë rast imperialistëve të ndërhyjnë në vendin t'one, por mbasi qëllimi i tija dështoi plotësisht dhe forcat ju asgjësuan. Gjindet i fshehun në një shtëpi në qytet të Shkodrës dhe vret vehten, mbasi u rrethua e s'kishte shpëtim. Kleri katolik punon në heshtje dhe në mënyrë shumë konspirative. Në kemi filluar një demaskim sistematik kundra gjithë atyre klerikëve që duan ta bëjnë kishën vatër reaksioni (në bazë të udhëzimeve që patëm nga lartë) që hedhin parulla kundra nesh dhe që mundohen ta ftohin fshatarin t'one nga pushteti. Bashkë me demaskimin kemi marrë edhe masa dhe mendojmë të godasim akoma ata priftërinj ose klerik që nuk heshtin... Organizata u udhëzua në lidhje me demaskimin e gjithë atyre klerikëve katolik e musliman (mbasi na del se edhe disa hoxhallarë kanë punuar kundra nesh të nxitur nga Kazazi me shokë) që hedhin parulla, që flasin kundra pushtetit – Goditjet e mbrojtjes këtu në qytet kanë dhënë gjer diku rezultate të mira (shumica e të arrestuarve implikohen) po akoma sot nuk kemi arritur të zbulojmë kokën drejtonjëse të këtij organizimi. Proceset vazhdojnë, merren masa të rrepta, po rezistenca që ndeshim është e madhe. Ka raste që proceset vazhdojnë 4-5 ditë rjesht (ndoshta edhe më tepër) pa mbritur në një përfundim. (d.m.th. torturat). ... Organizata është mobilizuar e tëra në mënyrë që... të demaskojë përpjekjen e reaksionit, ... të demaskojë Riza Danin, Kol Prelën dhe shokët e tyre, të shtojë informacionin

dhe të skjarojë opinionin e popullit për goditjet t'ona, në mënyrë që këto goditje të aprovohen nga masa. Goditëm rëndë në Postrisë (me pushkatime e djegie shtëpiash), ... Por bashkë me axhitacionin është nevojë dhe për masa të repta (pushkatime në vend të elementit në se kemi informata se është armik i ynë e ka armë).

*Komitetin Qarkor të Partisë
(Spiro Pano)*

42. Spiro Pano lindur më 24 nëntor 1916 në fshatin Vranishtë të Gjirokastrës, vdiq më 13 korrik 1974 në Durrës- komunist që në kohën e grupeve komuniste, zëvendëskryeministër i qeverisë shqiptare në vitet 1950-1951. Në prill të vitit 1945 drejtonte organizatën e partisë komuniste në Shkodër. Në atë kohë ai mori pjesë në përndjekjen e klerit katolik. Anëtar i KQ të Partisë së Punës së Shqipërisë

43. Dëshmitari Arif Gjyli vazhdimisht tregon historira kundra Pader Harapit që i kishte të dëgjua duke u shprehur: "...në popull u dëgjua sikur ky i kish thënë..."

44. Shaqir Omari Lindi në Shkodër ka një aktivitet të shquar kombëtar, në mbrojtjen e Shkodrës nga Malazesët 1912-1912, Në luftën e Koplikut 1920 kundër ushtrisë Jugosllave, me pushtimin e Shqipërisë nga Italia është pjestar i Asamblesë Konstituente e datës 12 prill 1939 që midis të tjerave aprovuan rezimin e Dinastisë Zogu nga Froni Mbretëror i Shqipërisë. Ofrimin e Kurorës së Shqipërisë madhërisë së tij,

Mbretit të Italisë dhe Perandor i Etopisë. Anëtar i Këshillit të Epërm Fashist 3 Prill 1940. Anëtar i partisë Indipendente. Është një nga drejtuesit e organizimit të Shkodranëve në luftë kundër komunistave. Me marjen e pushtetit nga komunistat qëndron i aratisur në male. Dënohet me burgim të përjetshëm në mungesë. Arestohet e vuan dënimin.

45. *Hiqmet Delvina lindi në Delvinë në 10 Korrik 1888 vdes në Nju Jork 1957. Arsimimi Juridik, Ka studjuar në Greqi e Stamboll, Turqi. Ka qenë jurist, nënpunës shteti, ministër. Nënkyetar Parlamenti. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste largohet nga Shqipëria së bashku me Mbretin Zog. Aktivizohet në emigracion në veprimtari kombëtare e anti-komuniste.*

46. *Lulash Gjoni, Lindi më 1910, në Shosh, Dukagjin. Më 27 shkurt 1947, me vendim nr. 62, Gjykata Ushtarake Shkodër e dënoi për “Krime kundër shtetit”, me 1 vit burg. Dënohet përsëri më 8 tetor 1953, me vendim nr. 185, Gjykata Ushtarake Shkodër e dënoi për “Tradhëti ndaj atdheut”, me 15 vjet burg dhe humbjen e të drejtës elektorale për 5 vjet.*

47. *Ndok Gjeloshi lindi në Meksh, komuna e Shalës, Dukagjin 15 nëntor 1893 – vrrarë nga komunistët me antentat në Tiranë në 11 prill 1943, ishte oficer i ushtrisë shqiptare dhe komandant i milicisë gjatë luftës së Dytë Botërore. Studioi në Kolegjin Françeskan në Shkodër dhe më pas mbaroi Akademinë Ushtarake të Modenës. Gjeloshi mbështeti Princin Wied gjatë mbretërimit të tij të shkurtër në Principatën e Shqipërisë. Përkrahës i lëvizjes politike të Fan Nolit me shokë, ai ishte pjesëmarrës në grushtit të shtetit të vitit 1924 dhe u gradua "Kapiten" i rojes kufitare.*

Pas dështimit të grushtit të shtetit ai u largua nga vendi dhe shkoi në mërgim. Në vitin 1926, së bashku me Dom Loro Cakën, prift katolik, Gjeloshi organizoi një rebelim në Dukagjin. Në emigracion ai u bashkua me emigrantin politik shqiptar në Vjenë të Austrisë dhe u bë anëtar i "Bashkimit Kombëtar", një organizatë e veprimtarëve antizog në mërgim, e cila u formua në vitin 1925 në Vjenë me iniciativën e Ali Këlcyrës, Angjelin Suma, Xhemal Bushati dhe Sejfi Vllamasi. Në vitin 1931, ai u arrestua së bashku me Aziz Çamin për një atentat kundër mbretit Zog në Vjenë të Austrisë

48. Ndue Pali Lindur në Shkodër, më 15 janar 1919. U Internua nga Italianët në ishullin e Ventotenes për 2 vjet. Anëtar i organizatës Ballit Kombëtar. Komandonte një njësi ushtarake. Arestohet nga regjimi komunist në vitin 1945 Me vendimin nr. 192, datë 20 korrik 1945, Gjykata e Lartë Ushtarake e dënon me pushkatim

49. Prof. Ardita Repishti, Istituto Storico Italiano per l'Età Moderna e Kontemporanea në studimin e saj me titull "Internimet politike të shqiptarëve gjatë pushimit Italian, profilet antifashiste gjatë luftës dhe pas saj" shkruan: Nga rreth 130 veta të dënuar në Ventotene, gati gjysma e tyre u ridënuar pas kthimit në Shqipëri dhe vendosjes së regjimit komunist. Krijimi i tablosë së plotë të shqiptarëve të dënuar në Ventotene dhe ishujt kufitarë e më gjerë në të gjithë Italinë, në qendra të ndryshme të dedikuara, Bari, (Grumo), Perugia (Colfiorito, Monte Santa Maria Tiberina), si edhe në Shqipëri, është impenjativ (përkushtim)." Me një probalitet logjik i bie që shifra e të internuar

shqiptar nga pushtuesit Italian e gjerman nuk mund ti kalojë shifrën 200-400 njerëz.

Nga studimi i profesor Teodor Kareco të vrarë nga radhët partizane gjatë luftës në Shqipëri shifra si kalon të 3800 njerëz, kjo temë ka nevojë të studjuhet shumë seriozisht nga studjuesit e historiës, spekulimi i historiografisë enveriste është në nivele banale e të turpëshme për ta. Studjuesit italian të historisë të fokusuar te pushtimit i Shqipërisë nga italia fashiste konkludojnë që Shqipëria përfitoi shumë ma tepër investime ekonomike se sa pëfitoi italia nga pushtimit i Shqipërisë.

Prof. Ksenofon Krisafi në studimin e tij për këtë temë shkruan: Konferenca e Reparacioneve e Parisit, 1945, i caktoi Shqipërisë përkatësisht 0.05 % dhe 0.35 %, të pasurive të jashtme dhe të brendshme gjermane, shumë të cilën delegacioni i saj e konsideroi të frymëzuar nga mëshira dhe jo nga realiteti. Shqipëria mori rreth një milionë dollarë dhe pothuajse po aq në objekte në natyrë, paisje, mjete etj nga çmontimi i industrive gjermane. Midis tyre bënte pjesë edhe një anije, të cilës iu vu emri “Borova”, në përkujtim të masakrës së kryer nga ushtritë naziste në fshatin Borovë, kur hynë në territorin shqiptar nga Greqia. Por ajo nuk u përdor sepse, kishte nevojë për riparime dhe u la në një nga portet e ish-Jugosllavisë, prej nga nuk erdhi fare në Shqipëri. Shifrat e reme të propogandës e ofruara në këtë dosje gjyqësore nga njerëzit e kësaj trupe gjykues janë thjesht fantazi e injorancë juridike të njerëzve me mendësi kriminale që qëllim nuk kishin

drejtësinë por dënimin e kundërshtarëve politik të tyre.

50. Akademik Beqir Meta - Dr. Ermal Frashëri

Pas vendimeve të marra në dhjetor 1944, një sërë urdhëresash detyruan një kategori të caktuar njerëzish: pronarë tokash, tregtarë, ish-politikanë të largohen nga qytetet kryesore të Shqipërisë si: Tiranë, Durrës, Korçë, Shkodër etj. dhe të jetonin në zona të tjera të vendit. Këtyre individëve u hiqej e drejta për t'u ktyer në shtëpitë e tyre, të cilat u konfiskuan dhe e përdorën për të strehuar zyrtarë të regjimit të ri, familje të dëshmorëve të lëvizjes nacional çlirimtare etj. Që prej vitit 1945, filloi të përdorej internimi si një masë tjetër ndëshkimore ndaj kundërshtarëve politikë. Të dhënat më të hershme që kemi për zbatimin e kësaj mase i takojnë shkurtit të vitit 1945, kur Mehmet Shehu porositi të internohen personat që strehojnë të arratisurit në male, apo “Kriminelët e luftës”, si dhe ata që nuk pranonin të dorëzonin armët. Në dosjen që përmban këto urdhra, jepen edhe emrat e banorëve të Malësisë së Shkodrës, Pukës e Mirditës të cilët janë internuar. Sipas këtyre dokumenteve, internimet nuk janë kryer duke u bazuar në një ligj të posaçëm. Ato kanë shërbyer si mjet dhune dhe presi- oni, me qëllimin e vetëm për të nënshtruar banorët e Veriut të cilët nuk ishin mbështetës së qeverisë provi- zore të E. Hoxhës. Një tjetër kategori që u internuan që në fillimet e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, ishte ajo e familjeve të personave që ishin dënuar si “Kriminelë lufte”. Nga kërkimet e deritani- shme nuk gjenden shumë të dhëna për vendimet e internimeve të tyre, por dëshmitë e shumë prej tyre e vërtetojnë se ata janë dërguar në kampe internimi që

prej vitit 1945. Në një analizë të përgjithshme vitet 1945-1949 kanë qenë vitet më të rënda të zbatimit të këtij sistemi, për shumë arsye: Së pari, në këto vite funksiononte sistemi i kampeve të internimit të rrethuar me tela me gjemba, shumë të ngjashme me konceptin e kampeve të përqendrimit. Territori ku ishte shtrirë kampi ishte një vend i rrethuar me tela me gjemba i ruajtur nga anët kryesore me roje të armatosura. Kampet ishin të përshtatura në godina të vjetra, si depo repartesh, magazina ose baraka të përshtatura. Duke qenë se të gjitha këto kampe, nuk ishin të ndërhuara për të strehuar familjarë, por ato u përshtatën me shpejtësi si kampe grumbullimi apo përqendrimi, siç shprehej Enver Hoxha shpesh në mbledhjet e Byrosë Politike, kushtet elementare të jetesës, ushqimi, fjetja, higjiena, linin tej mase për të dëshiruar. Që prej marsit 1945, deri më 1949, ishin dy kampe të kësaj natyre, në Berat dhe në Krujë. Si rregull, të internuarit nga Veriu dërgoheshin në kampin e Beratit dhe ata të Jugut në Krujë. Kjo ishte një taktikë e mirëmenduar, pasi shmangte familjaritetin që mund të krijohet midis të internuarve dhe rojeve të kampit. Njëkohësisht kjo gjë krijonte vështirësi për familjarët e të internuarve të kujdeseshin për ta dhe t'u siguronin ndonjë mundësi më shumë për ushqimin dhe higjenën.

51. “Terrorizmi në parti, në popull, në ushtri, – dëshmon Sejfulla.Malëshova, – tregon së pari dobësinë e vijës sonë politike; e dyta, mosbesimi që kemi në popull; e treta, që nuk kemi lidhje me masat. Me terror i zgjidhnim të gjitha. Nuk u çudita kur më thanë se sa më terrorist të ishte njeriu, aq më komunist ishte. Kështu duken simptomat e degjenerimit nga një

parti politike në një bandë kriminelësh". (AQSH, Fondi 14, D.2/a, v.1944.) "Shumë njerëz janë vrarë pa gjyq e pa faj... Këtë frymë e ka futur Dushan Mugosha. Kështu, sot ushtria duket sikur ka dalë të mbysë popullin. Partizanët vrasin vetë, pa i vënë fare njerëzit përpara gjyqit" – Tuk Jakova. (AQSH, F.14/AP d.2/a v.1944.)

* Rrahje me dru, shpim i mishit me tel të djegur, futja e kripës në mish, lënia në ujë të ftohtë, lënia pa bukë deri në vdekje, varje me kokëposhtë, shtrëngimi i gjinjve me pinca, maçoku në tumane, mbushja e gojës me kripë , futja e jashtëqitjes në gojë...

Kjo listë e hartuar nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) në Shqipëri, bazuar në një dokumentacion të gjerë arkivor dhe dëshmi gojore nga ish të persekutuar, cilësohet si lista zyrtare e torturave të përdorura gjatë regjimit komunist nëpër qelitë e hetuesive, zyrat e ish Sigurimit të Shtetit dhe rrethana të tjera represioni, gjatë viteve 1945-1991 në Shqipëri

52. Komunizmi shqiptar vuri në praktikë një shtypje sistematike, deri në ngritjen në momentet kulmore të terrorit si mënyrë qeverisje. Rregjimi komuniste për të mbajtur pushtetin e tyre, ngritën krimin në masë në një system të vërtetë qeverisje, e gjithë shteti u perfeksionua në ushtrimin e një shtypjeje të përditëshme përmes një demagogjie ekstreme e çensure të plotë të të gjitha mynyrave të komunikimit e eliminimit të desidentëve. Terrori e dhuna kanë qenë që në fillim një nga tiparet themelore të enverizmit, si një formë e deformuar e barbare e komunizmit.

“Latzin, një nga shefat kryesor të Çeka-s (policia politike sovjetike) në derektivat që i dha punonjësve të tij tha: Ne nuk bëjmë luftë kundër një njeriu të veçantë. Ne do të zhdukim borgjezinë si klasë. Mos kërkonit gjatë hetimeve, dokumente dhe prova mbi atë që i akuzuari ka bërë, me vepra apo me fjalë kundra shteti sovjetik. Pyetja e parë që ju duhet ti drejtoni është se cilës klasë i përket, cila është origjina e tij, edukata e tij, shkolla e tij, profesioni i tij.”

** Komunistët shqiptarë kishin vendosur të eleminonin ligjërish, por dhe fizikisht, çdo opozitë dhe çdo rezistencë, bile dhe pasive, ndaj pushtetit të tyre hegjemon, jo vetëm kur ky ishte si rezultat i një grupi kundështar politik, por dhe grupeve sociale, parisë së vendit, borgjezia, inteligjenca, drejtuesit krahinor e fisnor, njerëzve të fesë e gjithkujt që ata e amendonin si kundërshtarë të tyre.*

52. Marshalli Pilippe Petain ishte një gjeneral fitimtar që komandoi ushtrinë franceze në luftën e Parë Botërore. Në luftën e Dytë Botërore mbas humbjes katastrofike të Francës nga ushtria gjermane u vu në krye të një qeverie me qëndër në qytetin Vichy në Francën Jugore Qëndrore, bashkëpunoi me gjermanët. Në 24 tetor 1940 Petain takohet me Hitlerin. Shumë hebre francez u persekutuan dhe u dërguan në Gjermani. Kur Franca u çlirua Petaini u dënua me vdekje. Gjenerali de Gaulle si president i Francës ja ktheu dënimin në burgim të përjetshëm. Ai vdiq në vitin 1951. Një figurë që në Francë dhe sot shihet me dy standarte një pjesë e quaj në tradhëtar e një pjesë e vlerësojnë për arritje e tij në luftën e Parë Botërore,

dhe shmangjen e dëmeve të mëdha që do përjetonte Franca gjatë pushtimit nazist.

53. Pjesë nga rrëfimi i Ali Këlcyrës botuar nga Historiani Erald Kapri:

Organizata Bashkimi Kombëtar

Në dhjetor të vitit 1924, pothuaj 1200 kundërshtar të Ahmet Zogut ikën në ekzil, Në Brindisi, u mbloodhën liderët kryesorë të këtyre emigrantëve për të vendosur mbi politikën që do të ndiqej në emigracion. Një pjesë zgjodhi Vjenën si vendin e tyre për t'u vendosur dhe morën emrin "KONARE" (Komiteti Nacional Revolucionar). Grupi i tjetër u njoh me emrin "Bashkimi Kombëtar". Komiteti Qendror i "Bashkimit Kombëtar" u përbë nga katër persona; Sotir Peci ish-regjent, Xhemal Bushati ish-ministër, Angjelin Suma ish-drejtor i Përgjithshëm dhe Ali Këlcyra ish-deputet. Organizata deri në vitin 1926 ka qëndruar në Bari të Italisë. Qeveria italiane, pavarësisht premtimeve formale që na bëri, kërkoi të na ndalojë lirinë e të vepruarit. Në vitin 1927 "Bashkimi Kombëtar" largohet nga Italia. Në fillim, shkuan në Beograd dhe Athinë, duke mos gjetur mirëkuptim u vendosën në Vjenë. Pas tentativës për vrasjen e Zogut që u bë nga anëtarë të kësaj organizate u detyrua nga autoritetet Vjeneze që të zhvendoseshin në Paris. Në Vjenë, organizata KONARE u shpërnda. Komiterni dëshironin që organizata të kthehej e gjitha në komuniste dhe të vihej në shërbim të tyre për revolucionin botëror. Shumë prej anëtarëve të saj u larguan nga KONARE e u bashkuan me organizatën "Bashkimi Kombëtar".

* *Kur u bë e ditur marveshja që u titullua “Boshti mes Romës dhe Berlinit”, organizata i dërgoj telegram qeverisë së Beogradit e Athinës për solaridet kundër këtij boshti thirja nuk u morën në konsideratë. Në fundi i vitit 1938, Mustafa Kruja, një njeri me konfidencë (që ka besim, i sigurtë) për Pallatin e Chigit, shkoi në Paris duke ju thënë: “Roma kërkon që të arrijë një marrëveshje me organizatën tonë. Ajo premtion që nëse do të vendoset një sovran i Shqipërisë, një princ nga Savoja dhe nëse e mbështesim këtë projekt, atëherë premtion se do të na kthehet e gjithë fuqia politike dhe ekonomia që kishim para regjimit të Mbretit Zog, me një Parlament të lirë që mund të kishte të zgjedhurit e vet, si dhe mundësinë e rishikimit të kufirit me Jugosllavinë në favor të Shqipërisë, në akordancë (marveshje) me parimet që u vendosën nga Konferenca e Mynihut në vitin 1938”. Ne e pranuan këtë propozim pasi dukej si favorit për interesat e vendit tonë, nga çdo lloj pikëpamje, gjithnjë nga pikëpamja e situatës ndërkombëtare të kohës. Mbas pushtimit të Shqipërisë nga Italia anëtarët e kësaj organizate u kthyen në Shqipëri në shtator 1939. Disa javë pas ardhjes sonë së bashku me Mit’hat Frashrin, Fuat Dibrën, Hasan Dostin, Nuredin Vlorën, Faik Qukun, Kol Tromarën, por dhe të tjerë formuan një organizatë të re që e quajtën “Balli Kombëtar”. Ali Këlcyra*

54. *Të kuptosh Padër Anton Harapin dhe vendimin e tij për të marrë pjesë në Regjencë, kur ishte i vetëdijshëm që Gjermania e kishte humbur luftën, kur Shqipëria ishte në prag të një lufte vlla-vrasje ai me besim e shpresë u mundua të na japë një model të tijën duke kombinuar shpirtin dhe jetën e duke mbajtur gjallë amanetin e etërve të tij shpirtëror.*

Duhet të kuptojmë në radhë të parë që fraçeskanët nuk ishin e nuk janë ca të huaj në realitetin tonë shqiptar, ata nuk ishin e nuk janë një realitet në vete por ishin të ngurtësuar në një lidhje spiritualiteti misionar me rrjedhën historike të kombit të tyre. Ai me vendimin e tij na tregon se është tipiku i konceptit të Krishtërimin ku sakrificat mbajnë gjallë shpresat që janë në zemrat tona

Literatura shtesë e cituar:

Një falenderim të veçantë për Zotin Tanush Mulleti, që nuk është më mes nesh, falë informacioneve e dijeve të tij të pa fund, të ndihmës së pa përtueshme duke mos u bezdisur nga pyetjet e mia në kohë e pa kohë u bë e mundur shkrimit i këtij studimi.

1. Ali Këlcyra “Organizata Bashkimi Kombëtar”
2. At Zef Pllumi “Fraçeskanët e mëdhaj” (2002)
3. Chimène Keitner, Profesore e Drejtësisë në Universitetin e Kalifornisë, “Konventa e gjenocidit”
4. “Ditari i komandës supreme Gjermane”.
5. De Matei “Persekutimi i egër komunist kundër krishterimit”
6. Dr. Gjon Boriçi “Kleri katolik shqiptar si imazhi simbol i perceptimit të armikut të popullit nga dik-tatura komuniste në Shqipëri”
8. Dr. Mirela Sinani “Studim dosja gjyqësore-hetimore e Maliq Bushatit, Patër Anton Harapit, Lef Nosit”
9. Dr. Dom Nik Ukgjini: “Kisha Katolike në trevat shqiptare nga shek. XI deri sot”

10. Dixon W. McCorquodale, 2010 “Sovraniteti i shteteve”

11. Dosja gjyqësore-Hetimore A-1086

12. Fatbardha Saraçi Mulleti libri “Dhimbje 5” Kujtimet e Kolë Verrit për Patër Anton Harapin

13. Hasan Bello “Kisha dhe kleri në periudhën e pushtimit italian (1939-1943)”

14. Herman Nojenbaher “Institucionet gjermane për historinë shqiptare 1941-1944.

15. Historia e Françeskanëve

16. “Historia e Bankës Qëndrore në Shqipëri periudha 1943-1944”

17. Internimet politike të shqiptarëve gjatë pushtimit italian, profilet antifashiste gjatë luftës dhe pas saj”. Ardita Repishti.

18. “Jetshkrimi” i Ministrit të Mbrojtjes Gjeneral Mirdach

19. John Rwëls “Teoria e drejtësisë”

20. Kolaboracionizmi francez 1940-1944 pa autor

21. Krimet naziste në Geograd e Athinë wikipedia

22. Kujtime të dr. Martin B. Schliep Ministria për Europën dhe punëve të jashtëme arkivi historik-diplomatik

23. Kujtimeve të ish veteranit të LANÇ Hysen Ali-bali

24. Kolaboracionizmi francez 1940-1944 pa autor

25. Krimet naziste në Geograd e Athinë wikipedia

26. Kujtime të dr. Martin B. Schliep Ministria për Europën dhe punëve të jashtëme arkivi historik-diplomatik

27. Kujtimeve të ish veteranit të LANÇ Hysen Ali-bali

28. “Kolaboracionistët e fashizmit” Hary Fullc (Shef i zyrës për Shqipërinë Shërbimi i Inteligjencës Amerikane gjatë luftës së Dytë Botërore.

29. Letra e Kol Bib Mirakës e viti 1967, ish Sekretar i Partisë Nacionaliste Fashiste Shqiptare, drejtuar Abaz Armenin si kryetar i partisë Agrare në emigracion

30. Marshall Pétain (1856 - 1951) wikipedia

31. Mërgim Korça “Fjalimi i Shkëlqesisë Patër Anton Harapi O.F.M.”

32. Mësimdhënja e Historisë Moderne të Europës Juglindore gjatë Luftës së Dytë Botërore

33. Musa Shaqir Gjylbegu dosja gjyqësore-hetimor

34. Nga Hamza Kazazi “Kryengritja e Postribës dhe Jup Kazazi në dokumentet arkivore, provat që zbardhin të vërtetën”

35. Nikollë Loka Nikolin Kurti Autorë i librit “I Lumi Dom Shtjefën Kurti, Dëshmitar i Kishës Martire”

36. Padër Anton Harapi “Nji kushtrim për kulturë”

37. Proçesë verbali i mbajtur në mbledhjen e Asamblesë Konstituene 12 prill 1939

38. Prof. Ksenofon Krisafi “Shqipëria dhe reparacioneve të luftës me Gjermaninë”

39. Rakip Beqaj “Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik shqiptarë”

40. Revista “Hylli i Dritës”

41. Romeo Gurakuqi studim i dokumentit të vitit 1939 me titull Konsiderata të përgjithshme mbi politikën shqiptare”.

42. “Shqipëria nën pushtimin gjerman” wikopedia

43. “Tokat e Lirume Studim” Astrit Jegeni

44. Viktor Emanueli III (italisht: Vittorio Emanuele III; 1869-1947) Wikipedia

45. 4 Shkurti 1944 Astrit Jegeni

***Çdo njeri që përdorë pjesë nga ky shkrimi
duhet të përmënd autorin. Faleminderit***

Tiranë, Janar 2025